



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E**  
**PËRGJITHSHME TË TATIMEVE**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**NË**

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE**

**“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”**

**Shtator, 2022**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>3-13</b>
	a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
	b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimet	3-10
	c. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	10-13
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>14-16</b>
	1. Objekti i auditimit	14
	2. Qëllimi i auditimit	14
	3. Identifikimi i çështjes	14-15
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	15
	5. Përgjegjësitë e audituesve	15
	6. Kriteret e vlerësimit	15-16
	7. Standardet e auditimit	16
	8. Metoda e auditimit	16
	9. Dokumentimi i auditimit	16
<b>III.</b>	<b>PËRSHRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>17-224</b>
	1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	17
	2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	17-224
	2.1.Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm	18-34
	2.2.Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.	34-43
	2.3. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.	43-66
	2.4. Mbi deklarin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH.	65-72
	2.5. Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.	73-83
	2.6. Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale.	84-134
	2.7. Auditim i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare.	134-176
	2.8. Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion.	176-196
	2.9. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallrave dhe shërbime.	197-198
	10. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm.	198-218
	11.Auditimi i çështjeve të tjera të cilat mund të rezultojnë gjatë auditimit	218-224
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>225-245</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>246-252</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 20/1, datë 14.01.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.01.2022 deri më datën 13.05.2022, në Institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) u krye në terren auditimi i ÷Përputhshmërisë.

Auditimi mbuloi periudhën: prej 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm, përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, si Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë së Kontrollit Tatimor; Drejtorisë së Hetimit Tatimor; Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH; Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, hartimin e pasqyrave financiare, marrëdhëniet e punës dhe pagat, planifikimi dhe zhvillimin i procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt verifikim dhe 15 akt konstatimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit, brenda afatit të periudhës së auditimit në terren.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe Projektraportin e Auditimit dhe janë marrë në konsideratë observacionet, të cilat janë të gjetur të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion argumentues shtesë. Problematikat e evidentuara sipas çështjeve të auditimit gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar.

### I.b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi konstatohet se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën rreth 122,468 milion lekë që i përket një numri prej 168,851 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 134,935 milion lekë që i përket një numri prej rreth 192,701 subjektsh debitorë. Pra, nga krahasimi i situatës në fund të vitit 2021 me atë të fillim vitit, rezulton një rritje prej rreth 12.5 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 23,850 të numrit të debitorëve të shtuar në fund të vitit. Krahasuar me një vit më parë (ku rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2020 në 21.12.2020 ishte me rreth 5.4 miliard lekë dhe 17,609 subjekte debitorë) kjo rritje paraqitet e konsiderueshme, si në drejtim të vlerës së detyrimeve të papaguara, ashtu edhe në numër subjektsh debitorë. Krahasuar me vitin paraardhës, gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2021 rezulton <b>12,467 milion lekë më shumë të vlerës së detyrimeve dhe me një rritje prej</b>	<b>Pika 2.3 Fq 43-65</b>	<b>E lartë</b>	DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masat për të luajtur një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit dhe marrjen e masave konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar për uljen e borxhit tatimor, i cili gjatë periudhës objekt auditimi paraqitet me një trend rritës. Titullari i DPT të marrë masat për të siguruar nga DRT-të informacionin analitik lidhur me subjektet debitorë, që i përket të dhënave statistikore të raportuara në total nga këto struktura pranë DMDTP, në mënyrë që të kryhet

	<p><b>23.850 të numrit të subjekteve debitoare.</b>  Nga auditimi konstatohet gjithashtu se <b>stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mblidhet) veçanërisht nga subjektet që administrohen nga DRT Qendror ku vlera e detyrimeve të shtuara është rreth 2 fish më shumë se e atyre të pakësuara.</b>  Me rritje rezultojnë edhe numri i subjekteve debitorë në proces gjyqësor, i cili deri në fund të vitit 2021 paraqitet në 1,592 subjektsh me një vlerë prej rreth 14,298 milion lekë të detyrimeve të papaguara, pra rreth 130 subjekte më shumë se një vit më parë, dhe me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuara në gjykatë prej rreth 576 milion lekë më shumë. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve, situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuara prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,142 subjekte, ndjekur nga DRT VIP me rreth 3,138 miliard lekë për 96 subjekte.  Gjithashtu, rezulton se evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike, gjë e cila nuk mundëson kryerjen e analizave të detajuara në nivel DRT-je, ku edhe në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për të dhënat analitike të detyrimeve tatimore të papaguara në rang subjektsh debitorë/tatimpaguesish sipas vlerave respektive të këtyre detyrimeve, me qëllim analizimin e subjekteve që përbëjnë edhe pjesën më të konsiderueshme të këtij stoku, ky informacion nuk u vendos në dispozicion përgjatë periudhës së auditimit në terren.</p>			<p>një analizë më e hollësishme nga ana e drejtorisë lidhur me numrin e subjekteve që përbëjnë stokun më të lartë të detyrimeve të papaguara; implementimin e masave shtrënguese nga ana e tyre, duke nxjerrë përgjegjësinë e zyrtarëve përkatës në këtë drejtim.</p>
2	<p>Nga auditimi rezulton se, pavarësisht realizimit bruto të të ardhurve nga tatimet në masën 103.3 % kundrejt planit, të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për shumën 7,134,393 mijë lekë, ose janë arkëtuar më pak në masën 4.7 %, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor, konkretisht:  - Për vitin 2021 të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore, në terma bruto u realizuan në shumën 54,461,470 mijë lekë, ose në masën 93.4 % të planit, me një mosrealizim në shumën 3,848,530 mijë lekë, ndërsa të ardhurat në terma neto, janë realizuar në shumën 30,359,348 mijë lekë nga shuma 41,310,000 mijë lekë që ishin programuar, pra me një mosrealizim në vlerë prej 10,950,652 mijë lekë, ose 26.5 % më pak. Ndikim në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat ka patur jo vetëm mosarkëtimi i të ardhurave nga TVSH e krijimi i detyrimeve të reja, si ndikim i dy fenomeneve ( tërmetit të vitit 2019 dhe Covid 19), por dhe tejkalimi i planit të rimbursimit me 42% të tij.  - Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 14,215,000 mijë lekë dhe janë arkëtuar 13,429,960 lekë, me një mosrealizim prej 785,040 mijë lekë ose 5.5 % më pak, ndërsa të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, nga vlera 20,500,000</p>	<p><b>Pika 2.2</b>  <b>Fq 34-43</b></p>	<p><b>E lartë</b></p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre lloj të të ardhurave, përfshirë dhe çështjet e planifikimit, me qëllim marrjen e masave për arritjen e objektivave të institucionit dhe shmangien e situatave të tilla në të ardhmen.  Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim saktësimin e vlerës së të ardhurave gjithsej dhe atyre tatimore në mënyrë analitike sipas llojit të tatimeve/taksave të shprehur në raportimet e DPT-së</p>

	<p>mijë lekë të programuara, janë arkëtuar në shumën 19,706,202 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 793,798 mijë lekë, ose 3.9 % me pak, në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 137/2020, datë 16.11.2020 për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar, si dhe shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi planin e të ardhurave tatimore.</p> <p>Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe të raportimit të të ardhurave tatimore konstatohet se, raportohen si të ardhura gjordat e vendosura nga sistemi tatimor gjatë vitit 2021 në shumën 633,826 mijë lekë, ndërsa sipas klasifikimit ekonomik gjordat që lidhen me tatimet dhe taksat përfshihen në titullin e të ardhurave jo tatimore, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.</p>			
3	<p>Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është <b>programuar në shumën 17,000,000 mijë lekë</b>, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është <b>realizuar në shumën 24,100,604 mijë lekë</b>, duke rezultuar <b>me tejkalim në shumën 7,101,604 mijë lekë</b>, ose <b>42%</b> më shumë kundrejt planit të rimbursimit.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se në 7 Drejtori Rajonale është tejkualuar plani i rimbursimit, konkretisht: në DRT Tiranë, DTM, Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë dhe Vlorë, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale 7,596,852 mijë lekë, ose ka tejkualuar fondet e parashikuara për rimbursimin e TVSH-së, ndërsa 7 DRT nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për shumën 496,248 mijë lekë.</p> <p>Referuar sa më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën 16,651,143 mijë lekë, ose 69 %, të totalit të realizimit faktik në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën 158.6% e ndjekur më pas më DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 2,816,584 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 142%, ose e ka tejkualuar atë në shumën 831,854 mijë lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar, neni 14; ligjin nr. 137/2020 për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.</p>	<b>Pika 2.5, Fq 73-83</b>	<b>E lartë</b>	<p>Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se mund të procedohet me kryerjen e pagesave, në bashkëpunim me MFE, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve të rimbursimit.</p>
4	<p>Drejtorja e Rimbursimit të TVSH-së me shkresën nr. 1293 prot., 27.01.2022 <u>ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit në shumën 476,650 mijë lekë</u> në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2021, në zbatim të Udhëzimit nr. 8, të MFE për përgatitjen e pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendrore.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, rezultojnë <b>69 kërkesa</b> për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa</p>	<b>Pika 2.5, Fq 73-83</b>	<b>E lartë</b>	<p>Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit</p>

	miratuara në vlerën totale për <b>1,893,609 mijë lekë</b> , të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, òRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore, pika 1, dhe VKM nr. 953, datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4. <b><i>Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit më 31.12.2021 sipas vlerësimit tonë më së paku është 2,370,259 mijë lekë.</i></b>			të TVSH-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore.
5	Nga përgjigjet e pyetësorit të dhënë Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, rezulton se nuk janë identifikuar individët me të ardhura personale të padeklaruara dhe të pa tatuara për të gjitha burimet e të ardhurave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Informacioni është mbledhur nga TIK (brenda sistemit tatimor), për deklarin e DIVA, ndërsa vlerësimi i riskut është kryer sipas metodologjisë së përcaktuar në manual. Procedimi në këtë mënyrë vlerësojmë se është jo korrekt, sepse risku i lartë i evazionit në deklarin dhe fshehjen e të ardhurave nuk është brenda sistemit tatimor, por jashtë tij. Për vitin 2021 nuk ka patur urdhra pune, nuk janë kryer intervistime, nuk kanë rezultuar raste për ti përcjellë në DRT përkatëse për vlerësimet tatimore, nuk janë krijuar profile për individët bazuar në informacionet e mbledhura, si dhe dosje për secilin, por janë dërguar disa formular tip për individët me të ardhura të larta dhe deklarues të DIVA 2020, kjo sipas problematikave të identifikuar, me qëllim nxitjen e përmbushjes vullnetare të detyrimit për deklarin. Nga sa është konstatuar, arrijmë në konkluzionin se Drejtoria e Kontrollit të Specializuar nuk e ka përmbushur misionin e krijimit të saj, duke qenë një strukturë jo efiçente në përmbushjen e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i fushës, ku shkak kryesor i kësaj situatë është mungesa e akteve ligjore dhe nënligjore për të operuar normalisht në funksion të qëllimit të krijimit të kësaj drejtorie.	<b>Pika 2.6, Fq 84-134</b>	<b>E lartë</b>	DPT të marrë masa për hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim vijimin normal të punës në përmbushje të misionit dhe objektivit të krijimit të kësaj drejtorie.
6	Nga auditimi i dosjeve me akt konstatime dhe procesverbale gjobash të mbajtura në lidhje me raste rastet e shkeljeve: 5 dosje " <i>Mallra pa faturë</i> ", 10 dosje " <i>Moslëshim i kuponit tatimorë- rasti i parë</i> " dhe 5 dosje ò <i>Punonjës i padeklaruar biznesi i vogël</i> ", të mbajtura në vitin 2021, kanë rezultuar problematikat si mëposhtë: - Raste kur nuk është mbajtur procesverbal i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumente tatimore; - Raste në akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve ku citohet se " <i>në pamundësi verifikimi nga sistemi verifikohet nga zyra</i> ", pra në këtë rast nuk është përdorur programi " <i>E-Inspektor</i> " sipas përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe	<b>Pika 2.6, Fq 84-134</b>	<b>E lartë</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave për mos përsëritjen e parregullsiave të konstatuara nga grupi i auditimit të ngrejë një grup pune për rishikimin e akteve të

	<p>Koordinimit në Terren;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raste në akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve ku nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen;</li> <li>- Raste ku nuk është lëshuar faturë tatimore ose faturë e thjesht tatimore për të dokumentuar mallin e gjetur të pashoqëruar më dokumentacion tatimor;</li> <li>- Ka rezultuar se sipas akt konstatimeve në disa raste subjekti nuk ka në përdorim dokumentacion dhe duhet të ishte kryer penalizimi i subjektit sipas nenit 118 “Mosmbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</li> <li>- Në disa akt konstatime nuk janë shprehur n.q.s ka pasur të afishuar apo jo listë të çmimeve të produkteve. Dhe n.q.s nuk i ka të afishuara çmimet, të kryej penalizimi sipas nenit 130 “Mosafishimi i çmimeve të shitjes” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</li> <li>- Në disa raste inventarizimi i mallit gjendje është kryer gabim nga ana e inspektorëve sepse nuk janë fiksuar faturat e fundit të shitjes dhe blerjes.</li> <li>- Raste kur është mbajtur vetëm akt-konstatimi në lidhje me shkeljen e “Moslëshim të faturave tatimore” dhe nuk është mbajtur procesverbal gjobe për këtë rast, si dhe nuk është bërë verifikimi n.q.s subjekti e ka shkelje për herë të parë apo të përsëritur;</li> <li>- Në disa raste në akt konstatim dhe proces verbal nuk evidentohet afati ligjor 15 ditor për vendosjen e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit dhe më tej zhblokimi aktivitetit të tatimpaguesit;</li> <li>- Nuk janë bërë verifikimet në sistem nëpërmjet programit “E-Inspektor” n.q.s shkeljet janë rast i përsëritur apo jo;</li> <li>- Nuk është bërë përshkrimin e mallit/produktit/shërbimit për të cilin nuk është lëshuar kuponi tatimor në momentin e verifikimit;</li> <li>- Nuk janë bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit ÷E-Inspektorë listëpagesën e subjektit me pretendimin se nuk punonte sistemi C@ts;</li> <li>- Nuk janë bërë verifikimet e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore;</li> <li>- Nuk janë marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat;</li> <li>- Janë tejkalluar vazhdimisht afatet e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash.</li> </ul>			<p>mbajtura nga inspektorët e DVKT për vitin 2021.</p>
7	<p>Nga auditimi konstatohet se nga Drejtoria e Kontrollit nuk janë përfunduar kontrole nga viti 2015, pasi deri në fund të dhjetorit të vitit 2021 janë gjithsej 678 kontrole të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në 278 kontrole të pa filluara nga administrata tatimore janë përfshirë edhe kontrollet e planifikuara për muajin Dhjetor 2021, të cilat u janë nisur njoftimi për kontroll, kjo bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në RSHö, i ndryshuar dhe Udhëzimit në mbështetje të</li> </ul>	<p><b>Pika 2.6, Fq 84-134</b></p>	<p><b>E lartë</b></p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e përfunduar me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të gjitha drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislativës</p>

	<p>tij, neni 81.1/1;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 14 kontrolle janë të pezulluar;</li> <li>- 291 kontrolle janë në fazë projekt raporti;</li> <li>- 87 kontrolle janë në fazën e raportit përfundimtar.</li> <li>- 1 kontroll është në fazën e evadimit.</li> </ul> <p>Konstatohet se kontrollet e mësipërme janë jashtë afateve përkatëse të kryerjes së kontrollit, projekt-raportit, raportit përfundimtar apo dhe evadimit.</p>			tatimor.
8	<p>Gjatë vitit 2021, ATQ ka hartuar planin e nevojave për rekrutim, nga ku i ka përcjellë DAP nevojën për plotësimin e 130 vendeve vakante. Nga këto 130 vende vakante, DAP ka shpallur 62 prej tyre, ku vetëm 44 janë plotësuar me fituesit e shpallur. Vihet re se, përgjatë gjithë vitit ka patur vende vakante të paplotësuara për një kohë të gjatë, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, u konstatuan ndryshime të shpeshta të stafit, situatë kjo që mbart riskun për cënimin e funksionimit e drejtorive të ndikuara nga këto situata për shkak të kapacitetit jo të plotë të stafit aktual.</p> <p>Përgjatë vitit 2021, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në strukturat përkatëse të tyre në Rajonet Qendrore, Veriore dhe Jugore, vihet re një nivel i lartë i ndryshueshmërisë së punonjësve përmes Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve òLirim dhe emërim në detyrë. Për vitin 2021, është konstatuar se vetëm në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT dhe strukturat e hetimit në DRT ka patur 6 lirime dhe emërim në detyrë, si dhe 5 largime nga 60 gjithsej punonjës. Ndërkohë në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në struktura përkatëse në DRT ka patur 9 lirime dhe emërim në detyrë, dhe 10 largime përgjatë vitit 2021, nga 24 punonjës gjithsej. Gjithashtu, konstatohet se strategjia menaxheriale dhe plani operacional për rekrutim nuk është hartuar për punonjësit, marrëdhënia e të cilëve rregullohet përmes Kodit të Punës, por është hartuar vetëm planifikimi i vendeve vakante për punonjësit e shërbimit civil që është përcjellë në DAP, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 të nenit 72 të Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore.</p>	<b>Pika 2.8, Fq 176-196</b>	<b>E lartë</b>	<p>Titullari i DPT, në bashkëpunim edhe me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020.</p> <p>Drejtori i DBNJ të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për të minimizuar lëvizjet e shpeshta brenda strukturave, që do të cënonin mbarëvajtjen e punës dhe efektivitetin e tyre.</p>
9	<p>Gjatë vitit 2021 nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në mënyrë të pa drejtë, në vlerën <b>186,466,238 lekë</b>, për 196 punonjës, për periudhën 2005-2021, të paguara në dy këste, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar proceset gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve nga puna ka qenë i pa rregullt dhe nga institucioni i DPT nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për këtë proces. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të proceseve</p>	<b>Pika 2.8, Fq 176-196</b>	<b>E lartë</b>	<p>Titullari i DPT të marrë masa për evidentimin e arsyeve të largimeve të padrejta nga puna me qëllim përmirësimin e procedurave të kryera gabim duke sjellë kështu minimizim të shpenzimeve gjyqësore në të ardhmen dhe përdorim me efektivitet të fondeve buxhetore.</p>



	<p>gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga DPT në proceset e largimit të punonjësve nga puna.</p>			
10	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit, konstatohet se, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për vitin 2021 janë lëshuar për tatimpaguesit 1180 autorizime për përjashtimin nga TVSH për procesin e rindërtimit dhe që i përkasin 581 NIPT-eve. Nga Grupi i Auditimit u përzgjedhën për auditim autorizimet e lëshuara në muajt Prill dhe Nëntor 2021, gjithsej 153 autorizime (sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p> <p>Nga auditimi i këtyre praktikave dokumentare rezultoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nga Grupi i Punës dhe Titullari i DPT në lëshimin e autorizimeve <b>është tejkaluar afati 5 ditor</b>, konkretisht: në muajin Prill në 74 raste nga 94 autorizime të lëshuara gjithsej në këtë muaj, ndërsa në muajin Nëntor në 55 raste nga 58 autorizime të lëshuara gjithsej, në kundërshtim me nenin 5 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, me ndryshime, ku përcaktohet: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor.</li> <li>- Për lëshimin e autorizimeve Grupi i Punës nuk ka respektuar dhe kërkesat e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37, datë 22.05.2020 për ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimin të kushteve të subjekteve të rindërtimit që aplikojnë për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, me ndryshimet e mëvonshme, pika 5, ku përcaktohet afati 5 ditor për shqyrtimin e dokumentacionit dhe lëshimin e autorizimeve.</li> <li>- Grupi i Punës në shqyrtimin e kërkesave, verifikimin e dokumentacionit dhe duke i rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit ka vepruar në kushtet e mosplotësimin të dokumentacionit, në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, i ndryshuar, konkretisht, për 33 raste gjithsej, për autorizimet e muajit Prill 2021 me nr. 256, 266, 269, 272, 274, 276, 287, 278, 279, 292, 293, 297, 307, 313, 318, 321, 324, 327, 333, 335 dhe të muajit Nëntor me nr. 974, 975, 977, 978, 985, 990, 1006, 1014, 2017, 1018, 1020, 1021 dhe 1026, të cilët u takojnë subjekteve nënkontraktore dhe furnizuese në procesin e rindërtimit. Bashkëlidhur këtyre praktikave mungojnë kontratat bazë dhe preventivat e subjekteve që kanë marrë pjesë në procesin e</li> </ul>	<p><b>Pika 2.11,</b> <b>Fq 218-224</b></p>	<p><b>E lartë</b></p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa të menjëhershme për monitorimin e procedurave të lëshimit të autorizimit, si dhe marrjen e masave për kontrollin e DRT lidhur me zbatimin e kërkesave të shkresës sqaruese nr. 4985/3prot., datë 04.03.2020, drejtuar DRT-ve.</p>

<p>prokurimit e kanë lidhur kontrata me njësinë zbatuese (Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Tiranë, etj.) kjo me qëllim evidentimin e saktë të punëve, shërbimeve apo materialeve që do të kryhen nga këta subjekte.</p> <p>Në kontratat e lidhura me këto njësi, përcaktohet që, <b>nënkontraktimi nuk lejohet, përveçse kur jepet miratim me shkrim nga autoriteti, por në asnjë rast nuk ka miratim me shkrim të këtyre autoriteteve</b> për lejjimin e nënkontraktimeve me subjektet që kanë lidhur kontrata nënsipërmarrje me ndërtuesit/ kontraktorët subjekte të rindërtimit, të cilët janë pajisur me autorizime për përjashtimin nga TVSH, duke krijuar risk të shtuar në monitorimin e këtij procesi nga të gjithë aktorët, në deformimin e procesit të prokurimit, por dhe krijimin e risqeve potenciale për shmangie të pagesës së TVSH-së.</p> <p>Për të orientuar DRT në këtë proces, nga DPT është dërguar shkresa sqaruese nr. 4985/3 prot., datë 04.03.2020, ku përcaktohet procedura që do të ndiqet prej tyre.</p> <p>Me urdhrin nr. 48, datë 9.07.2021 òPër një ndryshim në urdhrin nr. 37, datë 22.05.2020...ò, është shtuar pika 6.1 me këtë përmbajtje: <i>òGrupi i Punës monitoron zbatimin e procedurës së ndjekur nga ana e DRT-ve saktësuar shkresës sqaruese nr. 4985/3, datë 04.03.2020”</i>, por nga auditimi rezultoi <b>se nga Grupi i punës për vitin 2021 nuk është kryer procesi i monitorimit ndaj DRT</b> për zbatimin e kësaj procedure, gjithashtu prej tij nuk dihet e raportohet se sa është vlera e investimeve që lidhen me procesin e rindërtimit të përjashtuar nga TVSH, duke e lënë këtë proces të pamonitoruar e duke krijuar risqe të shtuara në administrimin e të ardhurave nga TVSH-ja, pavarësisht se me Planin Sektorial të Rindërtimit janë marrë në shqyrtim 399 subjekte për periudhën Gusht 2020- Prill 2021.</p> <p>- Nga verifikimi i dokumentacionit në Sektorin e Protokollit rezultoi se, subjekte u janë përcjellë dorazi autorizimet e lëshuara në 71 raste (60 raste në muajin Prill dhe 11 raste në muajin Nëntor) dhe njëkohësisht me vonesë nga data e lëshimit të autorizimit nga 1 ditë punë në 11 ditë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar neni 23.</p>		
---	--	--

### I.c. KONKLUZION I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), në lidhje me shkallën e zbatueshmërisë së ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimoreò, i ndryshuar; ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe rregullore mbi të cilët ushtron veprimtarinë DPT për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021. Gjatë auditimit në terren janë marrë

evidenca me të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

### **Opinion i modifikuar/kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë<sup>1</sup>:**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se, në veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e Baza për Opinionë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale por jo të përhapura** dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**.

### **Baza për opinionin e kualifikuar/cilësuar:**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin e mëposhtëm, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të shërbyer si bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

### **Përshkrimi i çështjeve kryesore:**

- Mangësi nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku gjendja e detyrimeve të papaguara deri me datën 31.12.2021 është 134,935 milion lekë, si dhe stoku i detyrimeve tatimore gjatë vitit 2021 ka pësuar një rritje neto prej **12.5** miliard lekë krahasuar me një vit më parë;

- Nuk është respektuar plani i rimbursimit të TVSH-së, i cili është tejkaluar në shumën 7.1 miliardë lekë. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, rezultojnë **69** kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale prej **1,893,609** mijë lekë, në tejkallim të afatit ligjor 60-ditor, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Nga auditimi ka rezultuar se, vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së, në opinionin tonë është **2,370,259** mijë lekë nga 476,650 mijë e paraqitur nga DPT;

- Të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për vlerën 7,134,393 mijë lekë, ose janë arkëtuar më pak në masën 4.7%, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor. Mangësi në përbërje të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuar sipas natyrës dhe llojit, janë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 e Mjete në ruajtje, e cila përfaqëson arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemimin e tyre;

- Mangësi në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, ku rezultojnë parregullsi në plotësimin e vendeve vakante, në përshkrimet e punës për punonjësit jashtë shërbimit civil për Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, ku shfaqen raste që për të njëjtin përshkrim pune me të njëjtat detyra funksionale, të ndryshojë kriteri i nivelit të arsimimit apo fushës së edukimit, si dhe mangësi në shprehjen e marrëdhënieve të punës e në administrimin e

<sup>1</sup> **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura**.

dosjeve të personelit. DPT ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në vlerën totale **186,466,238 lekë**, vlerë e cila ka efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit;

- Mangësi në zbatimin e buxhetit institucional për shpenzimet operative për vitin 2021, si dhe në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, ku moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja që nga viti 2015 i implementimit të tij, pasi ky modul shqyrton automatikisht aspekte të veçanta të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi. Pra, mungon azhomimi për të qenë në koherencë me gjithë ndryshimet që ka pësuar legjislacioni fiskal ndër vite, vetë administrata tatimore por edhe profili i tatimpaguesve. Rezulton se, edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë: Subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e DRT, të cilat konstatohen në unifikimin e organizimit dhe të strukturës në përputhje me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore, në rritjen e pavarësisë, në përfundimin e analizimin e rasteve të denoncimeve të ardhura etj.;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të cilat konstatohen në monitorimin periodik të punës së Drejtorive Rajonale Tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor, në përfundimin e kontrolleve dhe arkëtimin e detyrimeve, në realizimin e kontrolleve nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts, në mos përfundimin e kontrolleve për disa vite;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, e cila nuk ka përmbushur misionin e krijimit të saj, duke qenë një strukturë jo efiçente në përmbushje të përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i fushës, ku shkaku kryesor i kësaj situate është mungesa e akteve ligjore dhe nënligjore për të operuar normalisht në funksion të qëllimit të krijimit të kësaj drejtorie;

- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Verifikimit dhe Kontrollit në Terren, që kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura nga inspektorët në terren dhe bazueshmëria ligjore e akteve të mbajtura prej tyre.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të DPT-së:**

Strukturat drejtuese të DPT, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore në përputhje me politikën, ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues dhe personeli i DPT ka përgjegjësi menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin e tij.

Drejtesit e të gjitha niveleve janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë, si dhe për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Drejtimi i DPT është përgjegjës ndër të tjera për aktivitetet e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, rimbursimin në kohë të TVSH-së, ushtrimin e kontrolleve nga drejtoritë përkatëse në DPT për zbatimin e procedurave tatimore nga tatimpaguesit me qëllim maksimizimin e të ardhurave tatimore.

Gjithashtu, ata janë përgjegjës për t'ua siguruar grupit të auditimit të KLSH dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH në Auditimin e Përputhshmërisë:**

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e DPT është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të DPT-së.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet t'ua kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSHö, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 20/1, datë 14.01.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, ndryshuar me shkresën nr. 20/2, datë 23.04.2022, në subjektin: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga data 17.01.2022 deri më 13.05.2022, u krye auditimi mbi Përputhshmërinë, për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 31.12.2021, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S. B., Përgjegjës Grupi;
2. J. T.;
3. A. P.;
4. R. Xh.;
5. Xh. N.

Auditimi u krye me bazë risku, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit, duke përfshirë saktësinë e paraqitjes së të ardhurat dhe shpenzimet, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj.

### 1. Objektivat e auditimit:

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivi kryesor i veprimtarisë audituese është vlerësimin i përputhshmërisë dhe dhënien e opinionit mbi procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, gjatë procesit të realizimit të aktivitetit të tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor dhe kuadrin mbështetës në fuqi për mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe realizimin e aktivitetit tjetër të institucionit, në përmbushje të misionit që ka struktura e DPT.

### 2. Qëllimi i auditimit:

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura dhe procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë procesit të realizimit të objektivave të tij, në përputhje me legjislacionin, vlerësimi me objektivitet, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit, vlerësimi e evidentimi i shkeljeve si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e përgjegjësisë institucionale.

### 3. Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, shpërndarja e tyre në Drejtoritë Rajonale Tatimore, hartimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor për vitin 2021, transaksionet ekonomike, planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike, monitorimi i masave të marra për mbledhjen e detyrimit tatimor, efektiviteti i strukturave të veçanta si, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Hetimit Tatimor, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, etj., si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit si delegimi i

kompetencave, zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për punonjësit, plotësimi i vendeve vakante, apo përmirësime ligjore të nevojshme, etj.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar.

-Drejtori i Përgjithshëm si (*Nëpunësi Autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale.

-Drejtori i Financës (*Nëpunësi Zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

#### **5. Përgjegjësitë e audituesve:**

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, i cili shprehet nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. ISSAI 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave të nevojshme për të siguruar dëshmi e evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionin tonë. Procedurat e kryera janë bazuar në gjykimin profesional të audituesve publikë, duke përfshirë vlerësimin e riskut të mospërputhjeve materiale, qofshin këto për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ne besojmë se provat e mbledhura të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionin tonë.

Audituesit e KLSH janë të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 òDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 òKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

#### **6. Kriteret e vlerësimit:**

Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të procedurave tatimore.

-Ligji nr. 154/2014 òMbi Organizimin dhe Funkcionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareveò;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;

- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 ò Për buxhetin e vitit 2021ò, i ndryshuar;

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;

- Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;

- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 òPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò;

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar;
- Ligj nr. 33/2017 ÷Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore.
- Akte të tjera ligjore e nënligjore mbi të cilat ushtron veprimtarinë subjekti nën auditim.

#### **7. Standardet e auditimit.**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.;
- Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë të miratuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.;

#### **8. Metoda e auditimit.**

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efijencës së auditimit, duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të prokurimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA).

Për sa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës.

#### **9. Dokumentimi i auditimit.**

Auditimi është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 400-499 ÷Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e planifikimit dhe auditim në terren, si dhe janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera.



### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është pjesë e Administratës Tatimore Qendrore dhe ka varësi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Administrata Tatimore Qendrore është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, veç atyre që parashikohen në ligje të veçanta, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklarimit dhe, mbi këtë bazë, përcakton detyrimet tatimore shtesë të një tatimpaguesi, si dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara më tepër, nëse ka të tilla.

DPT drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, cili sipas strukturës së miratuar ka në varësi të tij tre Zëvendësdyrektore të Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën, me qëllim realizimin e objektivave të programuara nga Qeveria, duke mbikëqyrur menaxhimin e funksioneve të veçanta në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë etj. Ky ligj, përcakton parimet bazë mbi të cilat mbështetet sistemi tatimor shqiptar dhe administrimi i tij. Sanksionohen të drejtat e tatimpaguesve, që në fakt janë një balancë e plotë përkundrejt detyrimeve të tyre kontributeve, në të hyrat e buxhetit të shtetit. Gjithashtu përgjegjësitë dhe funksionet e DPT pasqyrohen qartë në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 24, datë 02.09.2008, pika 14.2 òAdministrimi Tatimorò.

DPT ka funksionuar me rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të MFE, òRregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, në të cilën trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, etj.

Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe renditet si një nga institucionet ligj zbatuese më të rëndësishme në vend.

*Funksionet kryesore të punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë si më poshtë:*

1. Administron detyrimet tatimore në Republikën e Shqipërisë në nivel qendror për llojet e tatimeve dhe taksave të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 òPër Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

2. Përgatit dhe miraton planin strategjik të objektivave dhe synimeve kryesore të administratës tatimore qendrore për një periudhë afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë si edhe monitoron zbatimin rigoroz të tij nga të gjitha drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nga të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore.

3. Evidenton nevojat për ndryshime dhe paraqet propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me ndryshimet në ligjet tatimore, në aktet nën-ligjore të nxjerra në zbatim të tyre, në procedurat tatimore dhe gjithë elementët e tjerë që kanë të bëjnë me administrimin e tatimeve.

4. Përgatit dhe miraton procedura standarde pune operative. Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sigurohet se këto procedura promovojnë transparencën e duhur në marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesit, krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat

minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë tatimpaguesit dhe reduktojnë subjektivitetin e punonjësve tatimorë.

5. Ofron asistencë për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor, akteve nën-ligjore në zbatim të tij dhe manualeve operacionale në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

6. Përcakton, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, masa uniforme për matjen e performancës së punonjësve të administratës tatimore dhe krijon raporte standarde për të kontrolluar vlerësimin e performancës në nivel kombëtar, si dhe për çdo Drejtori Rajonale Tatimore. Ndjek zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës për Administratën Tatimore Qendrore.

7. Siguron shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore në çdo Drejtori Rajonale Tatimore.

8. Bashkëpunon me të gjitha Drejtorinë Rajonale Tatimore, për të përgatitur plane vjetore pune, bazuar në numrin e personelit që është përcaktuar për çdo drejtori dhe në objektivat funksionale të performancës për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.

9. Harton dhe zbaton një program vjetor të vizitave të punës në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, për të ofruar asistencë dhe për të kryer vlerësime, lidhur me efikasitetin dhe cilësinë e punës së kryer.

10. Përgatit raporte të vlerësimit të punës për secilën Drejtori Rajonale Tatimore.

11. Miraton planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.

12. Përcakton planin e buxhetit të çdo Drejtorie Rajonale Tatimore dhe kontrollon zbatimin e tij.

13. Përgatit marrëveshje të përbashkëta për të koordinuar punën me shoqatat e biznesit dhe me autoritete të tjera shtetërore, të tilla si: Doganat, Thesari, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, njësitë e qeverisjes vendore, etj., lidhur me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, në interes të administrimit tatimor.

14. Koordinon marrëdhëniet ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me administratat tatimore të shteteve të tjera.

15. Zbaton një politikë rekrutimi të punonjësve tatimorë në zbatim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në RSHö, i ndryshuar, Ligjin nr. 152, datë 30.05.2013 òPër nëpunësin civilö, i ndryshuar, Ligjin nr. 7691, datë 12.07.1995 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, në përputhje me strukturat e miratuara.

16. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Kodit të Etikës për punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me rregullat e etikës së administratës publike.

17. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore për parandalimin e konfliktit të interesit të nëpunësit të Administratës Tatimore qendrore.

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.**

*Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi:*

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitö, Neni 15, 30 dhe 31.

- Manuali òPër ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucionalö, miratuar me vendimin nr. 67, datë 13.06.2020.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm në DPT, u konstatua se:

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, (këtu e në vijim DPT) është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020, për të cilin Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 298/16

Prot., datë 13.10.2021, protokolluar në DPT me nr. 8715/44 Prot., datë 15.10.2021 dhe shkresën nr. 513/33 Prot., datë 14.10.2021 protokolluar në DPT me shkresën nr. 8715/43 Prot., datë 15.10.2021. KLSH ka kërkuar zbatimin e rekomandimeve për 2 òMasa për ndryshim apo përmirësim ligjorë, 32 òMasa organizative, 2 òMasa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike dhe i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT shqyrtimi dhe dhënia e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

DPT me shkresën nr. 8715/45, datë 11.11.2021 drejtuar KLSH òNjoftim mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, bashkëlidhur planin e masave, ku ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në tejkalim të afatit kohor prej 20 ditë, si dhe nuk ka raportuar për realizimin e tyre në afatin 6-mujor, në kundërshtim me germën (j) të nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka raportuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve rezultoi si më poshtë:

#### **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**1.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të ndërmarrë një iniciativë ligjore me qëllim ndryshimin e VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe konkretisht pika 3, neni 10, duke hequr frazën “...Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit”.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet komunikimit elektronik nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore subjekti pretendon se kjo detyrë është në proces.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi rezulton se deri në përfundim të auditimit nga DPT nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë për ndryshimin e VKM nr. 953, datë 29.12.2014.

**Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar**

**2.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të ndërmarrin iniciativën ligjore me qëllim përditësimin e Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 òPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorë, në koherencë me ndryshimet strukturore të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, rritjen e pavarësisë së saj dhe harmonizimin e këtij akti nënligjor me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore.

**Përgjigja e subjektit:** Në vijim të rekomandimeve lidhur me ndryshimet dhe përditësimin e VKM nr. 400, datë 22.04.2009, ju informojmë se nga ana e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT janë propozuar ndryshime në VKM nr. 400, datë 22.04.2009 me qëllim përditësimin, organizimin dhe harmonizimin e veprimtarisë së DHT në DPT. Qëllim i përditësimit është përmirësimi i analizimit, zbulimit dhe evidentimit të veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Na janë vendosur në dispozicion print-screen e email-it të dërguar Drejtorisë Ligjore në DPT, me propozimet e Drejtorisë së Hetimit për ndryshimet në VKM Nr. 400, datë 22.04.2009 “Për përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së Hetimit Tatimor”.

**Rekomandimi konsiderohet i në proces.**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se, mund të procedohet me kryerjen e pagesave, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve për Drejtoritë Rajonale të cilat prezantojnë situata të tilla.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet komunikimit elektronik nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore subjekti pretendon se ky rekomandim është në proces në vijimësi.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi rezulton se edhe pse rekomandimet e KLSH janë dërguar në DPT në muajin Tetor, vërehet se në muajin Dhjetor ka tejkalime të planit të rimbursimit, ndërsa gjatë vitit 2022 konstatohet mosrealizim i planit të rimbursimit.*

**Rekomandimi konsiderohet në vijimësi në proces**

**2.1.Rekomandim:** Drejtoria e Rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të marrë masat e nevojshme me qëllim që, në mbyllje të periudhës ushtrimore të mbajë akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me **stokun e detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së** dhe, një kopje të këtij dokumenti ta paraqesë në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Kontabilitetit me qëllim dokumentimin e vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiare pasi kjo vlerë del jashtë sistemit C@TS.

**Përgjigja e subjektit:** Me shkresën nr. 282 Prot., datë 11.01.222, DRTVSH ka njoftuar tatimpaguesin -K. I.ØSha, lidhur me stokun e rimbursimit.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga DRTVSH për njoftuar mbi miratimin e shumës së rimbursimit të tatimpaguesit i cili raportohet si stok, e njëkohësisht është njoftuar dhe Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës për stokun e rimbursimit të miratuar, i cili del jashtë C@TS pas miratimit.*

**Rekomandimi konsiderohet i zbatuar**

**3.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme me qëllim respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së dhe raportimin e saktë dhe të plotë të stokut të detyrimeve për tu paguar.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet komunikimit elektronik nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore subjekti pretendon se ky rekomandim është realizuar.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi konstatohet se për periudhën nëntor- dhjetor 2021 përsëri vërehen thyerje të afateve ligjore në procesin e rimbursimit, si dhe pasaktësi në raportimin e stokut nga DRTVSH. Për sa kohë nuk ka një evidencë të masave/qëndrimit të mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm, rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.*

**Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar**

**4.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave nga këto Drejtori Rajonale me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet komunikimit elektronik nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore subjekti pretendon se ky rekomandim është realizuar.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë raport apo analizë të vënë në dispozicion, ku të jenë analizuar shkaqet e mosrealizimit të të ardhurave nga DRT. Për sa kohë nuk ka*

*një evidencë të masave/qëndrimit të mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm, rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.*

***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.***

**5.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve të marrin masat e nevojshme për mbikëqyrjen e punës së DRT-ve në drejtim të sistemimit të arkëtimit të pa identifikuar me qëllim minimizimin e vlerës së paraqitur në llogarinë 466 Mjete në ruajtje dhe klasifikimin e saktë të të ardhurave tatimore.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet komunikimit elektronik nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore subjekti pretendon se ky rekomandim është i zbatueshëm në vijimësi.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi nuk rezulton të jenë marrë masat e duhura për minimizimin e vlerës së llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” dhe klasifikimin e saktë të të ardhurave tatimore pasi kjo llogari ashtu si dhe në vitet e kaluara vazhdon të marrë vlera më të larta.*

***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar***

**6.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim unifikimin e vlerës së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shprehur në raportimet e DPT-së me vlerën e raportuar si e ardhur nga kontributet për institucionet e ISSH-së dhe FSDKSH-së.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet komunikimit elektronik nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore subjekti pretendon se ky rekomandim është i zbatueshëm në vijimësi.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi nuk rezulton të jenë marrë masat e duhura për unifikimin e vlerës së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pasi dhe në këtë vit kemi vlera të ndryshme raportimi.*

***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar***

**6.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim unifikimin e vlerës së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shprehur në raportimet e DPT-së me vlerën e raportuar si e ardhur nga kontributet për institucionet e ISSH-së dhe FSDKSH-së.

**Përgjigja e subjektit:** Në përgjigjen nëpërmjet shkresës nr 121/34 Prot., datë 20.05.2022 subjekti sqaron sistemi tatimor SIT nuk ka qenë sistem kontabiliteti por thjesht një sistem informatik, në këto kushte kontabilizimi i detyrimeve nuk bëhet sipas rregullave të kontabilitetit me klasat përkatëse në nivel 7 shifror. Migrimi i këtyre detyrimeve nga SIT në E Tax në janar 2015 total, i paidentifikuar se sa janë gjobat sipas llojit kontribute dhe tap, në momentin që këto detyrime paguhet tani me sistemin e ri pagesa është zgjidhur të kontabilizohet si një e vetme gjobë për pagesë të vonuar kontribute dhe TAP.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi rezulton se të ardhurat nga kjo llogari me kalimin e viteve janë reduktuar dhe impakti i tyre për llogari të ISSH dhe FSDKSH është minimalist (0,01% e totalit vjetor të të ardhurave).*

***Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar***

**7.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

**Përgjigja e subjektit:** Në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka përgatitur shkresën e datës 17.11.2021 drejtuar DAP me qëllim bashkëpunimin për plotësimin e vendeve vakante. DBNJ ka ndjekur procedurat në lidhje me pozicionet vakante të krijuara duke njoftuar njësinë përgjegjëse DAP, e cila ka për detyrë të bëjë shpalljen e vendeve të lira. Është realizuar

hedhja në sistemin HRMIS dhe administrata.al për pozicionet e lira në fund të vitit 2021. Më datë 28.12.2021, DBNJ ka përcjellë pranë DAP vakancën në Administratën Tatimore Qendrore.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi është konstatuar se DPT ka dërguar planifikimin vjetor për rekrutim drejtuar Departamentit të Administratës Publike. Gjatë vitit 2021, sikurse trajtuar edhe përgjatë materialit, janë bërë shpallje nga ana e DAP, por përsëri organika e DPT ka vakanca.

**Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht nga subjekti.**

**8.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa që në të ardhmen inspektimet në rajone të intensifikohen, duke përbushur edhe detyrat e parashikuara në planin operacional miratuar me Vendimin nr. 16, datë 06.02.2020.

**Përgjigja e subjektit:** Me shkresën nr. 17897 Prot., datë 05.10.2021 është miratuar plani i inspektimit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Verior dhe Rajoni Qendror. Auditimet janë në proces.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** U administrua plani i inspektimit dhe projektraportet për këto dy auditime. Ende nuk janë përfshirë në inspektim të gjithë rajonet, dhe për këto të dyja mbetet ende në proces raporti përfundimtar.

**Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi**

**9.1.Rekomandim:** Të merren masa nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për minimizimin detyrimeve tatimore të papaguara përmes mbledhjes së tyre, duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuara.

**Përgjigja e subjektit:** Drejtoritë Rajonale të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara janë përgjegjëse për përdorimin e instrumenteve ligjore për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore. Ndërmarrja e të gjitha masave shtrënguese është detyrim ligjor.

**Komenti i Grupit të Auditimit:**Stoku i borxhit paraqitet në rritje, dhe raporti i shtimit me atë të pakësimit mbetet i lartë, duke mos mundur të zbatohet ky rekomandim.

**Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**

**10.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar modulën e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore për të zbuluar evazionin dhe mashtrimin tatimor.

**Përgjigja e subjektit:** Me vendimin nr. 27 datë 13.10.2021 (bashkëlidhur kopje) në Komitetin e Përbushjes janë miratuar kriteret e riskut me impakt në analizën dhe evidentimin e tatimpaguesve mos përbushës në kuadër të planit të informalitetin në tregun e punës.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga grupi i auditimit u verifikua miratimi i kriterëve të riskut sipas vendimit të sipërcituar.

**Rekomandimi konsiderohet i zbatuar plotësisht.**

**10.2.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa për standardizimin e raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundur unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara. Në çdo rast të përgatiten raporte përgjithësuese në mënyrë periodike me problematikën më të shpeshta të hasura dhe me mendime për përmirësimin e kriterëve të risqeve.

**Përgjigja e subjektit:** Në vijim të analizimit të dokumentit template të dakordësuar për standardizimin e raportit të kontrollit, bashkëngjitur po dërgojmë raportin e kontrollit ku gjeni të evidentuara disa pyetje të tjera që kanë nevojë për sqarime e saktësime nga ana juaj në pjesën më të madhe të seksioneve të tij. Pavarësisht nevojës për saktësimin më tej të kërkesës lidhur me këtë çështje, nga një

testim i përafërt i punës zhvilluese që nevojitet për plotësimin e pikave që janë të qarta deri më tani, rezulton se nevojitet një periudhë prej 4 ó 6 muaj pune nga ekipi zhvillues.

Sugjerojmë që kjo kërkesë për ndryshim të vendoset në radhë pune pas finalizimit të çështjeve të tjera si VAT Refund, shërbimet online, çështjet lidhur me modulën e borxhit, modulën e case management. Këto të fundit janë ende duke u zhvilluar dhe janë dakordësuar gjatë takimeve si më me prioritet. Mbetemi në pritje të vendimit nga ana juaj. Mbetet që standardizimi i raporteve të kontrollet të implementohet pas procesit të fiskalizimit.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Për sa kohë ende nuk ka konkluzione të rekomandimit të lenë, kjo çështje mbetet objekt verifikimi në vijim.*

**Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi**

**11.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, të punojë që kjo iniciativë të shtrihet në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të informacionit do të mundësohet përfshirja e të gjithë tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve.

**Përgjigja e subjektit:** Në kuadër të planit të turizmit ka pasur bashkëpunim me bashkitë për subjektet që operojnë në këtë sektor (Bashkëlidhur kopje shkrese me nr. 9497 Prot., datë 27.05.2021 dhe shkresa nr. 9498 Prot., datë 27.05.2021). Në kuadër të njësisë speciale antiinformalitet në tregun e punës ka pasur bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (me email grupi i punës)

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga grupi i auditimit u konstatua bashkëpunimi me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut vetëm për planin e turizmit, dhe jo në rang kombëtar.*

**Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.**

**12.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që Drejtoria e Hetimit Tatimor të përfundojë vlerësimin e situatës financiare të subjekteve të propozuara për kontroll gjatë vitit 2020 për 152 raste nga 296 raste gjithsej të cilat janë në proces ndjekje nga DRT si dhe të përfundojnë analizimin e rreth 50 % të rasteve të denoncimeve të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues.

**Përgjigja e subjektit:** Lidhur me rekomandimin e mësipërm, nga ana e DHT në DPT janë marrë masat e nevojshme me kujtesa dhe rikujtesa shkresore kundrejt Drejtorive Rajonale Tatimore me qëllim ezaurimin e praktikave të Raport Kontrolleve. Në varësi dhe evidentim të shkeljeve nga secili rast, janë marrë masat e nevojshme administrative dhe penale. Nga verifikimi dhe të dhënat statistikore rezulton se nga 296 kontrole dhe vlerësime në proces të evidentuara në rekomandimet e KLSH aktualisht janë 146 propozime për kontrole dhe vlerësime ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale respektive. Nga ana e DR Tatimore përkatëse janë marrë masat për dhënien prioritet të kontrolleve dhe vlerësimeve. Nga verifikimi dhe të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2020 janë deklaruar 26 raste janë përcjellë në Drejtorinë e Hetimit Tatimor ndër të cilat:16 rezultojnë të ezauruara;

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *janë vendosur në dispozicion shkresat që Drejtoria e Hetimit ju ka dërguar DRT Rajonale ku kërkohet verifikimi i situatës financiare të subjekteve dhe kryerja e vlerësimit të tyre.*

**Rekomandimi konsiderohet në proces.**

**12.2.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të analizojë dhe të japë përgjigje të argumentuar për mos paraqitjen e të dhënave dhe për mos vënien në dispozicion të dosjeve të subjekteve, me qëllimin auditimin e përputhshmërisë ligjore dhe procedurale

të ndjekur nga struktura e Hetimit Tatimor, në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të shmangieve fiskale.

**Përgjigja e subjektit:** Në vijim të rekomandimit të sipërcituar, nga ana e DHT janë propozuar ndryshime në nenin 105 të Ligjit Nr. 9920 bazuar në ndryshimet e fundit strukturore të DHT në DPT.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Na janë vendosur në dispozicion print screen e email-it të dërguar Drejtorisë Ligjore në DPT, me propozimet e Drejtorisë së Hetimit për ndryshime në nenin 105 të Ligjit Nr. 9920, por deri tani nuk është bërë asgjë konkretisht për zbatimin e rekomandimit të KLSH.

**Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**

**13.1.Rekomandim:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor të realizojë në vijim kontrollin e performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, në DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës në DRT, bazuar në kriteret për vlerësim, me qëllim plotësimin e detyrave të përcaktuara në objektivat e saj për vitin 2020 e në vijim.

**Përgjigja e subjektit:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor gjatë vitit 2021 ka nxjerrë Autorizimet për kontroll:

- o Autorizimi nr. 16944 datë 17.09.2021 në DRT Dibër.
- o Autorizimi nr. 3992 datë 03.03.2021 në DRT Kukës dhe në DRT Korçë.
- o Autorizimi nr. 16945 datë 17.09.2021 në DRT Vlorë.
- o Autorizimi nr. 16946 datë 17.09.2021 në DRT Tiranë.
- o Autorizimi nr. 16947 datë 17.09.2021 në DRT Durrës.
- o Autorizimi nr. 16945/2 Prot., datë 01.10.2021 në DRT Shkodër.
- o Autorizimi nr. 1693Prot, datë 28.01.2021 në DRT Sarandë.

Është kryer kontroll në DRT Shkodër, Sarandë, Kukës, Dibër, Vlorë, Korçë dhe është në proces DRT Durrës hartimi të projektit si dhe janë paraqitur propozimet dhe rekomandimet përkatëse.

Nga të cilat Kontrolli i DRT Kukës, Dibër, Vlorë nuk janë mbyllur akoma dhe janë në fazën e përcjelljes së projekt raportit. Kontrolli në DRT Tiranë është shtyrë për shkak të kontrollit që po ushtron KLSH. Të përfunduara dhe validuara DRT Sarandë dhe Shkodër, Korçë.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Grupi i auditimit verifikoi informacionin gjatë kryerjes së auditimit dhe rezultoni se rekomandimi është zbatuar.

**Rekomandimi konsiderohet i zbatuar**

**13.2.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e përcaktuara dhe monitorimin e munguar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor gjatë vitit 2020. Kjo me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të gjithë drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor.

**Përgjigja e subjektit:** Drejtoria e Kontrollit gjatë vitit 2020, përveç situatës pandemike, për periudhën gusht - dhjetor 2020 nuk ka patur Drejtor megjithatë inspektorët e kësaj Drejtorie janë angazhuar:

Ë Në grupet e punës për pagat e luftës.

Ë Në realizimin e Kontrollit në DRT Berat dhe Gjirokastrë nr. 19297 datë 06.10.2020

Ë Në realizimin e Kontrolleve në kuadër të planit operacional nr. 20409 datë 20.10.2020

Ë Në ndjekje e grupeve të tjera të punës për Procesin e Rindërtimit, Fiskalizimit etj.

Ë Asistencën teknike implementimin e ndryshimeve ligjore të ndodhura si pasojë e situatës pandemike (ndryshimet për tatim fitimin, TVSH) etj.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Për sa kohë nuk ka një evidencë të masave/qëndrimit të mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm, rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

**Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**



**14.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të urdhërojë përfundimin e kontrollit të ndërprerë në DRT Lezhë, Tiranë, Berat, në bazë të autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020 për saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të vlerësuara si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për drejtuesit të cilët kanë anuluar pa shkak kontrollin në DRT Lezhë, Tiranë, Berat, në bazë të autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020.

**Përgjigja e subjektit:** Afati I kryerjes së kontrollit dhe monitorimit (kontroll tematik) sipas Autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me Nr. 746.Prot., datë 18.01.2022 është nga data 24.01.2022 deri 25.02.2022. Deri me sot janë rezultatet e kontrollit janë në proces për të tre DRT-te Tirane, Berat dhe Lezhe.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Pas administrimit të të dhënave të vendosura në dispozicion, rezultoni se rekomandimi është në proces zbatimi.

**Rekomandimi konsiderohet në proces**

**15.1.Rekomandim:** Drejtorja e Kontrollit të hartojë praktika verifikimi nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts nëpërmjet analizave: të situatave kreditore- debitor të tatimpaguesve për sigurimet; të zbatimit të procesit të rimbursimit; të gjendjes kreditore të TVSh-së; analiza për kështet e tatimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi, kryqëzimin me të dhënat nga sistemi doganor, etj., me qëllim identifikimin e fenomeneve dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.

**Përgjigja e subjektit:** Për këtë me shkresën nr. 8715/48, datë 24.12.2021 i kemi dërguar të gjitha DRT-ve Formatin e Raportimeve mujore si dhe të gjithë treguesit që çdo DRT duhet të përfshihen në këtë raportim, sipas rekomandimeve të KLSH-së, me qëllim identifikimin e fenomeneve dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.

Drejtoritë Rajonale Tatimore bazuar në këtë format po raportojnë për rezultatet në Drejtorinë e Kontrollit në DPT.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** U verifikuan masat e mara për zbatimin e këtij rekomandimi nga ana e Drejtorisë së Kontrollit, pra rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

**Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.**

**16.1.Rekomandim:** Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të ngrihet grup pune me përfaqësuesit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për të mundur një rakordim të saktë, automatik dhe të gjurmueshëm të kontrolleve të përzgjedhura sipas modulit 70%, dhe propozimeve në nivelin 30%, me qëllim monitorimin e realizimit të planit të kontrolleve deri në përfundimin dhe raportimin tyre, për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonësive në kryerjen e kontrolleve.

**Përgjigja e subjektit:** Me anë të shkresës nr. 8715/56 Prot., datë 25.02.2022 kemi caktuar anëtarin në grupin e punës (bashkëlidhur kopje).

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Për sa kohë ende nuk ka konkluzione mbi rekomandimin e lënë, kjo mbetet objekt verifikimi për auditimin pasardhës.

**Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi**

**17.1.Rekomandim:** Drejtorja e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të nxjerrë përgjegjësitë për kontrollet e planifikuara për vitin 2020 dhe të përealizuara ku mosrealizimet më të mëdha janë në DRT: Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë dhe DTM.

**Përgjigja e subjektit:** Drejtorja e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të nxjerrë përgjegjësitë për kontrollet e planifikuara për vitin 2020 dhe të përealizuara ku mosrealizimet më të

mëdha janë në DRT: Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë dhe DTM. Në lidhje me këtë rekomandim për mosmbylljen brenda afateve e kontrolleve të planifikuara për vitin 2020 nga DRT-të Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë dhe DTM sqarohet se: ÷ Për arsye të situatës së pandemisë dhe riskut që paraqiste kryerja e kontrolleve në vend tek subjektet e planifikuara për kontroll në zbatim të Urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 156 datë 10.03.2020 ju është dërguar Drejtorive Rajonale Tatimore në rrethet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, shkresa me nr. 5897 datë 19.03.2020 ku u bëhet me dije se : a) Të gjitha kontrollet në vend pranë ambienteve të tatimpaguesve të cilat janë në proces kontrolli dhe kërkohet prezenca fizike e inspektorit të kontrollit të pezulloheshin deri në normalizimin e situatës) për kontrollet që ishin në plan por që subjekti nuk ishte njoftuar ose ishte njoftuar për fillimin e kontrollit do të pezullohen deri në normalizimin e situatës. ÷ Në fund të vitit 2021 kontrolle të planifikuara në vitin 2020 dhe të pambyllura janë 76 kontrolle nga 348 që ishin në fund të vitit 2020 ose 21.8 % e tyre

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Kontrollit ka dërguar shkresat dhe është zbatuar rekomandimi i lënë.

**Rekomandimi konsiderohet i zbatuar**

**18.1.Rekomandim:** Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të nxjerrë përgjegjësitë për gjithsej 537 kontrolle nga viti 2015, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, të planifikuara në vite e të përealizuara.

**Përgjigja e subjektit:** Nisur nga analiza që Drejtoria e Kontrollit në DPT, i ka bërë kontrolleve në proces dhe të pafilluara, për vitin 2020 në vijim të shkresës me nr. 23285prot, datë 31.12.2019 të DK në DPT, me lëndë: ÷ Për kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjëseve ÷ janë propozuar fillim ecurie disiplinore për personat që nuk kanë mbyllur procedurat e kontrollit brenda afateve ligjore.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Bashkëlidhur janë vendosur në dispozicion edhe dokumentacioni i dërguar drejtuar DRT-ve, por grupi i auditimit konstaton se vijon ende problematika e kontrolleve të pa filluara dhe në proces.

**Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.**

**19.1.Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për raportimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore të detyrimeve për stokun e rimbursimit të TVSH-së në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH të informojë zyrtarisht Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës për vlerën e detyrimit.

**Përgjigja e subjektit:** Ky rekomandim zbatohet normalisht nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Raportimi i detyrimeve nuk ka pësuar ndryshime me vitin paraardhës.

**Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**

**19.2.Rekomandim:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të ndërpresin praktikën e marrjes së angazhimeve buxhetor pa pasur më parë fonde në dispozicion. Në hartimin e buxhetit për vitin 2022, më parë të planifikohen fonde (dhe të zbatohen të pa ndryshuara gjatë vitit), fonde investimet e filluara dhe të pa likuiduara sipas parashikimit në kontratë.

**Përgjigja e subjektit:** Nuk ka patur angazhime të reja .

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Përgjatë vitit 2021 nuk ka patur angazhime të reja për investime pa fonde në dispozicion, me përjashtim të një projekti në llog 602, për të cilin procedurat e prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës janë ndërmarrë nga AKSHI-. Për sa i përket projekteve të investimit në proces, planifikimi i fondeve është impaktuar nga prioritarizimi i procesit të Fiskalizimit.

***Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.***

**20.1.Rekomandim:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor të marrë masa për hedhjen në sistemin C@TS të vlerën 317,577 mijë lekë, detyrime të subjekteve të pa përfshira në këtë sistem dhe për të cilat ka modul.

**Përgjigja e subjektit:** Bazuar në Rekomandimin Tuaj me shkresën nr. 8715/47, date 24.12.2021, Të gjithave Drejtorive Rajonale Tatimore ju është kërkuar që: të saktësojnë të gjitha detyrimet e tatimpaguesve të papërfshira në sistemin CATS dhe për të cilat ka modul dhe nëqoftëse plotësojnë kushtet ligjore të hidhen në sistem, bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi. Lidhur me këtë rekomandim në datë 26.01.2022 është hartuar edhe një tjetër shkresë në sqarim të shkresës nr. 8715/47, date 24.12.2021, sipas pyetjeve të paraqitura nga DRT-të lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi. Në çdo DRT vazhdon puna për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Komenti i Grupit të Auditimit:***Nga administrimi i dokumentacionit konstatohet puna e kryer nga Drejtoria e Kontrollit, por e pa zbatuar nga DRT-të.*

***Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.***

**21.1.Rekomandim:** Drejtoria Teknike dhe Ligjore të marrë masa që me përfundimin e proceseve gjyqësore dhe daljen e vendimit të Gjykatës, të njihet menjëherë institucioni më këtë vendim për të programuar zbatimin e tij në kohë. Të mundësohet në çdo rast kryerja e pagesës së vendimit gjyqësor në mënyrë vullnetare, duke lidhur aktmarrëveshje me kreditorin, me qëllim shmangien e shpenzimeve përbarimorë.

**Përgjigja e subjektit:** Pas njoftimit zyrtar nga ana e Gjykatës së vendimit të arsyetuar me shkrim, Drejtoria Teknike dhe Ligjore ka marrë masa për përcjelljen e tyre pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në mënyrë që kjo e fundit të mund të përlllogarisë dhe planifikojë fondin për shlyerjen e tyre. Në lidhje me shlyerjen e pagesave në mënyrë vullnetare, duke lidhur aktmarrëveshje me kreditorin, sqarojmë se kjo procedurë nuk është kompetencë e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore.

**Komenti i Grupit të Auditimit:***Nga auditimi është konstatuar që Drejtoria Teknike dhe Ligjore ka përcjellë vendimet gjyqësore pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, por nga situacioni vjetor i kryerjes së këtyre pagesave, grupi i auditimit ka konstatuar që sërish pagesat kryhen kryesisht nëpërmjet përbaruesve gjyqësore*

***Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.***

**22.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet strukturave përkatëse që programojnë blerjen e shtypshkrimeve, si dhe nëpunësit zbatues, të vlerësojnë nivelin e lartë të stokut të shtypshkrimeve dhe të rishikojë sasinë e nevojave reale për çdo dokument në të ardhmen duke marrë në konsideratë shitjet që janë kryer gjatë vitit të mëparshëm buxhetor ashtu edhe pritshmërinë e nevojave të përdoruesve të shtypshkrimeve, si dhe duke shtuar shpeshtësinë e porosisë dhe duke ulur sasinë e artikujve, me qëllim që të shmang mallin stok.

**Përgjigja e subjektit:** Me shkresën nr. 121/42 prot., datë 27.07.2022, protokolluar në KLSH me nr. 20/14 prot., datë 27.07.2022 argumenton se, nga Nëpunësi Zbatues bëhet një rakordim çdo 4 muaj për llogarinë 34 dhe 35 dhe i dërgohet me shkresë përcjellëse Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Nga kjo e fundit, gjatë vitit 2021, në kuadër të vlerësimit të shtypshkrimeve është rishikuar procedura e monitorimit të nevojave reale në lidhje me planifikimin e dokumentacionit tatimor janë marrë masa dhe nuk bëhet asnjë planifikim pa kërkesat e DRT-ve. Lidhur me kontratat e shtypshkrimeve të letrave me vlerë janë marrë masa të bëhen në masë më të vogël dhe më të shpeshta.

***Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.***

**23.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë duhet të marrin masa për të përcaktuar skemën e kontabilizimit të veprimeve rregulluese për llogarinë 466 -Kreditorë për mjete në ruajtje dhe llogarinë 520 -Disponibilitete në thesarë me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të mjeteve disponibël në Thesar dhe detyrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj tatimpaguesit kreditor për tatimin mbi fitimin e mbi paguar.

**Përgjigja e subjektit:** Drejtoria Kontabilitet dhe Statistikës informon se ky është një rekomandim i lënë në vijimësi nga grupet e auditimit të KLSH-së për vitet e audituara 2019 dhe 2020. Referuar ligjit dhe udhëzime në fuqi për Kontabilitetin, kontabilizimet në këto llogari janë konform ligjit dhe nuk ka vend për ndryshime ligjore. Sipas standardeve të Auditimit një rekomandim i lënë nga audituesit, i papranuar dhe i pazbatuar nuk mund të jetë rekomandim për periudhat e tjera për të njëjtin Entitet të Audituar.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *KLSH e ka shprehur qëndrimin dhe në auditimet e mëparshme, problematika vijon.*

**Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.**

**24.1.Rekomandim:** Grupi i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe grupi i punës i ngritur për transferimin e aktiveve nga DPT tek AKSHI, të bashkëpunojnë me grupin e punës të AKSHI-t i ngritur për këtë qëllim, për të bërë të mundur zgjidhjen e pengesave të deritanishme dhe të realizojnë përfundimin e transferimit të aktiveve nga DPT te AKSHI.

**Përgjigja e subjektit:** Nga subjekti janë vendosur në dispozicion shkresat respektive mbi punën e ndjekur.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Ky proces ende nuk është finalizuar.*

**Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.**

**25.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve duhet menjëherë të urdhërojë ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), me pjesëmarrjen e nivelit drejtues ekzistues të njësisë, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të përkujdeset për performancën e Institucionit.

**Përgjigja e subjektit:** Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin e Titullarit të Institucionit nr. 11, datë 15.02.2021, "Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)", i kryesuar nga Titullari i Institucionit dhe në cilësinë e anëtarëve janë caktuar zv/drejtorët e Përgjithshëm dhe të gjithë menaxherët e nivelit të lartë drejtues, ku mungon prania e vëzhguesit dhe Nëpunësit Zbatues (NZ). Ndërkohë, përmes Urdhrit të Titullarit të Institucionit nr. 20, datë 17.03.2021, "Për disa korrigjime në Urdhrin nr. 11, datë 15.02.2021 "Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)", është caktuar Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (DFB) si NZ, si dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (DAB) në rolin e vëzhguesit, në përputhje me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut II, pika 2.2.6 të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nga auditimi u konstatua që është ngritur GMS, në përputhje me përcaktimet ligjore.*

**Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar nga subjekti.**

**26.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP-in të marrin masa, në plotësimin e strukturës së DAB.

**Përgjigja e subjektit:** DBNJ ka përcjellë shkresën e datës 17.11.2021 drejt DAP me qëllim bashkëpunimin për plotësimin e vendeve vakante në DAB. DBNJ ka përcjellë njoftimin në DAP për

vakancën (një vend të lirë) dhe është në pritje të shpalljes së vendit vakant nga DAP. Ky pozicion është dërguar dhe në planin e rekrutimit vjetor të dërguar nga DPT drejt DAP në 28.12.2021. Deri në fund të afatit 31.12.2021, vakanca nuk është plotësuar.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi u konstatua se DPT ka përcjellë planifikimin vjetor për rekrutim, ku është përfshirë edhe vakanca në njësinë e auditimit të brendshëm. Deri në përfundim të periudhës së auditimit, vakanca nuk është plotësuar.

**Rekomandimi konsiderohet i pranuar pjesërisht dhe zbatuar pjesërisht.**

**26.2. Rekomandim:** Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa në vijimësi që çdo dosje angazhimi auditimi, të plotësohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas formatit standard 1, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të zbatojë afatet e dorëzimit të raporteve, në angazhimet e tyre audituese.

**Përgjigja e subjektit:** Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka përgatitur dosjet për çdo angazhim auditimi të cilat janë të përfunduara dhe të arkivuara. Dosjet përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm që gjykohet nga grupi i auditimit si dhe dokumentet në përputhje me formatin standard nr. 1. Të gjitha dosjet janë të inventarizuara. Janë respektuar afatet e dorëzimit të raporteve audituese.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet janë të inventarizuara dhe janë respektuar afatet e dorëzimit të raporteve mbi auditimet e përfunduara në vitin 2021.

**Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar nga subjekti.**

**27.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve. Të vijojë prej DPT marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe të pa zbatuara.

**Përgjigja e subjektit:** Ky rekomandim është realizuar. Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se, për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe në proces të dhëna sipas raportit përfundimtar të auditimit të dërguar nga KLSH me shkresën nr 333/16 prot datë 30.10.2020, nga DAB është realizuar rekomandimi "DPT me strukturat e saj përgjegjëse të kryejë verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin të evidentuar sa më lart, me qëllim vlerësimin e vijueshmërisë dhe saktësisë së shumës së rimbursuar subjektit".

Sa më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka nxjerrë Urdhrit nr. 76 prot., datë 07.10.2021 "Për angazhim auditimi, të kryhet auditim i përputhshmërisë mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin, me qëllim vlerësimin e vijueshmërisë dhe saktësisë së shumës së rimbursuar për subjektet S. P. me Nipt L...V, E. O. me Nipt L...Q, F. A. Nipt K...L, F. Sh. me Nipt J...N, A. me Nipt L...I, L. me Nipt J...D, V. H. me Nipt L...A."

Në zbatim të urdhrin nr. 76 prot., datë 07.10.2021, janë kryer auditime në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, DTM, Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, auditime që kanë përfunduar në vitin 2021 si dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër, auditim i përfunduar në vitin 2022.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Për sa kohë nuk ka një evidencë të masave/qëndrimit të mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm, rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

-Sa i takon masave për shpërblim dëmi në vlerën totale 1,662,900 lekë, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës rezulton se janë arkëtuar 420,000 lekë. Ndërsa për masat e tjera konstatohet se ato kanë mbetur në realizimin e vitit të kaluar.

**Rekomandimi konsiderohet në proces**

## **D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË**

## **ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna, duke ulur në këtë mënyre efektet financiare në buxhet për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

**Përgjigja e subjektit:** Ky rekomandim është në proces.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *DPT nuk ka paraqitur dokumentacion mbi angazhimin e personave dhe njësisve të përmendura në rekomandim në analizimin e përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbje të çështjeve gjyqësore.*

**Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar nga subjekti.**

**1.2. Rekomandim:** Nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pas kryerjes së analizës së vendimeve gjyqësore, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësive administrative, në përputhje me pikën nr. 60, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.

**Përgjigja e subjektit:** Ky rekomandim është në proces.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** *Nuk janë evidentuar ende masa të mara për finalizimin e këtij procesi.*

**Rekomandimi konsiderohet në proces.**

## **E. MASA DISIPLINORE**

Bazuar në Kreun X òDisiplina në Shërbimin Civilò, të Ligjit nr. 153/2013 òPër nëpunësin civilò, mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 òPër nëpunësin civilò, i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënie masash disiplinore nga òVërejtjeò deri òLargim nga shërbimi civilò, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjës të lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga òVërejtjeò deri në òLargim nga punaò për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Përgjigja e subjektit:** Ky rekomandim është në proces.

**Komenti i Grupit të Auditimit:** Nga auditimi në terren nuk rezultoi të ketë procedurë të dokumentuar për zbatimin e këtij rekomandimi, ndërsa nga shpjegimet e subjektit dhe dokumentacioni justifikues, sjellë me shkresën nr. 121/42, datë 21.07.2022 konstatohet se Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 8715/59, datë 06.04.2022 ka marrë në analizë gjetjet/problematikat e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe ka konkluduar se nuk ka shkaqe për fillimin e procedimit disiplinor, por janë marrë masa për shmangien e problematikave të evidentuara dhe pranuar.

**Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar**

### **Konkluzion:**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 298/16 prot., datë 13.10.2021, protokolluar në DPT me nr. 8715/44

prot., datë 15.10.2021 është konstatuar se, DPT me shkresën nr. 8715/45, datë 11.11.2021 òNjoftim mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, bashkëlidhur planin e masave, ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në tejkallim të afatit kohor prej 20 ditë, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe nuk ka raportuar për ecurinë e realizimit të tyre në afatin 6-mujor, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm konstatohet se, nga 37 rekomandime të lëna subjekti ka pranuar plotësisht 31 rekomandime, ose 83.8 % e tyre dhe ka pranuar pjesërisht 5 rekomandime, ose 13.5 % të tyre. Janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime ose 21.6 %, janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime ose 16.2 %, janë në proces 11 rekomandime ose 29.7 % dhe nuk janë realizuar 12 rekomandime ose 32.4 % e tyre.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.121/42 prot., datë 21.07.2022 òObservacion mbi projektraportin e auditimit nr. 16/20, datë 17.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 20/14 prot., datë 27.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Për përmirësime ligjore, rekomandimi 1.1, Rekomandimet e lëna nga KLSH për rishikim të afateve janë diskutuar në takimet e zhvilluara me përfaqësues të MFE, të cilat kanë përkuar me periudhën e ndryshimeve të paketës fiskale. Do të risillet në vëmendje të MFE ky ndryshim i propozuar.*

**Për masat organizative:**

*Për rekomandimin 3.1: Me qëllim respektimin e afateve ligjore në kryerjen e kontroleve përfshirë dhe të procesit të rimbursimit të TVSH-së nga ana e DRT-ve, të gjitha DRT-ve u është dërguar shkresë nga DK në DPT që të kryejnë analizë për çdo rast. Mbas analizës të bëhej menjëherë propozim për fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës duke lajmëruar DK në DPT. Bashkëlidhur përgjigjes nuk ka asnjë dokumentacion shkresor mbi këtë pretendim.*

*Për rekomandimin 4.1: Subjekti pretendon se AT kryen periodikisht çdo muaj, por edhe më shumë se një analizë në muaj në raste të veçanta, përveç ndjekjes operacionale ditore të treguesve të realizimit të planit të të ardhurave në nivel tatimi dhe DRT-je. Format i analizave mujore është standard dhe përmbyllja vjetore reflektohet në performancën vjetore të DPT. Bashkëlidhur nuk ka asnjë dokument shkresor mbi pretendimin.*

*Për rekomandimin 5.1: Subjekti pretendon se rekomandimi i lënë me objekt sistemimin e arkëtimeve të paidentifikuara nuk realizohet nga strukturat e DPT, por zhvillohet periodikisht nga DRT dhe automatikisht nga vetë sistemi E-tax. Këto pagesa nuk janë të paidentifikuara pasi sistemi elektronik i pagesave për sistemin E-tax, nuk lejon që të kemi një pagesë të paidentifikuar. Këto pagesa janë me NIPT, lloj tatimi dhe periudhë tatimore të identifikuar, pra përmbajnë të gjitha elementet e identifikimit të një pagese elektronike. Kontabilizimi i këtyre pagesave në llogarinë 4665XXX ndodh sepse në momentin e pagesës tatimpaguesi nuk ka kryer një deklaram të lidhur me këtë pagesë. Sistemimi në këtë llogari bëhet nga DRT dhe DKT, vetëm pasi tatimpaguesi të ketë paraqitur fizikisht dhe elektronikisht një kërkesë për sistemim/kompensim të detyrimeve tatimore me një pagesë të kontabilizuar në llogarinë 4665XXX. E njëjta procedurë zbatohet edhe për sistemet e pagesave në llogarinë 4665510 për kontribute.*

*Për rekomandimin 6.1: Subjekti pretendon se ky rekomandim lidhet me pagesa të vjetra për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të migruara nga sistemi i vjetër tatimor SIT në sistemin e ri E-tax në janar 2015. Sistemi tatimor SIT nuk ka qenë sistem kontabiliteti por thjesht një sistem informatik, në këto kushte kontabilizimi i detyrimeve nuk bëhej sipas rregullave të kontabilitetit me klasat përkatëse në nivel 7 shifror. Migrimi i këtyre detyrimeve nga SIT në E Tax në janar 2015 total, i paidentifikuar se sa janë gjordat sipas llojit kontribute dhe tap, në momentin që këto detyrime paguhen tani me sistemin e ri pagesa është zgjidhur të kontabilizohet si një e vetme gjorbë për pagesë të vonuar kontribute dhe TAP.*

*Për rekomandimin 9.1: Në zbatim të detyrave operacionale, nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së*

Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT, kryhen analiza mujore me DRT të DMDPT. Nga ana e DMDPT kryhet mbikëqyrja operationale e DMDTP Rajonale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për rekomandimin 12.2: Pas vlerësimit është konkluduar se Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal të kundravajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e tatim-taksave. Legjislacioni tatimor dhe ai penal përmbajnë dispozita që listojnë të gjitha veprimet e kundraligjshme. Për ndjekjen e këtyre veprave penale në fushën e tatimeve, Ligji i procedurave tatimore ka krijuar struktura të veçanta, ku punonjësit gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore. Për informacionin e mbledhur nga DHT për tatimpaguesit në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, dokumentimit të shkeljeve konsiderohen konfidenciale dhe mosrespektimi i të këtij detyrimi për administratën konsiderohet si cenim i së drejtës për tatimpaguesin. Tatimpaguesi prezumohet i pafajshëm deri në marrjen e vendimit të formës së prerë të gjykatës, ndaj dhënia e informacionit për të cenon këtë parim dhe dëmton emrin e mirë. Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 25, mosrespektimi i këtij detyrimi konsiderohet si cenim i së drejtës për tatimpaguesin. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 35, pika 2, përcakton “Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj”.

Për rekomandimin 13.2: Drejtoria e Kontrollit gjatë vitit 2020, përveç situatës pandemike, për periudhën gusht - dhjetor 2020 nuk ka patur Drejtor, megjithatë inspektorët e kësaj Drejtorie janë angazhuar:

- Në grupet e punës për pagat e luftës.
- Në realizimin e Kontrollit në DRT Berat dhe Gjirokastrë nr. 19297, datë 06.10.2020
- Në realizimin e Kontrolleve në kuadër të planit Operacional nr. 20409 datë 20.10.2020
- Në ndjekje e grupeve të tjera të punës për Procesin e Rindërtimit, Fiskalizimit etj.
- Asistencën teknike implementimin e ndryshimeve ligjore të ndodhura si pasojë e situatës pandemike (ndryshimet për tatim fitimin, TVSH) etj.

Për rekomandimin 19.1: Ky rekomandim zbatohet normalisht nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së. Stoku dhe rimbursimet raportohen në DFB çdo muaj në evidencën dhe degën e thesarit Tiranë.

Për rekomandimin 22.1: Nga Nëpunësi Zbatues bëhet një rakordim çdo 4 muaj për llogarinë 34 dhe 35 dhe i dërgohet me shkresë përcjellëse Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Nga kjo e fundit, gjatë vitit 2021, në kuadër të vlerësimit të shtypshkrimeve është rishikuar procedura e monitorimit të nevojave reale në lidhje me planifikimin e dokumentacionit tatimor janë marrë masa dhe nuk bëhet asnjë planifikim pa kërkesat e DRT-ve. Lidhur me kontratat e shtypshkrimeve të letrave me vlerë janë marrë masa të bëhen në masë më të vogël dhe më të shpeshta.

Për rekomandimin 23.1: Drejtoria Kontabilitet dhe Statistikës informon se ky është një rekomandim i lënë në vijimësi nga grupet e auditimit të KLSH-së për vitet e audituara 2019 dhe 2020. Referuar ligjit dhe udhëzime në fuqi për Kontabilitetin, kontabilizimet në këto llogari janë konform ligjit dhe nuk ka vend për ndryshime ligjore. Sipas standardeve të Auditimit një rekomandim i lënë nga audituesit, i papranuar dhe i pazbatuar nuk mund të jetë rekomandim për periudhat e tjera për të njëjtin Entitet të Audituar.

Për rekomandimet 3 E, rekomandimi 1.1: Nga Komisioni i Posaçëm gjatë shqyrtimit të vendimeve gjyqësore për zbatimin e tyre, shqyrtohen vendimet gjyqësore, evidentohen problematikat dhe shkaqet për largimet nga puna. Për 74 vendime gjyqësore të formës së prerë që janë shqyrtuar nga KP, nga të cilët janë rikthyer në punë 64 punonjës, rezulton se vendimmarrja për largim nga puna është një vendimmarrje e komisionit të disiplinës si një organ kolegjal dhe është përtej kompetencës së DPT nxjerrja e përgjegjësive.

Për masat disiplinore: Është bërë një analizë e gjetjeve të konstatuara në raportin përfundimtar dhe është konkluduar se nuk ka shkaqe për fillimin e procedimit disiplinor, por janë marrë masa për shmangien e problematikave të evidentuara dhe pranuar. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar këtë rekomandim dhe me shkresën nr. 8715/59, datë 06.04.2022 bashkëlidhur është shprehur në lidhje me zbatimin e tij.



### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, konstaton se për rekomandimet nuk janë sjellë dokumente apo fakte të reja, nga ato që janë trajtuar në akt-konstatim apo projekt raport. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

### ***Në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:***

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Zbatuar</b>	<b>Pjesërisht</b>	<b>Në proces</b>	<b>Pa zbatuar</b>
1	<b>Përmirësime ligjore</b>	2	2			1	1
2	<b>Masa organizative</b>	32	31	8	6	8	9
3	<b>Masa për 3 E</b>	2	2			1	1
	<i>Në vlerë</i>	<b>377,601</b>	<b>377,601</b>			<b>377,601</b>	
4	<b>Masa disiplinore</b>	1	1				1
	<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>36</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>12</b>

### **Titulli i gjetjes:**

Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 298/16 prot., datë 13.10.2021, protokolluar në DPT me nr. 8715/44 prot., datë 15.10.2021 është konstatuar se, DPT me shkresën nr. 8715/45, datë 11.11.2021 òNjoftim mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, bashkëlidhur planin e masave, ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në tejkalim të afatit kohor prej 20 ditë, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe nuk ka raportuar për ecurinë e realizimit të tyre në afatin 6-mujor, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm konstatohet se, nga 37 rekomandime të lëna subjekti ka pranuar plotësisht 31 rekomandime, ose 83.8 % e tyre dhe ka pranuar pjesërisht 5 rekomandime, ose 13.5 % të tyre.

Janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime ose 21.6 %, janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime ose 16.2 %, janë në proces 11 rekomandime ose 29.7 % dhe nuk janë realizuar 12 rekomandime ose 32.4 % e tyre, si më poshtë:

- Janë rekomanduar 2 masa òPropozime për ndryshime apo përmirësime në legjisllacionin në fuqi, të pranuar, nga të cilat një rekomandim nuk është zbatuar dhe një rekomandim është në proces;

- Janë lënë 32 rekomandime òMasa Organizative nga të cilat janë pranuar 26 rekomandime janë pranuar pjesërisht 5 rekomandime dhe nuk është pranuar një rekomandim;

Nga 26 rekomandime të pranuar, 6 rekomandime janë realizuar; 8 rekomandime janë në proces, 2 rekomandime janë në pjesërisht të realizuara dhe 10 rekomandime nuk janë realizuar;

Nga 5 rekomandime të pranuar pjesërisht rezulton se: një rekomandim është zbatuar, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe një rekomandim është në proces;

- Janë lënë dy masa òEliminimin e efekteve negative financiare nga të cilat janë pranuar dhe një rekomandim është në proces dhe tjetri është i pazbatuar;

- Është lënë në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm vlerësimi i

### **Situata:**

	shkeljeve të konstatuara nga auditimi dhe dhënia e masave disiplinore, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se titullari ka vendosur mosfillimin e procedimit disiplinor.
<b>Kriteri :</b>	-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit, neni 15 dhe 30, -Shkresa e KLSH-së nr. 298/16, datë 13.10.2021, protokolluar në DPT me nr. 8715/44prot., datë 15.10.2021, -Shkresa e KLSH-së nr. 513/33, datë 14.10.2021 protokolluar në DPT me shkresën nr. 8715/43prot., datë 15.10.2021
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Rekomandimet e papranuara, të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht ndikojnë në performancën e DPT-së, duke mos përmirësuar situatën e menaxhimit të fondeve dhe pasurisë publike.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe të vijojë marrja e masave nga DPT për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe të pa zbatuara.
<b>Afati:</b>	Menjëherë

## **2.2 Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.**

Nga auditimi u shqyrtua dokumentacioni si në vijim:

- Shkresat e MFE për planin e të ardhurave për tu mbledhur nga administrata tatimore gjatë vitit 2021, bazuar në ligjin 137/2020, datë 16.11.2020 ÷Për Buxhetin e Vitit 2021ö, si dhe ndryshimet përkatëse në planin e të ardhurave;
- Treguesit e të ardhurave për vitin 2021 dhe realizimet, të publikuara nga DPT;
- Raporti vjetor 2021 i publikuar nga DPT;
- Dokumentacione tjera të administruar gjatë auditimit.

### Baza Ligjore

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për Procedurat Tatimore, i ndryshuar,
- Ligji nr. 25, datë 10.05.2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareveö;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 ÷Për buxhetin e vitit 2021ö, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollinö, i ndryshuar;
- Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ÷Për tatimin mbi të ardhuratö, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 ÷Për taksat kombëtareö, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 ÷Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar;
- Akte nënligjore dalë në zbatim të tyre.

### **➤ Planifikimi i të ardhurave tatimore të vitit 2021, ndryshimet, plani përfundimtar dhe shpërndarja e tij sipas Drejtorive Rajonale dhe zërave, miratimi i tyre.**

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Nga auditimi konstatohet se, për planifikimin e të ardhurave vazhdon të ndiqet e njëjta praktikë, ku DPT me përfaqësuesit e saj është pjesë e programit buxhetor të ardhurat tatimore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku dhe hartohen treguesit e të ardhurave në bazë të politikave të qeverisë, ndërsa administratës tatimore i dërgohet plani i të ardhurave i miratuar nga MFE i cili më pas shpërndahet në Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Në këto kushte, në gjykimin e audituesit, u referuam në relacionin e Projekt-Ligjit për Buxhetin e vitit 2021<sup>2</sup> ku referohet se, metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë e tatim. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për vitin 2021 si dhe rritja nominale, deflatori, analiza e importeve në grup produkteve kryesore, analiza e serive kohore si dhe modelet e bazuar në koeficientin e elasticitetit “Buoyancy” dhe “Effective Tax Rate” për çdo taksë. Në planifikim janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Në projekt buxhetin e vitit 2021 programimi i të ardhurave bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet. Në vijimësi projektbuxheti 2021 synon të shpërndajë në mënyrë të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë.

Pra, Kontributi i DPT në planifikimin e të ardhurave tatimore konsiston vetëm në paraqitjen e statistikave mbi të ardhurat tatimore të realizuara të cilat përgatiten në formate standarde, në nivel tepër sintetik, të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin apo mosrealizimin të ardhurave tatimore, në zbatim të misionit të saj si dhe burimeve të vëna në dispozicion.

#### ➤ Detajimi planit të buxhetit të vitit 2021.

Detajimi i planit të buxhetit për të ardhurat nga tatimet në programin 1140 ÷ Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore është bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas shkresave në vijim:

-Shkresa nr. 644 prot., datë 14.01.2021, protokolluar në DPT me nr. 844 prot., datë 18.01.2021 dhe me shkresën nr. 644/1 prot., datë 25.01.2021 ÷ Plani i të ardhurave për administratën tatimore për vitin 2021 ÷,

-Shkresa nr. 655 prot., datë 14.01.2021, protokolluar në DPT me nr. 836 prot., datë 18.01.2021 ÷ Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ÷,

-Shkresa nr. 656 prot., datë 14.01.2021 ÷ Mbi taksën nacionale të tjera ÷, protokolluar në DPT me nr. 835 prot. Datë 18.01.2021.

Tabela në vijim paraqet, planin e të ardhurave tatimore, bazuar në ligjin e buxhetit të vitit 2021 dhe ndryshimet me Aktin Normativ nr. 4, datë 05.02.2021 dhe Aktin Normativ nr. 18, datë 14.04.2021:

Tabela nr. 1

në 000/lekë

	EMERTIMI	Realizimi Faktik 2020	Plani 2021 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2021 sipas Aktit Normativ nr. 4 date 05.02.2021	Plani 2021 sipas Aktit Normativ nr. 18, date 14.04.2021
		1	2	3	
	<b>D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)</b>	<b>235,499,428</b>	<b>262,886,000</b>	<b>264,596,000</b>	<b>266,196,000</b>
<b>A</b>	<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)</b>	<b>141,382,557</b>	<b>166,231,000</b>	<b>167,941,000</b>	<b>168,741,000</b>
<b>1</b>	TVSH (bruto)	46,174,825	56,600,000	58,310,000	<b>58,310,000</b>
	- TVSH (neto)	29,663,293	39,600,000	41,310,000	41,310,000
	- Rimbursimi i kryer	16,511,532	17,000,000	17,000,000	17,000,000
<b>2</b>	Tatim mbi Fitimin	28,358,795	33,031,000	33,031,000	33,631,000
<b>3</b>	Ardhura Personale	37,069,163	41,000,000	41,000,000	41,200,000

<sup>2</sup> www.financave.gov.al/buxheti

4	Taksat Nacionale	11,903,013	14,215,000	14,215,000	14,215,000
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	17,033,877	20,509,000	20,500,000	20,500,000
6	Lojërat e Fatit	726,963	885,000	885,000	885,000
7	Te tjera pa identifikuar	(0.02)		0	0
8	Dënimet Administrative	115,920		0	0
<b>B</b>	<b>Te Ardhurat Tatimore (neto)</b>	<b>124,871,024</b>	<b>149,231,000</b>	<b>150,941,000</b>	<b>151,741,000</b>
<b>C</b>	<b>Kontributet e Sigurimeve</b>	<b>94,116,872</b>	<b>96,655,000</b>	<b>96,655,000</b>	<b>97,455,000</b>
	<b>Tarifa jo Tatimore</b>	<b>-</b>			
<b>D=B+C</b>	<b>TË ARDHURA TOTAL (Neto)</b>	<b>235,951,958</b>	<b>245,886,000</b>	<b>247,596,000</b>	<b>249,196,000</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se plani i rishikuar me dy Aktet Normative të të ardhurave tatimore (Arkëtime) për vitin 2021 është rritur me 19.3% krahasuar me faktin e vitit 2020, ndërsa krahasuar me planin fillestar të vitit 2020 është ulur me rreth 7.2% (i cili ka qenë 280,455,000 mijë lekë, pasi plani përfundimtar është korrigjuar si rezultat e pandemisë Covid-19 në shumën 246,480,000 mijë lekë). Konstatohet se, të ardhurat sipas zërave tatimorë janë rishikuar me rritje në tre zëra të ardhurash, si ÷TVSH bruto, ÷Tatim mbi Fitimin dhe ÷Të ardhurat personale, ndërsa zërat e tjerë nuk kanë ndryshime ose ndryshime në vlera të vogla.

#### ➤ Shpërndarja e Planit të të Ardhurave sipas Drejtorive Rajonale.

Plani i miratuar për të ardhurat tatimore për vitin 2021 detajohet dhe miratohet nga Komiteti i Përbushjes, i cili në vijim është përcjellë me shkresë secilës DRT. Nga auditimi konstatohet se, për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar e njëjta metodologji, mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore. Më konkretisht, plani i ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpërndahet bazuar në Metodologjinë e shpërndarjes së planit në nivel DRT vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës/Spektori i Statistikë Analizë, bazuar në përqindjet historike që zënë të ardhurat e realizuara në raport me totalin e arkëtimeve të tre viteve të fundit, për secilin zë të të ardhurave. Më pas, projektplanin dërgohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Komitetit të Përbushjes dhe më tej për miratim tek Drejtoria e Përgjithshme, procedurë kjo e ndjekur ndër vite nga DPT. Pra, kjo metodologji që DPT përdor për shpërndarjen e planit të të ardhurave, bën një ndarje mekanike të tij, bazuar vetëm në historikun e peshës specifike të secilës DRT, pa përfshirë faktorë të tillë si: struktura e tatimpaguesve sipas llojit, ndryshimet në statusin e tyre, problematikat në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe borxhit tatimor që këto drejtori mbartin, në raport kjo dhe me kapacitetet në dispozicion të secilës DRT.

Pesha specifike e çdo DRT në planin e të ardhurave tatimore, sipas të dhënave të vëna në dispozicion, paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr. 2

Në 000/lekë

Nr.	Drejtoria Rajonale Tatimore	Fakti 2020	Plani 2021 referuar Ligjit të Buxhetit	Plani 2021 Akti Normativ 4 dt 05.02.2021	Plani 2021 Akti Normativ nr. 18, dt 14.04.2021	Diferenca me ligjin e buxhetit në vlerë	Pesha specifike kundrejt planit me ndrysh.
		1	2	3	4	5=4-2	
1	D.R. Tatimore Berat	3,436,374	3,574,000	3,591,000	3,613,000	39,000	1.4
2	D.R. Tatimore Dibra	2,796,761	2,936,000	2,952,000	2,967,500	31,500	1.1
3	D.R. Tatimore Durrësi	13,211,494	14,514,000	14,582,000	14,674,500	160,500	5.5
4	D.R. Tatimore Elbasani	6,521,513	7,029,000	7,065,000	7,114,500	85,500	2.7
5	D.R. Tatimore Fieri	7,481,537	8,165,000	8,217,000	8,275,500	110,500	3.1
6	D.R. Tatimore Gjirokastra	2,659,726	2,626,000	2,638,000	2,646,000	20,000	1
7	D.R. Tatimore Korça	5,240,820	5,530,000	5,554,500	5,597,000	67,000	2.1
8	D.R. Tatimore Kukësi	2,074,051	1,826,000	1,842,000	1,858,000	32,000	0.7
9	D.R. Tatimore Lezha	3,438,400	3,799,000	3,818,000	3,841,000	42,000	1.4
10	D.R. Tatimore Saranda	1,830,667	1,958,000	1,970,000	1,983,500	25,500	0.7
11	D.R. Tatimore Shkodra	5,485,549	5,725,000	5,749,000	5,784,000	59,000	2.2

12	D.R. Tatimore Tirana	87,575,965	98,292,000	98,802,500	99,229,000	937,000	37.3
13	D.R. Tatimore TM	88,708,521	101,536,000	102,417,000	103,179,500	1,643,500	38.8
14	D.R. Tatimore Vlora	5,038,051	5,375,000	5,401,000	5,433,000	58,000	2
	<b>Te Ardhurat Tatimore Bruto</b>	<b>235,499,428</b>	<b>262,886,000</b>	<b>264,596,000</b>	<b>266,196,000</b>	<b>3,310,000</b>	<b>100</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se, DRT Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe ajo e Tiranës zënë peshën më të madhe, përkatësisht 38.7% dhe 37.3% të totalit të ardhurave të vitit 2021, më pas renditet DRT Durrës me 5.5% ndaj totalit, ndërsa DRT-të e tjera, kanë një peshë specifike të ulët ndaj totalit të të ardhurave, duke variuar nga 0.7% (Kukësi dhe Saranda) deri në 3% të tjerat.

### ➤ Realizimi i të ardhurave tatimore sipas llojit të tyre dhe problematika që lidhet me to.

Sipas ligjit për Buxhetin e vitit 2021 dhe bazuar në ndryshimet sipas Akteve Normative përkatëse, respektivisht Aktit Normativ 4, datë 05.02.2021 dhe Aktit Normativ nr. 14, datë 14.04.2021 ðPër disa ndryshime në Ligjin nr. 137/2020, ðPër buxhetin e vitit 2021 ð dhe krahasuar me realizimin faktik 2020, situata paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3

në 000/lekë

	LLOJI I TE ARDHURAVE	FAKTET		PLANI	REALIZIM %	DIFERENCA PLAN – FAKT		DIFERENCA 2021 - 2020	
		2020	2021	2021		(+) (-)	%	(+) (-)	%
A	<b>D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)</b>	<b>235,499,428</b>	<b>274,974,890</b>	<b>266,196,000</b>	<b>103.3</b>	<b>8,778,890</b>	<b>3.30</b>	<b>39,475,462</b>	<b>16.76</b>
B	<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (Arkëtime)</b>	<b>141,382,557</b>	<b>168,708,730</b>	<b>168,741,000</b>	<b>99.98</b>	<b>(32,270)</b>	<b>-0.02</b>	<b>27,326,173</b>	<b>19.33</b>
1	<b>Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)</b>	<b>46,174,825</b>	<b>54,461,470</b>	<b>58,310,000</b>	93.4	(3,848,530)	-6.60	8,286,645	17.95
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	29,663,293	30,359,348	41,310,000	73.49	(10,950,652)	-26.51	696,055	2.35
	<b>- Rimbursimi i kryer (gjithej)</b>	<b>16,511,532</b>	<b>24,102,123</b>	<b>17,000,000</b>	<b>141.77</b>	<b>7,102,123</b>	<b>41.78</b>	<b>7,590,590</b>	<b>45.97</b>
2	<b>Tatim mbi Fitimin</b>	28,358,795	35,664,554	33,631,000	106.9	2,033,554	6.05	7,305,759	25.76
3	<b>Ardhura Personale</b>	37,069,163	43,801,087	41,200,000	106.31	2,601,087	6.31	6,731,924	18.16
4	<b>Taksat dhe Tarifa Nacionale</b>	11,903,013	13,429,960	14,215,000	94.48	(785,040)	-5.52	1,526,947	12.83
5	<b>Taksa Qarkullimi Rrugor</b>	17,033,877	19,706,202	20,500,000	96.13	(793,798)	-3.87	2,672,325	15.69
6	<b>Lojërat e Fatit</b>	726,963	1,534,803	885,000	173.42	649,803	73.42	807,840	111.13
7	<b>Te tjera pa identifikuar</b>	(0.02)	(0)	0	0	-0.02		0.00	0.00
8	<b>Dënimet Administrative</b>	115,920	110,653	0		110,653		(5,267)	-4.54
	<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)</b>	<b>124,871,024</b>	<b>144,606,607</b>	<b>151,741,000</b>	<b>95.3</b>	<b>(7,134,393)</b>	<b>-4.70</b>	<b>19,735,583</b>	<b>15.80</b>
D	<b>Kontributet e Sigurimeve gjithsej</b>	<b>94,116,872</b>	<b>106,266,160</b>	<b>97,455,000</b>	<b>109</b>	<b>8,811,160</b>	<b>9.04</b>	<b>12,149,288</b>	<b>12.91</b>
	<b>Tarifa jo Tatimore</b>	<b>3,037,772</b>	<b>3,826,206</b>					<b>788,434</b>	<b>25.95</b>
E	<b>D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)</b>	<b>218,987,896</b>	<b>250,872,767</b>	<b>249,196,000</b>	<b>100.67</b>	<b>1,676,767</b>	<b>0.67</b>	<b>31,884,871</b>	<b>14.56</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezultojnë se, të ardhurat bruto nga tatimet (Të ardhurat tatimore dhe Kontributet nga Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore) janë realizuar në masën 103.3% kundrejt planit të të ardhurave, ose me tejkalim në shumën 8,778,890 mijë lekë, ndërsa të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për 7,134,393 mijë lekë, ose janë arkëtuar më pak në masën 4.7%. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat bruto janë mbledhur më shumë në masën 16.7%, ose 39,745 milion lekë, ku të ardhurat nga detyrimet tatimore të papaguara në afat janë arkëtuar në shumën 1,654.5 milion lekë, që zënë afërsisht 1% të totalit të arkëtimit.

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezultojnë:

#### A. Të Ardhurat Tatimore (në arkëtim)

Për vitin 2021, të ardhurat tatimore janë programuar 168,741 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 168,708.7 milion lekë, me një mosrealizim prej 32.3 milion lekë, ose 0.02 % më pak, Krahasuar me vitin 2020, në të cilën të ardhurat u realizuan 141,382 milion lekë, të ardhurat e vitit 2021 janë me rritje me 27,326 milion lekë, ose 19.3 % më shumë.

#### Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit.

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2021 dhe faktin e vitit 2020, për periudhën Janar ó Dhjetor 2021, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

#### **A.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (bruto).**

Për vitin 2021 të ardhurat nga TVSH në terma bruto u realizuan në shumën 54,461,5 milion lekë, ose në masën 93.4% të planit, me një mosrealizim në shumën 3,848.5 milion lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2020 është arkëtuar më shumë 8,286.6 milion lekë, ose rreth 18% më shumë.

##### **A.1.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto).**

Për vitin 2021, të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto) ishin programuar në vlerën prej 41,310 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 30,351 milion lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 10,950 milionë lekë, ose 26.5 % më pak. Ndikim në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat ka patur jo vetëm mosarkëtimi i të ardhurave nga TVSH e krijimi i detyrimeve të reja, si ndikim i dy fenomeneve (tërmetit të vitit 2019 dhe Covid 19) por dhe tejkalimi i planit të rimbursimit me 42% të tij.

Krahasuar me vitin 2020, ku u arkëtuan 29,663 milion lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 969 milion lekë më shumë, ose 2.4 % më shumë.

##### **A.1.2 Rimbursimi i TVSH-së.**

Për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 17,000 milion lekë dhe është realizuar në vlerën 24,102 milion lekë me një tejkalim prej 7,102 milion lekë ose 42 % më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 në të cilën janë rimbursuar 16,512 milion lekë, rimbursimet janë realizuar me 7,591 milion lekë më shumë, ose 46% më shumë.

**A.2 Tatimi mbi Fitimin** Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 33,631 milion lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 35,664 milion lekë, me një tejkalim prej 2,033 milion lekë ose 6% më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 28,359 milion lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 7,306 milion lekë më tepër, ose 25.8% më shumë.

**A.3 Tatimi mbi të Ardhurat Personale.** Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 41,200 milion lekë dhe është realizuar 43,801 milion lekë, me një tejkalim prej 2,601 milion lekë ose 6.3 % më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 37,069 milion lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 6,731 milion lekë më tepër, ose 18.2% më shumë.

**A.4 Taksat Kombëtare dhe Tarifa.** Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 14,215 milion lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 13,430 milion lekë, me një mosrealizim 785 milion lekë ose 5.5% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 11,903 milion lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 1,527 milion lekë ose 12.8 % më shumë.

**A.5 Taksa e Qarkullimit Rrugor** Të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 20,500 milion lekë, janë arkëtuar 19,706 milion lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 794 milion lekë ose 3.9% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 17,034 milion lekë, të ardhurat janë realizuar me rritje prej 2,672 milion lekë ose 15.7 % më shumë.

*Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:*

TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 32.3% të të ardhurave tatimore; Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 26 % të të ardhurave tatimore; Tatimi mbi fitimin zë 21.1 % të të ardhurave tatimore dhe Taksa e qarkullimit me 11.7% të të ardhurave tatimore.

## **B. Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**

Për vitin 2021, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 97,455 milion lekë dhe janë realizuar **106,266 milion lekë**, me një tejkalim prej 8,811 milion lekë, ose

9 % më shumë se plani sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021, ndërsa kundrejt buxhetit fillestar kemi një rritje prej 10%.

Konstatohet se në vitin 2021, të të ardhurave nga kontributet, krahasuar me vitin 2020, janë rritur në vlerën për 12,149 milion lekë, ose 12.9% më shumë.

Nga krahasimi i të dhënave statistikore për të ardhurat tatimore të realizuara gjatë vitit 2021 krahasuar me realizimin e vitit 2020, vërehet se ato janë realizuar me shumë, ku ka dhënë efektet e veta implementimi i fiskalizimit, por dhe duhet theksuar se vitin e kaluar ka ndikuar dukshëm pandemia Covid-19.

**Për vitin buxhetor 2021**, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në lidhje me rakordimin e Të ardhurave Tatimore Fiskale mujore dhe progresive për vitin 2021, ku DPT rakordon të ardhurat e arkëtuara në sistemin E-tax dhe të pasqyruara në SIFQ. Në të ardhurat tatimore për vitin 2021 përfshihet edhe e ardhura nga rivlerësimi i pasurisë, tatim i cili bazuar në udhëzimin nr. 2727, datë 4.2.2020 òPër procedurat e zbatimit të Ligjit nr. 90/2019, òPër rivlerësimin e pasurisë së paluajtshmeò dhe përcaktimin e tarifës së shërbimitò derdhet direkt në Thesar në të ardhurat dytësore të DRT-ve në shumën 4,359,669 mijë lekë.

Nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi treguesit analitikë fiskal Janar ó Dhjetor 2021 (adresa zyrtare e MFE)<sup>3</sup> konstatohet se të dhënat e publikuara nga MFE paraqiten me diferenca me raportimet nga DPT për realizimin e të ardhurave, kryesisht në tre zërat kryesorë të të ardhurave e konkretisht: Të ardhurat nga TVSH janë raportuar më shumë nga DPT për 127 milion lekë, të ardhurat nga Tatim Fitimi janë raportuar më shumë për 54 milion lekë, ndërsa të ardhurat nga TAP janë raportuar më shumë për 4,489 milion lekë. Nga sa konstatuar del e domosdoshme rakordimi ndërmjet DPT dhe strukturave përkatëse në MFE për raportimin dhe publikimin e saktë të të dhënave.

#### ➤ Mbi analizën e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje”.

Nga auditimi, u konstatua se në përbërje të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuar sipas natyrës dhe llojit të të ardhurave janë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 òMjete në ruajtjeò e cila përfaqëson **arkëtimet e paidentifikuara me një detyrim në C@TS deri në sistemin e tyre**. Konstatohet se për vitin 2021, vlera e llogarisë 466 òMjete në ruajtjeò, e përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave është në shumën për **27,217 milion lekë**, nga 23,008 milion lekë që ishte në vitin 2020, pra me rritje për 4,209 milion lekë.

Llogaria 466 funksionon në sistemin E Tax për të gjitha deklaratat tatimore në sistem dhe që kontabilizohen të ardhura për lloj tatimi (deklaratë) për të cilën në momentin e procesimit të një pagese ende nuk ka një detyrim të kontabilizuar. Funksionimi i kësaj llogarie përfshin në pjesën më të madhe kontabilizimin e pagesave për këstet e tatim fitimit të cilat nuk kanë një deklaratë në sistem në momentin e pagesës, pasi ajo deklarohet në 3 mujorin e parë të vitit pasardhës me mbylljen e pasqyrave financiare.

Tabela në vijim paraqet raportimin e llogarisë 466 òMjete në ruajtjeò, sipas shkresës nr. 814, datë 19.01.2022, për rakordimin e të ardhurave tatimore dhe kontributin e sigurimeve shoqërore, konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë:

Tabela nr. 4

		Në lekë
<b>4665</b>	<b>Depozitime te tjera (për tu sistemuar në të Ardhmen)</b>	<b>27,216,803,507</b>
<b>4665100</b>	Depozitime te tjera ne ruajtje , Te vitit ushtrimor	-
<b>4665502</b>	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	85,601,751

<sup>3</sup> [www.financave.gov.al/statistika-fiskale-mujore/](http://www.financave.gov.al/statistika-fiskale-mujore/)

4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	26,781,094,476
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	188,933,554
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	644,478
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	1,431,018
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lodrave të fatit	856,420
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	3,018,928
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjobat	3,217,486
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sig shoqërore, shëndet, TAP )	124,824,634
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	27,180,753

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Konstatohet se, lëvizjet më të mëdha kjo llogari i ka në muajin dhjetor të vitit, duke ndikuar në të ardhurat tatimore gjithsej të raportuara nga DPT për periudhën ushtrimore si dhe në saktësinë e raportimit sipas zërave të të ardhurave në llogaritë e dedikuara sipas klasifikimit buxhetor në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 2.3.

*Për sa më lart vlera për 27,217 milion lekë, vetëm për vitin 2021, e mbetur pezull dhe e pa kontabilizuar në llogarinë e të ardhurave paraqet një risk të shtuar në:*

*-realizimin fiktiv të të ardhurave, si pasojë e parapagimeve nga ana e tatimpaguesit me kërkesë të DRT-ve si realizim faktik të ardhurash;*

*Vlera për 124,825 mijë lekë e mbetur pezull dhe e pa kontabilizuar në llogarinë e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ka efekt në:*

*-planifikimin jo të saktë të shpenzimeve nga ana e ISSH dhe FSDKSH-së, pasi kontabilizimi i pagesave të tatimpaguesve në këtë llogari përfaqëson një të ardhur të munguar për ISSH-në dhe FSDKSH-në.*

*-mbartja e kësaj llogarie do të ndikonte në kontributet për pension të individëve pagesa e të cilëve ka mbetur pezull në këtë llogari.*

Nga auditimi konstatohet se, **raportohen** si të ardhura tatimore gjobat e vendosura nga sistemi tatimor, ku për vitin 2021 janë në shumën 633,826 mijë lekë, në kundërshtim Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Llogaria 70 òTatime dhe taksatò, ku citohet òNë këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njëjstive të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimoreò.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara sa më lart, me z. C. K., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe me znj. M. S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nr. 121/42 datë 21.07.2022 òObservacion mbi projekt raportin e auditimit nr. 16/20, datë 17.06.2022ò, protokolluar në KLSH me nr. 20/14, datë 21.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*...llog 466 "mjete ne ruajtje", nuk përfaqëson arketime te paidentifikuara sepse keto jane te gjitha pagesa te identifikuar me një detyrim në sistemin E Tax...Kjo llogari funksionon për kontabilizimin e të ardhurave në sistemin e tatimeve kryesisht (98.4% e totalit) janë pagesa për Tatim fitimin e parapaguar nga tatimpaguesit në vitin kalendarik (këste të tatim fitimit). Në zbatim e funksion të parimit të kontabilitetit për të drejta e detyrime të konstatuara këto pagesa kontabilizohen në llogari të klasës 4 të të ardhurave me kundërparti klasën 520 Disponibilitete në Thesar sepse: Detyrimi për tatim fitimin konstatohet (maturohet) si i tillë në vitin e ardhshëm kalendarik brenda datës 31 Mars kur tatimpaguesit dorëzojnë deklaratën vjetore të ardhura/shpenzime për vitin kalendarik paraardhës.Me dorëzimin e kësaj*



deklarate sistemi merr në konsideratë në momentin e kontabilizimit të deklaratës të gjitha parapagimet e kryera (këste tatim fitimi/parapagime) në vitin e ardhshëm kalendarik dhe bën kontabilizim detyrimi Për diferencë nëse parapagimet janë më pak se rezultati tatimot (detyrim për tu paguar)... Tatimpaguesi printon urdhërpagesën dhe kryen likuidimin në bankë, pagesë e cila kontabilizohet menjëherë në klasën 7 të të ardhurave për tatim fitimin. Funkcionimi i kësaj llogarie 466 Mjete në ruajtje është specifike për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila po me këtë skemë kontabilizimi, të ardhurat i dërgon (elektronikisht) dhe në sistemin Informatik të Qeverisë, sistem i cili është dhe Sistemi i Kontabilitetit për Qeverinë (SIFQ).

Referuar konstatimit tuaj se levizjet me te medha kjo llogari i ka ne muajin dhjetor 2021 nuk qendron dhe nuk ka asnjë pasaktësi në raportim...Muaji dhjetor është muaji i fundit i i tremujorit të katërt afat i cili sipas kërkesave të ligjit per tatimit mbi te ardhurat përbë afatin e fundit për pagesën e kësteve të tatim fitimit të tremujorit...

Lidhur me gjetjen tuaj se gjobat që lidhen me tatime dhe taksa janë përfshië gabimisht në zërin tatime e taksa në shumën 633,826 mijë lekë... është gabim...Raportimi ne evidenca statistikore bëhet në referencë të ligjit bazë të taimëve, për procedurat tatimore i cili përcakton se: "Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për raste e parashikuara nga ky ligj, sipas përcakrimit në neni 6 pika 3...".

### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, pas shqyrtimit të tyre, sqarojmë se:

-Sa i takon pretendimit tuaj për mënyrën e funksionimit e të kontabilizimit nuk kemi asnjë kontestim, por pretendimi juaj nuk merret në konsideratë dhe as shpjegon se përveç sa trajtuar në këtë drejtim të programit të auditimit, nuk na sqaron edhe se, meqenëse tatimpaguesit kanë parapaguar këstet e tatim fitimit sipas tremujorëve dhe me dorëzimin e deklaratës vjetore të ardhura/shpenzime të vitit paraardhës, nga ku rezulton se janë paguar të gjitha detyrimet për tatim fitimin ose tatimpaguesi rezulton me detyrim, atëherë pse në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003, më datën 31.12.2021 paraqitet në shumën 134.4 miliardë lekë dhe me rritje nga viti në vit, ndërsa sipas sistemit C@ts teprica kreditore më datë 31.12.2021 është në vlerën 13.5 miliard lekë.

- Sa i takon kundërshtive për konstatimin mbi fluksin e lartë të pagesave në muajin dhjetor në llogarinë 466xxx lidhur dhe me rishikimin e kësteve të tatim fitimit nuk merren në konsideratë, kjo referuar vetëm shumave të kësaj llogarie të raportuar e rakorduar nga vetë ju me Degën e Thesarit Tiranë (referuar dhe rakordimeve mujore të vëna në dispozicion të grupit të auditimit).

- Sa i takon përfshirjes në realizimin e të ardhurave nga gjobat në sistemin tatimor, **ne kemi trajtuar raportimin e llojit të të ardhurave** sipas klasifikimit ekonomik për efekt të realizimit të të ardhurave dhe referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ÷Llogaria 70ö ku përcaktohet edhe se: ÷...Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimoreö dhe në asnjë rast nuk kemi kontestuar apo trajtuar si parregullsi veprimet kontable të kryera nga ana juaj. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë e do të trajtohen në material.

**Titulli i gjetjes:** Performancë jo të mirë në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

Nga auditimi rezulton se, pavarësisht realizimit bruto të të ardhurave nga tatimet në masën 103.3 % kundrejt planit, të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për 7,134,393 mijë lekë, ose janë arkëtuar më pak në masën 4.7 %, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor, konkretisht:

**Situata 1:**

- Për vitin 2021 të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore, në terma bruto u realizuan në shumën 54,461,470 mijë lekë, ose në masën 93.4 % të planit, me një mosrealizim në shumën 3,848,530 mijë lekë, ndërsa të ardhurat në terma neto, janë realizuar në shumën 30,359,348 mijë lekë nga 41,310,000 mijë lekë që ishin programuar, pra me një mosrealizim në vlerë prej 10,950,652 mijë lekë, ose 26.5 % më pak. Ndikim në

	<p>mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat ka patur jo vetëm mosarkëtimi i të ardhurave nga TVSH e krijimi i detyrimeve të reja, si ndikim i dy fenomeneve ( tërmetit të vitit 2019 dhe Covid 19), por dhe tejkalimi i planit të rimbursimit me 42% të tij.</p> <p>- Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 14,215,000 mijë lekë dhe janë arkëtuar 13,429,960 lekë, me një mosrealizim prej 785,040 mijë lekë ose 5.5 % më pak, ndërsa të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, nga 20,500,000 mijë lekë të programuara, janë arkëtuar në shumën 19,706,202 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 793,798 mijë lekë, ose 3.9 % me pak, në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 137/2020, datë 16.11.2020 për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar, si dhe shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi planin e të ardhurave tatimore.</p> <p>Ligji nr.137/2020, datë 16.11.2020 për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar, nenet 1, 2 dhe 9;</p> <p>Shkresa e MFE nr. 644prot., datë 14.01.2021, protokolluar në DPT me nr. 844 prot., datë 18.01.2021 dhe me shkresën nr. 644/1prot., datë 25.01.2021 për planin i të ardhurave për administratën tatimore për vitin 2021;</p> <p>Shkresa e MFE nr. 655 prot., datë 14.01.2021, protokolluar në DPT me nr. 836 prot., datë 18.01.2021 për planin i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;</p> <p>Shkresa e MFE nr. 656 prot., datë 14.01.2021 për mbi taksën nacionale të tjera, protokolluar në DPT me nr. 835 prot. Datë 18.01.2021.</p>
<b>Kriteri :</b>	
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrealizimi i planit sjell mos arritjen e objektivave të institucionit dhe ndikon në zhvillimin ekonomik në shkallë vendi
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre llojeve të të ardhurave, përfshirë dhe çështjet e planifikimit, me qëllim marrjen e masave për arritjen e objektivave të institucionit dhe shmangien e situatave të tilla në të ardhmen.
<b>Afati:</b>	Në vijimësi
<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë gabimisht në zërin e Tatimeve dhe taksat në shumën 633,826 mijë lekë.
<b>Situata 2:</b>	<p>Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe të raportimit të të ardhurave tatimore konstatohet se, raportohen si të ardhura gjobat e vendosura nga sistemi tatimor gjatë vitit 2021 në shumën 633,826 mijë lekë, ndërsa sipas klasifikimit ekonomik gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat përfshihen në titullin e të ardhurave jo tatimore, përcaktuar kjo në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Llogaria 70 e Tatimeve dhe taksat, ku citohet <i>“Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njëjtit të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimore”</i>.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Llogaria 70 e Tatimeve dhe taksat.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Mos raportim i saktë i të ardhurave tatimore të realizuara sipas llojit
<b>Rëndësia</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e

nevojshme me qëllim saktësimin e vlerës së të ardhurave gjithsej dhe atyre tatimore në mënyrë analitike sipas llojit të tatimeve/taksave të shprehur në raportimet e DPT-së.

**Afati:** Në vijimësi

### **1.3. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 6 i tij përcakton se *ËDetyrim tatimorë quhet ËDetyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.... Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj*. Nenet 88-103 të këtij ligji përcaktojnë përgjegjësinë ligjore të Administratës Tatimore për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Megjithatë, është nën përgjegjësinë e DPT që nëpërmjet drejtorive të saj të garantojë udhëheqjen metodologjike dhe strategjike, zhvillimin e politikave dhe procedurave në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, zhvillimin e planeve operacionale, përcaktimin dhe monitorimin e targeteve operacionale dhe varësinë funksionale mbi Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, me qëllim maksimizimin e arkëtimin të detyrimeve tatimore të papaguara duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që të sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve duke zbatuar me korrektësi legjislacionin tatimor në fuqi, sikundër përcaktohet edhe në Rregulloren e Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me urdhër nr. 193, datë 12.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm. Ky rol në DPT realizohet nëpërmjet **Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP)** e cila është e organizuar me një strukturë prej 12 punonjësish dhe funksionon si vijon:

- Sektori i Monitorimit dhe Analizës me 1 përgjegjës sektori dhe 3 punonjës;
- Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese me 1 përgjegjës sektori dhe 3 punonjës;
- Sektori i Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë me 1 përgjegjës sektori dhe 2 punonjës;

Nga auditimi konstatohet se deri në fund të vitit 2021, DMDTP ka funksionuar me strukturë jo të plotë, me 3 **vende të lira/vakante** (1 përgjegjës sektori në Sektorin e Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë dhe 2 inspektorë në Sektorin e Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese) jo në përputhje me strukturën organike miratuar me urdhrin e Kryeministrit, ku struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është përcaktuar me 12 punonjës (75% e strukturës e plotësuar), situatë kjo që mbart riskun për të çenuar funksionimin e drejtorisë për shkak të kapacitetit jo të plotë të strukturës faktike.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 DPT ka funksionuar sipas Manualit të Mbledhjes me Forcë të DPT-së, Nr. 14, datë 13/01/2017. Në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, në zbatim të Planit Operacional të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe partnerët ndërkombëtar për konsolidimin e Funkcionit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, me

shkresën nr. 11912 Prot., datë 29.06.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është dërguar për zbatim **manuali i rishikuar i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.**

Për vitin 2021, plani operacional i DMDTP si pjesë e Planit Operacional të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është përcjellë me vendim nr. 19, datë 21.12.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve në rolin e Kryetarit të Komitetit Operacional duke përcaktuar drejtimet e më poshtme, në zbatim të të cilave janë marrë edhe masat respektive:

- *Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së detyrimeve tatimore të papaguara.* Kjo është planifikuar të kryhet nëpërmjet kryqëzimit të vazhdueshëm të informacionit me Drejtorinë e Kontrollit, Drejtorinë Ligjore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, Drejtorinë e Proceseve të Biznesit dhe struktura të tjera, me qëllim saktësimin e detyrimeve tatimore të papaguara dhe parandalimin e krijimit të borxheve të reja.

Lidhur me këtë çështje nga ana e drejtorisë është raportuar se është :

- Dërguar shkresë Drejtorisë Teknike dhe Ligjore mbi vendosjen në dispozicion të evidencave të tatimpaguesve, të cilët janë në proces gjyqësor.
- Dërguar shkresë Drejtorive Rajonale Tatimore, ku është kërkuar raportim periodik mujor dhe progresiv të tatimpaguesve që janë në proces gjyqësor.
- Është bashkëpunuar me Drejtorinë e Shërbimit, Sektorin Call Center duke dërguar tatimpaguesit të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet tatimore brenda afateve të caktuara në ligj me qëllim komunikimin me këta tatimpagues për përmbushje vullnetare të detyrimit.
- Në bashkëpunim me Etax Helpdesk, në muajin Mars ka kaluar funksioni i "Kërkesës për Lirimin nga Masat Shtrënguese" nga e tatimpaguesit.
- Është kërkuar informacion nga Drejtoria e Financës lidhur me akordimin e fondit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese.
- Është kërkuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore plotësimi i vakancave në strukturën e Drejtorisë së Mbledhjes.
- Është kërkuar nga Drejtoritë e Kontrollit të kryejnë sistemin e situatave të parregullta, të cilat janë debitore dhe kreditore njëkohësisht.
- Është kërkuar nga DRT-të dërgimi i Njoftim Vlerësimit nga Kontrolli, me qëllim ndjekjen e menjëhershme të detyrimeve tatimore të lindura.
- Është zhvilluar takim me Drejtorinë e Proceseve të Bizneseve mbi evidentimin e proceseve të punës së Drejtorisë së Mbledhjes që mund të automatizohen.
- Është kërkuar në formë shkresore Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës të zbatojë dhe të hedhë në sistem vendimet e apelimit tatimor dhe vendimet e formës së prerë të gjykatave në lidhje me detyrimet tatimore dhe penaltetet, si dhe sistemin e situatave të tatimpaguesit.
- Janë marrë në dispozicion tatimpaguesit me risk, të dalë sipas kritereve të borxhit tatimor në Modulin e Riskut me shkresën nr. 6637 Prot., dt. 12.04.2021 dhe janë përcjellë në rrugë elektronike lista e tatimpaguesve në drejtoritë përkatëse të mbledhjes në rajone.
- Është dërguar shkresë drejtorive të mbledhjes në rajone mbi fillimin e procedurës së falimentit nga sektori ligjor, në rast se vlerësohet përmbushja e kushteve përkatëse.
- Është dërguar email dhe shkresë drejtorive të mbledhjes në rajone, mbi arkëtimin e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- Është dërguar shkresë drejtorive të mbledhjes mbi shqyrtimin e procedurave për tatimpaguesit pasiv me borxhin më të madh dhe që kanë mbi 5 (pesë) vjet që nuk përmbushin detyrimet tatimore.

- Është dërguar shkresë Drejtorisë Teknike dhe Ligjore mbi propozimin pranë MFE-së mbi ndryshimet ligjore lidhur me marrëveshjet me këste.
- Është dërguar shkresë drejtorisë së mbledhjes në Rajonin Verior për zbatimin e procedurës mbi evidentimin e tatimpaguesve, të cilët përmbushin kushtet për fillimin e procedurës së falimentit.
- Është dërguar shkresë drejtorive të mbledhjes në rajone ku është kërkuar marrja e masave më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, me qëllim maksimizimin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore & shëndetësore dhe TAP.

*-Informimi i punonjësve të Administratës Tatimore në kohë reale për ndryshimet në legjislacionin tatimor .*

Gjatë vitit është raportuar se janë trajnuar punonjësit e rinj, të sapo rekrutuar në administratën tatimore mbi organizimin, funksionimin dhe manualin e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Gjithashtu është dërguar me shkresë zyrtare drejtorive të mbledhjes në rajone për zbatim "Manuali i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara".

*- Mundësimi i aksesit në regjistrin publik të Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, ASHK-së, Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Autoritetit të Aviacionit Civil. Regjistri i llogarive bankare.*

Gjatë vitit është përfunduar përditësimi i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara dhe janë trajnuar stafi i DMDTP-së në rajone mbi modulën e ASHK-së për institucionet.

*-Publikimi i informacionit (NIPT, tatimpagues, administrator dhe pronar) për tatimpaguesit me detyrime tatimore të papaguara.*

Lidhur me këtë çështje nga ana e drejtorisë është dërguar shkresë me nr. 1130 Prot., datë 21.01.2021 pranë Komisionerit për te Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, për dhënie opinionit mbi publikimin në web të informacioneve lidhur me tatimpaguesit debitorë. Sipas shkresës me nr. 1130/1 prot. datë 11/02/2021 të Komisionerit, informacionet lidhur me tatimpaguesit debitorë nuk konsiderohen informacione të lejuara për publikim.

Për sa i përket përmirësimit ligjor në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 oPër Procedurat Tatimore o i ndryshuar në lidhje me kthimin në otitull ekzekutiv o të aktit administrativ oNjoftim Vlerësimi Tatimor o për të cilin nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrative e gjyqësor, të iniciuar nga DPT, konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk ka patur asnjë zhvillim të mëtejshëm.

#### *Mbi Inspektimet e Kryera për Mbledhjen e Detyrimeve Tatimore të Papaguara*

Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara , Kreu 2.1.1 oInspektimiö, përcakton se Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtori të Përgjithshme duhet të garantojnë që të gjithë Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve në Rajone të kenë planet e punës dhe objektiva operacionale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara duke kryer plane inspektimi për të kontrolluar nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale; kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhurnuar të debitorëve; kanë ndjekur procedura të përcaktuara të masave shtrënguese. Në zbatim të tij, me shkresën nr. 17897 prot., datë 05.10.2021 është miratuar programi i inspektimit nga Z/v. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me objekt oMbledhja e detyrimeve tatimore të papaguaraö për rajonin Verior dhe Qendror, për periudhën 01.08.2020-31.08.2021. Inspektimi për rajonin Verior është kryer në periudhën 11.10.2021-25.10.2021 dhe projektraporti është dërguar në datën 16.02.2022. Inspektimi për rajonin Verior është kryer në periudhën 08.11.2021-22.11.2021 dhe projektraporti është dërguar në datën 25.02.2022. Nga auditimi konstatohet se programet e inspektimit për këtë periudhë, **nuk kanë përfshirë rajonin Jugor dhe VIP.** Gjithashtu, referuar faktit se edhe një vit më parë nuk janë kryer inspektimet në 4 rajonet/ Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM pranë Drejtorive Rajonale, me argumentin e shpalljes së gjendjes së okarantinësö për Covid 19,

kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

Në **Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara** përcaktohen hallkat e mëposhtme për sigurimin e pagesave të detyrimeve papaguara:

-*“Njoftim dhe kërkesë për të paguar”*: Njoftimi i tatimpaguesit për të paguar detyrimet tatimore, del pas 10 ditëve nga ana e administratës tatimore dhe ky afat fillon të llogaritet nga data kur tatimpaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar atë. Aktualisht sistemi C@TS është programuar për të shënuar fillimin e kësaj faze brenda 3 ditëve nga data kur tatimpaguesi ka patur detyrimin për të paguar. Tatimpaguesi ka mundësi të paguajë detyrimin brenda 10 ditëve nga data e nisjes me postë e këtij njoftim ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit dorazi të njoftimit apo në rrugë elektronike. Pas kalimit të këtij afati, fillon zbatimi i procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve.

- *“Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”*: Si afat i mos pagimit në mënyrë vullnetare i detyrimeve do të merret dita e parë e punës pas datës së vendosur në njoftimin e bërë nga administrata tatimore. Nëse deri në këtë datë nuk është paguar detyrimi tatimor, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore nxjerr urdhër bllokimit të llogarive bankare dhe të llogarisë depozite të tatimpaguesit si masë për garantimin e mbledhjes me forcë. Ky urdhër bllokim i dërgohet bankave të cilat administrata tatimore ka dijeni se tatimpaguesi ka llogarinë e tij. Për ekzekutimin e urdhrit, inspektori përgjegjës i dërgon bankave shumën që do të transferohet, si dhe numrat e llogarive. Nëse pas bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit debitor, detyrimet tatimore janë ende të pashlyera, atëherë Inspektori i Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Masave Shtrënguese, brenda 10 ditëve gjeneron masat e sigurimit të detyrimit tatimore sipas sistemit C@TS dhe në mënyrë shkresore si më poshtë:

- *“Njoftim Tatimpaguesit për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor”*: Ky njoftim bëhet me qëllim që tatimpaguesi të marrë dijeni për vendosjen e masës së sigurimit mbi pasuritë e tij dhe të ketë mundësinë e ushtrimit të të drejtës së ankimit, bazuar në legjislacionin në fuqi.

- *“Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor”*: Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të web-it të administratës tatimore dhe bëhet për faktin, që personat e tretë të marrin dijeni për fillimin e këtyre procedurave, dhe që organet apo institucionet të cilët kanë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit debitor të regjistrojnë detyrimin tatimor të papaguar si barrë mbi këto pasuri, dhe të mos lejojnë kryerjen e transaksioneve për transferimin e pasurive të tatimpaguesit debitor, deri në momentin që detyrimi i papaguar është arkëtuar.

- *“Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese”*: Qëllimi i vendosjes së masave të sigurimit të detyrimit tatimor është mos humbja e pasurisë, apo mos tjetërsimi i saj tek të tretët, pa u paguar më parë detyrimet tatimore. Masat e sigurimit të pasurisë vendosen nëpërmjet barrëve siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit, apo të personave të cilëve ju drejtohet akti i cili bën vendosjen e tyre. Akti me anë të të cilit kërkohet të vendoset hipoteka, i dërgohet Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e tatimpaguesit, apo ku ndodhet selia e tij, si dhe Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kur nga ana e administratës tatimore identifikohen pasuritë e luajtshme mbi të cilat mund të vendoset barra siguruese, Drejtoria Rajonale është përgjegjëse për njoftim pranë Regjistrimit të Barrëve Siguruese për këto pasuri mbi të cilat është vendosur barra siguruese.

-*“Pezullim të aktivitetit në Doganë”*: Në rastet kur tatimpaguesi, si pjesë të aktivitetit të tij tregtar, kryen importe dhe/ose eksporte, nga ana e organit tatimor, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit

ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave, kërkohet si masë siguroese për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar, pezullimi i aktivitetit të operatorit ekonomik, deri në përmbushjen e detyrimeve tatimore.

#### Mbi Marrëveshjet me këste

Neni 77 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar përcakton se kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar në afat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë në çdo kohë marrëveshje pagese me këste, duke renditur më pas hapat dhe procedurat konkrete që duhet të ndiqen nga administrata tatimore. Me ndryshimet ligjore dhe strukturore që ka pësuar DMDTP në zbatim të Urdhrit nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit si dhe pikës 5, të nenit 88, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ndjekja e aktmarrëveshjeve me kusht bëhet tanimë nga Drejtoritë e Kontrollit Tatimor dhe jo nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara pranë Rajoneve. Si rezultat, nga ana e DMDTP në Manualin e Rishikuar të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, **është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e marrëveshjeve me këste**, me argumentin se ky rol nuk kryhet më nga kjo drejtori, por mbetet nën kompetencën e Drejtorive të Kontrollit në rajone. Grupi i auditimit kërkoi informacion nga Drejtoria e Kontrollit në DPT lidhur me këto evidenca ku u konstatua se kjo drejtori nuk i administronte dhe as monitoronte këto të dhëna, dhe gjithashtu procedurat e parashikuara më parë në manualin e mbledhjes me force për akt marrëveshjet nuk ishin bërë pjesë të akteve nënligjore sipas së cilave operon drejtoria. Drejtoria e Kontrollit në DPT e gjeneronte këtë informacion vetëm sipas raportimit të Drejtorive të Kontrollit në Rajone, kur është kërkuar sipas rastit. Si rezultat ky proces lidhur me akt marrëveshjet dhe një regjistër analitik i aktmarrëveshjeve të pagesës me këste, mbi bazën e të dhënave të dërguara nga Rajonet, **ka mbetur i pa mbuluar** si në drejtim të hartimit të akteve nën ligjore për rregullimin e këtij procesi (mjedisit të kontrollit të brendshëm), ashtu edhe në drejtim të kontrollit për të monitoruar atë duke identifikuar edhe risqe të ndryshme (aktivitetet e kontrollit, risku i kontrollit, monitorim, etj). Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është detyruar për administratën tatimore mbështetur në nenin 135 të Ndjerrjes së akteve nënligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, i cili përcakton ndër të tjera se *“Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale të tjera.”*. Ky manual, sikundër është përcaktuar edhe në hyrjen e dokumentit, del në ndihmë të inspektorëve tatimorë gjatë punës së tyre për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Nën gjykimin e grupit të auditimit, ky manual nuk duhet të konsiderohet si një produkt që i përket vetëm DMDTP, por një manual gjithëpërfshirës për të gjithë strukturat e administratës tatimore, dhe që duhet të parashikojë të gjitha hallkat dhe procedurat që do të ndiqen për ndjekjen e detyrimeve (duke përfshirë edhe marrëveshjet me këste), **pavarësisht se nën kompetencën e kujt drejtorie të DPT ato janë**. Sa më sipër, procedura për zbatimin e marrëveshjeve me këste rezulton e pa rregulluar në aktet administrative, manual apo udhëzim të DPT, duke cënuar veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre .

Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, kërkoi informacion nga rajonet për marrëveshjet me këste të lidhura gjatë vitit 2021, ku rezulton të jenë lidhur në total 722 marrëveshje për 658 subjekte me një vlerë totale të detyrimit për të cilin është lidhur marrëveshja në shumën 3,671,219 mijë lekë. Në momentin e lidhjes së marrëveshjes janë paguar si kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit rreth 958,228 mijë lekë (ose 26% e shumës së debisë, për të cilën është lidhur aktmarrëveshja). Gjatë vitit 2021, vlera e arkëtuar nga marrëveshjet e mbartura dhe ato të lidhura rishtazi është 387,604 mijë lekë. Marrëveshjet e anuluar në total janë 232 ku përfshihen

dhe marrëveshjet e lidhura në vitin e mëparshëm. Sipas Rajoneve marrëveshjet e lidhura, pagesat e kryera, pagesat në momentin e lidhjes së AM paraqiten në tabelë:

Në lekë

Drejtoritë Rajonale	Nr. A-M te lidhura	Nr. Subjekteve qe kane lidhur A-M	Vlera totale e debisë për të cilën është lidhur A-M	Pagesa ne momentin e lidhjes A-M (vlera fillestare e pagesës)	Vlera e paguar gjate periudhës nga A-M e mbartura	Nr. A-M te anuluar
Berat	18	18	45,148,299	9,474,189	24,085,124	3
Dibër	33	33	86,756,577	27,724,097	23,941,693	4
Durrës	88	83	335,909,833	85,550,161	62,836,100	30
Elbasan	53	49	72,629,781	24,268,219	27,796,115	15
Fier	66	61	242,227,868	81,139,193	59,719,175	8
Gjirokastrë	30	30	36,151,354	10,228,550	24,841,488	6
Korçë	21	21	25,111,790	6,504,867	-	10
Kukës	8	8	90,393,818	3,839,205	-	4
Lezhe	37	37	67,207,618	18,007,303	26,041,395	5
Sarandë	27	15	10,472,221	3,828,859	4,659,418	10
Shkodër	44	41	263,034,423	77,816,350	35,000,171	16
Tiranë	238	209	1,562,922,162	359,935,573		103
DTM	31	31	801,740,730	238,036,431	85,857,328	7
Vlorë	28	22	31,512,725	11,875,399	12,826,371	11
<b>Total</b>	<b>722</b>	<b>658</b>	<b>3,671,219,199</b>	<b>958,228,395</b>	<b>387,604,378</b>	<b>232</b>

Burimi: DPT

Krahasuar me vitin paraardhës, rezultojnë të kemi një rritje të numrit të akt marrëveshjeve (në vitin 2020 numëroheshin 472 akt marrëveshje për 472 subjekte), dhe një rritje të vlerës totale të debisë për të cilën është lidhur akt marrëveshje me 2,519,767 mijë lekë, më shumë se dyfish krahasuar me vitin paraardhës (në vitin 2020 vlera totale e debisë për të cilën ishte lidhur AM rezultonte në vlerën 1,151,452 mijë lekë për të cilat ishin likuiduar në momentin e lidhjes 417,378 mijë lekë). Për sa i përket vlerës që është mundur të arkëtohet si rezultat i AM, gjatë vitit 2021 janë paguar 157,385 mijë lekë më shumë se viti paraardhës (41% më shumë); dhe janë anuluar 90 AM më shumë krahasuar me vitin 2020, trajtuar më hollësisht në aneksin bashkëlidhur materialit.

#### Mbi vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese

Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, çështja 4.4.6 ÷ Njoftimi për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese, përcakton se me qëllim sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, administrata tatimore duhet të vendosë për marrjen e masave të sigurimit për ekzekutimin e detyrimit duke vendosur masa sigurimi të pasurisë nëpërmjet barrëve siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit. Për këtë çështje udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 ÷ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 91, i tij i cili përcakton se "Për vendosjen e barrëve siguruese administrata tatimore do të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikës dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006, si dhe në përputhje me Udhëzimet e nxjerra nga Kryeregjistruesi i Barreve Siguruese."; ligji nr. 8537, datë 18.10.1999 ÷ Për barrët siguruese, Kreu IV, Regjistri i barrëve siguruese, neni 25 i tij përcakton se ÷ Regjistri i Barrëve Siguruese krijohet për regjistrimin e barrëve siguruese, pretendimeve dhe të drejtave që lindin nga ky ligj ose nga çdo ligj tjetër i cili kërkon ose lejon regjistrimin në Regjistrin e Barrëve Siguruese. Regjistri i Barrëve Siguruese është zyrë që vepron në varësi të Ministrisë së Financave.", ndërsa Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, ÷ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 91, pika 91.2.5 e tij përcakton se ÷ Për vendosjen e barrës siguruese, në rastet kur administrata tatimore ka dijeni për sende të luajtshme në pronësi të tatimpaguesit apo të personave të tjerë ndaj të cilëve ajo ka nxjerrë urdhrin, vendosja e barrës siguruese bëhet sipas Formularit "Njoftimi C61-Regjistrimi i Pretendimeve Shtetërore" të Zyrës së Regjistrimit të Barrëve Siguruese", sipas modelit të



përcaktuar në Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikës dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006ö.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPT **nuk është siguruar regjistrimin e barrës siguruese në R.B.S** nga ana e strukturave përgjegjëse, për shkak se referuar Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nr. 486, datë 29.05.2009, shërbimet që kryhen në Regjistrin e Barrëve Siguruese bëhen kundrejt tarifave dhe këto shpenzime **nuk kanë mundur të mbulojnë me buxhetin e alokuar në dispozicion të DPT**. Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar akordimi i fondeve të nevojshme për të kryer këto shërbime, pasi mos kryerja e pagesave ka kushtëzuar vendosjen e barrëve hipotekore dhe siguruese. Në vijim të tyre nga ana DPT këto kërkesa janë parashikuar tek fondet shtesë drejtuar MFE, por për të cilat nuk janë çelur fonde, duke mos mundur të arrihet një zgjidhje optimale për këtë situatë.

#### Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara

Në seksionin 3.3.1 ÷Kërkesat për evidentim dhe analizë të Manualit përcaktohet se çdo muaj Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrenguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, përgatit raporte dhe analiza lidhur me situatën e detyrimeve tatimore të papaguara të cilat dërgohen brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës në rrugë elektronike dhe brenda datës 14 në rrugë zyrtare pranë DMDTP në DPT, e cila më pas përpunon materialin përmbledhës për të gjitha drejtoritë rajonale si dhe raportin të strukturat drejtuese mbi ecurinë e këtyre detyrimeve.

Situata e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

*Në milion lekë*

DRT	Detyrimet 01.01.2021		Detyrime të shtuara		Detyrime të pakësuara				Detyrimet 31.12.2021		Në proces gjyqësor	
					Arkëtuar		Kthyer për Sistemin					
	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma
Qendror	108,364	90,494	118,152	20,780	94,019	10,493	111	633	117,285	100,147	1,142	9,247
VIP	271	12,509	741	6,375	647	5,211	57	464	308	13,209	96	3,138 <sup>4</sup>
Jugor	30,678	8,458	26,254	2,681	24,123	2,010	221	142	32,588	8,987	166	401
Verior	29,538	11,007	42,282	3,581	29,300	1,997	-	-	42,520	12,591	188	1,512
<b>Totali</b>	<b>168,851</b>	<b>122,468</b>	<b>187,429</b>	<b>33,418</b>	<b>148,089</b>	<b>19,712</b>	<b>389</b>	<b>1,240</b>	<b>192,701</b>	<b>134,935</b>	<b>1,592</b>	<b>14,298</b>

Burimi: DPT

**Shënim:** Rajoni Jugor përfshin DRT- Fier, Vlore, Sarandë, Gjirokastrë, Berat

Rajoni Verior përfshin DRT- Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër


VIP -Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Referuar të dhënave të mësipërme, gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën rreth 122,468 milion lekë që i përket një numri prej 168,851 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 134,935 milion lekë që i përket një numri prej rreth 192,701 subjektsh debitorë. Pra, nëse krahasojmë situatën në fund të vitit 2021 me atë të fillim vitit, rezultojnë një rritje prej rreth 12.5 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 23,850 të debitorëve të shtuar në fund të vitit. Krahasuar me një vit më parë ( ku rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2020 në 31.12.2020 ishte me rreth 5.4 miliard lekë dhe 17,609 subjekte debitorë) kjo rritje paraqitet e konsiderueshme si në drejtim të vlerës së detyrimeve të papaguara, ashtu edhe në numër subjektsh debitorë. Krahasuar me vitin paraardhës, gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2021 rezultojnë **12,467 milion lekë më shumë të vlerës së detyrimeve dhe me një rritje prej 23,850 të numrit të subjekteve debitorë**. Nga auditimi konstatohet gjithashtu se **stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mbledhet) veçanërisht nga subjektet që administrohen nga DRT Qendror ku vlera e detyrimeve të shtuara është rreth 2 fish e atyre të pakësuara.**

<sup>4</sup> Drejtoria Rajonale VIP ka edhe subjekte në vlerë rreth 158 milion lekë në proces apelimi.


Me rritje rezultojnë edhe numri i subjekteve debitorë në proces gjyqësor, i cili deri në fund të vitit 2021 paraqitet në 1,592 subjektësh me një vlerë prej rreth 14,298 milion lekë të detyrimeve të papaguara, pra rreth 130 subjekte më shumë se një vit më parë, dhe me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuar në gjykatë prej rreth 576 milion lekë më shumë. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuar prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,142 subjekte, ndjekur nga DRT VIP me rreth 3,138 miliard lekë për 96 subjekte.

Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara progresive sipas muajve përgjatë vitit 2021 paraqitet në tabelën e mëposhtme:




*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Krahasuar me vitin paraardhës, ecuria sipas muajve rezulton si më poshtë:




*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Sikundër vërehet niveli më i lartë i detyrimeve ka arritur në muajin Shtator (me një vlerë detyrimesh prej rreth 135,007 milion lekë) për t'u ndjekur më pas nga muaji Gusht (me një vlerë detyrimesh prej rreth 134,972 milion lekë) dhe përfundimisht në muajin Dhjetor me rreth 134,934 milion lekë.




*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Për sa i përket stokut të detyrimeve tatimore te papaguara sipas rajoneve, peshën më të madhe e zë Rajoni Qendror me 74% e ndjekur nga VIP-at me 10%, Rajoni Verior me 9% e më pas Rajoni i Jugut me 7%.




*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Referuar të dhënave rezultojnë se detyrimet e shtuara paraqiten në rreth 8,090 milion lekë më shumë për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.



*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Referuar të dhënave rezulton se detyrimet e arkëtuara paraqiten në rreth 1,765 milion lekë më shumë për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.



*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Referuar të dhënave rezulton se detyrimet e kthyera për sistemim paraqiten në rreth 666 milion lekë më pak për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Duke qenë se në sistemin C@TS ekziston Moduli i Menaxhimit të Mbledhjes me Force, ky modul rezulton se vijon të përdoret nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, dhe Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara evidenton vlerën e detyrimeve të borxhit të papaguara vetëm sipas formatit të evidencave. Këto evidenca janë sintetike dhe mbi to nuk mund të kryhen analiza mbi ecurinë e borxhit; efektivitetin e masave në nivel DRT-je; apo procedurat e ndjekura për monitorimin dhe ecurinë e borxhit jashtë sistemit. Në përputhje me pikën 3.3.1 òKërkesat për evidentim dhe analizë, të Manualit, çdo muaj, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtoritë Rajonale duhet të dërgojë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT raporte, evidenca dhe analiza të cilat pasqyrojnë situatën e detyrimeve të papaguara tatimore. Raportimet periodike mujore të Drejtorive Rajonale duhet të dërgohen nga Drejtori i DMDTP në Rajone në rrugë elektronike brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës dhe me postë zyrtare brenda datës 14 të çdo muaji pasardhës pranë DPT/Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT përpunon materialin përmbledhës dhe raporton se strukturat drejtuese mbi ecurinë e këtyre detyrimeve. Raportimet duhet të bëhen sipas evidencave të miratuara mujore dhe progresive të cilat duhet të përfshijnë:

- detyrimet sipas llojit të tatimit
- shtesat dhe pakësimet e detyrimeve
- moshën e detyrimeve
- statusi i tatimpaguesve
- detyrimin e ndare në principale/gjobë/kamatëvonesë
- raporti sipas DRT-ve mujore dhe progresive
- të dhëna të tjera për analiza të thelluara të detyrimeve

Gjithashtu, çdo 3 muaj drejtoritë rajonale përcjellin në DPT analiza mbi ecurinë e detyrimeve të papaguara, duke përfshirë arsyet/faktorët që kanë ndikuar në uljen/shtimin e stokut të detyrimeve të papaguara për periudhën, subjektet që kanë ndikuar më së tepërmi, objektivat dhe pritshmëritë në vijim. Çdo datë 16 të muajit do të merret raporti për TP vetëdeklarues dhe mospagues për llojin e


tatimit TVSh dhe çdo datë 22 të muajit për llojet e tjera të tatimeve. Inspektorët kontaktojnë me tatimpaguesit për pagesën e detyrimeve duke mbajtur evidence për telefonatat/email-et e kryera dhe çdo të premtë përcillet një raport përmblidhës pranë DPT.

## Mosha e detyrimeve të papaguara

*Në mijë lekë*

MOSHA E DETYRIMEVE TË PAPAGUARA NE AFAT DERI NË 31.12.2021							
Periudha	Detyrimet deri 3 muaj	Detyrimet 3 - 6 muaj	Detyrimet 6-12 muaj	Detyrimet nga 1-2 vjet	Detyrimet nga 2-5 vjet	Detyrimet mbi 5 vjet	Total
Detyrime të papaguara në afat	3,552,603	4,265,582	11,902,699	10,505,337	52,380,756	52,327,704	134,934,682
Pesha specifike në %	3%	3%	9%	8%	39%	39%	

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*



*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara vihet re se peshën më të madhe të stokut sipas moshës e zënë detyrimet nga 2-5 vite me peshë 39%, dhe detyrimet mbi 5 vite me peshë gjithashtu rreth 39% (pra me nivele të njëjta për të dyja këto grupe).


Për sa i përket moshës së detyrimeve sipas llojit të tatimit, situata paraqitet si më poshtë:

*Në mijë lekë*

Mosha e borxhit	Tatim mbi të ardhurat personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	106,925	731,561	1,095,675	1,396,009	222,443	3,552,603
borxhi nga 3 - 6 muaj	113,948	1,591,275	822,111	1,396,151	342,087	4,265,582
borxhi nga 6-12 muaj	164,075	4,166,419	5,574,948	1,535,198	462,059	11,902,699
borxhi nga 1-2 vjet	234,816	3,326,728	3,640,358	2,429,534	873,900	10,505,337
borxhi nga 2-5 vjet	699,007	17,952,546	17,037,360	2,671,229	14,020,615	52,380,756
borxhi mbi 5 vjet	911,238	10,984,897	19,519,054	8,315,394	12,597,122	52,327,704
<b>TOTALI</b>	<b>2,230,008</b>	<b>38,753,426</b>	<b>47,689,506</b>	<b>17,743,515</b>	<b>28,518,227</b>	<b>134,934,682</b>

*Burimi: DPT*

### Mosha e detyrimeve sipas llojit të tatimit



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

### Mosha e detyrimeve tatimore sipas llojit në bazë rajoni.

Tabela: Mosha e detyrimeve ó Rajoni Qendror

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime Shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	75,213	269,004	635,892	807,860	123,334	1,911,303
borxhi nga 3 - 6 muaj	94,899	730,991	509,046	990,945	178,178	2,504,059
borxhi nga 6-12 muaj	117,964	3,021,416	4,765,008	1,005,857	249,173	9,159,418
borxhi nga 1-2 vjet	171,553	1,454,987	2,126,878	1,707,852	413,606	5,874,875
borxhi nga 2-5 vjet	599,668	11,895,897	12,955,984	1,708,988	12,286,686	39,447,223
borxhi mbi 5 vjet	711,524	8,508,811	14,340,582	7,089,413	10,600,168	41,250,499
<b>TOTALI</b>	<b>1,770,822</b>	<b>25,881,106</b>	<b>35,333,390</b>	<b>13,310,915</b>	<b>23,851,145</b>	<b>100,147,377</b>

Burimi: DPT

Tabela: Mosha e detyrimeve ó Rajoni VIP

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime Shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	15,674	376,907	185,096	60,371	34,055	672,093
borxhi nga 3 - 6 muaj	4,603	683,465	94,044	13,364	21,036	816,523
borxhi nga 6-12 muaj	12,331	658,843	99,614	48,833	54,449	874,070
borxhi nga 1-2 vjet	18,260	1,327,498	181,088	63,648	193,112	1,783,606
borxhi nga 2-5 vjet	17,352	4,694,956	2,489,958	40,172	925,553	8,167,991
borxhi mbi 5 vjet	2,415	291,691	429,100	15,913	155,480	894,598
<b>TOTALI</b>	<b>70,635</b>	<b>8,033,361</b>	<b>3,478,900</b>	<b>242,301</b>	<b>1,383,686</b>	<b>13,208,882</b>

Burimi: DPT

Tabela: Mosha e detyrimeve ó Rajoni Jugor

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime Shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	15,859	39,286	171,925	382,690	38,908	648,668
borxhi nga 3 - 6 muaj	14,350	110,049	125,302	231,012	127,006	607,719
borxhi nga 6-12 muaj	32,315	96,952	186,615	298,410	106,941	721,233
borxhi nga 1-2 vjet	43,865	155,444	705,864	360,055	218,746	1,483,974
borxhi nga 2-5 vjet	79,103	850,122	745,773	320,117	608,273	2,603,388
borxhi mbi 5 vjet	67,233	571,305	1,309,260	368,601	605,547	2,921,946
<b>TOTALI</b>	<b>252,725</b>	<b>1,823,158</b>	<b>3,244,739</b>	<b>1,960,885</b>	<b>1,705,421</b>	<b>8,986,928</b>

Burimi: DPT

Tabela: Mosha e detyrimeve ó Rajoni Verior

Në mijë lekë

Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
-----------------	--------------------	--	--	--	--	--

	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime Shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	178	46,365	102,762	145,088	26,146	320,539
borxhi nga 3 - 6 muaj	95	66,770	93,719	160,830	15,867	337,281
borxhi nga 6-12 muaj	1,465	389,208	523,711	182,098	51,496	1,147,978
borxhi nga 1-2 vjet	1,138	388,799	626,528	297,979	48,437	1,362,881
borxhi nga 2-5 vjet	2,884	511,570	845,645	601,952	200,103	2,162,154
borxhi mbi 5 vjet	130,066	1,613,090	3,440,112	841,467	1,235,926	7,260,661
<b>TOTALI</b>	<b>135,826</b>	<b>3,015,802</b>	<b>5,632,477</b>	<b>2,229,414</b>	<b>1,577,975</b>	<b>12,591,494</b>

Burimi: DPT

### Detyrimet tatimore sipas statusit të tatimpaguesit

-Subjektet Aktiv zënë 43% të numrit total të subjekteve debitorë me një vlerë prej 46,830 milion lekë ose 35% të masës totale të borxhit.

-Subjektet Pasiv zënë 57% të numrit total të subjekteve debitor me një vlerë prej 88,104 milion lekë ose 65% të masës totale të borxhit.

Numri më i lartë i subjekteve pasiv që përbejnë pjesën më të konsiderueshme të detyrimeve të papaguara, është një tregues edhe për vështirësinë në mbledhjen e këtyre detyrimeve, për sa kohë këto subjekte nuk vijojnë aktivitetin e tyre.

**Tabela :** Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesve

Në mijë lekë

DRT	Subjekte aktiv	Vlera e borxhit për subjektet aktiv	Subjekte pasiv	Vlera e borxhit për subjektet pasiv	Borxhi deri me 31.12.2021	
					Nr.Sub	Vlerë Borxhi
Qendror	43,118	26,882,525	74,167	73,264,852	117,285	100,147,377
VIP	297	11,707,742	11	1,501,141	308	13,208,882
JUG	15,321	4,102,205	17,267	4,884,723	32,588	8,986,928
VERI	23,253	4,137,783	19,267	8,453,711	42,520	12,591,494
<b>Totali</b>	<b>81,989</b>	<b>46,830,254</b>	<b>110,712</b>	<b>88,104,427</b>	<b>192,701</b>	<b>134,934,682</b>


Burimi: DPT

### Detyrimet sipas llojit të Tatimit për vitin 2021

Në mijë lekë

LLOJI I TATIMIT	Gjendja e detyrimeve ne fillim te vitit	Detyrime te shtuara gjate vitit	Detyrime te pakësuar gjate vitit		Vlera gjithsej e detyrimeve ne fund te vitit 2021	Nga këto ne proces gjyqësor
			Arkëtime gjate vitit	Sistemime gjate vitit		
Tatim Fitimi	33,392,452	10,180,491	4,445,066	374,451	38,753,426	2,653,901
TVSH	41,907,068	10,609,595	4,611,780	215,377	47,689,506	8,818,751
Sig.Shoqerore	16,965,800	9,462,064	8,678,969	5,379	17,743,515	1,256,892
TAP	2,058,454	856,422	679,514	5,355	2,230,008	74,354
Te tjera	28,144,637	2,309,619	1,296,749	639,280	28,518,227	1,494,514
	<b>122,468,410</b>	<b>33,418,191</b>	<b>19,712,078</b>	<b>1,239,841</b>	<b>134,934,682</b>	<b>14,298,412</b>

Burimi: DPT




Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, rezulton se zëri TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 35% me një vlerë prej rreth 47,689 milion lekë, ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% ose në vlerën prej rreth 38,753 milion lekë, e më pas zëri ÷Të Tjerao me 21% ose në vlerën prej rreth 28,518 milion lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 13% ose në vlerën prej rreth 17,743 milion lekë., dhe zëri TAP me rreth 2%, ose në vlerën prej rreth 2,230 milion lekë.

Në zërin të tjera, për vitin 2021 u vendos në dispozicion edhe një detajim më i hollësishëm, krahasuar me vitin paraardhës ku përfshihet zëri Tatimi në burim me në vlerën prej rreth 4,682 milion lekë, dhe zëri DIVA rreth 298 milion lekë. Megjithatë, zëri të tjera mbetet ende i pa detajuar në totalin e tij, informacion ky i kërkuar edhe në vitet paraardhëse nga KLSH por që vijon të mos mundësohet të gjenerohet në DPT.

Krahasuar me një vit më parë, sikundër vërehet në tabelën e mëposhtme, kemi një rritje pothuajse të njëtrajtshme në të gjitha llojet e tatimit:

#### Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2020 vs 2021



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Më hollësisht për zërin e Tatim Fitimit, gjendja e detyrimeve në vitin 2021 rezulton 5,360 milion lekë më shumë se viti paraardhës (në vitin 2020 këto detyrime paraqiten në vlerën 33,392 milion lekë); zëri i TVSH-së rezulton 5,782 milion lekë më shumë (në vitin 2020 këto detyrime paraqiten në vlerën 41,907 milion lekë); zëri i Sigurimeve Shoqërore 777 milion lekë më shumë (në vitin 2020 këto detyrime paraqiten në vlerën 16,965 milion lekë); zëri TAP 171 milion lekë më shumë (në vitin 2020 këto detyrime paraqiten në vlerën 2,058 milion lekë) dhe zëri të tjera 373 milion lekë më shumë (në vitin 2020 këto detyrime paraqiten në vlerën 28,144 milion lekë).

#### Tabela -Borxhi i ndare sipas Detyrim/Gjobe/Interes

Në total borxhi sipas llojit i ndarë në detyrim, gjobë dhe interes rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë


DRT	Borxhi ne TOTAL			
	Detyrim	Gjobe	Interes	Total
Qendror	62,911,711	33,465,922	3,769,744	100,147,377
VIP	5,681,214	6,237,990	1,289,678	13,208,882
JUG	5,109,892	3,191,753	685,283	8,986,928
VERI	7,365,484	4,172,274	1,053,737	12,591,494
<b>Totali</b>	<b>81,068,301</b>	<b>47,067,939</b>	<b>6,798,443</b>	<b>134,934,682</b>

Burimi: DPT

Referuar të dhënave në dispozicion lidhur me detyrimet e papaguara deri në fund të vitit 2021, specifikuar sipas zërave përbërës, pesha më e madhe këtyre detyrimeve për secilin zë përbëhet nga



rajoni qendror. Në total për të gjithë rajonet, principali i detyrimeve tatimore të akumuluarua përben rreth 60% të vlerës totale të detyrimeve tatimore, për t'u ndjekur më pas nga penalitetet (gjobat) me 35% dhe 5% kamatëvonesat (interesat).



*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT*

Për sa i përket borxhit të ndarë në detyrim, gjobë dhe interes për secilin lloj të detyrimit, situata për çdo rajon paraqitet si më poshtë:

#### Detyrime

*Në mijë lekë*

DRT	TAP			
	Detyrim	Gjobe	Interes	Total
Qendror	1,325,589	287,994	157,239	1,770,822
VIP	57,671	10,286	2,678	70,635
JUG	146,631	71,086	35,008	252,725
VERI	70,000	33,128	32,698	135,826
<b>Totali</b>	<b>1,599,891</b>	<b>402,494</b>	<b>227,623</b>	<b>2,230,008</b>

*Burimi: DPT*

#### Detyrime Tatim Fitim

*Në mijë lekë*

DRT	Tatim Fitim			
	Detyrim	Gjobe	Interes	Total
Qendror	16,650,122	8,495,237	735,747	25,881,106
VIP	3,511,066	3,338,995	1,183,300	8,033,361
JUG	1,061,368	690,032	71,758	1,823,158
VERI	2,011,389	839,834	164,579	3,015,802
<b>Totali</b>	<b>23,233,945</b>	<b>13,364,097</b>	<b>2,155,384</b>	<b>38,753,426</b>

*Burimi: DPT*

#### Detyrime TVSH

*Në mijë lekë*

DRT	TVSH			
	Detyrim	Gjobe	Interes	Total
Qendror	20,059,909	13,748,692	1,524,789	35,333,390
VIP	1,314,734	2,096,923	67,243	3,478,900
JUG	1,830,750	1,206,573	207,416	3,244,739
VERI	3,134,747	1,792,102	705,628	5,632,477
<b>Totali</b>	<b>26,340,140</b>	<b>18,844,290</b>	<b>2,505,076</b>	<b>47,689,506</b>

*Burimi: DPT*

#### Detyrime Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

*Në mijë lekë*

DRT	SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE			
	Detyrim	Gjobe	Interes	Total
Qendror	9,743,498	2,900,037	667,380	13,310,915

VIP	195,098	36,668	10,535	242,301
JUG	1,300,324	306,632	353,929	1,960,885
VERI	1,664,188	446,345	118,880	2,229,414
<b>Totali</b>	<b>12,903,108</b>	<b>3,689,682</b>	<b>1,150,725</b>	<b>17,743,515</b>

Burimi: DPT

### Detyrime Te Tjera

Në mijë lekë

DRT	Te Tjera			
	Detyrim	Gjobe	Interes	
Qendror	15,132,592	8,033,963	684,590	23,851,145
VIP	602,646	755,117	25,922	1,383,686
JUG	770,819	917,430	17,172	1,705,421
VERI	485,160	1,060,865	31,951	1,577,975
<b>Totali</b>	<b>16,991,216</b>	<b>10,767,375</b>	<b>759,635</b>	<b>28,518,227</b>

Burimi: DPT

### Borxhi sipas burimit të krijimit rezulton si me poshtë:

Në mijë lekë

DRT	Shtesa e borxhit sipas evidencave	Borxh i krijuar nga vetëdeklarimi	Borxh i krijuar nga kontrollet, detyrimet e vlerësuara nga administrata tatimore (njoftim vlerësime, gjoba sistemi etj)
Qendror	868,622	565,758	302,864
VIP	450,006	96,742	353,265
JUG	404,239	283,410	120,829
VERI	228,580	214,024	14,556
<b>Totali</b>	<b>1,951,447</b>	<b>1,159,933</b>	<b>791,514</b>

Burimi: DPT

Në seksionin 3.3.2 ÷ Mbledhja me forcë e detyrimit tatimorë të Manualit përcaktohet se administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara. Kjo mundësohet nga Sistemi C@TS, në të cilin ekzekutohet në gjitha veprimet automatike lidhur me menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara pa ndërhyrje manual nga zyrtarët e tatimeve. Funkcioni i mbledhjes me forcë kryhet në secilën nga DRT që përfshihen në 4 rajonet. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ÷ Për procedurat tatimore në RSHö i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 ÷ Për procedurat tatimore, i ndryshuar parashikojnë instrumentet që DPT duhet dhe mund të përdorë për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor. Për vitin 2021, ka vijuar zbatimi i procedurës në kuadër të rikuperimit të detyrimeve të vetë deklaruara pa u kthyer në borxh në bashkëpunim me Qendrën e Thirrjeve për tatimpaguesit debitorë me qëllim vetë përmbushjen e detyrimit nga ana e tatimpaguesve. Masat shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe arkëtimet gjatë vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Llojet e masave shtrënguese	Masa të vendosura		Detyrim i arkëtuar	
		nr. raste	shuma	nr. raste	shuma
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	44,968	55,233,689	43,486	4,435,874
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	48,203	66,718,566	45,003	4,603,198
3	Urdhër ekzekutime	764	428,266	941	1,063,574
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurorese	17,140	19,414,075	3,163	319,932
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurorese	20,588	15,751,344	2,349	162,878
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	10,265	12,549,003	1,359	159,962
7	Njoftim për vendosjen e barrës sigurorese	10,507	105,644,577	880	146,002
8	Urdhër sekuestrimi	6,885	4,469,416	601	27,656
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	194	520,931	109	29,716
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	9	11,059	1	1,175
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	41	112,563	7	3,526
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	8,382	11,626,229	2,599	853,151

13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	1,994	11,194,068	8	5,357
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore	936	1,278,337	526	586,115

Burimi: DPT

Për vitin 2021, sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, masa shtrënguese që është aplikuar më tepër në numër rastesh ndaj tatimpaguesve është ÷urdhër bllokimi i llogarisë bankare ÷ në 48,203 raste për vlerën prej rreth 66,718 milion lekë detyrim, nga të cilat janë arkëtuar 45,003 raste me 4,603 milion lekë (**vetëm 7% te masave të vendosura për detyrimin**), vlerë kjo e ngjashme me atë të arkëtuar nga ÷njoftim dhe kërkesa për pagesë me 43,486 raste të arkëtuar në vlerën prej rreth 4,435 milion lekë. Për sa i përket masave të vendosura me vlerën më të madhe paraqiten masat për Njoftim për vendosjen e barrës siguroese për të cilat janë vendosur nga ana e institucionit 10,507 raste me vlerën rreth 105,644 milion lekë, për të cilat janë arkëtuar vetëm 880 raste me vlerën rreth 146 milion lekë (**vetëm 1% te masave të vendosura për detyrimin**).

Për sa i përket masave shtrënguese të masa nga rajonet, situatë paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

DMDTP Rajoni Verior periudha 01.01.2021-31.12.2021					
Nr	Llojet e masave shtrënguese	Masa të vendosura		Detyrim i arkëtuar	
		nr. raste	shuma	nr. raste	shuma
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,378	5,032,394	88	21,099
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	1,284	5,455,337	98	435,925
3	Urdhër ekzekutime	200	70,559	65	682,132
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	1,202	1,989,297	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	910	1,750,638	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	760	1,369,644	-	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	1,040	1,980,298	11	2,391
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	194	520,931	109	29,716
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	41	112,563	7	3,526
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	1,187	3,000,185	127	653,686
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	738	2,466,438	4	1,709
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore	649	587,703	182	73,974

Burimi: DPT

Në mijë lekë

DMDTP ne DTM periudha 01.01.2021-31.12.2021					
Nr	Llojet e masave shtrënguese	Masa të vendosura		Detyrim i arkëtuar	
		shuma	nr. raste	shuma	nr. raste
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,232	4,839,212	768	2,233,358
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	59	1,526,053	38	460,337
3	Urdhër ekzekutime	54	270,836	52	270,427
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	18	862,469	1	3,100
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	20	880,502	1	3,100
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	17	362,765	1	3,100
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	16	794,091	1	3,100
8	Urdhër sekuestrimi	5	225,527	0	0
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	0	0	0	0
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në	1	1,176	1	1,175

	zbatim të nenit 98				
<b>11</b>	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	0	0	0	0
<b>12</b>	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	18	827,776	1	3,100
<b>13</b>	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	20	880,502	1	3,100
<b>14</b>	Konfiskim I 50% te xhiros ditore	106	642,436	105	487,147

Burimi: DPT

Në mijë lekë

<b>DMDTP Rajoni Jugor periudha 01.01.2021-31.12.2021</b>					
Nr	Llojet e masave shtrënguese	Masa të vendosura		Detyrim i arkëtuar	
		shuma	nr. raste	shuma	nr. raste
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	3,931	4,296,144	16,773	959,851
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	3,188	4,117,081	5,192	685,623
3	Urdhër ekzekutime	243	72,234	557	103,433
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	627	1,083,158	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	475	1,064,615	-	0
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	554	798,951	-	0
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	516	786,369	-	0
8	Urdhër sekuestrimi	-	0	-	0
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	0	-	0
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	8	9,883	-	0
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	0	-	0
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	550	864,011	195	73,700
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	14	40,701	-	-
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore	181	48,198	139	20,944

Burimi: DPT

Në mijë lekë

<b>DMDTP Rajoni Qendror periudha 01.01.2021-31.12.2021</b>					
Nr	Llojet e masave shtrënguese	Masa të vendosura		Detyrim i arkëtuar	
		shuma	nr. raste	shuma	nr. raste
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	38,427	41,065,939	25,857	1,221,566
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	43,672	55,620,095	39,675	3,021,313
3	Urdhër ekzekutime	267	14,637	267	7,582
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	15,293	15,479,151	3,162	316,832
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	19,183	12,055,589	2,348	159,778
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	8,934	10,017,643	1,358	156,862
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	8,935	102,083,819	868	140,511
8	Urdhër sekuestrimi	6,880	4,243,889	601	27,656
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë				
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98				
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit				
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	6,627	6,934,257	2,276	122,665
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	1,222	7,806,427	3	548
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore			100	4,050

Burimi: DPT

Nga auditimi konstatohet se në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për të dhënat analitike të detyrimeve tatimore të pa paguara në rang subjektesh debitore sipas vlerave respektive të këtyre

detyrimeve, me qëllim analizimin e subjekteve që përbejnë edhe pjesën më të konsiderueshme të këtij stoku, ky informacion nuk u vendos në dispozicion përgjatë periudhës së auditimit në terren.

Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim, gjendja e detyrimeve me 31.12.2021, jashtë sistemit C@TS, krahasimisht me vitin 2020, 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

*Në lekë*

Llog	Emërtimi	Detyrimet tatimore gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2018	Detyrimet tatimore gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2019	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2020	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2021	Diferenca 2021-2020
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	57,942,360	58,993,901	58,993,901.00	56,844,018	(2,149,883.00)
7001	Tatim mbi fitimin	2,883,175	2,883,175	2,772,290.00	2,772,290	-
7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogël		63,750	63,750.00	63,750	-
7009	Tjera tatime	63,750	17,556,858	17,556,858.00	18,655,210	1,098,352.00
7030	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	17,556,858	10,609,113	10,609,113.00	10,609,113	-
7031	Akciza	10,609,113	2,107,792,556	2,107,792,556.00	2,107,792,556	-
7032	Takse mbi shërbimet specifike (Lojëra fati)	2,231,447,296	0	-	-	-
7033	Takse mbi perd. mallrave e lejim veprimtarie		0	-	-	-
7050	Taksa e rrugës		331,675	165,000.00	165,000	-
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	331,675	0	-	-	-
7115	Gjoha dhe kamatëvonesa,sekuestreime e zhëmtime		10,113,513	10,113,513.00	10,113,513	-
75	<b>Sigurime shoqërore e shëndetësore</b>	<b>10,113,513</b>	<b>217,302,943</b>	<b>217,302,943.00</b>	<b>213,798,546</b>	<b>(3,504,397.00)</b>
	<b>Sigurime shoqërore</b>	<b>217,446,554</b>	<b>178,924,414</b>	<b>178,924,414.00</b>	<b>175,781,514</b>	<b>(3,142,900.00)</b>
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	179,144,135	142,287,358	148,345,324.00	105,016,303	(43,329,021.00)
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	143,343,056	36,136,855	30,579,090.00	70,765,211	40,186,121.00
	<b>Sigurime shëndetësore</b>	<b>35,801,079</b>	<b>38,378,529</b>	<b>38,378,529.00</b>	<b>38,017,032</b>	<b>(361,497.00)</b>
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	38,302,419	34,283,457	34,031,663.00	35,524,103	1,492,440.00
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	34,245,402	4,095,072	4,346,866.00	2,492,929	(1,853,937.00)
	Detyrime për te tjera kontribute	4,057,017	0			-
	Të tjera	60,562,530	60,562,530	60,562,530.00	3,468,220	(57,094,310.00)
	Shtypshkrime	1,257,804	1,125,267	1,144,724.00	861,694	(283,030.50)
	1 % Grante	782,460	795,254	1,273,976.00	1,593,423	319,447.12
	Pulla (me çmim blerje)	434,576,110	307,582,788	321,467,297.00	288,222,896	(33,244,401.46)
	<b>Totali</b>	<b>3,045,573,197</b>	<b>2,795,713,322</b>	<b>2,809,818,452</b>	<b>2,714,960,228</b>	<b>(94,858,223.84)</b>

*Burimi: DPT dhe përpunuar nga grupi i auditimit*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nr. 121/42 datë 21.07.2022 òObservacion mbi projekt raportin e auditimit nr. 16/20, datë 17.06.2022ò, protokolluar në KLSH me nr. 20/14, datë 21.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Sqarojmë se rajoni jugor dhe VIP është audituar nga KLSH dhe auditi i brendshëm i DPT, dhe për këtë arsye është parë e nevojshme kryerja e inspektimeve në një moment tjetër për të shmangur kontrollin në të njëjtën kohë. Në lidhje me “Stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm të lartë” sqarojmë se*

*gjatë periudhës të marrë në analizë detyrimet kanë pësuar rritje neto prej 12.5 miliard në krahasim me fillim të vitit, ose e thënë ndryshe stoku është rritur me 10.2%, ku theksojmë se 7 tatimpagues kapin vlerën e 9 miliard; ndër të cilët vetëm dy tatimpagues si rezultati i vlerësimeve tatimore me metoda alternative kanë shtuar detyrimet me rreth 7.4 miliard lekë. DMDTP në rajon ka përgjegjësinë e vendosjes së masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve, dhe nuk është përgjegjëse për krijimin, konstatimin apo shtimin e detyrimeve. Drejtoria e mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajon ka përgjegjësinë e vendosjes së masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore te papaguara dhe nuk është përgjegjëse për krijimin, konstatimin apo shtimin e detyrimeve tatimore.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa trajtuar në këtë observacion, sqarojmë se për sa i përket rritjes së stokut të borxhit, në kushtet kur niveli i pakësimit është më i ulët se i shtimit të borxhit, kjo situatë reflekton edhe efektivitetin e masave shtrënguese. Gjithashtu, në lidhje me analizën e kryer nga ana e Drejtorisë për numrin e subjekteve që përfaqësojnë dhe rritjen me të stokut të borxhit (për të cilat drejtoria duket se pavarësisht se nuk e ka detyrim të bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi sqaruar në observacion, faktikisht i nevojiten këto të dhëna sikundër përcjellë dhe për grupin e auditimit në këtë analizë), sqarojmë se për sa kohë të dhënat analitike të këtij stoku në rang subjektsh debitorë nuk u vendosën në dispozicion, nuk u krijua mundësia për kryerjen e një analize të tij nga ana e grupit të auditimit.

### **Titulli i gjetjes:**

#### **Rritja e detyrimeve të papaguara/evidencat e borxhit sintetike**

#### **Situata 1:**

Nga auditimi konstatohet se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën rreth 122,468 milion lekë që i përket një numri prej 168,851 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit **2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 134,935 milion lekë që i përket një numri prej rreth 192,701 subjektsh debitorë.** Pra, nga krahasimi i situatës në fund të vitit 2021 me atë të fillim vitit, rezulton një **rritje** prej rreth 12.5 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 23,850 të numrit të debitorëve të shtuar në fund të vitit. Krahasuar me një vit më parë (ku rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2020 në 21.12.2020 ishte me rreth 5.4 miliard lekë dhe 17,609 subjekte debitorë) kjo rritje paraqitet e konsiderueshme, si në drejtim të vlerës së detyrimeve të papaguara, ashtu edhe në numër subjektsh debitorë. Krahasuar me vitin paraardhës, gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2021 rezulton **12,467 milion lekë më shumë të vlerës së detyrimeve dhe me një rritje prej 23,850 të numrit të subjekteve debitorë.**

Nga auditimi konstatohet gjithashtu se **stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mblidhet) veçanërisht nga subjektet që administrohen nga DRT Qendror ku vlera e detyrimeve të shtuara është rreth 2 fish më shumë se e atyre të pakësuara.**

Me rritje rezultojnë edhe numri i subjekteve debitorë në proces gjyqësor, i cili deri në fund të vitit 2021 paraqitet në 1,592 subjektsh me një vlerë prej rreth 14,298 milion lekë të detyrimeve të papaguara, pra rreth 130 subjekte më shumë se një vit më parë, dhe me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuara në gjykatë prej rreth 576 milion lekë më shumë. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve, situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuara prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,142 subjekte, ndjekur nga DRT VIP me rreth 3,138 miliard lekë për 96 subjekte.

Gjithashtu, rezulton se evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike, gjë e cila nuk mundëson kryerjen e analizave të detajuara në nivel DRT-je, ku edhe në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për të dhënat analitike të detyrimeve tatimore të pa paguara në rang subjektsh debitorë/tatimpaguesish sipas vlerave respektive të këtyre detyrimeve, me qëllim analizimin e subjekteve që përbëjnë edhe pjesën më të konsiderueshme të këtij

stoku, ky informacion nuk u vendos në dispozicion përgjatë periudhës së auditimit në terren.

**Kriteri:** - Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pika 1 neni 88 ku përcaktohet se *Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor*, Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në hyrje përcakton se *Ky manual del në ndihmë të inspektorëve tatimorë gjatë punës së tyre për mbledhjen e detyrimeve të papaguara* si dhe gjithë dokumenti i është dedikuar procedurave që do të ndiqen në këtë drejtim.

**Ndikimi/Efekti:** Mangësi në masat shtrënguese të implementuara për arkëtimin e detyrimeve të papaguara dhe në drejtim të procesit të monitorimit të borxhit nga momenti i krijimit të tij, deri në mbledhjen me forcë të borxhit tatimor në DRT.

**Shkaku:** Rritja e detyrimeve të papaguara nga ana e tatimpaguesve; Shtesat e detyrimeve tatimore nga vlerësimet dhe rivlerësimet e Administratës Tatimore; Numri i lartë i debitorëve pasiv, apo me moshë të konsiderueshme të këtij detyrimi; Vështirësitë e hasura nga DPT për monitorimin në rang DRT-je dhe sigurimin e evidencave periodike në rang subjektsh nga ana e këtyre strukturave

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** -DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masat për të luajtur një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit dhe marrjen e masave konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuara për uljen e borxhit tatimor, i cili gjatë periudhës objekt auditimi paraqitet me një trend rritës.

- Titullari i DPT të marrë masat për të siguruar nga DRT-të informacionin analitik lidhur me subjektet debitorë, që i përket të dhënave statistikore të raportuara në total nga këto struktura pranë DMDTP, në mënyrë që të kryhet një analizë më e hollësishme nga ana e drejtorisë lidhur me numrin e subjekteve që përbëjnë stokun më të lartë të detyrimeve të papaguara; implementimin e masave shtrënguese nga ana e tyre, duke nxjerrë përgjegjësinë e zyrtarëve përkatës në këtë drejtim.

**Afati:** Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

**Titulli i gjetjes:** **Numri i lartë i detyrimeve tatimore jashtë sistemit C@TS**

**Situata 2:** Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor jashtë sistemit **C@TS në vlerën 2,714,960,228 lekë**, i cili paraqiten me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën **94,858,223 lekë (2,809,818,452 lekë në vitin 2020)**, e cila përbëhet nga detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo të gjitha deklaratat tatimore ishin të informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin në ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore. Pjesën më të madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket periudhës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,107,792,556 lekë i përket vetëm 2 tatimpaguesve, òA.ò SHA në vlerën 2,106,993,328 lekë, subjekt i cili është në administrim të DRT Tiranë dhe subjekti òI.ò, në vlerën 799,228 lekë, subjekt i cili është në administrim të DR Tatimpaguesit e Mëdhenj, dhe sipas informacionit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikave nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem.

Detyrimet jashtë sistemit C@TS për pjesën e të ardhurave tatimore (kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shumën 217,302,943 lekë; tatim mbi të ardhurat personale në shumën 56,844,018 lekë; tatim fitimi në shumën 2,772,290 lekë; të tjera tatime në burim 18,655,210 lekë, etj.), për të cilat janë përgjegjës Drejtoritë Rajonale

Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektorët e kontrollit nga zyra. Këto detyrime më 31.12.2021 paraqiten në vlerën **313,021,440 lekë, të cilat duhej të ishin hedhur në sistemin C@TS**, pasi për to ka module përkatëse, por nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2021 të jenë kryer sistemime vetëm për një pjesë të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale.

**Kriteri:** Ligji nr. 9928, datë 29.04.2004 ðPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ðPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, etj.

**Ndikimi/Efekti:** Ekzistenca e detyrimeve tatimore jashtë sistemit aktual krijon kushte për keqpërdorime të pa analizuara në kohën e duhur; mangësi në raportimin e të dhënave lidhur me debitorët për sa kohë një pjesë e tyre mbahen në sistem, dhe një pjesë jashtë sistemit; gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT

**Shkaku:** Mangësitë e identifikuar në drejtim të hedhjes në sistem të këtyre detyrimeve; mungesa e moduleve në sistem

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** - Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektorët e kontrollit nga zyra të marrë masat për të hedhur në sistemin C@TS detyrimet prej 313,021,439 lekë, për të cilat ka module përkatëse në sistem, proces ky i monitoruar në DPT.  
- Nga ana e DPT të merren masa që të ndiqen sipas dispozitave ligjore në fuqi ndjekja deri në arkëtim e detyrimeve e akcizës të mbajtura jashtë sistemit C@TS në shumën prej 2,107,792,556 lekë, që i përket 2 subjekteve të sipërpërmendur, për të cilët sistemi ekzistues nuk disponon modulin e posaçëm për hedhjen e këtij detyrimi.

**Afati:** Brenda vitit 2022 e në vijimësi

**Titulli i gjetjes:** **Mos përfshirja e akt marrëveshjeve me këste për detyrimet e papaguara në aktet rregullative të DPT**

**Situata 3:** Nga auditimi konstatohet se me rishikimin e Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ndër të tjera është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e **marrëveshjeve me këste**. Këto ndryshime argumentohet se janë kryer në kuadër të riorganizimit të drejtorisë (DMDTP) pasi ky rol nuk do të kryhet më nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, por do të jetë nën kompetencën e Drejtorive të Kontrollit në Rajone. Nga auditimi rezultoi se këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë këto drejtori apo edhe Drejtoria e Kontrollit në DPT dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezultoi i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cënuar kështu veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre.

**Kriteri:** Neni 88, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008; Neni 135 ðNxjerrja e akteve nënligjore i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, i cili përcakton ndër të tjera se ð *Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualët teknike, manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale të tjera.*”. Urdhri nr. 33, datë 12.02.2020

**Ndikimi/Efekti:** Heqja e kësaj çështjeje nga manuali i mëparshëm i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, sjell që akt marrëveshjet me këste për detyrimet e papaguara mbeten tanimë të pa mbuluar në aktet nënligjore ekzistuese.

**Shkaku:** Konfuzioni i krijuar mes strukturave për të përcaktuar përgjegjësinë për hartimin e manualit; Manuali konsiderohet si një produkt që i përket vetëm DMDTP, dhe jo një manual gjithëpërfshirës për të gjithë strukturat e administratës tatimore, që duhet të parashikojë të gjitha hallkat dhe procedurat që do të ndiqen për ndjekjen e detyrimeve



<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtori i Përgjithshëm i DPT, Drejtoria e Kontrollit dhe Drejtoria Teknike Ligjore të marrin masat për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve të pagesës me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore, duke shqyrtuar mundësinë për të përfshirë në manualin ekzistues edhe procedurat përkatëse, apo reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të Drejtorive Rajonale DPT, ku Drejtoria e Kontrollit në DPT të kryejë rolin e saj si udhëheqëse metodologjike e funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimin e punës së DRT-ve për zbatimin, implementimin dhe cilësinë e kryerjes së kontrollit konform legjisllacionit në fuqi.
<b>Afati:</b>	Brenda vitit 2022
<b>Titulli i gjetjes:</b>	<b>Mangësi në drejtim të inspektimeve të kryera në rajone në zbatim të planit operacional.</b>
<b>Situata 4:</b>	Në zbatim të Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Kreu 2.1.1.0 Inspektimi, me shkresën nr. 17897 Prot., datë 05.10.2021 është miratuar programi i inspektimit nga Z/v. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me objekt 0 Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara për Rajonin Verior dhe Qendror, për periudhën 01.08.2020-31.08.2021. Inspektimi për Rajonin Verior është kryer në periudhën 11.10.2021-25.10.2021 dhe projektraporti është dërguar në datën 16.02.2022. Inspektimi për Rajonin Verior është kryer në periudhën 08.11.2021-22.11.2021 dhe projektraporti është dërguar në datën 25.02.2022. Nga auditimi konstatohet se programet e inspektimit për këtë periudhë, nuk kanë përfshirë Rajonin Jugor dhe VIP. Gjithashtu, referuar faktit se edhe një vit më parë nuk janë kryer inspektimet në 4 Rajonet/ Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM pranë Drejtorive Rajonale, me argumentin e shpalljes së gjendjes së okarantinës për Covid 19, kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara në të gjithë territorin e vendit.
<b>Kriteri:</b>	Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Kreu 2.1.1.0 Inspektimi; Plani operacional i DMDTP si pjesë e Planit Operacional të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, miratuar me vendim nr. 19, datë 21.12.2020 të Komitetit të Përbushjes.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektivave të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguar
<b>Shkaku:</b>	Vonesa në finalizimin e raporteve të inspektimeve dhe mos inicim i inspektimeve në disa rajone
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat për finalizimin e inspektimeve për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, në përmbushje të planit operacional, si dhe të garantojë një mbulim sa më të plotë të këtij procesi në të gjithë rajonet.
<b>Afati</b>	Brenda vitit 2022 e në vijimësi

#### **2.4. Mbi deklarin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH.**

Në zbatim të nenit 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Administrata Tatimore Qendrore është e ngarkuar për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar në rolin e agentit tatimor që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare,

pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve. Të ardhurat nga kontributet nënkuptojnë të ardhurat nga pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

**Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.**

- ðPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ð në zbatim të ligjit 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, është detajuar me shkresën e MFE me nr 644 prof., datë 14.01.2021, protokolluar ne DPT me nr. 847 prot., datë 18,01,2021. Referuar kësaj shkrese plani i të ardhurave për ISSH dhe FSDKSH-në për vitin 2021, është në vlerën prej **96,655,000 mijë lekë**.

- Me Aktin Normativ, nr. 4, datë 05.02.2021 ðPër disa ndryshime në Ligjin 137/2020 ð Për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar, nuk ka ndryshim të planit të të ardhurave krahasuar me planifikimin fillestar.

- Me Aktin Normativ, nr. 18, datë 14.04.2021 ðPër disa ndryshime në Ligjin 137/2020 ð Për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar, konstatohet se plani i të ardhurave është në vlerën 97,455,000 lekë, në rritje krahasuar me planifikimin fillestar me 800,000 mijë lekë ose në masën 1 %.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të cilat mblidhen nga DPT për llogari të ISSH-së dhe FSDKSH-së.

**Tabela nr.1 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të sig. shoqërore dhe shëndetësore në 000/lekë**

EMERTIMI	Realizimi Faktik 2021	Plani 2021 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2021 Akti normativ nr 18	Diferenca	Diferenca %
	1	2	3	4=3-2	
<b>Kontributet e Sigurimeve</b>	<b>105,528,898</b>	<b>96,655,000</b>	<b>97,455,000</b>	<b>800,000</b>	<b>1%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizim e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat në bazë të legjislacionit mblidhen nga DPT.

**Tabela nr. 2 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të sig. shoqërore dhe shëndetësore**

Mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2021 Akti Normativ	Realizimi Faktik 2021	%
Berat	2,265,000	2,424,786	107%
Dibër	1,920,000	2,029,441	106%
Durrës	8,860,000	8,968,544	101%
Elbasan	4,386,000	4,640,401	106%
Fier	5,090,000	5,407,360	106%
Gjirokastër	1,745,000	1,852,854	106%
Korçë	3,630,000	3,766,022	104%
Kukës	1,210,000	1,372,218	113%
Lezhe	2,415,000	2,512,332	104%
Sarandë	1,129,000	1,217,694	108%
Shkodër	3,920,000	4,149,278	106%
Tiranë	34,880,000	38,817,612	111%
DTM	22,790,000	24,900,712	109%
Vlorë	3,215,000	3,469,644	108%
<b>Totali</b>	<b>97,455,000</b>	<b>105,528,898</b>	<b>108%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Në realizimin e të ardhurave, si edhe në procesin e planifikimit, peshën specifike më të lartë e ka DRT Tiranë me rreth 37% të totalit dhe DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj me 24%, të totalit të të ardhurave.

Për vitin 2021 të gjitha Drejtoritë Rajonale rezultojnë me tejkalim të planit të të ardhurave, ku tejkalimin më të lartë e kanë DRT-të, Kukës, Tiranë dhe DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Me shkresën nr. 816 prot., datë 19.01.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, mbështetur në Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012, ka dërguar në ISSH të dhënat mbi të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2021, të saktësuar sipas sistemit C@ts në shumën 105,528,899 mijë lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka raportuar dhe të ardhurat nga kamatëvonesat dhe gjobat të detajuar në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr.3 Të ardhurat nga kamatëvonesat dhe gjobat** **në mijë lekë**

Llogari	Përshkrimi	Vlera në lekë
7090101	Kamat vonesa te kontrib te sig. shoqërore	113,889,449
7090104	Kamat vonesa te kontrib te sig. shëndetësore	18,446,322
7115101	Gjoha te sigurimeve shoqërore	267,712,164
7115118	Gjoha te sigurimeve shëndetësore	44,476,054
	<b>Totali I Përgjithshëm</b>	<b>444,523,989</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Për sa më lart, vlera e raportuar si e ardhur nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për **105,973,423 mijë lekë është e përbërë nga Të ardhura nga kontributet në vlerën për 105,528,899 mijë lekë dhe të ardhura të tjera për vlerën 444,523 mijë lekë.**

Me shkresën prot 814 nr., datë 19.01.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, mbështetur në Udhëzimin nr. 25, datë 09.12.2021, ka dërguar evidencën për të ardhurat Tatimore dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore të dhënat mbi të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2021, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë në shumën 105,528,999,095 lekë. Tabela në vijim paraqet realizimin faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2019-2021.

**Tabela nr.4 Realizimi faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2019-2021.** **në 000/lekë**

<b>E M È R T I M I</b>	<b>Realizimi Faktik 2019</b>	<b>Realizimi Faktik 2020</b>	<b>Realizimi Faktik 2021</b>
Të ardhura nga Kontributet e Sigurimeve	94,167,402	94,116,872	105,973,423

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Konstatohet se në vitin 2021, të të ardhurave nga kontributet, krahasuar me vitin 2020, janë rritur në vlerën për 11,856,551 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se, DPT në rakordimin me Thesarin, përfshin si të ardhur nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe të ardhurat nga **kamatëvonesat dhe gjobat** të cilat janë të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Vlera totale e këtyre të ardhurave të përfshira në zërin 0Të ardhura nga kontributet, rezulton në vlerën për 444,523,989 mijë lekë. Tabela në vijim paraqet në mënyrë analitike llogaritë e të ardhurave të përfshira si e ardhur nga kontributet.

**Tabela nr.5 Llogaritë analitike të të ardhurave nga kontributet**

<b>A=1+2+3</b>	<b>75</b>	<b>Kontributet e Sigurimeve Gjithsej</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>1</b>	<b>750</b>	<b>Kontribute nga te punësuarit</b>	
	<b>7500</b>	<b>Kontribute te sektorit buxhetor te punësuar</b>	
	7500100	Sigurime shoqërore	12,300,013,452
	7500200	Sigurime shëndetësore	2,292,566,513
	7500400	Kontribute suplementar	1,382,359,706
<b>1.1</b>	<b>7501</b>	<b>Kontribute te sektorit shtetëror te punësuar</b>	
	7501100	Sigurime shoqërore	1,916,563,224
	7501200	Sigurime shëndetësore	357,276,995
	7501400	Kontribute suplementar	3,506,490
<b>1.2</b>	<b>7502</b>	<b>Kontribute te sektorit Privat te punësuar</b>	

	7502100	Sigurime shoqërore	18,044,556,144
	7502200	Sigurime shëndetësore	4,084,239,914
	7502400	Kontribute suplementar	42,075,601
<b>2</b>	<b>751</b>	<b>Kontribute nga te punëdhënësi</b>	
<b>2.1</b>	<b>7510</b>	<b>Kontribute te sektorit buxhetor te punëdhënësis</b>	
	7510100	Sigurime shoqërore	19,429,075,405
	7510200	Sigurime shëndetësore	2,292,718,627
	7510400	Kontribute suplementar	10,981,365
<b>2.2</b>	<b>7511</b>	<b>Kontribute te sektorit shtetëror te punëdhënësis</b>	
	7511100	Sigurime shoqërore	3,029,298,329
	7511200	Sigurime shëndetësore	357,659,234
	7511400	Kontribute suplementar	79,243
<b>2.3</b>	<b>7512</b>	<b>Kontribute te sektorit Privat te punëdhënësis</b>	
	7512100	Sigurime shoqërore	
	7512200	Sigurime shëndetësore	31,732,898,717
	7512400	Kontribute suplementar	4,084,894,856
	7512999	Kontribute te paidentifikuara	50,316,241
<b>3</b>	<b>752</b>	<b>Kontribute nga te vetëpunësuarit</b>	
<b>3.1</b>	<b>7520</b>	<b>Kontribute nga te vetëpunësuarit</b>	
	7520100	Sigurime shoqërore	3,214,050,719
	7520200	Sigurime shëndetësore	903,768,320
<b>B=5+6+7</b>		<b>Te ardhura të tjera për llogari të kontributeve</b>	
<b>5</b>		<b>Gjoha dhe kamatëvonesa të kontributeve shoqërore</b>	
	7090101	Kamat vonesa te kontrib te sig. shoqërore	113,869,449
	7115101	Gjoha te sigurimeve shoqërore	267,712,164
<b>6</b>		<b>Gjoha dhe kamatëvonesa të kontributeve shëndetësore</b>	
	7090104	Kamat vonesa te kontrib te sig. shëndetësore	18,446,322
	7115118	Gjoha te sigurimeve shëndetësore	44,476,054
<b>A+B</b>		<b>Totali I Përgjithshëm</b>	<b>105,973,423,084</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Për sa më lart dhe referuar Raportit të DPT për vitin 2021, të ardhurat nga Kontributet janë në vlerën për **105,973 milion lekë**.

**Për vitin buxhetor 2021**, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në lidhje me rakordimin e të ardhurave fiskale mujore dhe progresive për vitin 2021.

Nga grupi i auditimit të KLSH me mailin e datës 08.04.2022 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorit të IT, përfaqësues të AKSHI pranë DPT janë dorëzuar të dhënat e konfirmuara në lidhje me të ardhurat nga kontributet shëndetësore dhe shoqërore në sistemin C@ts janë si më poshtë:

**Tabela nr.6 Të ardhurat nga kontributet shëndetësore dhe shoqërore**

**në lekë**

Nr Tatimpaguesish	Nr punonjësve	kutia : 23 Totali për sigurimet shoqërore	kutia : 25 Totali për sigurimet shëndet
134,449	806,031	93,580,151,275	14,808,736,065

Nga këto të dërguar në I.S.SH si më poshtë:

Nr Tatimpaguesish	Nr punonjësve	kutia : 23 Totali i Kontributeve për sigurimet shoqërore (19 + 22)	kutia : 25 Totali i Kontributeve për sigurimet shëndetësore
125,922	790,687	91,409,227,017	14,395,419,467

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga verifikimi rezulton se të dhënat e konfirmuara në lidhje me të ardhurat nga kontributet shëndetësore dhe shoqërore në sistemin C@ts janë në shumë 105,804,647 mijë lekë, ndërsa të ardhurat e rakorduara me Thesarin, përfshirë si të ardhur nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe të ardhurat nga kamatëvonesat dhe gjokat janë në vlerën 105,973,423 mijë lekë, me një diferencë prej 168,777 mijë lekë.

Nga grupi i auditimit janë kërkuar pranë personit të kontaktit për t'u adresuar sipas personave përgjegjës në DPT në datat 25.03.2022 dhe 05.04.2022, një sërë kërkesash në lidhje me të ardhurat tatimore si më poshtë:

1. Planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2021
2. Llogarinë analitike të të ardhurave të përfshira si e ardhur nga kontributet viti 2021
3. Të ardhurat nga kontributet sipas sektorëve të punësimit viti 2021
4. Realizimin e planit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2021 FSDKSH
5. Realizimin e planit të kontributeve shoqërore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2021 ISSH
6. Detyrimet e pasqyruara sipas sistemit E Tax të DPT-së që përfshin të Dhënat e DPT-së, së bashku me të dhënat e DRT-ve të cilat mbahen jashtë sistemit E-Tax. (detyrime gjendje 2020, detyrime gjendje 2021, detyrime te vitit 2021, detyrime para vitit 2021)
7. Lista e debitorëve të kontributeve shëndetësore (FSDKSH) sipas rajoneve
8. Peshën që zënë debitorët e kontributeve shëndetësore mbi realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2021
9. Lista e debitorëve të kontributeve shoqërore (ISSH).(detyrime gjendje 2020, detyrime gjendje 2021, detyrime te vitit 2021, detyrime para vitit 2021)
10. Peshën që zënë debitorët e kontributeve shoqërore mbi realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2021
11. Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2021 (sektori shtetëror dhe privat)

Nga dokumentacioni i mbërritur në datën 28.04.2022 rezultuan të paplota informacionet e kërkuara në lidhje me raporte analitike të të ardhurave, listës së debitorëve dhe listëpagesat, ku nga shpjegimet e bëra më mailit të datës 06.04.2022 rezulton se transferimi i listëpagesave në ISSH nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës.

Nga verifikimi i marrëdhënieve ndërinstitucionale midis ISSH dhe DPT, konstatojmë se, në zbatim të pikës 5.19, të kreut 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014, òAdministrata tatimore dërgon në organet përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimeve të kujdesit shëndetësor, të dhënat për kontributet siç përcaktohet në Vendimin përkatës e Këshillit të Ministrave. Administrata tatimore dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të dhënat mujore dhe progresive për kontributet e papaguara në afat, në mënyrë të përmbledhur dhe për çdo tatimpaguesë

- dhe të kreut II Objekti i Marrëveshjes e konkretisht të nënpikës öivö, shkronja öaö, të kreut II, të öMarrëveshjes së Bashkëpunimitö nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr. 11422, datë 19.5.2017, ndërmjet DPT dhe ISSH ödërgimin në format elektronik e të dhënave për detyrimet kontributeve progresive të papaguara për çdo subjekt debitorö.

### **Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (FSDKSH)**

-öPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreö në zbatim të ligjit 138/2020 öPër buxhetin e vitit 2021ö, është detajuar me shkresën e MFE me nr. 644 prot., datë 14.01.2021, protokolluar ne DPT me nr. 847 prot., datë 18.01.2021. Referuar kësaj shkrese plani i të ardhurave për FSDKSH-në për vitin 2021, është në vlerën për **13,540,000 mijë lekë**.

-öPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreö në zbatim të ligjit 138/2020 öPër buxhetin e vitit 2021ö, i ndryshuar është detajuar me shkresën e MFE me nr. 5249 prot., datë 18.03.2021, protokolluar ne DPT me nr. 5597 prot., datë 18.03.2021. Referuar kësaj shkrese plani i të ardhurave për FSDKSH-në për vitin 2021, është në vlerën për **13,678,000 mijë lekë**.

- ðPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit 138/2020 ðPër buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar është detajuar me shkresën e MFE me nr. 8446 prot., datë 12.05.2021, protokolluar ne DPT me nr. 8631 prot., datë 14.05.2021. Referuar kësaj shkrese plani i të ardhurave për FSDKSH-në për vitin 2021, është në vlerën për **13,679,000 mijë lekë**.

Tabela në vijim, paraqet planifikimin dhe realizimin e planit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale

**Tabela nr.7 Planifikimi dhe realizimi i planit të kontributeve shëndetësore sipas D.R.T mijë lekë**

Drejtoritë Rajonale	Plani ndryshuar date 12.05.21	Realizimi Faktik 2021	Diferenca	%
D. R. T. Berat	320,941	330,332	9,391	103%
D. R. T. Dibër	270,896	258,158	-12,738	95%
D. R. T. Durrës	1,247,026	1,210,565	-36,461	97%
D. R. T. Elbasan	619,956	630,108	10,152	102%
D. R. T. Fier	719,143	742,350	23,207	103%
D. R. T. Gjirokastrë	246,307	241,077	-5,230	98%
D. R. T. Korçë	513,611	513,206	-405	100%
D. R. T. Kukës	170,714	171,574	860	101%
D. R. T. Lezhe	339,639	338,359	-1,280	100%
D. R. T. Sarandë	160,006	170,956	10,950	107%
D. R. T. Shkodër	553,757	556,619	2,862	101%
D. R. T. Tirane	4,892,671	5,275,827	383,156	108%
D.T.M	3,171,167	3,486,093	314,926	110%
D. R. T. Vlore	453,165	467,897	14,732	103%
<b>Totali</b>	<b>13,679,000</b>	<b>14,393,122</b>	<b>714,121</b>	<b>105%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Referuar planifikimit të të ardhurave nga kontributet me shkresën e DPT-së nr. 8631, datë 14.05.2021, rezulton se të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore për vitin 2021, janë realizuar në masën 105%.

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2021 dhe krahasimi me vitin paraardhës.

**Tabela nr.8 Planifikimi i kontributeve shëndetësore sipas D.R.T mijë lekë**

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2020	Realizimi Faktik 2021	Diferenca	%
D. R. T. Berat	304,172	330,332	26,160	109%
D. R. T. Dibër	240,756	258,158	17,402	107%
D. R. T. Durrës	1,105,463	1,210,565	105,102	110%
D. R. T. Elbasan	574,053	630,108	56,055	110%
D. R. T. Fier	657,336	742,350	85,014	113%
D. R. T. Gjirokastrë	225,872	241,077	15,205	107%
D. R. T. Korçë	488,589	513,206	24,617	105%
D. R. T. Kukës	164,576	171,574	6,998	104%
D. R. T. Lezhe	302,457	338,359	35,902	112%
D. R. T. Sarandë	152,211	170,956	18,745	112%
D. R. T. Shkodër	501,860	556,619	54,759	111%
D. R. T. Tirane	4,622,339	5,275,827	653,488	114%
D.T.M	3,189,610	3,486,093	296,483	109%
D. R. T. Vlore	414,191	467,897	53,706	113%
<b>Totali</b>	<b>12,943,485</b>	<b>14,393,122</b>	<b>1,449,637</b>	<b>111%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Realizimi i planit për vitin 2021 krahasuar me vitin paraardhës rezulton në rritje me 1,449,637 mijë lekë ose rreth 11% më shumë. Nga tabela evidentohet se efektin më të madh në realizimin e planit e ka Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj e cila ka një realizim të planit në masën 109% dhe që përfaqëson 25% të të ardhurave e ndjekur nga DRT Tiranë në masën 114% të planit dhe që përfaqëson 37% të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

**Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore (ISSH)**

-oPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit 137/2020 oPër buxhetin e vitit 2021, është detajuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr. 644/645 prot, datë 14.01.2021, protokolluar nga D.P.T me shkresën nr. 847 prot., datë 18.01.2021. Referuar kësaj shkrese, plani i të ardhurave për ISSH-në për vitin 2021, është në vlerën për **83,115,000 mijë lekë**.

-oPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit 137/2020 oPër buxhetin e vitit 2021, i rishikuar është detajuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 5249 prot, datë 18.03.2021, protokolluar nga D.P.T me shkresën nr. 5597prot., datë 19.01.2021. Referuar kësaj shkrese plani i të ardhurave për ISSH-në për vitin 2021, është në vlerën për **82,977,000 mijë lekë**.

-oPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit 137/2020 oPër buxhetin e vitit 2021, i rishikuar është detajuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 8446 prot, datë 12.05.2021, protokolluar nga D.P.T me shkresën nr. 8631prot., datë 18.05.2021. Referuar kësaj shkresë plani i të ardhurave për ISSH-në për vitin 2021, është në vlerën për **83,776,000 mijë lekë**.

Të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2021, janë dërguar pranë ISSH-së me shkresën nr. 736, datë 15.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2021, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore është realizuar në masën për **80,786,625 mijë lekë**. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

**Tabela nr. 9 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga kontributet**

*mijë lekë*

	E M E R T I M I	Plani 2021 referuar Ligjit te buxhetit	Plani 2021 Akti normativ nr. 28	Realizimi Faktik 2021	Ndryshim fakt-plan-
		1	2	3=2-1	
C	Kontributet Sig.shoqërore	83,115,000	83,776,000	91,135,777	108%

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2021.

**Tabela nr. 10 Realizimi i të ardhurave nga kontributet sipas DRT**

*mijë lekë*

Drejtoritë Rajonale	Plani 2021 i ndryshuar date 18.05.21	Realizimi Faktik 2021	%
Berat	1,944,059	2,094,454	108%
Dibër	1,649,104	1,771,283	107%
Durrës	7,612,974	7,757,979	102%
Elbasan	3,766,044	4,010,293	106%
Fier	4,370,857	4,665,010	107%
Gjirokastrë	1,498,693	1,611,777	108%
Korçë	3,116,389	3,252,816	104%
Kukës	1,039,286	1,200,645	116%
Lezhe	2,075,361	2,173,973	105%
Sarandë	968,994	1,046,738	108%
Shkodër	3,366,243	3,592,660	107%
Tiranë	29,987,329	33,541,785	112%
DTM	19,618,833	21,414,619	109%
Vlorë	2,761,835	3,001,746	109%
<b>Totali</b>	<b>83,776,000</b>	<b>91,135,777</b>	<b>109%</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se, Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2021, janë realizuar në masën 109%, ku konstatohet se, efektin më të madh në realizimin e planit,

e ka Drejtoria e Tatimeve Tiranë e cila ka një realizim të planit në masën 112% dhe që përfaqëson 36% të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e ndjekur nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj në masën 109% të planit dhe që përfaqëson 24% të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

### Mbi listën e debitorëve të kontributeve shoqërore (ISSH).

Nga auditimi i marrëdhënies ndërinstitucionale midis ISSH dhe DPT konstatohet se:

A. Nga ana e DPT në lidhje me listëpagesat e kontributeve, deri më datë 22.01.2022, janë dërguar në ISSH gjithsej 10,953,766 listëpagesa, të formatit elektronik që i përkasin periudhës kohore 2012 ó 2021, nga këto:

1. Për vitin 2012 janë 718,190 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
2. Për vitin 2013 janë 822,975 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
3. Për vitin 2014 janë 913,539 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
4. Për vitin 2015 janë 1,102,361 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
5. Për vitin 2016 janë 1,281,403 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
6. Për vitin 2017 janë 1,241,279 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
7. Për vitin 2018 janë 1,261,172 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
8. Për vitin 2019 janë 1,260,577 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
9. Për vitin 2020 janë 1,261,131 listëpagesa (për periudhën janar ó dhjetor);
10. Për vitin 2021 janë 1,091,140 listëpagesa (për periudhën janar ó dhjetor);

Tabela në vijim paraqet vlerën totale të debitorëve të kontributeve shoqërore sipas grupimeve të subjekteve debitorë në: buxhetorë, jobuxhetorë, biznes i madh dhe biznes i vogël

**Tabela nr.11 Debitorët për kontribute sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** **mijë lekë**

Nr.	EMËRTIMI	Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë deri më 31.12.2021		Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë (deri më 31.12.2020)		Diferencat krahasuese të datës 31.12.2021 me datën 31.12.2020	
		Nr. i subjekteve debitorë	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë	Nr. i subjekteve debitorë	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë	Nr. i subjekteve	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë
1	Buxhetorë	384	341,464	491	385,683	(107)	(44,219)
2	Jobuxhetorë	279	449,096	296	339,582	(17)	109,514
3	Biznes i Madh	25,074	9,590,979	24,940	9,143,609	134	447,370
4	Biznes i Vogël	77,891	5,485,198	71,106	4,523,247	6,785	961,951
	<b>SHUMA</b>	<b>103,628</b>	<b>15,866,737</b>	<b>96,833</b>	<b>14,392,121</b>	<b>6,795</b>	<b>1,474,616</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Nga analiza e tabelës (një subjekt identifikohet si debitor nga mospagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore në momentin kur pagesa e kryer është më e vogël në vlerë se vlera e përcaktuar në Deklaratën e Listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurave nga TAP-i.), shihet se ka një rritje të konsiderueshme të numrit të subjekteve debitorë, prej 6,795 mijë subjektësh si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,474,616 mijë lekë nga viti 2020 në vitin 2021.

Në analizë të detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë, në organet tatimore, vihet re numri i lartë i subjekteve debitorë dhe detyrime të mëdha, për kontribute të papaguara nga këto subjekte. Numri i tyre deri më 31.12.2021 është 103,628 mijë subjekte debitorë dhe detyrimet kontributeve të prapambetura të tyre janë rreth 15.8 miliard lekë nga 14.4 miliard lekë që ishin deri në fund të vitit 2020.



## **2.5. Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.**

Për auditimin e këtij drejtimi të auditimit në Drejtorinë e Rimbursimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i kërkesave për rimbursimin e TVSH-së sipas sistemit C@TS dhe sistemit Excel të mbajtur manualisht;
- Lista mujore e rimbursimeve dhe evidenca statistikore mbi rimbursimin e TVSH-së 12 mujore të DRTVSH-së dërguar për Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit/ Sektori i Analizës dhe Statistikës në DPT;
- Raportim mbi gjendjen e stokut të rimbursimit në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit,
- Shkresat e Drejtorisë së Thesarit Tiranë;
- Praktikat dokumentare të tatimpaguseve.

### Baza ligjore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar Ligji nr. 92/2014 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar,
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 ÷Për Buxhetin e Vitit 2021, i ndryshuar,
- VKM nr. 953, datë 29.12.2014 ÷Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar,
- Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar,
- Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar,
- Udhëzimi nr. 19, datë 3.11.2014 ÷Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuar, i ndryshuar.
- Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së, miratuar më urdhërin nr. 19/1, datë 28.04.2020, ndryshuar me Vendimin nr. 27, datë 13.10.2021, hyrë në fuqi më 09.11.2021.

**Rimbursimi i TVSH-së:** Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së (DRTVSH) është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.

Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:

- Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSh-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
- Të kryejë procedurën e rimbursimit të TVSh-së bazuar në analizën e riskut;
- Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim të TVSH-së është bërë:

- nga organizatat jofitimprurëse për TVSH-në e paguar në blerje, për mallra të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit si pjesë e veprimtarisë së tyre bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme;
- nga çdo udhëtar jo i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për blerje mallrash të destinuara për tu transportuar në bagazhin personal të udhëtarëve;
- në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, në bazë të parimit të reciprocitetit për TVSH-në e paguar për blerjet brenda vendit nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre.

DRTVSH, me qëllimit automatizimin e procesit të rimbursimit në kohë të kërkesave të regjistruara pranë DRTVSH-së dhe uljen e numrit të kërkesave të cilat dërgohen për kontroll para rimbursimit, ka propozuar ndryshime/lehtësime në kriteret që analizohen gjatë procedurës së rimbursimit nga DRTVSH, por disa prej tyre nuk kanë mbështetje ligjore. Kështu, në Rregulloren e Drejtorisë së Rimbursimit miratuar me vendimin nr. 27, datë 13.10.2021, në mënyrën e trajtimit të kërkesës për rimbursim dhe kontrollet që duhet të kryhen, konstatohet se: Kontrolli nr. 2 òA është referuar në Prokurori tatimpaguesi gjatë 5 viteve të fundit nga strukturat kompetente hetimore bazuar në dyshimet e konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave apo evazionit fiskalë dhe Kontrolli nr. 4 òA është kërkesa për rimbursim më e madhe se 100 milion lekë, nuk gjejnë mbështetje në VKM nr. 953, datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, duke krijuar hallka të tepërta në këtë proces.

Gjithashtu, në këtë rregullore por dhe në rregulloren e miratuar më urdhërin nr. 19/1, datë 28.04.2020, e ndryshuar, në rastet e përcaktimit të subjekteve me risk, kalohen për kontroll në vend dhe për kontroll nga zyra, ku ky i fundit gjykojmë se është thjesht formal, pasi nuk kryhet procesi i inventarizimit në subjekt, si një ndër proceset kryesore të kontrollit, kjo duke ju referuar dhe 381 kontrolleve nga zyra për rimbursimin e TVSH-së me një vlerë të kërkuar prej 1,254 milion lekë, ku gjetjet nga këto kontrolle nuk janë materiale.

**Kërkesat:** Gjatë vitit ushtrimor 2021, pranë DRTVSH-së në DPT janë regjistruar **1,643 kërkesa** për rimbursim të TVSH-së, nga 1,476 kërkesa të regjistruara në 2020, me vlerë totale **21,726 milion lekë**, nga 21,620 milion lekë në 2020.

Gjithsej janë pranuar **1,220 kërkesa** (nga 1,066 kërkesa të pranuar në 2020), me një rritje në numër rreth 14.4% krahasuar me 2020, me vlerë **16,496 milion lekë** (nga 15,550 milion lekë në 2020), me një rritje në vlerë rreth 6.1% krahasuar me 2020, dhe **423 kërkesa** me vlerë **5,230 milion lekë** (nga 410 kërkesa në 2020, me vlerë 6,070 milion lekë), **nuk janë pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjore.

- Nga 1,220 kërkesa të pranuar, **61 kërkesa** me vlerë **595 milion lekë** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues me Risk Zero, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;

- Nga 1,220 kërkesa të pranuar, **682 kërkesa** me vlerë **7,769 milion lekë** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;

- Nga 1,220 kërkesa të pranuar, **477 kërkesa** me vlerë **8,132 milion lekë** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si jo-eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e kërkesës.

**Rimbursimet:** **Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, janë rimbursuar në total (FIFO + Këste) 24,101 milion lekë, rreth 46 % më shumë se në vitin 2020 (nga 15,608 milion lekë të rimbursuar në 2020) dhe duke tejkalluar planin me 17,000 milion lekë, ose rreth 42 % më shumë se plani i miratuar me ligjin vjetor të buxhetit 2021.**

Janë miratuar dhe rimbursuar **1,244 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO (nga 1,008 kërkesa të pranuar në 2020), me një rritje në numër rreth 23 % krahasuar me 2020, me vlerë totale për rimbursim **13,347 milion lekë** (nga 8,942 milion lekë në 2020) me një rritje në vlerë rreth 43 % krahasuar me 2020.

Pagesa e tatimpaguesve jo FIFO ka vijuar sikurse një vit më parë, duke rimbursuar me këste në total **10,753 milion leke** për periudhën Janar - Dhjetor 2021 (nga 7,566 milion lekë në 2020) me një rritje në vlerë rreth 42 % krahasuar me Janar - Dhjetor 2020. Pjesa më e madhe vlerës së rimbursuar, me rreth 69% është dhënë për tatimpaguesit e DTM (ndikuar nga tatimpaguesit e trajtuar jo FIFO).

Ne lidhje me kohën e procesimit (koha mesatare e miratimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-se, nga data e kërkesës deri në datën miratimit të kërkesës), për periudhën Janar - Dhjetor 2021, janë miratuar dhe rimbursuar **1,244 kërkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka qenë **67 ditë**, nga **70 dite** që ishte për vitin 2020, ku **35 %** të kërkesave janë procesuar brenda **30 ditëve**.

Rreth **61 %** e kërkesave janë procesuar brenda afatit **60-ditore**.

Rreth **13 %** e kërkesave janë procesuar mbi **120 ditë** dhe kryesisht arsyeja ka qenë mospagimi i detyrimeve për **“1900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”**, por dhe nga kontrollet e shumta të cilat janë mbyllur me vonesë ose janë akoma në proces.

Kështu, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga DMR dhe Drejtoria e Kontrollit nga 610 kontrolle gjithsej, janë mbyllur 528 kontrolle në vend, me një vlerë të gjetjeve në shumën 266,123 mijë lekë, ku konstatohen vonesa të theksuara, kryesisht nga DRT Tiranë, e cila dhe gjatë vitit 2021 ka mbyllur 6 kontrolle që i përkasin vitit 2019 dhe 31 kontrolle të vitit 2020.

• **Mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2021 në zërin Rimbursim TVSH-je,**

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2021 bazuar në ligjin nr. 137/2020, datë 16.12.2020 "Për Buxhetin e vitit 2021", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të TVSH-së, me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 644/1prot., datë 25.01.2021, protokolluar në DPT me nr.1426 prot., datë 26.01.2021. Për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është **programuar në shumën për 17,000,000 mijë lekë**, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është **realizuar në shumën 24,100,604 mijë lekë** duke rezultuar me tejkalim në shumën 7,101,604 mijë lekë, ose 42% më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

Tabela nr. 1

Në mijë lekë

EMERTIMI	Realizimi Faktik 2020	Plani 2021 referuar Ligjit të Buxhetit	Realizimi Faktik 2021	Diferenca Fakt Plan	% ndaj Planit
<b>- Rimbursimi i kryer</b>	16,511,532	17,000,000	24,101,604	+7,101,604	+42

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Tabela në vijim paraqet realizimin mujor të Rimbursimit të TVSH-së kundrejt planit:

Tabela nr. 2

Në mijë lekë

Nr	Periudha	Plani 2020	Realizimi Faktik	Diferenca Plan/Fakt	Realizimi ne %
1	Janar	1,650,000	2,266,833	616,833	137
2	Shkurt	1,650,000	1,549,637	-100,363	94
3	Mars	1,650,000	3,719,488	2,069,488	225
4	Prill	1,650,000	2,938,479	1,288,479	178
5	Maj	1,650,000	1,873,886	223,886	114
6	Qershor	1,650,000	2,985,509	1,335,509	181
7	Korrik	1,200,000	789,418	-410,582	66
8	Gusht	1,200,000	1,739,923	539,923	145
9	Shtator	1,200,000	2,890,387	1,690,387	241
10	Tetor	1,200,000	563,763	-636,237	47
11	Nëntor	1,200,000	986,888	-213,112	82
12	Dhjetor	1,100,000	1,796,393	696,393	163
	<b>Totali</b>	<b>17,000,000</b>	<b>24,100,604</b>	<b>7,100,604</b>	<b>142</b>

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se plani i rimbursimit mujor është tejkalluar ndjeshëm në 8 muajt të vitit 2021, konkretisht në muajt: janar, mars, prill, qershor, gusht, shtator dhe dhjetor, ndërsa në muajt shkurt, korrik, tetor dhe nëntor kemi mosrealizim të planit të rimbursimit.

Tabela në vijim paraqet realizimin faktit të Rimbursimit të TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale kundrejt planit të buxhetit.

Tabela nr. 3

Në mijë lekë

Nr	DRT Tatimore	Plani 2021	Realizimi Faktik	Diferenca Plan/Fakt	Realizimi ne %
	D. R. T. Berat	360,000	240,957	-119,043	67
	D. R. T. Dibër	300,000	133,849	-166,151	44.6
	D. R. T. Durrës	1,170,000	1,377,357	207,357	117.7
	D. R. T. Elbasan	395,000	538,148	143,148	136.2
	D. R. T. Fier	1,030,000	1,018,338	-11,662	98.9
	D.R. T. Gjirokaster	120,000	99,114	-20,886	82.6
	D. R. T. Korçë	264,000	208,204	-55,796	78.9
	D. R. T. Kukës	72,000	29,500	-42,500	41
	D. R. T. Lezha	90,000	147,234	57,234	163.6
	D. R. T. Saranda	90,000	216,201	126,201	240
	D. R. T. Shkodra	264,000	183,790	-80,210	69.6
	D. R. T. Tirana	1,985,000	2,816,584	831,584	141.9
	D. R. T. Mëdhenj	10,500,000	16,651,143	6,151,143	158.6
	D. R. T. Vlora	360,000	440,185	80,185	122.3
	<b>Shuma</b>	<b>17,000,000</b>	<b>24,100,604</b>	<b>7,100,604</b>	<b>142</b>

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Sa më sipër konstatohet se, në 7 Drejtori Rajonale është tejkalar ndjeshëm plani i rimbursimit, konkretisht në DRT Tiranë, DTM, Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë dhe Vlorë, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale për 7,596,852 mijë lekë, ose ka tejkalar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, ndërsa 7 DRT nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për 496,248 mijë lekë.

Referuar të dhënave si më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën për 16,651,143 mijë lekë, ose 69 %, të totalit të realizimit faktik të Rimbursimit të TVSH-së në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezultoi me një realizim të planit në masën 158.6% e ndjekur më pas më DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 2,816,584 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 142%, ose e ka tejkalar atë në shumën 831,854 mijë lekë.

**Në konkluzion:** Shpenzimet e Rimbursimeve të TVSH-së, për të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, janë tejkalar dukshëm në krahasim me planin e rimbursimeve, veprime këto në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në RSHö, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, ligjin nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

- **Tatimpagues të rimbursuar me metodën FIFO dhe me Këste**

a. Në periudhën ushtrimore 2021, janë miratuar dhe rimbursuar **1244 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO me vlerë totale **14,744,623 mijë lekë** nga të cilat 1,139,371 mijë lekë janë rimbursuar nëpërmjet metodës së kompensimit dhe **13,347,252 mijë lekë** janë rimbursuar me Thesar (Lista bashkëlidhur).

Tabela në vijim paraqet kërkesat e aprovuara për Rimbursimin e TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale për vitin 2021:

Tabela nr. 4

Drejtoria Tatimore	Kërkesa të Aprovuara	Vlera e Miratuar/ mijë lekë
<b>BERAT</b>	49	240,957
<b>DIBER</b>	14	133,849
<b>DURRES</b>	265	1,377,357
<b>ELBASAN</b>	49	355,029

<b>FIER</b>	131	1,018,338
<b>GJIROKASTER</b>	32	99,114
<b>KORCE</b>	64	208,204
<b>KUKES</b>	3	29,500
<b>LEZHE</b>	19	147,234
<b>SARANDE</b>	40	216,201
<b>SHKODER</b>	52	183,790
<b>TIRANE</b>	238	2,717,227
<b>DTM</b>	210	6,180,267
<b>VLORE</b>	78	440,185
<b>TOTALI</b>	<b>1,244</b>	<b>13,347,252</b>

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

b. Pagesa e tatimpaguesve **jo FIFO** për periudhën Janar-Dhjetor 2021, ka vijuar duke rimbursuar me këste në total **10,753,352 mijë lekë që i takon 71 kërkesave**, të cilat i takojnë 3 DRT (DTM, DRT Elbasan dhe Vlorë), ku pjesa me e madhe vlerës së rimbursuar rreth 97 % është dhënë për tatimpaguesit në përgjegjësi të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Në lidhje me **kohën e procesimit** konstatohet se, koha mesatare e miratimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së, nga data e kërkesës deri në datën miratimit të kërkesës, për periudhën Janar - Dhjetor 2021, koha mesatare e procesimit ka qenë **70 ditë**, ku **27 %** të kërkesave janë procesuar brenda **30 ditëve** dhe rreth **59 %** e kërkesave janë procesuar brenda afatit **60-ditore** dhe **13 %** e kërkesave janë procesuar mbi **120 dite** dhe kryesisht arsyeja ka qene mospagimi i detyrimeve për 01900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, nga ana e tatimpaguesve.

Tabela në vijim paraqet kohën mesatare të procesimit të Rimbursimit të TVSH-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat të cilat kanë kaluar afatin e procesimit mbi 120 ditë.

Tabela nr. 5

Dite	<31	31-60	61-90	91-120	>120	Total
<b>Numer</b>	269	325	190	94	130	<b>1008</b>
<b>%</b>	27	32	19	9	13	<b>100</b>

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

- **Mbi marrëveshjet për pagesën me këste të TVSH-së**, të miratuar për rimbursim në zbatim të VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste te Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, te miratuar për rimbursim"

DPT, në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 146, datë 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të miratuar për rimbursim" ku citohet se: "Në rastet kur tatimpaguesit realizojnë investime në vlera të larta apo kanë blerje mallrash/shërbimesh me TVSH, të cilat krijojnë tepricë të lartë kreditore të TVSH-së për t'u rimbursuar, administrata tatimore kërkon nga tatimpaguesi dhe, pasi merr dakordësinë e tij me shkrim, mund të lidhë marrëveshje për pagesë me këste të shumës së miratuar për t'u rimbursuar - Administrata tatimore i propozon tatimpaguesit lidhjen e një marrëveshjeje për pagesën me këste të shumës së miratuar për t'u rimbursuar në rastet e mëposhtme: a) shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar është mbi 150.000.000 lekë", ka miratuar Urdhrin nr 20, datë 02.03.2020, për miratimin e formatit të projekt-marrëveshjes "Për pagesën me këste të tatimit mbi vlerën e shtuar, të miratuar për rimbursim". Lidhur me zbatimin e urdhrin të sipërcituar, u kërkuar dhe u shqyrtuan praktikat e kërkesave të miratuara, për të cilat organi tatimor ka negociuar me tatim paguesit me qëllim lidhjen e Akt Marrëveshjeve si më poshtë:

- **A. H. C. Shpk**, në shumën gjithsej **178,191,929 lekë**, lidhur Akt Marrëveshja datë 08.03.2021 ku është përcaktuar për tu rimbursuar me **2 këste**, nga **89,095,964 lekë** secili, ku kësti i parë të paguhet në

muajin Mars 2021 dhe kësti i dytë në muajin Prill 2021, vlera të cilat janë likuiduar brenda muajit Mars 2021;

- **C.-A. (Ç. W. I. A.)** Sha me NIPT L...H, për shumën **183,118,708 lekë**, lidhur Akt Marrëveshja datë 13.10.2021 ku është përcaktuar për tu rimbursuar me 3 këste të barabarta në shumën 61,039,569 lekë, ku kësti i parë në muajin Tetor 2021, kësti i dytë në Nëntor dhe kësti i fundit është në muajin Dhjetor 2021, vlera të cilat janë likuiduar totalisht;

- **A. Shpk** me NIPT K...M, për shumën **166,004,986 lekë**, lidhur Akt Marrëveshja datë 09.11.2021 ku është përcaktuar për tu rimbursuar me 2 këste të barabarta në shumën 83,002,493 lekë, ku kësti i parë në muajin Nëntor 2021 dhe kësti i fundit është në muajin Dhjetor 2021.

- **E. D. A. Sha** me NIPT K...N, për shumën **263,988,547 lekë**, lidhur Akt Marrëveshja datë 14.12.2021 ku është përcaktuar për tu rimbursuar me 2 këste të barabarta në shumën 131,994,274 lekë, ku kësti i parë fillon në muajin Dhjetor 2021 dhe kësti i fundit parashikuar në muajin Janar 2022, por është likuiduar totalisht brenda muajit Dhjetor 2021.

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2021 janë likuiduar totalisht detyrimet për rimbursimin e TVSH-së, mbetur si detyrim më 31.12.2020, ku peshën më të madhe të stokut të rimbursimit të TVSH-së gjatë viteve të fundit e zë tatimpaguesi T. AG me shumën 7,117,300 mijë lekë. Po kështu janë likuiduar dhe detyrimet për të gjitha marrëveshjet me këste të lidhura gjatë vitit 2020, ku peshën më të madhe e zë tatimpaguesi B. P. Shpk në shumën 1,557,007 mijë lekë, si dhe detyrimet për tatimpaguesit e tjerë të trajtuar me këste sipas marrëveshjeve të nënshkruara (me përjashtim të tatimpaguesit òK.ò Sha).

Lidhur me rimbursimin e tatimpaguesit **T. AG** nga DPT është negocuar në vitin 2020 me subjektin për të lidhur marrëveshje për pagesë me këste, por subjekti ka propozuar të rishikojnë kushtet e marrëveshjes, ku të llogariten edhe interesat, të cilat nuk gjenin mbështetje ligjore në VKM nr. 146, datë 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste të tatimit mbi vlerën e shtuar, të miratuar për rimbursim". Gjatë vitit 2021 DPT ka vazhduar likuidimin e plotë me këste të tatimpaguesit, ndërsa në muajin dhjetor 2021 tatimpaguesi në komunikim elektronik me MFE kërkon nga DPT të shlyejë detyrimet që rrjedhin **nga kamatëvonesat/interesat për rimbursim të vonuar në shumën 882,688,116 lekë**. Për trajtimin e kësaj kërkesë Drejtori i Përgjithshëm me urdhërin nr. 93, datë 30.12.2021 ka ngritur një grup pune, i cili ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, si dhe janë zhvilluar takime më tatimpaguesin për dokordësinë e vlerës. Pas përlllogaritjeve të interesave bazuar dhe në ligjin nr. 116/2013 òPër ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe T. AG, lidhur me projektin e gazsjellësit transadriatik (projekti TAP)...ò, grupi i punës ka konkluduar në vlerën 806,618,673 lekë.

Me shkresën nr. 5970 prot., datë 13.04.2022 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **për gjykim e vlerësim**, DPT, referuar dhe shkresave të tatimpaguesit TAP nr. 3981, datë 09.03.2021 dhe 4160, datë 11.03.2022, ka konfirmuar shumën e kamatëvonesave për rimbursim të vonuar të TVSH-së në vlerën 806,618,673 lekë. Deri në përfundimin e auditimit nuk ka nje vendimmarrje të MFE apo trajtim të mëtejshëm ku të jetë vënë në dijeni dhe DPT.

**Kërkesat në proces:** Deri më datë 31.12.2021 nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Rimbursimit rezultojnë se janë në proces në total **202 kërkesa** (nga 245 kërkesa që rezultojnë më 31.12.2020), me një rënie në numër rreth 17.6 % krahasuar me vitin 2020, në vlerë **3,841 milion lekë** (nga 4,679 milion lekë më 31.12.2020) me një rënie në vlerë rreth 17.9% krahasuar me 2020, konkretisht:

Tabela nr. 6

<b>Kërkesat në proces të regjistruara sipas viteve</b>
--

Viti	Numri i kërkesave	Vlera e Kërkesave (milion lekë)
2017	1	5
2019	3	45
2020	9	130
2021	189	3,661
<b>Total</b>	<b>202</b>	<b>3,841</b>

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se janë në proces 13 kërkesa me vonesë nga 1 deri në 5 vjet në shumën 180 milion lekë, ndërsa kërkesat në proces mbi 50 milion lekë paraqiten:

Tabela nr. 7

Kërkesat analitike me vlere mbi 50 milion					
Nr.	DRT	NIPT	SUBJEKTI	Data e kërkesës	Shuma e Kërkuar(leke)
1	DRT TIRANE	K...E	T. B.P. Shpk	04.12.2020	109,908,188
2	DTM	K...T	K. Sha	04.02.2021	422,793,067
3	DRT TIRANE	L...C	S.-C.A. Shpk	12.07.2021	72,486,666
4	DTM	L...O	Q.S.K. Z. Sha	10.08.2021	175,142,415
5	DTM	K...L	B. P. A. Shpk	12.08.2021	130,025,239
6	DTM	K...L	B.P.A. Shpk	25.08.2021	143,344,840
7	DTM	J...J	G. Shpk	06.10.2021	114,505,795
8	DTM	K...B	N. Shpk	18.10.2021	138,774,786
9	DTM	J...J	G. Shpk	28.10.2021	148,819,879
10	DTM	K...E	F. K. C. F. Shpk	01.11.2021	75,692,241
11	DTM	K...M	A. Shpk	17.11.2021	216,692,937
12	DTM	L...U	M. Shpk	01.12.2021	59,074,762
13	DTM	K...M	A. Shpk	17.12.2021	89,271,387
14	DURRES	J...L	A. P. D. EP	24.12.2021	346,698,977
15	DTM	L...P	A. G. O. Shpk	24.12.2021	64,791,240
16	DTM	K...V	A. M. S. Shpk	30.12.2021	50,968,540

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

**Stoku me 31.12.2021:** Stoku i rimbursimeve për kërkesat e miratuara dhe të pa likuiduara nga administrata tatimore, i raportuar nga DRTVSH më datë 31.12.2021, është **476,650,390 lekë**, i përket subjektit òK.ò Sha, me aktivitet prodhim dhe tregtim hekuri, pasi procesi i rimbursimit është pezulluar, pasi është referuar në prokurori nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për skema mashtrimi me TVSH-në.

Drejtorja e Rimbursimit të TVSH-së me shkresën nr. 1293 prot, 27.01.2022 ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit, shumën 476,650 mijë lekë në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2021, raportim ky në zbatim të udhëzimit nr. 8, të MFE òPër përgatitjen e pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendrore.

Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, rezultojnë **69 kërkesa** për rimbursimin e TVSh-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për **1,893,609 mijë lekë** të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, òRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika 1, dhe VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4. ***Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit më 31.12.2021 sipas gjykimit tonë më së paku është 2,370,259 mijë lekë.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nr. 121/42 datë 21.07.2022 òObservacion mbi projekt raportin e auditimit nr. 16/20, datë 17.06.2022ò, protokolluar në KLSH me nr. 20/14, datë 21.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

### **Pretendimet e subjektit:**

Lidhur me rekomandimin 8.1 të lënë në projektraportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 16/20, datë 17.06.2022, që ka të bëjë me ndryshimin e rregullores së rimbursimit, pretendohet se:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 75/1 dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar pika 75/1...parashikon se:

Rimbursimi i TVSH-së kryhet sipas një procedure të bazuar në analizën e riskut për rimbursim. Kriteret e riskut janë objektive dhe zbatohen me drejtësi për të gjithë tatimpaguesit. Trajtimi i kërkesave mund të ndryshojë në varësi të shkallës së riskut dhe vlerës së TVSH-së të kërkuar për rimbursim.

Administrimi i procesit të rimbursimit të TVSH-së kryhet në përputhje me rregullat me bazë riskun, të vendosura në rregulloren e hartuar nga Komiteti Menaxhimit të Riskut pranë DPT-së dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve”.

Bazuar sa më sipër Komiteti i Përbushjes në DPT ka miratuar “Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut” ...dhe për element të riskut DRTVSH ka vlerësuar dhe Kontrollin nr. 2, 3 dhe 4...Me ndryshimin e VKM 953, datë 29.12.2014...Kontroli nr. 3 është përfshirë në germën a) të pikës 2 të nenit 10.

Lidhur me kontrollin në vend apo kontrollin nga zyra me implementimin e platformës dixhitale të rimbursimit të TVSH-së, kërkesat për rimbursim nuk kalohen më për kontroll nga zyra...

Lidhur me rekomandimin nr. 9.1, pretendohet se: Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se, nuk ka plan të mirëfilltë rimbursimi, por kemi një parashikim indikativ rimbursimi, i cili vjen bashkë me planin e të ardhurave nga MFE. Kjo pasi:

1. Kërkesat për rimbursim bëhen çdo muaj dhe duhet që MFE të rishikojë çdo muaj këtë parashikim gjë e cila e është e pamundur. Gjithashtu, Administrata Tatimore nuk ka asnjë mundësi të diktojë, parashikojë apo të pengojë kërkesat e tatimpaguesve për rimbursim.

2. Çdo kërkesë për rimbursim AT duhet ti përgjigjet brenda afateve ligjore.

Theksojmë se ka një plan Bruto dhe Neto të të ardhurave të miratuara nga MFE. Administrata Tatimore mban përgjegjësi për realizimin e planit Neto të të ardhurave. Administrata Tatimore ndjek me rigorozitet planin Bruto të të ardhurave dhe në varësi të kërkesave për rimbursim mundohet ta realizojë ose tejkalojë atë në mënyrë që të mos çënojë planin Neto apo të drejtën ligjore të subjekteve për tu rimbursuar brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Likuidimi i rimbursimeve pranë Degës së Thesarit është bërë me qëllim eliminimin e stokut, në varësi të realizimit të të ardhurave tatimore dhe në bashkëpunim me MFE.

Për rekomandimin nr. 10.1 pretendohet se: Lidhur me stokun e vlerësuar sipas mënyrës së grupit të auditimit të KLSH-së, DRTVSH nuk është dakord, sepse është në kundërshtim me definicionin e “stokut” ku: ‘**STOKU**’ I rimbursimit të TVSH-së është vlera e TVSH-së e aprovuar për tu rimbursuar nga administrata tatimore, në pritje për t’u kaluar në Degën e Thesarit”.

Pra, stoku i llogaritur sipas metodës ë KLSH-së merr në vlerësim edhe kërkesat të cilat janë në proces, të pa aprovuara për rimbursim, detyrimi i të cilave është i pamaturuar ku teprica kreditore është e lirë dhe e përdorshme nga tatimpaguesi...

Stoku i rimbursimit të TVSH-së duhet të llogaritet sipas definicionit: Stoku në fund të periudhës = Stoku në çelje + kërkesat e miratuara gjatë periudhës – kompensimet – rimbursimet e kryera.

Stoku më 31.12.2021 vlerësuar dhe raportuar nga DPT është 476,650 mijë lekë dhe jo 2,370,259 mijë lekë, sa vlerëson KLSH me metodën e aplikuar prej saj.

Sipas përcaktimeve në pikën 75/1.1) të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, nga TVSH-ja për rimbursim nuk mund të kompensohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore & shëndetësore.

Gjithashtu, sipas përcaktimeve në këtë Udhëzim, kategoria e tatimpaguesve jo-eksportues rimbursohet pas kontrollit në vend dhe nxjerrjes së rezultateve përfundimtare të tij.

Për pasojë, bazuar në sa më sipër, kërkesat për rimbursim për të cilat tatimpaguesit nuk kanë likuiduar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore & shëndetësore, nga DRTVSH nuk mund të rimbursohen pavarësisht tejkallimit të afatit ligjor për rimbursim.



### **Oëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se, Grupi i Auditimit pasi shqyrtoi observacionin Tuaj sqaron se, sa i takon rishikimit të Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së, gjetja dhe rekomandimi i lënë bazohet në kërkesat e dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari dhe çdo rregullore/manual apo udhëzim për zbatim të tyre duhet të hartohet e miratohet brenda kornizës ligjore që në rastin konkret ka të bëjë me kontrollin nr. 2 dhe 4, merret në konsideratë e pasqyrohet në material pretendimi sa i takon kontrollit nr. 3. Ndërsa për òkontrollit nga zyraë pavarësisht se pretendoni se me implementimin e platformës dixhitale të rimbursimit të TVSH-së, kërkesat për rimbursim nuk kalohen më për kontroll nga zyra, duhet të bëhen reflektimet përkatës në rregullore.

-Lidhur me pretendimin se AT nuk ka plan të mirëfilltë rimbursimi, por kemi një parashikim indikativ rimbursimi, i cili vjen bashkë me planin e të ardhurave nga MFE dhe pretendimet për planin Bruto dhe planin Neto, sqarojmë se nuk merren në konsideratë, pasi misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore për financimin e buxhetit të shtetit, duke ju referuar **planit të miratuar** nga MFE në të dy termat (Bruto dhe Neto).

-Grupi i Auditimit i qëndron arsytimit të shprehur në Raportin e Auditimit në lidhje me vlerën për 2,370,259 mijë lekë si stok të rimbursimit të TVSH-së në mbyllje të periudhës ushtrimore përveç vlerës së shprehur të nga DPT dhe shton se: referuar Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, òRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore, pika 1 dhe VKM nr. 953 datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar pika 3, neni 10, vërehet se i gjithë procesi i rimbursimit të TVSh-së, *duhet të përfundojë brenda 60, ditëve. Pra pas përfundimit të afatit ligjor tatimpaguesit i lind një e drejtë e konstatuar për rimbursimin e TVSh-së.* Në Standardin Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 1) ò Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare cìtohet: *òMe qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.* Për sa shpjeguar më lart, në vlerësimin e audituesve të KLSH-së, kjo vlerë duhet ti shtohet shumës së stokut të rimbursimit të TVSH-së dhe të paraqitet në pasqyrat financiare të institucionit.

- Titulli i gjetjes:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka tejkalar dukshëm planin për shpenzimet e rimbursimit të TVSH-së.  
Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është **programuar në shumën 17,000,000 mijë lekë**, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është **realizuar në shumën 24,100,604 mijë lekë**, duke rezultuar **me tejkalim në shumën 7,101,604 mijë lekë**, ose **42%** më shumë kundrejt planit të rimbursimit.
- Situata 1:** Gjithashtu, konstatohet se në 7 Drejtori Rajonale është tejkalar plani i rimbursimit, konkretisht: në DRT Tiranë, DTM, Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë dhe Vlorë, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale 7,596,852 mijë lekë, ose ka tejkalar fondet e parashikuara për rimbursimin e TVSH-së, ndërsa 7 DRT nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për shumën 496,248 mijë lekë.  
Referuar sa më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën 16,651,143 mijë lekë, ose 69

%, të totalit të realizimit faktik në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën 158.6% e ndjekur më pas më DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 2,816,584 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 142%, ose e ka tejkaluar atë në shumën 831,854 mijë lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar, neni 14; ligjin nr. 137/2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò, i ndryshuar dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve të rimbursimit.

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, neni 14

- Ligji Nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", dhe

**Kriteri :**

-Shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

**Ndikimi**

Mosrespektimi i legjislacionit tatimor.

**Rëndësia**

E lartë.

**Rekomandim**

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se mund të procedohet me kryerjen e pagesave, në bashkëpunim me MFE, të marrë masat e nevojshme

**Afati**

Në vijimësi

**Titulli i Gjetjes:**

Pasaktësi në raportimin e stokut të rimbursimit.

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së me shkresën nr. 1293 prot., 27.01.2022 ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit në shumën 476,650 mijë lekë në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2021, në zbatim të Udhëzimit nr. 8, të MFE òPër përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë të qeverisjes qendroreò.

**Situata 2:**

Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, rezultojnë **69 kërkesa** për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për **1,893,609 mijë lekë**, të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 75/1, òRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika 1, dhe VKM nr. 953, datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4. ***Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit më 31.12.2021 sipas vlerësimit tonë më së paku është 2,370,259 mijë lekë.***

-Ligji nr. 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, òRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika1,

**Kriteri :**

- VKM nr. 953, datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10, Pika 4.

**Ndikimi/Efekti:**

Kryerja e pagesës nga ana e DPT-së brenda afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim në zbatim të pikës 3, të VKM nr. 953, datë 29.12.2014, pa miratimin e raportit të kontrollit të drejtorive rajonale paraqet një risk të shtuar për DPT-në për të gjithë ato raste kur vlera e kërkesës së pranuar për rimbursim është më e ulët se vlera e miratuar nga

	raporti i kontrollit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore.
<b>Afati</b>	Në vijimësi
<b>Titulli i gjetjes:</b>	Rregullorja e Drejtorisë së Rimbursimit nuk gjen mbështetje në legjislacionin tatimor. Nga auditimi konstatohet se, DRTVSH, me qëllim automatizimin e procesit të rimbursimit në kohë të kërkesave të regjistruara pranë DRTVSH-së dhe uljen e numrit të kërkesave të cilat dërgohen për kontroll para rimbursimit, ka propozuar ndryshime/lehtësime në kriteret që analizohen gjatë procedurës së rimbursimit nga DRTVSH, por disa prej tyre nuk kanë mbështetje ligjore. Kështu, në Rregulloren e Drejtorisë së Rimbursimit miratuar me vendimin nr. 27, datë 13.10.2021 të Komitetit të Përbushjes, në mënyrën e trajtimit të kërkesës për rimbursim dhe kontrollat që duhet të kryhen, konstatohet se: Kontrolli nr. 2 ðA është referuar në Prokurori tatimpaguesi gjatë 5 viteve të fundit nga strukturat kompetente hetimore bazuar në dyshimet e konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave apo evazionit fiskalë dhe Kontrolli nr. 4 ðA është kërkesa për rimbursim më e madhe se 100 milion lekë nuk bazohen në kërkesat e VKM nr. 953, datë 29.12.2014 ðPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 ðPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, duke krijuar hallka të tepërta në këtë proces. Gjithashtu, në këtë rregullore, por dhe në rregulloren e miratuar më urdhrin nr. 19/1, datë 28.04.2020, e ndryshuar, në rastet e përcaktimit të subjekteve me risk, kalohen për kontroll <b>në vend</b> dhe për kontroll <b>nga zyra</b> , ku ky i fundit vlerësojmë se është thjesht formal, pasi nuk kryhet procesi i inventarizimit në subjekt, si një ndër proceset kryesore të kontrollit, kjo duke ju referuar dhe 381 kontrolleve nga zyra për rimbursimin e TVSH-së me një vlerë të kërkuar prej 1,254 milion lekë, ku gjetjet nga këto kontrolle nuk janë materiale. - <b>VKM Nr. 953</b> , datë 29.12.2014 ðPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 ðPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
<b>Situata 3:</b>	Krijohen hallka të tepërta në këtë proces dhe pa mbështetje ligjore.
<b>Kriteri :</b>	E lartë.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të ndërmarrë masat e nevojshme për rishikimin e Rregullosës së Drejtorisë së Rimbursimit, duke hequr: Kontrollin nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, me qëllim eliminimin e hallkave të tepërta në këtë proces e sjelljen e tij në kornizën ligjore. Gjithashtu, të hiqet edhe paragrafi i kontrollit nga zyra, në rastet kur subjektet me risk kalohen për kontroll <b>në vend</b> dhe për kontroll <b>nga zyra</b> , ku ky i fundit është thjesht formal, pasi nuk kryhet procesi i inventarizimit në subjekt, si një ndër proceset kryesore të kontrollit.
<b>Rëndësia</b>	Brenda vitit 2022
<b>Rekomandimi:</b>	
<b>Afati</b>	

## 2.6. Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operationale.

### **A. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.**

Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.
- Analiza të Drejtorisë së menaxhimit të riskut;
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT

#### **Baza Ligjore**

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,
- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 òPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Rregullore dhe Manuale për funksionimin e drejtorisë;
- Manuali i Menaxhimit të Riskut;
- Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore
- Akte të tjera ligjore e nënligjore.

Nga të dhënat dhe dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se:

*Në bazë të organizimit, funksionimit dhe drejtimit të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut përgjatë vitit 2021 ajo ka funksionuar në bazë të Urdhrit nr. 33 datë 12.02.2020 òPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendroreò e ka patur në strukturë dy sektorë:*

- Sektori i hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve (1 përgjegjës +6 punonjës), aktualisht 1 përgjegjës + 5 punonjës);
- Sektori i Analizës së Riskut (1 përgjegjës +10 punonjës), aktualisht (0 përgjegjës + 10 punonjës)

Konstatohet se kjo drejtori nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës. Sistemi i Menaxhimit të Riskut ka për qëllim të ndikojë në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave të parashikuara duke siguruar :

- Menaxhimin eficient dhe transparent të ardhurave tatimore;
- Evidentimin dhe zvogëlimin e risqeve të mos përmbushjes së objektivave të administratës tatimore;
- Inkurajimin dhe rritjen e shkallës së zbatimit dhe respektimit vullnetar të përmbushjes së detyrimeve tatimore, si dhe sigurimin e nxitjes së besimit publik ndaj integritetit dhe efikasitetit të Administratës Tatimore;

Gjithashtu Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka si objektivi parësor nëpërmjet modulit të riskut identifikimin mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

Tatimpaguesit renditen duke filluar nga vlerësimi më i lartë tek ai më i ulët. Subjektet që kanë numrin më të lartë të kritereve të thyera të riskut vlerësohen më riskun më të lartë dhe listohen të parët në *Dokumentin e listës së subjekteve.*

Një element shumë i rëndësishëm është edhe periodiciteti i ekzekutimit të modulit të riskut ku DMR ekzekuton modulën e riskut 2 herë në vit çdo 6 muaj dhe bazuar në rezultatet e tij dhe renditjen e

tatimpaguesve planifikon kontrollat tatimore mujore për pjesën e 70% ndërsa për rimbursimet periodiciteti i ekzekutimit të modulit të riskut është 4 herë në vit e më konkretisht:

është kryer 2 (dy) herë për vitin 2021 ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut, nga Komiteti i Përmbushjes, për planet e kontrollit (për pjesën e 70% ) si më poshtë:

-Plan Kontrolli janar - qershor 2021 datë 21.01.2021;

-Plan Kontrolli korrik - dhjetor 2021 datë 21.07.2021.

është kryer 4 (katër) herë për vitin 2021 ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut, kriteret për rimbursimin e TVSH-së, si më poshtë:

- shkurt - prill 2021 datë 08.02.2021;

- maj - korrik 2021 datë 14.05.2021;

- gusht - shtator 2021 datë 16.08.2021;

- nëntor - janar 2021 datë 09.11.2021.

*Përmirësime të Modulit të Riskut:* Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësi pasi ato ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Konstatohet se Moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2016, vit në të cilin është instaluar dhe është arritur përdorimi i plotë i tij, por i janë përmirësuar rregullat brenda vetë modulit.

Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoritë Funktionale në DPT nuk i paraqesin apo dërgojnë në D.M.R informacion në periodicitet vjetor nevoja për përmirësim të Modulit të Riskut aktual, ashtu edhe në mundësinë e përshtatjes së sjelljeve të saj në terma afatgjatë gjatë hartimit të strategjive të trajtimit të riskut dhe grup risqeve të evidentuara si një avantazh për Administratën Tatimore;

Përzgjedhja e subjekteve përgjatë kësaj periudhe për tu kontrolluar është bërë duke marrë në konsideratë si variabël kryesor orët në dispozicion për kontroll nga ana e secilës Drejtori Rajonale Tatimore. Ky është faktori i parë kufizues në përzgjedhjen e subjekteve për kontroll, ndërkohë që nga ana e Drejtorisë së Kontrollit ky variabël përkthehet në numër subjektësh për tu kontrolluar bazuar në eksperiencat e mëparshme për kohën mesatare të shpenzuar për një kontroll.

*Konstatohet se për vitin 2021 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 278 kontrole nga 1975 kontrole të planifikuara ose rreth 14% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë dhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale.*

*Referuar manualit të riskut, Drejtoritë Rajonale Tatimore i dërgojnë Drejtorisë së Kontrollit në DPT, brenda datës 10 të çdo muaji, raportin mbi aktivitetin e kontrollit të muajit të kaluar, përfshirë kontrollat e plota dhe vizitat fiskale. Drejtoritë e Kontrollit në DPT përpilon raportin mujor i cili shqyrtohet dhe nga Drejtoritë e Menaxhimit të Riskut për qëllime të objektit të punës në lidhje me kriteret e riskut. Mbi këtë bazë Drejtoritë e Menaxhimit të Riskut raporton rregullisht brenda datës 20 të çdo muaji te nëndrejtori i Përgjithshëm i varësisë. Nga auditimi konstatohet mungesa e dokumentimit të raportimit mujor të DMR-së.*

Drejtoritë e Menaxhimit të Riskut pas marrjes së konfirmimit për realizueshmërinë e kontroleve duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve si variabël ka realizuar përzgjedhjen automatike të atyre subjekteve të cilat janë renditur më lart në bazë të Modulit të Menaxhimit të Riskut (**CRM Compliance Risk Managment**, pjesë përbërëse e sistemit të informatizuar të deklaramentit të tatimeve nga ana e tatimpaguesve.

Në të gjitha rastet, tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll sipas Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut në DPT janë referuar për kontroll të plotë sipas Modulit të Menaxhimit të Riskut dhe planeve sektoriale.

Nga grupi i kontrollit u përzgjedhën 30 subjekte nga subjektet e renditur për kontroll në bazë të Modullit të Menaxhimit të Riskut (CRM) Compliance Risk Management, me qëllim verifikimin e kritereve të përzgjedhjes, të detajuar sipas listës së mëposhtme:

**Tabela nr.1 Subjektet e kontolluar për kriteret e riskut**

DRT	Subjekti	TVSH (periudha)	Zgjedhje Automatike nga Sistemi (2), Propozimi i DRT (3), Burime te tjera	Muaji
TIRANË	F. shpk	07/2021-10/2021	1	Dhjetor
DTM	I.E.	11/2019 - 10/2021	1	Dhjetor
DTM	B.	0	1	Dhjetor
DURRËS	O. SHPK	01/2020 - 10/2021	1	Dhjetor
KORÇË	GJ.	07/2019-06/2021	1	Gusht
SARANDË	P.	07/2019 - 06/2021	1	Gusht
TIRANË	L. T.	09/2019-04/2021	1	Korrik
DTM	P. ó V. ó K.	06/2019 - 05/2021	1	Korrik
DTM	P.	06/2019 - 05/2021	1	Korrik
TIRANË	P. SH.P.K	08/2020-04/2021	1	Nentor
BERAT	"I. S."	10/2019-09/2021	1	Nentor
GJIROKASTËR	"K. ó M." SHPK	10/2019-09/2021	1	Nentor
SHKODËR	I.	10/2019-09/2021	1	Nentor
VLORË	M. F.	10/2019-09/2021	1	Nentor
DTM	E. C. F.	0	1	Qershor
FIER	A. C.	05/2016 - 04/2021	1	Qershor
SARANDË	S. 2008	05/2018 - 01/2021	1	Qershor
FIER	B.	01/2021 - 06/2021	1	Shtator
Diber	"R."	02/2019-03/2021	1	Maj
Durrës	A. S. G. B.	02/2018 - 12/2020	1	Maj
Elbasan	O. C.	07/2020-03/2021	1	Maj
Diber	P.		1	Mars
Tiranë	C. R. 2008		1	Mars
TIRANË	M. B.	03/2016-02/2021	1	Prill
DTM	M. B. M.	03/2016 - 12/2017 & 04/2020 - 02/2021	1	Prill
SHKODËR	H.	03/2016-02/2021	1	Prill
Tiranë	E.	01/2016-12/2020	1	Shkurt
Tiranë	F.	01/2016-12/2020	1	Shkurt
DTM	E. SHPK	03/2019 - 12/2020	1	Shkurt
DTM	F. A.	03/2018 - 11/2020	1	Janar

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Konstatohet se edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën Drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë:

*-Subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale.*

*-Renditjen e subjekteve me të njëjtin numër rregullash të thyera.*

Në analizat e kryera është bërë e mundur evidentimi i numrit të kritereve që thyhen nga sektorët si dhe numrit të ÷shmgjies potenciale e shprehur në pikë. Me anë të këtij informacioni i cili gjenerohet automatikisht, është bërë e mundur analizimi dhe trajtimi i sektorëve më me risk ose prioritar.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur 12 aktivitetet me risk nga 556 aktivitetet gjithsej:

**Tabela nr2. Top 12 aktivitetet me risk**

Kodi i aktivitetit	Përshkrimi i Aktivitetit	Nr. i rregullave te thyera	% Nr. i rregullave te thyera
I5630	Aktivite të shërbimit të pijeve	36,397	8.1%
G4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan	19,333	4.3%
G4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara	16,373	3.6%

G4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar	11,479	2.5%
I5610	Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	10,964	2.4%
G4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara	10,715	2.4%
S9602	Flokët dhe trajtime të tjera të bukurisë	9,931	2.2%
G4773	Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara	8,476	1.9%
F4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale	8,373	1.9%
G4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	7,885	1.8%
H4941	Transporti rrugor i mallrave	7,437	1.7%
G4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara	6,760	1.5%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Në bazë të zgjedhjes së tatimpaguesve për kontroll realizohet nëpërmjet hartimit të listave përfundimtare për kontroll bazuar në rezultatet e gjeneruara nga Moduli i Riskut Tatimore atodërgohen të nënshkuara nga Drejtori i Përgjithshëm jo më vonë se data 25 e çdo muaji për kontrollet që do të ushtrohen në muajt pasardhës. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka realizuar hartimin e listave për tatimpaguesit e zgjedhur për kontroll si më poshtë:

**Tabela nr.3 Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 1 / 70%)**

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	25044	28.12.2020	Shkrese percjellese
Shkurt	1289	25.01.2021	Shkrese percjellese
Mars	3572	25.02.2021	Shkrese percjellese
Prill	5689	25.03.2021	Shkrese percjellese
Maj	7573	26.04.2021	Shkrese percjellese
Qershor	9258	25.05.2021	Shkrese percjellese
Korrik	11646	25.06.2021	Shkrese percjellese
Gusht	14661	05.08.2021	Shkrese percjellese
Shtator	15680	25.08.2021	Shkrese percjellese
Tetor	18293	11.10.2021	Shkrese percjellese
Nëntor	20029	05.11.2021	Shkrese percjellese
Dhjetor	22242	14.12.2021	Shkrese percjellese

**Tabela nr.4 Planet e kontrollit të dërguara në DRT për ( Rasti 2/ 30% )**

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	25130	28.12.2020	Shkrese percjellese
Shkurt	1626	27.01.2021	Shkrese percjellese
Mars	3626	25.02.2021	Shkrese percjellese
Prill	5997	30.03.2021	Shkrese percjellese
Maj	7244	19.04.2021	Shkrese percjellese
Qershor	9700	31.05.2021	Shkrese percjellese
Korrik	11315	21.06.2021	Shkrese percjellese
Gusht	14017	27.07.2021	Shkrese percjellese
Shtator	15524	20.08.2021	Shkrese percjellese
Tetor	18167	08.10.2021	Shkrese percjellese
Nëntor	20390	11.11.2021	Shkrese percjellese
Dhjetor	21622	03.12.2021	Shkrese percjellese

**Tabela nr.5 Kontrollet planifikuara sipas DRT-ve viti 2021**

Raste kontrolli/DRT	BR	DB	DTM	DR	EL	FR	GJI	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Tot
Raste 1 nga 70%	36	37	312	179	101	162	29	132	15	44	44	74	305	66	1,536
Raste 2 nga 30%	18	11	87	30	43	53	9	31	9	4	7	26	92	12	432
Raste 3 nga prokuroria								1		1		1	3	1	7
<b>TOTALI</b>	<b>54</b>	<b>48</b>	<b>399</b>	<b>209</b>	<b>144</b>	<b>215</b>	<b>38</b>	<b>164</b>	<b>24</b>	<b>49</b>	<b>51</b>	<b>101</b>	<b>400</b>	<b>79</b>	<b>1,975</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga analiza e tabelës së mësipërme rezulton janë planifikuar për kontroll 1975 subjekte, nga të cilët 1536 janë të propozuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, 432 subjekte janë propozuar nga Drejtoritë Rajonale dhe 7 raste janë referuar nga organi i prokurorisë për fillim kontrolli. Drejtoritë Rajonale që zënë peshën më të madhe janë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 399 kontrolle ose rreth 20% të totalit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me 400 kontrolle ose rreth 20% te kontrolle totale të planifikuara.

Gjatë Vitit 2021 kanë ardhur 105 kërkesa për rimbursim të cilat janë për 736 tatimpagues të ndryshëm. Bazuar në analizat 3 mujore të bazuara në ekzekutimet e Modullit të Riskut 116 tatimpagues janë propozuar për kontroll. Më poshtë tabela e specifikuar sipas muajve të vitit 2021:

**Tabela nr.6 Kërkesat për rimbursim sipas muajve**

Muaji	Numri I kërkesave te ardhurave	Numri I tatimpaguesve qe kërkojnë Rimbursim Tvsh-je	Numri I tatimpaguesve qe propozohen per kontroll bazuar ne Analizen e Riskut
JANAR	7	57	15
SHKURT	8	72	5
MARS	4	26	5
PRILL	5	52	7
MAJ	11	82	8
QERSHOR	2	9	2
KORRIK	10	66	7
GUSHT	13	51	5
SHTATOR	8	65	9
TETOR	8	59	5
NENTOR	14	106	21
DHJETOR	15	91	27
<b>TOTALI</b>	<b>105</b>	<b>736</b>	<b>116</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

## **Planet sektoriale të realizuara gjatë vitit 2021**

Gjatë vitit 2021, nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut u hartua, implementua dhe analizua plani Sektorial i Turizmit dhe plani Sektorial i Ndërtimit si sektor të evidentuar me risk potencial dhe me ndikim në të ardhurat tatimore, nën asistencën e FMN dhe në zbatim të shkresës nr.9438/2 prot., datë 02.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

### **1. Plani Sektorial i Turizmit**

Objektivat kryesore të Planit Sektorial të Turizmit renditen si më poshtë:

- Rritje me 8% e qarkullimit gjate sezonit turistik 2021 krahasuar me vitin 2019 për të njëjtën periudhë për tatimpaguesit e targetuar aktive;
- Regjistrimi në përgjegjësinë e TVSH-së për 1.000 TP nga të cilët 400 me mbi 15 dhoma hoteli dhe 600 me qarkullim me TVSH mbi 8 milion lekë;
- Rritja me 4% e pagesës së TVSH-së duke evidentuar dhe nxitur tatimpaguesit që rezultojnë mosdeklarues ose vonesë në pagesë;
- Ulja me 25% e numrit të tatimpaguesve që deklarojnë në listëpagesa 1 punonjës nga 4.878 TP që rezultojnë në listëpagesat e periudhës 08/2020;
- Ulja me 15% e numrit të punonjësve me pagë minimale ose më të vogël nga 30.507 punonjës që rezultojnë në listëpagesat e periudhës 08/2020;
- Rritja me rreth 1% ose 5.250 e numrit të punonjësve të deklaruar për popullatën e targetuar aktive;
- Rritja me 2% e fondit të pagave për popullatën e targetuar aktive;
- Ulja nga 90% e numrit të punonjësve me pagë minimale për tatimpagues, në 70%;



- Reduktim i subjekteve që rezultojnë të parregjistruar ose pasiv në organet tatimore ndërkohë që kryejnë aktivitet. Në fund të gushtit 2021 të rezultojnë të në këtë sektor 13.500 tatimpagues aktiv;
- Rritja me 10% e individëve që paguajnë Tatim në Burim në zonat turistike.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka vlerësuar si sektor me risk të lartë potencial **sektorin e turizmit** (hotele, struktura akomoduese, bare-restorante, agjenci turistike, etj).

Janë evidentuar **13.109 tatimpagues** që ushtrojnë aktivitet në zona turistike bregdetare dhe malore. Në këtë listë u përfshinë:

- **11.617** tatimpaguesit aktivë në popullatën gusht 2020;
- **925** tatimpaguesit aktivë që janë regjistruar pas datës 1 shtator 2020 deri në 1 maj 2021;
- **473** tatimpaguesit që rezultojnë të regjistruar pranë Ministrisë së Turizmit për struktura akomoduese dhe hotele;
- **94** tatimpaguesit që rezultojnë me shitje me normë TVSH-je 6% në deklarat e TVSH-së gjatë vitit 2020

Si pjesë e planit të komunikimit nga ana e Administratës Tatimore u ndërmorën veprimet si mëposhtë:

- Njoftim të tatimpaguesve që operojnë në sektorin e turizmit dhe Bar-Restoranteve për planin dhe për disa nga faktorët riskorë nën monitorim (ëeb, rrjete sociale, etj).
- Komunikim përmes Qendrës së Thirrjeve me subjektet e biznesit si kujtesë informuese dhe ndërgjegjësuere;
- Mesazh ndërgjegjësues për punonjësit e administratës e më gjerë për rëndësinë e tërheqjes së kuponit tatimor;
- Mezazhe ndërgjegjësuese për 57 kompanitë që kanë numër të lartë punonjësish;
- Vendosjen në dispozicion të një adrese e-maili dhe numër telefoni për çdo denoncim që mund të merret nga publiku i gjerë;
- Njoftime periodike në lidhje me rezultatet e arritura në zbatimin e planit për sezonin turistik;
- Kronika në edicionet kryesore të lajmeve të televizioneve kombëtare dhe në emisionet locale;
- Takime me shoqatat lokale të operatorëve turistik (në DRT), Bashkitë dhe Njësitë Administrative në zonat turistike.

Fokusi i Drejtorisë së Manaxhimit të Riskut u përqëndrua te vlerësimi i faktorëve të renditur si më poshtë:

- Monitorimi i të gjithë tatimpaguesve të cilët ushtrojnë veprimtari në sektorin turistik (hoteleri, akomodim, bar-restorante) në zonat turistike kryesisht bregdetare dhe malore;
- Monitorim specifik të subjekteve me një kapacitet akomodues mbi 15 dhoma në mënyrë që të regjistrohen për përgjegjësinë tatimore TVSH nëse nuk e kanë atë;
- Analiza javore dhe mujore e xhiros në pajisje fiskale dhe krahasimi me javën ose muajin e mëparshëm;
- Analizë e sektorit të turizmit duke e fragmentizuar atë në 7 rajone kryesore: Tiranë, Durrës, Vlorë, Sarandë ó Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër ó Kukës, Korçë, të tjera qytete për sektorin hotelier;
- Analizë e çmimeve në platformat online (si booking) për të krahasuar me çmimet e afishuara për dhoma përkatëse në structure;
- Krahasim i shpenzimeve mujore duke përfshirë blerjet, shpenzime për paga, ujë, energji elektrike, taksat dhe tarifatat vendore me të ardhurat e deklaruara në pajisjet fiskale;
- Krahasimi i xhiros së deklaruar me numrin e punonjësve (xhiro e ulët numër i lartë punonjësish ose e kundërta);

- Verifikimi i raportit të blerjeve mbi shitjet;
- Analizë e listpagesave për të verifikuar deklarin e pagës, profesionit, kategorinë e punësimit dhe ditët e punës;
- Analizë e tatimpaguesve pjesë e sektorit të cilët kanë kërkuar shuma të larta rimbursimi për investimin e kryer dhe duhet të justifikojnë atë nëpërmjet qarkullimit (informacioni do merret nga Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së);
- Analizë e tatimpaguesve me pagesë të vonuar të detyrimit tatimor dhe me dorëzim të deklaratave me 0.
- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut monitoroi të gjithë tatimpaguesit mbi baza javore në bazë të infomacionit nga vetdeklarimi tatimpaguesve.
- Vlerësimi në vazhdim i popullatës së turizmit u krye në bazë të të dhënave nga pajisjet fiskale dhe te vetdeklarimeve duke vënë në fokus trendin e xhiros dhe kuponave te prerë gjatë javës dhe ne fundjavë dhe në periudhën pikë të turizmit.

Në përmbushje të qëllimit të planit operacional për sezonin veror 2021, Drejtoria e Kontrollit Tatimor manaxhoi dhe koordinoi punën me Drejtoritë e Kontrollit në Drejtoritë Rajonale për arritjen e objektivave objektivat kryesorë të vendosur.

## **II – Deklarimet me shkallë tatimore 6% të TVSH-së**

Me qëllim shmangien e abuzimeve gjatë sezonit veror kur edhe volumi i aktiviteti është me i lartë u kryen verifikimet e mëposhtme:

- ✓ Nga tatimpagues që deklarojnë 6% TVSH, por që nga verifikimi i informacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk kanë aplikuar për pajisjen me çertifikatë si strukturë akomoduese u kryhen rivlerësime të shitjeve të kryera me 6%.
- ✓ Gjatë vizitave fiskale bazuar në programin e kontrollit u bë verifikimi i raportit të TVSH-së në shitje/TVSH në blerje, gjendjes së inventarit dhe vlerësimit nëse blerjet janë me dokumentacion të rregullt tatimor.

## **II – Verifikimi i ardhurave /shpenzimeve**

Pjesë e planit operacional, për sektorin e turizmit ishte gjithashtu:

- ✓ Verifikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, qira, tatim në burim, shpenzime utilitare (energji elektrike, ujë, gaz, etj)
- ✓ Vlerësimi i marzhit të fitimit dhe marzhit të TVSH-së
- ✓ Verifikim i aftësisë paguese të detyrimeve tatimore për tatimpagues debitor.
- ✓ Përputhshmëria ndërmjet qarkullimit të pajisjeve fiskale dhe deklaratave të TVSH-së
- ✓ Reklamimet e shtypjeve gabim të pajisjeve fiskale sipas udhëzimit përkatës
- ✓ Verifikime të raportit: numri i punonjësve në krahasim me qarkullimin e realizuar

## **Nga analiza e këtyre planeve konstatohet se:**

Në zbatim të Shkresës Nr.9438/2 prot datë 02.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve janë kryer monitorime të strukturave të kontrollit pranë Drejtorive Rajonale Tatimore që kryenin monitorim të xhiros ditore për tatimpaguesit e propozuar për kontroll nga DPT;

Në zbatim të Shkresës Nr.14613 prot datë 05.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve janë kryer monitorime të strukturave të verifikimit në terren pranë Drejtorive të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT dhe në Rajone, që kryenin verifikime në vend për tatimpaguesit e propozuar për kontroll nga DPT.

-Regjistrim për pergjegjesine tatimore të TVSH I 175 tatimpaguesve, nga të cilët 151 ekzistues dhe 24

tatimpagues të rinj.

-Rritja me rreth 16 % e numrit të punonjesve të deklaruar për popullatën e targetuar aktive

-Rritje me 8% e numrit të punonjesve për tatimpaguesit aktiv

-Rritja me 35% e pagesës së kontributeve për muajin gusht 2021 në raport me gusht 2019.

## 2. Plani Sektorial i Rindërtimit

Një tjetër analizë që u zhvillua nga DRT-të, është ajo e tatimpaguesve të përfshirë në procesin e rindërtimit. Në këtë raport janë marrë në analizë 399 subjekte (NIPT-e) të përfshirë në procesin e Rindërtimit. Grupimi i këtyre subjekteve sipas DRT është i paraqitur si më poshtë:

**Tabela nr.7 Subjektet e rindërtimit**

DRT	Nr i Nipteve të rindërtimit	Nr i Nipteve të rindërtimit në përqindje
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	9	2%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	7	2%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	69	17%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	36	9%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	6	2%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	21	5%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	7	2%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	1	0%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	1	0%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	28	7%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	1	0%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	2	1%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	210	53%
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	1	0%
<b>Totali</b>	<b>399</b>	<b>100%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, evidentohet se 53% e subjekteve të analizuar janë nën juridiksionin e DRT Tiranë, 17% janë në juridiksionin e DTM dhe pjesa tjetër është e shpërndarë në DRT e tjera. 81% e subjekteve të analizuar janë të formës ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe rreth 15% janë të formës ligjore person fizik.

Sa i takon tipologjisë së biznesit, pjesa më e madhe janë biznes i madh në masën 89% dhe pjesa tjetër prej 11% është biznes i vogël. Nga kryqëzimi i informacionit të marrë nga numri i deklaratave të TVSH-së dhe kotnrollit nëpërmjet sistemit, u evidentua se disa prej subjekteve të analizuar nuk e kanë sistemuar tipin e llojit të biznesit, për shkak se kanë përfutur nga rritja e pragut të TVSH-së dhe nuk janë më nën përgjegjësi të TVSH.

**Tabela nr.8 Subjekte që kanë përfutur nga rritja e pragut të TVSH**

Përshkrimi sipas Rev 2	Nr I Nipteve të Rindërtimit	Nr I Nipteve të Rindërtimit në %
Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale	68	17%
Aktivitetet inxhinjerieke dhe konsulenca teknike të lidhura me to	43	11%
Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale	41	10%
Aktivitetet arkitekturore	38	10%
Të tjera punime të specializuara ndërtimi p.k.t.	24	6%
Tregtia me shumicë jo e specializuar	16	4%
Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare	11	3%
Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi	9	2%
Punime të tjera përfundimtare dhe finicioni të ndërtesave	7	2%

Ndërtimi i veprave të tubacioneve e kanalizimeve	6	2%
Nxjerrja nga karriera e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumës dhe rrasave	6	2%
Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave	5	1%
Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim	5	1%
Punime montimi	5	1%
Punime suvatimi	5	1%
Aktivitetet të ndërmjetësimit për shitjen e lëndës drusore	4	1%
Instalime elektrike	4	1%
Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.t.k.	4	1%
Prodhimi i dyerve dhe dritareve metalike	4	1%
Transporti rrugor i mallrave	4	1%
Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuara	4	1%
Tregtia me shumicë e produkteve të tjerë ndërmjetës	4	1%
Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	3	1%
Tregtia me pakicë e pjesëve elektronike, bojrave dhe xhamit	3	1%
Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake dhe radio e televizorë	3	1%
Aktivitetet të qendrave telefonike (call center)	2	1%
Aktivitetet të tjera p.k.t	2	1%
Aktivitetet e shoqatave e organizimeve ekonomike dhe punëdhënësve	2	1%
Prodhimi i aluminit	2	1%
Prodhimi i llaçit	2	1%
Prodhimi i mobiljeve të tjera	2	1%
Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara	2	1%
Shpime	2	1%
Të tjera aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t	2	1%
Testimet dhe analizat teknike	2	1%
Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara	2	1%
Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes	2	1%
Aktivitetet të tjera	49	12%
<b>Totali</b>	<b>399</b>	<b>100%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga tabela e mësipërme, evidentohet se aktivitetet ekonomike që zënë popullatën më të madhe janë: Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale dhe Aktivitetet inxhinierike dhe konsulentat teknike të lidhura me to.

Për këto subjekte është marrë informacion për deklaratat e TVSH për një periudhë 9-mujore, nga Gushti 2020 ó Prilli 2021. Nga deklaratat janë identifikuar Shitjet e Përrjashtuara dhe Blerjet e Përrjashtuara në nivel subjekti dhe në total:

*Shitjet e përrjashtuara në total janë* 30,130,640,347

*Blerjet e përrjashtuara në total janë* 28,131,149,354

Evidentohet se raporti Shitje të përrjashtuara/Blerje të përrjashtuara = 1,07, pra rreth 1,07 herë më shumë shitje të përrjashtuara.

Rreth 174 nipte kanë një raport Shitje/ Blerje të Përrjashtuara më të vogël se 2. Ndërsa nga ana tjetër kemi rreth 158 tatimpagues që raportin e Shitje/ Blerje të përrjashtuar e kanë > 2. Për 30 prej tyre raporti është në vlera shumë të larta ( mbi 30 deri ne 4,300 ) por kryesisht janë subjekte që kanë kryer Shitje të përrjashtuar në vlera jo shumë të larta krahasuar me pjesën tjetër të tatimpaguesve dhe nga ana tjetër Blerjet i kanë në shifra minimaliste. Këto subjekte janë kryesisht Shpk dhe person fizik, të cilët ofrojnë Shërbime Arkitekturore, Konsulenca Teknike, Ndërtimi i ndërtesave, etj.

Për Tatim paguesit e rindërtimit është marrë dhe një informacion përsa i përket TVSH-së së kreditueshme nga ku rezultojnë:

- 31 subjekte me Tvsh të kreditueshme nga 0 ó 10.000.000 lekë, që përbëjnë 8 % të subjekteve të analizuara;
- 5 subjekte me Tvsh të kreditueshme më të lartë se 10.000.000 lekë, që përbëjnë vetëm 1 % të

subjekteve të analizuara;

Nga informacioni i marrë për humbjen tatimore për vitin 2020 konkludohet që rreth 13 tatimpagues kanë dalë me humbje tatimore që variojnë nga 950,000 leke deri në 108,000,000 lekë, të cilët kanë pasur shitje dhe blerje të përjashtuara gjatë periudhës së marrë në shqyrtim (Gusht 2020 ó Prill 2019) disa prej tyre në shifra të larta sidomos në blerje.

Një tjetër aspekt subjekt analize ishin listëpagesat, specifikisht, listëpagesa e muajit Mars 2021. Rreth 36.2% e punonjësve janë me pagë minimale, të punësuar me profesione të ndryshme si hidraulik, mekanik, elektrikisht, saldator etj. Vihet re që një numër shumë i lartë rreth 14.5% i të punësuarve nën pagën minimale. Nga këto në kategorinë òl punësuar i larguar nga puna (shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës) pavarësisht nga data e shkëputjes dhe orët e punuara gjatë muajit, subjekti punëdhënës deklaronë janë 2.511 punonjës.

Nga 399 tatimpagues të analizuar, 29 prej tyre kanë një deri në dy punonjës, pavarësisht formës së biznesit të tyre apo xhiros që ato realizojnë, ku 5 punonjës janë me pagë nën minimale.

Për të parë ndikimin në Tvsh-në e paguar për tatimpaguesit është marrë në analizë situata financiare e vitit 2019 dhe 2021 ku është marrë informacion për totalin e vlerës së tatueshme në shitje për të dy vitet që u bë krahasimi.

**Tabela nr.9 Vlera e tatueshme në shitje për dy vitet e fundit**

Rënie të koeficientit= TVSH e paguar / Shitjet me TVSH	Numri I TP-ve	në përqindje
10%-30%	12	4%
1%-9%	138	48%
0%	38	13%

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Rezulton që rreth 4% e tatimpaguesve kanë pasur një ulje të këtij koeficienti nga 10% deri në 30%, 138 tatimpagues kanë pasur ulje nga 1% deri në 9% , 38 TP nuk kanë pasur ndryshim ndërsa pjesa tjetër ka pasur rritje të këtij treguesi.

Nga ana e DMR janë evidentuar tatimpaguesit të cilët do të dërgohen për kontroll të plotë tatimor, kontroll nga zyra, vizita fiskale, monitorime, kontaktim ndërmjet letrave në Drejtoritë Rajonale respektive (duke përjashtuar tatimpaguesit të cilët janë kontrolluar vitin e fundit) të detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr.10 Tatimpaguesit sipas llojit të kontrollit**

Lloji i kontrollit	Numri i Nipteve
Kontakt nepermjet letrave	105
Kontroll Tatimor	45
Monitorim ne terren	42
Vizite fiskale	125
<b>TOTAL</b>	<b>317</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

- 105 letra të personalizuara i janë dërguar tatimpaguesve të cilët nuk kanë kritere të thyera
- 45 kontrole tatimore janë në proces për tatimpaguesit me mbi 100 milion lekë shitje, të cilët rezultojnë me 3-4 kritere të thyera nga 8 kritere në total.
- 42 monitorime në terren për tatimpaguesit me % të lartë të punonjësve me pagë minimale dhe me numër të vogël punonjësish
- 125 Vizita fiskale janë planifikuar per rastet e:
  1. Shitjeve të përjashtuara më shumë se dyfishi i blerjeve.
  2. Rënie e koeficientit të pagesës së TVSh-së më shumë se 2%
  3. Gjendje e Tvsh-së së kreditueshme.
  4. Humbje gjatë vitit 2020.

Gjithashtu janë propozuar për tu kontrolluar nga sektorët e kontrollit nga zyra në Drejtorinë Rajonale Tatimore tatimpaguesit 340 tatimpagues që rezultojnë pa autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilët kanë realizuar një volum shitjesh të përjashtuara mbi 5 000.000 lekë tek tatimpaguesit e pajisur me autorizim.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 10, datë 13.05.2022 me z. I. K. protokolluar në DPT me nr. 121/22 Prot, datë 13.05.2022.

- Titulli i gjetjes:** Mangësi në identifikimin mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të trajtohet nga administrata tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi, kryerjes së analizave për risqet e evidentuara dhe hartimi i propozimeve dhe rekomandimeve për trajtimin e tyre në nivel sektorial, rajonal apo kombëtar.
- Situata:**
- Nga auditimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut konstatohet se, moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2015, vit në të cilin është implementuar sepse ky modul shqyrton automatikisht aspekte të veçantë të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi. Ky azhurnim bëhet i domosdoshëm për të qenë në koherencë me gjithë ndryshimet që ka pësuar legjislacioni fiskal ndër vite, vetë administrata tatimore por edhe profili i tatimpaguesve. Kjo me qëllim identifikimin dhe verifikimin e tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial në harmoni me procedurat ligjore në fuqi dhe ndihmon administratën tatimore të zbulojë evazionin dhe mashtrimin tatimor.
  - Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Menaxhimit të Riskut nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës.
  - Konstatohet se edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën Drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë:
    - Subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtorinë Rajonale.
    - Renditjen e subjekteve me të njëjtin numër rregullash të thyera.
    - Për vitin 2021 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 278 kontrole nga 1975 kontrole të planifikuara ose rreth 14% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë dhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale.
- Referuar manualit të riskut, Drejtorinë Rajonale Tatimore i dërgojnë Drejtorisë së Kontrollit në DPT, brenda datës 10 të çdo muaji, raportin mbi aktivitetin e kontrollit të muajit të kaluar, përfshirë kontrollet e plota dhe vizitat fiskale. Drejtoria e Kontrollit në DPT përpilon raportin mujor i cili shqyrtohet dhe nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut për qëllime të objektit të punës në lidhje me kriteret e riskut. Mbi këtë bazë Drejtoria e Menaxhimit të Riskut raporton rregullisht brenda datës 20 të çdo muaji te nëndrejtori i Përgjithshëm i varësisë. Nga auditimi konstatohet mungesa e dokumentimit të raportimit mujor të DMR-së.
- Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar, neni 33;

	Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 116; Manuali i Menaxhimit të Riskut; Rregullore e Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në marrjen e masave efikase nëpërmjet përcaktimit të detyrave të strukturave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre, arritjen e objektivave, përmirësimet ligjore në lidhje me përmirësimin e sistemit të riskut, në përputhje me prioritetet e DPT në mbrojtje të interesave të tatimpaguesit.
<b>Shkaku:</b>	Mungesë e bashkëveprimit midis drejtorive me qëllim përsosjen e sistemit të riskut dhe hedhjes së të dhënave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar modulën e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore për të zbuluar evazionin dhe mashtrimin tatimor. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për standardizimin dhe dokumentimin e raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundësuar unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara. Në çdo rast të përgatiten raporte përgjithësuese në mënyrë periodike me problematikat më të shpeshta të hasura dhe me mendime për përmirësimin e kriterëve të risqëve.
<b>Afati:</b>	Menjëherë

## **B. Drejtoria e Kontrollit Tatimor**

Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit.
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT dhe DRT

*Baza Ligjore*

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore, i ndryshuar,
- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 òPër taksat kombëtare, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- Rregullore dhe Manuale për funksionimin e drejtorisë;
- Manuali i Kontrollit Tatimor;
- Rregullore e Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore
- Akte të tjera ligjore e nënligjore.

Nga auditimi dhe dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se:

ÉDrejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në të gjitha DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

ÉObjektivi kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale. Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është miratuar me Urdhrin nr. 79 datë 27.03.2020, nr. 1181/6 Prot datë 27.03.2020.

Drejtoria e Kontrollit tatimor përbëhet si më poshtë:

1. Drejtori i Drejtorisë
2. Sektori i Kontrollit Tatimor (1+5)
3. Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit (1+5)
4. Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave (1+2)

Në zbatim të nenit 117-118 të Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në planin operacional të vitit 2021 ka programuar për kontroll 7 Drejtori Rajonale Tatimore lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe përmbushjen e kontrollit tatimor ne tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshëm.

Në bazë të planit operacional Drejtoria e Kontrollit Tatimor ka planifikuar Drejtoritë Rajonale si më poshtë:

- DRT Sarandë me autorizimi nr. 1693 date 28.01.2021;
- DRT Shkodër me autorizim nr. 25441 date 25.01.2018;
- DRT Korçë me autorizim nr. 3992 date 03.03.2021;
- DRT Kukës me autorizim nr. 3992 date 03.03.2021;
- DRT Vlore me autorizim nr. 16945/1, date 01.10.2021;
- DRT Dibër me autorizim nr. 22248 date 02.11.2018;
- DRT Tiranë me autorizim nr 16946 datë 17.09.2021.

Nga verifikimi i kontrolleve të ushtruara në drejtoritë rajonale nga inspektorët e kontrollit të D.K.T (sektori i kontrollit tatimor dhe sektori i procedurave të kontrollit dhe monitorimit sipas programeve të kontrollit të miratuara, për zbatimin e legjislacionit tatimor si më poshtë vijon:

**1.** DRT Shkodër me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 25441/2, datë 15.01.2021 dhe program kontrolli nr. 25441/1, datë 07.01.2021 për periudhën 01.04.2018-31.12.2020. Kontrolli është realizuar nga data 15.01.2021 deri 15.03.2021

Inspektor: M. A., A. Ll.

Aktet e Inspektoreve: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 14171 prot., datë 28.07.2021 dhe shkresa nr. 24441 prot., datë 02.09.2021 për dërgimin e Raport Kontrolli Përfundimtar së bashku për detyrat e rekomanduara për zbatim.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin se analiza për ndryshimet në postet e bilanceve me vlera materiale ka karakter formal. Huatë apo overdraft-et dhe ndryshimi i vlerës së tyre nga njëra periudhë objekt kontrolli në tjetrën, nuk janë trajtuar plotësisht. Kërkohet vëmendje më e madhe mbi kontrollin mbi sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP, pasi konstatohet se zbulueshmëria është në nivele të pa përfillshme. Në kontrollin mbi sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP, zbulueshmëria është në nivele të pa përfillshme dhe në asnjë rast nuk konstatohet se është ndryshuar numri i të punësuarve apo niveli i pagave, nga vetdeklarimet e subjektit. Me mbylljen e kontrollit nuk pasqyrohet niveli i ri i treguesve financiarë. Analiza e qarkullimit te parasë (cash flo ), lëvizjet e bankës, saktësia e të ardhurave dhe shpenzimeve te bëhen ne mënyrë të detajuar, për



periudhën nën kontroll me FDP-të mujore dhe në rast mosrakordimi të njoftohet tatimpaguesi dhe të bëhet vlerësim tatimor.

**2.** DRT Vlorë me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 25441/2, datë 15.01.2021 dhe program kontroll nr. 25441/1, datë 07.01.2021 për periudhën 01.04.2018-31.12.2020. Kontrolli është realizuar nga data 15.01.2021 deri 15.03.2021.

Inspektor: M. A., A. Ll., A. G.

Aktet e Inspektoreve: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 14171 prot., datë 28.07.2021 dhe shkresa nr. 24441 prot., datë 02.09.2021 për dërgimin e Raport Kontrolli Përfundimtar së bashku për detyrat e rekomanduara për zbatim.

**3.** DRT Dibër me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr.16944/2, datë 01.10.2021 dhe program kontroll nr.16944/1, datë 17.09.2021 për periudhën 01.01.2019-30.08.2021. Kontrolli është realizuar nga data 01.10.2021 deri 31.10.2021

Inspektor: N. K., A. Ç.

Aktet e Drejtorisë së Kontrollit: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 16944/3 prot., datë 22.02.2022.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin:

- Për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e hotelerisë dhe kanë llogaritur TVSH-në në shitje në masën 6%, pa u pajisuar me leje përkatëse, të bëhet sistemimi i situatave për këto subjekte dhe llogaritja e detyrimeve, duke aplikuar TVSH-në, në shitje me shkallë tatimore 20%, për çdo rast kur tatimpaguesit nuk plotësojnë kushtet ligjore.

-Për kontrollet që do të ushtrohen në subjektet me veprimtari specifike si, në fushën minerare, të ndërtimit, ashtu edhe në të tjera, në të ardhmen rekomandojmë që të kryhen në bashkëpunimin me specialistë të jashtëm të fushës.

-Në rastin e vizitave fiskale, të bëhet më shumë kujdes në përzgjedhjen e artikujve për inventarizimin fizik sipas metodikave të përcaktuara për hartimin e bilancit material, krahasuar me gjendjen kontabël.

-Të rritet zbulueshmëria për kontrollin mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe TAP, si për numrin e punonjësve të punësuar në subjekt apo nivelit të pagave të vetdeklaruar nga subjekti.

-Drejtoria e Kontrollit në Dibër, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, pas çdo tremujori duhet të evidentojnë subjekte mospagues të kësteve të tatim fitimit dhe menjëherë të vendosë gjoba në masën 10% të shumës së detyrimit të papaguar, bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në RSHö, i ndryshuar, neni 114/1.

**4.** DRT Sarandë me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1693 prot. datë 02.07.2021 dhe program kontroll nr.1693 prot., datë 02.09.2021 për periudhën Janar 2019 ó Dhjetor 2020. Kontrolli është realizuar nga data 01.02.2021 deri 31.03.2021

Inspektor: J. Sh., A. Ç.

Aktet e Drejtorisë së Kontrollit: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 1693 prot., datë 02.07.2021, Raporti i kontrollit nr.1693 prot., datë 02.08.2021.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin:

Procesi i fiskalizimit duhet të ndiqet me korrektësi dhe me përparësi. Në mënyrë të vazhdueshme, si grupi i punës ashtu edhe inspektorët e kontrollit të njihen në kohë reale me të rejtat e procesit dhe të ndjekin të gjitha etapat deri në vënien në efikasitet të plotë të këtij sistemi.

Duke qenë se DRT Sarandë pjesën më të madhe të subjekteve (bizneseve) të regjistruar e kryejnë aktivitetin e tyre në fushën e shërbimeve si, Bar, Restorante, Hotele etj, në sezonin turistik inspektorët e kontrollit në kontrollet që planifikojnë apo kryejnë në këto subjekte duhet që të analizojnë edhe kostot e produkteve që ato tregtojnë.

Në lidhje me DIVA-n, DRT Sarandë dhe inspektori i ngarkuar për ndjekjen e këtij lloji tatimi të mbajë parasysh Rregulloren e DPT-së me nr. 24607, datë 24.10.2017 për saktësimin e procedurave lidhur me vlerësimin tatimor të tatimit mbi të ardhurat personale për të ardhurat e padeklaruar dhe të

patatuara të individëve. Për deklaratimet e vitit 2020 e në vazhdimësi të evidentohen personat te cilet kane qene te dypunësuar ose me shume se njëherë te punësuar të cilët janë subjekte deklarimi të këtij lloj tatimi bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 òPër Tatim mbi të Ardhuratò, i ndryshuar.

Në kontrollin mbi sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP, të rritet zbulueshmëria mbasi në asnjë rast nuk konstatohet se është ndryshuar numri i të punësuarve apo niveli i pagave, nga vetdeklarimet e subjektit.

Të vazhdojë puna sistematikisht për trajnimin e të gjithë subjektet të cilët janë të interesuar për procesin e fiskalizimit

**5. DRT Korçë me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3992, datë 03.03.2021 dhe program kontroll nr. 3992/1, datë 03.03.2021 për periudhën 2019-2020. Kontrolli është realizuar nga data 30.03.2021 deri 13.07.2021**

Inspektor: B. B., L. Gj., V. Dh.

Aktet e Drejtorisë së Kontrollit: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 3992/2 prot., datë 14.09.2021, Raporti Përfundimtar i Kontrollit nr. 3992/7 prot., datë 22.10.2022

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin:

Me mbylljen e kontrollit nuk pasqyrohet niveli i ri i treguesve financiarë. Analiza e qarkullimit te parasë (cash flow), lëvizjet e bankës, saktësia e të ardhurave dhe shpenzimeve te bëhen ne mënyrë të detajuar, për periudhën nën kontroll me FDP-të mujore dhe në rast mosrakordimi te njoftohet tatimpaguesi dhe të behet vlerësim tatimor. Kërkohet vëmëndje më e madhe mbi kontrollin mbi sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP, pasi konstatohet se zbulueshmëria është në nivele të pa përfillshme. Në kontrollin mbi sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP, zbulueshmëria është në nivele të pa përfillshme dhe në asnjë rast nuk konstatohet se është ndryshuar numri i të punësuarve apo niveli i pagave, nga vetdeklarimet e subjektit. Analiza për ndryshimet në postet e bilanceve me vlera materiale ka karakter formal. Huatë apo overdraft-et dhe ndryshimi i vlerës së tyre nga njëra periudhë objekt kontrolli në tjetrën, nuk janë trajtuar plotësisht.

**6. DRT Kukës me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr.3992, datë 03.03.2021 dhe program kontroll nr. 3992/1, datë 03.03.2021 për periudhën 2019-2020. Kontrolli është realizuar nga data 20.09.2021 deri 22.10.2021**

Inspektor: B. B., L. Gj., V. Dh.

Aktet e Drejtorisë së Kontrollit: 1. Raport Kontrolli Paraprak nr. 3992/8 prot., datë 22.02.2022.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin:

Krahasimi i nivelit të treguesve (vlerësimi i pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin) për secilën periudhë në kontroll (krahasuar me të dhënat e analizës së riskut në fillimin e kontrollit) dhe niveli i këtyre treguesve të arritur pas kontrollit grupi i kontrollit ka konstatuar se jo ne te gjitha rastet pasqyrohet ne aktet e kontrollit.

Me mbylljen e kontrollit tatimor, në raportin përfundimtar të kontrollit, të pasqyrohen jo vetëm zbulimet, por edhe niveli i ri (ndryshimi) i treguesve fiskal/llojeve të tatimit pas kontrollit (ishte-bëhet). Kjo jo vetëm për të dhënë sa më të qarta efektet e kontrollit, por edhe për arsye se në disa raste, megjithëse subjekti ka dalë për kontroll të plotë tatimorë, pra me risk, zbulueshmëria nga kryerja e kontrollit është e tillë, sa që edhe pas kryerjes së kontrollit, treguesit e riskut ngelen të pa ndryshuar.

Lidhur me analizën e efektshmërisë së kontroleve të ushtruar në subjekte, nisur nga arsyet e planifikimit për kontroll, si nga risku i DPT-së, apo propozime nga vet DRT-të, grupi i kontrollit ka konstatuar se në raportet e kontrollit nuk është trajtuar kjo problematikë.

Drejtoria e Kontrollit në DRT-të, në lidhje me efektshmërinë e nxjerrjes nga risku i subjekteve për kontroll të bëjë analiza dhe ti japë përgjigje departamentit të analizës së riskut nëpërmjet plotësisht të formularit përkatës i cili duhet të pasqyrohet në sistemin c@ts si në rastet e përzgjedhura nga DMR-ja ashtu edhe në rastet kur janë propozime nga DRT-të.

Nga grupi i kontrollit është konstatuar se: analiza e treguesit të tatim fitimit në disa raste është bërë kryesisht duke trajtuar në raport të dhënat e treguesve të pasqyrave financiare të bilancit, pa kryer një analizë dhe shqyrtim të tyre duke u nisur nga vëllimi e treguesve të shitjes norma e fitimi, Në raportet e kontrollit analiza e posteve të bilancit, nuk duhet të ketë karakter formal, por duke analizuar/shprehur për faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e tyre sipas periudhave nën kontroll dhe justifikimi i ndryshimeve, mbi bazë dokumentacioni.

Nga auditimi për kontrollin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale sipas pikave të programit rezultoi se u konstatua se:

-Grupi i kontrollit në pikën nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr.5. të programit, përmban konstatime përgjithëse, pa problematikë të veçantë, ku të evidentohen shkelje të afateve procedurale. Trajtohet në përgjithësi pa analiza konkrete pika 2 ÷ Kontrolli i afateve në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit të Kontrollit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit, në zbatim të neneve 83 dhe 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷ Për procedurat tatimore në RSHo i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2009, i ndryshuar me komentin se do të trajtohet në pikën 6 të programit. Në programin e kontrollit, duhet të përfshihen ato çështje që paraqesin risk, dhe jo program përgjithësues, pikat e të cilave mund të verifikohen lehtësisht nga zyra sipas të dhënave dhe dokumenteve të ngarkuara në sistemin C@TS.

- Grupi i kontrollit për realizimin e pikës 6 ÷ Shqyrtimi dhe verifikimi i cilësisë së raporteve të kontrollit sipas inspektoreve të kontrollit ka trajtuar subjektet në të cilat janë përshkruar saktësisht e raportit të kontrollit dhe parregullsitë e konstatuara në të. Nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit specifikohet se përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll nga grupi i punës është bërë duke pasur parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Analiza e nivelit të gjetjeve, Kriteret e Riskut për përzgjedhje (rastet 1 dhe 2), përzgjedhjen për çdo inspektor kontrolli, si dhe llojet e ndryshme të aktivitetit.

- Mosrespektimi i procedurave (kontrolli me vonesë/ shkaqet).

- Proporcionalitetin sipas muajve e llojit të kontrollit (i plotë dhe vizitë fiskale).

Raste specifike të raportuara nga hetimi, nga DRT për interpretim etj.

- Nga grupi i auditimit nuk është dokumentuar evidenca mbi të cilën Drejtoria e Kontrollit ka kryer përzgjedhjen e subjekteve për kontroll dhe mënyra e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll.

- Është pezulluar kontrolli i planifikuar në DRT Tiranë.

- Për vitin 2021 konstatohen tejkalime të afateve të evadimit të Raportit të Kontrollit për D.R.T Shkodër dhe Sarandë, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.121/42, datë 21.07.2021 ÷ Observacion për Projekt Raportin e Auditimit, protokolluar në KLSH me nr. 20/14, datë 24.07.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Për sa i përket pikave, grupi i punës evidenton se në Raportin e Kontrollit të DRT janë trajtuar problematika dhe konstatime analitike sipas Program Kontrollit të miratuar në mbështetje të neneve 83 dhe 84 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, në zbatim të tij në komentin se do të trajtohen në pikën 6 të programit të kontrollit.*

**Qëndrimi i grupit auditues:** Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon që argumentet e trajtuara merren pjesërisht në konsideratë, pasi pas argumenteve të paraqitura grupi i auditimit gjykon se analiza mbi pikën 2 ÷ Kontrolli i afateve në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit të Kontrollit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit në zbatim të neneve 83 dhe 84 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008

oPër Procedurat Tatimore në RSHö, i ndryshuar edhe pse nuk është realizuar sipas përcaktimeve në programin e kontrollit, është trajtuar në pikën 6 të programit të kontrollit.

**Pretendimi i subjektit:**

*Për sa i përket konstatimit lidhur me përzgjedhjen e kontrollit sqarojmë se kriteret e përcaktuara mbi përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontroll përveç risqeve të evidentuar nga ju, është bazuar mbi regjistrin plan – fakt, sipas formularit nr.4 plan-fakt. Evidentimi i kontrolleve të përzgjedhura për kontroll bëhet në rrugë zyrtare që nga momenti i fillimit të kontrollit me strukturën përkatëse sipas shkallës hierarkike duke pasur parasysh të gjitha kriteret e cituara*

**Qëndrimi i grupit auditues:** Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon që çështjet e trajtuara nuk merren në konsideratë, pasi pas argumenteve të paraqitura grupi i auditimit gjykon se nuk evidentohet mënyra e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll mbi bazë risku.

**Pretendimi i subjektit:**

*Sqarojmë se përgatitja e Raport Kontrollit për DRT Shkodër dhe Sarandë është mbyllur brenda afateve të kontrollit. Në lidhje me tejkalimin e afateve të evadimit në protokoll ju bëjmë me dije se për kryerjen e kontrolleve gjatë vitit 2021 kemi hasur vështirësi në zbatimin e afateve para dhe gjatë ushtrimit të kontrolleve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.... Në pjesën më të madhe të vitit është punuar me sistemin on line. Përveç sa më lart vlen të theksohen mungesat në staf në strukturën Drejtuese dhe Kontrolluese. Për sa i përket rekomandimit nr.6.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është në shqyrtim të këtij problemi, ku Drejtoria e Kontrollit do të jetë pjesë përbërëse e tij.*

*Për sa i përket rekomandimeve 12.1, 12.2 dhe 13.1 Drejtoria e Kontrollit po punon me përmirësimin e “Manualit të Kontrollit nga Zyra” në mbështetje të raporteve që do të prodhohen nga projekti i fiskalizimit.... Për sa i përket rekomandimit 12.3 do të zbatohet menjëherë nga ana e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.*

**Qëndrimi i grupit auditues:** Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon që çështjet e trajtuara nuk merren në konsideratë, pasi pas argumenteve të parashtruara nuk janë paraqitura evidenca të reja nga faza e auditimit në terren.

**Problematika të konstatuara në funksionimin në sektorin e kontrollit tatimor në DRT nga kontrolli tatimor.**

1. Hartimi i programeve të kontrollit vijon të jetë standard, pa pasqyruar veçoritë e aktivitetit, kryesisht në aktivitete prodhues, fason etj.
2. Në hartimin e Raporteve Përfundimtar të Kontrollit në DRT-re, nuk respektohen me korrektësi pikat/kërkesat e programit të kontrollit, por trajtohen në mënyrë të përgjithshme, pa qartësuar e justifikuar shmangiet nga kërkesat e programuara për kontroll.
3. Me mbylljen e kontrollit tatimor, në raportin përfundimtar të kontrollit, të pasqyrohen jo vetëm zbulimet, por edhe niveli i ri (ndryshimi) i treguesve fiskal/llojeve të tatimit pas kontrollit (ishte-bëhet). Kjo për të dalë sa më të qarta efektet e zbulimit nga kryerja e kontrollit dhe situata e treguesve fiskalë të tatimpaguesit, pas dërgimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe për të përcaktuar nëse subjekti ka dalë nga risku, krahasuar me treguesit me të cilët është evidentuar si subjekt me risk.
4. Kontrollat e inspektoreve të rajonale përgjithësisht nuk kundërshtohen nga subjekti i kontrolluar, tregues i nivelit jo cilësor të kontrollit tatimor.
5. Për sigurimet shoqërore, zbulueshmëria është në nivele të papërfillshme, megjithëse është pike në programin e kontrollit.

*Nga të dhënat dhe dokumentacioni i Sektorit Cilësisë dhe Standardizimit për vitin 2021 konstatohet se: - ndjek planet e kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, nga DMR (70% të modulit 1 të DMR si dhe 30% e propozuara nga DRT dhe të miratuara) mbi bazën e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji.*

- analizon dhe përpunon vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale,
- mban evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR,
- të gjitha të dhënat e raportuara nga DRT-të, mbas analizimit dhe përpunimit i dërgohen Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, në DPT.

**Tabela nr.11 Realizimi i kontrolleve për vitin 2021 të detajuar sipas DRT-ve plan, fakt, zbulime (70+30%)**

*Në mijë lekë*

Nr	Rrethet	Nr. Kontrollte te plan. gjithsej			Nr. Kontrollte te kryera gjithsej			Zbulimet sipas llojeve te tatimeve				
		Plote	V.fiskale	Totali	Plote	V.fiskale	Totali	TVSH	T FIT	Sig Shoq	Te tjera	Gjithsej
1	Berat	29	25	54	25	23	48	23,773	6,359	97	739	30,968
2	Diber	39	11	50	31	13	44	18,532	4,883	394	200	24,009
3	Durres	71	112	183	80	108	188	211,020	105,814	16,215	9,072	342,121
4	Elbasan	120	26	146	99	26	125	48,906	21,977	1,903	5,856	78,642
5	Fier	124	87	211	127	89	216	173,114	40,531	2,668	12,680	228,993
6	Gjirokastr	25	13	38	26	12	38	4,714	6,424	193	560	11,891
7	Korçe	138	26	164	109	26	135	30,362	33,256	644	15,221	79,483
8	Kukes	22	0	22	25	2	27	5,498	2,855	108	1,251	9,712
9	Lezhe	33	19	52	19	16	35	412,648	286,068	89	2,413	701,218
11	Sarande	20	27	47	10	30	40	2,842	683	45	470	4,040
12	Shkoder	66	25	91	66	25	91	37,754	26,042	2,097	1,649	67,542
13	Vlore	46	32	78	50	42	92	75,821	16,720	598	1,579	94,718
14	Tirana	187	196	383	242	161	403	620,473	459,108	20,098	265,879	1,365,558
15	Pag Medh	238	146	384	224	150	374	419,873	785,779	7,988	70,901	1,284,542
	<b>Shuma</b>	<b>1158</b>	<b>745</b>	<b>1903</b>	<b>1133</b>	<b>723</b>	<b>1856</b>	<b>2,085,330</b>	<b>1,796,499</b>	<b>53,137</b>	<b>388,470</b>	<b>4,323,437</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Bazuar në tabelën e mësipërme evidentohet se numri i kontrolleve të planifikuara gjatë vitit 2021 është 1903 kontrolle, ku 1158 kontrolle janë kontrolle të plota dhe 745 kontrolle janë vizita fiskale. Kontrolltet e realizuara janë 1856, ku 1133 kontrolle janë të plota dhe 723 kontrolle janë vizita fiskale. Konstatohet një mosrealizim i kontrolleve të realizuara prej 47 kontrollesh ose rreth 3% e totalit.

**Tabela nr.12 Numri i kontrolleve të kryera për vitin 2021 e krahasuar me vitin 2020(70+30%)**

Emërtimi	Totali i rasteve te kontrollit		Zbulimet ne vlere		Tatimet sipas zërave / Totalin e zbulimeve	Tatimet sipas zërave / Totalin e zbulimeve	Numri i kontrollev e në %	Zbulimet sipas zërave në %,
	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021/2020	2021/2020
1.Kontroll fakt biznes i vogël		0	0	0	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
2.Kontroll fakt B.M	1158	1,432	4,323,437	9,514,993	100,0%	100,0%	81%	45%
2.1. TVSH			2,085,330	5,475,514	58%	57,5%		38%
2.2. Tatim fitimi			1,796,499	3,831,283	40%	40,3%		47%
2.3. Sigurime Shoq e Shën			53,137	60,606	1%	0,6%		88%
2.4. Tatim mbi te ardhurat				3710	0%	0,0%		0%
2.5. Akcizë					0%	0,0%		0%
2.6. Lojëra fati					0%	0,0%		0%
2.7. Taksa nacionale					0%	0,0%		0%
2.8. Të tjera			388,470	147,590	2%	1,5%		263%
<b>Shuma ( 1 + 2)</b>	<b>1158</b>	<b>1432</b>	<b>4,323,437</b>	<b>9514993</b>	<b>100,0%</b>	<b>100,0%</b>	<b>81%</b>	<b>45%</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH*

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se realizimi i numrit të kontrolleve për periudhën 12 mujore të vitit 2021 e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 është realizuar në masën 81% të kontrolleve ndërsa realizimi i zbulimeve është në masën 45 %, e krahasuar me vitin 2020, çka tregon për punën jo efektive gjatë 2021 si në realizimin e kontrolleve të planifikuara dhe në zbulimet e konstatuara nga ana e DRT-ve.

**Tabela nr.13 Evidenca progresive për realizimin e planit të kontrollit 12 mujor 2020(70+30%)**

Nr.	DRT	Kontrolle plan. 12 mujori 2021			Kontrolle fakt 12 mujori 2021			Realizimi i planit kontrolleve %		
		Te plota	V.fiskale	Gjithsej	Te plota	V.fiskale	Gjithsej	Gjithsej	Te plota	V. fiskale
1	Berat	29	25	54	25	23	48	89%	86%	92%
2	Dibër	39	11	50	31	13	44	88%	79%	118%
3	Durrës	71	112	183	80	108	188	103%	113%	96%
4	Elbasan	120	26	146	99	26	125	86%	83%	100%
5	Fier	124	87	211	127	89	216	102%	102%	102%
6	Gjirokastrë	25	13	38	26	12	38	100%	104%	92%
7	Korçë	138	26	164	109	26	135	82%	79%	100%
8	Kukës	22	0	22	25	2	27	123%	114%	0%
9	Lezhë	33	19	52	19	16	35	67%	58%	84%
10	Sarandë	20	27	47	10	30	40	85%	50%	111%
11	Shkodër	66	25	91	66	25	91	100%	100%	100%
12	Vlorë	46	32	78	50	42	92	118%	109%	131%
13	Tiranë	187	196	383	242	161	403	105%	129%	82%
14	VIP	238	146	384	224	150	374	97%	94%	103%
	<b>TOTALI</b>	<b>1158</b>	<b>745</b>	<b>1903</b>	<b>1133</b>	<b>723</b>	<b>1856</b>	<b>98%</b>	<b>98%</b>	<b>97%</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se disa DRT janë me mosrealizime të mëdha të kontrolleve e konkretisht DRT Berat me 89% kontrolle të realizuara, DRT Dibër me 88% kontrolle të realizuara, Elbasan me 86% kontrolle të realizuara, Korçë me 88% kontrolle të realizuara, Lezhë me 67% kontrolle të realizuara, VIP me 97% kontrolle të realizuara.

Gjithashtu nëse analizojmë dhe kontrollet janë kryer sipas Moduleve 1, 2,3, e konkretisht:

**Tabela nr.14 Moduli 1 (70% DMR) ne (000/lekë)**

DR	Toali	Kontrolle të kryera raste 1			Totali vlere
		Me zbulime	Pa zbulime	pa zbul %	
Berat	33	31	2	6.06	23,689
Diber	32	26	6	18.75	18,025
Durres	142	87	55	38.73	203,661
Elbasan	87	81	6	6.9	27,865
Fier	161	145	16	9.94	162,929
Gjirokaster	26	22	4	15.38	8,422
Korçe	100	81	19	19	40,214
Kukes	17	16	1	5.88	6,072
Lezhe	28	26	2	7.14	38,801
Sarande	35	11	24	68.57	2,863
Shkoder	64	63	1	1.56	39,885
Vlore	75	71	4	5.3	85,318
Tirana	287	206	81	28.22	854,486
DTM	280	203	77	27.5	904,388
<b>Totali</b>	<b>1367</b>	<b>1069</b>	<b>298</b>	<b>21.799561</b>	<b>2,416,618</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga 1367 kontrolle të kryera sipas propozimit të Drejtorisë së Menaxhimit të riskut, 1069 kontrolle ose rreth 78% e totalit rezultojnë me zbulime nga ana e inspektorëve të kontrollit. Zbulimi për kontroll

është 1,768 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 1,650 mijë lekë, pra kemi rritje të zbulimit për kontroll ose e realizuar 107 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar;

**Tabela nr.15 Moduli 2 (30% DMR) në (000/lekë)**

DR	Kontrolle të kryera raste 2				Totali
	gjithsej	me zbulime	pa zbulime	pa zbul %	
Berat	15	11	4	26.7	7,279
Diber	12	12	0	0	5,984
Durres	45	38	7	15.6	138,377
Elbasan	38	36	2	5.3	50,778
Fier	55	50	5	9.1	66,064
Gjirokaster	12	12	0	0	3,469
Korçe	34	27	7	20.6	29,483
Kukes	10	10	0	0	3,640
Lezhe	5	5	0	0	660,092
Sarande	5	5	0	0	1,177
Shkoder	26	26	0	0	23,694
Vlore	16	12	4	25	9,086
Tirana	109	95	14	12.8	359,577
DTM	86	84	2	2.3	335,769
<b>Totali</b>	<b>468</b>	<b>423</b>	<b>45</b>	<b>9.6</b>	<b>1,694,469</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga 468 kontrolle të kryera sipas propozimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, 423 kontrolle ose rreth 9% e totalit rezultojnë me zbulime nga ana e inspektorëve të kontrollit. Zbulimi për kontroll është 3,261 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 26,478 mijë lekë, pra kemi ulje të konsiderueshme të zbulimit për kontroll ose e realizuar vetëm 15 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar;

*Nga grupi i auditimit konstatohet se:*

-nuk ka një bashkërendim midis të tre Drejtorive, Drejtoria e Analizës dhe Riskut, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT dhe Drejtoritë e Kontrollit Rajonale, ku nëpërmjet një data baze të jenë rakorduar në mënyrë të saktë dhe automatike moduli 70%, moduli 30%, nga momenti i nxjerrjes nga sistemi i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, miratimi për kontroll i regjistrimit të kontrollit e deri në përfundimin e tij në çdo fazë të kontrollit për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve; kontrollet e lëna pa u mbyllur nuk mund të kenë asnjë justifikim por mos mbyllja e tyre në afate ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e Drejtorisë së Kontrollit në vitet sipas përkatësisë dhe organizimit si dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore dhe Drejtorët e Kontrollit të DRT;

Për vitin 2021 në lidhje me kontrollet e papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, stoku i kontrolleve vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84, edhe pse gjendja është përmirësuar në krahasim me vitin 2020, ku nga 537 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces, në vitin 2021 kjo shifër ka kaluar në 671 kontrolle. Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit me qëllim marrjen e masave për zbatimin e afateve të kontrollit janë bërë njoftime si më poshtë:

- nr. 13186, datë 14.07.2021, drejtuar DRT Tiranë, nr. 13181, datë 14.07.2021 drejtuar DRT Diber, nr. 13192, datë 14.07.2021, drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, nr. 13181, datë 14.07.2021, drejtuar DRT Elbasan, nr. 13186, datë 14.07.2021, drejtuar DRT Tiranë, nr. 13187, datë 14.07.2021, drejtuar DRT Gjirokastër, nr. 13189, datë 14.07.2021, drejtuar DRT Kukës, nr. 13185, datë 14.07.2021, drejtuar DRT Korçë, nr. 13184, datë 14.07.2021 drejtuar DRT Fier, nr. 13180, datë 14.07.2021 drejtuar

DRT Sarandë, nr. 13182, datë 14.07.2021 drejtuar DRT Lezhë, nr. 13188, datë 14.07.2021 drejtuar DRT Vlorë òPër zbatimin e afateve të përfundimit të akteve të kontrolleve tatimore në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor.

Konstatohet një stok i lartë kontrollesh të papërfunduara nga viti 2015, ku deri në 31.12.2021, janë gjithsej 671 kontrolle, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr.16 Evidenca e Fazave në të cilat ndodhen Kontrollat në proces te ndara sipas viteve**

Kontrolle sipas viteve	Kontrolle		Kontrolle pezulluar	Fazat ne te cilen ndodhet Kontrolli				
	Nr.gjithsej	Pa Filluar		Projekt Raport	Pergj Operacional	Drejtori kontrollit	Derguar raport paraprak	Raporti Perfundimtar
				Inspektori				
2015	4	4						
2016	11	8		3				
2017	11	3		8				
2018	27	12		13			2	
2019	33	16		11			6	
2020	91	8	10	58		2	13	
2021	494	227	4	175	1	20	66	1
<b>Totali</b>	<b>671</b>	<b>278</b>	<b>14</b>	<b>268</b>	<b>1</b>	<b>22</b>	<b>87</b>	<b>1</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH

Nga tabela evidentohet se:

-Numri i kontrolleve të pa mbyllura, nga kontrollat e planifikuara për periudhën 2015-2020 është 177 kontrolle, ose rreth 26% e kontrolleve;

-Në 278 kontrolle të pa filluara nga administrata tatimore janë përfshirë edhe kontrollat e planifikuara për muajin Dhjetor 2021, të cilat u janë nisur njoftimi për kontroll, kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Proçedurat Tatimore në R.SHö, i ndryshuar dhe Udhëzimit në mbështetje të tijë neni 81.1/1 Njoftimi për fillimin e kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit të plotë tatimor të shkruar në njoftim, ndërsa në rastin e vizitave fiskale ky njoftim i dërgohet tatimpaguesit të paktën 10 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vizitës fiskale;

- 14 kontrolle janë të pezulluar;

-291 kontrolle janë në fazë projekt raporti;

-87 kontrolle janë në fazën e raportit përfundimtar.

-1 kontroll është në fazën e evadimit

Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet kontrollon dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e Drejtorive të Kontrollit në DRT si:

analiza për këstet e tatimit për rastet që është ndërhyrë pas këstit që vendos sistemi;

analiza si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT; analiza e gjendjes kreditore të TVSh-së;

analizave të situatave kreditore debitor e tatimpaguesve për sigurimet; analiza e efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra;

analiza nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve;

analiza si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit;

analiza për kontrollat nga zyra;



analiza për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit; analiza sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur nuk ka apelime.

- Titulli i gjetjes:** Mangësi në funksion të performancës së realizimit të detyrave dhe udhëheqjes metodologjike në funksionim të kontrollit tatimor.
- Situata 1:** Nga auditimi konstatohet se grupet e kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit në DPT në pikën nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 dhe nr. 5. të programit të kontrollit, përmbajnë konstatime përgjithësuëse, pa problematikë të veçantë, ku të evidentohen shkelje të afateve procedurale. Trajtohet në përgjithësi pa analiza konkrete pika 2 ÷ Kontrolli i afateve në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit të Kontrollit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit, në zbatim të neneve 83 dhe 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷ Për procedurat tatimore në RSHo i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.20009, i ndryshuar me komentin se do të trajtohet në pikën 6 të programit. Në programin e kontrollit duhet të përfshihen ato çështje që paraqesin risk, e jo program përgjithësues, pikat e te cilit mund të verifikohen lehtësisht nga zyra sipas të dhënave dhe dokumenteve të ngarkuara në sistemin C@TS.
- Grupi kontrollit për realizimin e pikës 6 ÷ Shqyrtimi dhe verifikimi i cilësisë së raporteve të kontrollit sipas inspektoreve të kontrollit ka trajtuar subjektet në të cilat janë përshkruar saktësisht e raportit të kontrollit dhe parregullsitë e konstatuara në të. Nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit specifikohet se përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll nga grupi i punës është bërë duke pasur parasysh faktorët e mëposhtëm:
  - Analiza e nivelit të gjetjeve, Kriteret e Riskut për përzgjedhje (rastet 1 dhe 2), përzgjedhjen për çdo inspektor kontrolli, si dhe llojet e ndryshme të aktivitetit.
  - Mosrespektimi i procedurave (kontrollet me vonesë/ shkaqet).
  - Proporcionalitetin sipas muajve e llojit të kontrollit (i plotë dhe vizitë fiskale).
  - Raste specifike të raportuara nga hetimi, nga DRT për interpretim etj.
  - Nga grupi i auditimit nuk është dokumentuar evidenca mbi të cilën Drejtoria e Kontrollit ka kryer përzgjedhjen e subjekteve për kontroll dhe mënyra e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll.
- Për vitin 2021 konstatohen tejkalime të afateve të evadimit të Raportit të Kontrollit për DRT Shkodër dhe Sarandë, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor.
- Nga auditimi i kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor e DPT në drejtoritë rajonale konstatohet se është pezulluar kontrolli i planifikuar në Drejtorinë Rajonale Tiranë.
- Kriteri:**
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ÷ Për Procedurat Tatimore, i ndryshuar, neni 73;
  - Rregullore e Brendshme ÷ Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017;
  - Manuali i Kontrollit Tatimor
- Ndikimi.Efekti:** Drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rezulton të ketë përmbushur me efektivitet rolin e saj.
- Shkaku:** Mungesë e bashkëveprimit dhe zbatimit të ligjit.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandime:**
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të ngrejë një grup pune për përmirësimin e Manualit të Kontrollit ku të përcaktohen kriteret e përzgjedhjes dhe metodat e kampionimit të subjekteve për kontroll që në fazën e planifikimit.
  - Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të urdhërojë përfundimin e kontrollit të ndërprerë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, në bazë të autorizimit nr 16946 datë 17.09.2021.
- Afati:** Menjëherë e në vijimësi
- Titulli i gjetjes :** Mangësi në funksionimin e sektorit të kontrollit nga zyra në Drejtorinë e Kontrollit në DPT.
- Situata 2:** Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë për verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të

dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet, kontrollohet dhe analizohen çështje të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e DK në DRT si: situata kreditore debitore e tatimpaguesve për sigurimet; efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra; nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve; si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit; për kështet e tatimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi; për kontrollet nga zyra; për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit; sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur sërka apelime; si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT; gjendja kreditore të TVSH-së; mbi situatat e parregullta sa janë dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët e kontrollit nga zyra; se ku bazohen dhe si zgjidhen rastet për kontroll nga inspektorët e kontrollit në DRT.

**Kriteri:** -Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar, neni 71;  
-Rregullore e Brendshme òPër Funkcionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 19 datë 22.02.2017, neni 116, neni 117;

- Manuali i Kontrollit Tatimor kapitulli VIII, pika 8.2.

**Ndikimi.Efekti:** Drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rezulton të ketë përmbushur me efektivitet rolin e saj.

**Shkaku:** Kontroll jo efektiv i veprimtarisë së sektorëve të kontrollit nga zyra në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor të hartojë praktika verifikimi nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga sistemi C@ts, nëpërmjet analizave të situatave kreditor- debitor të tatimpaguesve për sigurimet shoqërore; të zbatimit të procesit të rimbursimit; të gjendjes kreditore të TVSH-së; analiza për kështet e tatimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi, kryqëzimin me të dhënat nga sistemi doganor, etj., me qëllim identifikimin e problematikave dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.

**Afati:** Brenda datës 31.12.2022

**Titulli i gjetjes:** Monitorimi i veprimtarisë së Drejtorive Rajonale Tatimore

**Situata 3:** Nga auditimi konstatohet se nga Drejtoria e Kontrollit nuk janë përfunduar kontrolle nga viti 2015, pasi deri në fund të dhjetorit të vitit 2021 janë gjithsej 678 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë:

- Në 278 kontrolle të pa filluara nga administrata tatimore janë përfshirë edhe kontrollet e planifikuara për muajin Dhjetor 2021, të cilat u janë nisur njoftimi për kontroll, kjo bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar dhe Udhëzimit në mbështetje të tij, neni 81.1/1;

- 14 kontrolle janë të pezulluar;

- 291 kontrolle janë në fazë projekt raporti;

- 87 kontrolle janë në fazën e raportit përfundimtar.

- 1 kontroll është në fazën e evadimit.

Nga auditimi konstatohet se kontrollet e mësipërme janë jashtë afateve përkatëse të kryerjes së kontrollit, projekt-raportit, raportit përfundimtar apo dhe evadimit.

**Kriteri:** -Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar, neni 73,  
-Rregullore e Brendshme òPër Funkcionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 19 datë 22.02.2017, neni 116, neni 117;  
- Manuali i Kontrollit Tatimor kapitulli IX, pika 9.1.

<b>Ndikimi.Efekti:</b>	Drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rezulton të ketë përmbushur me efektivitet rolin e saj.
<b>Shkaku:</b>	Monitorim jo efektiv i detyrave funksionale të Drejtorive Rajonale Tatimore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e përealizuara me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të gjitha drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor.
<b>Afati:</b>	Menjëherë e në vijimësi

### **C. Drejtoria e Hetimit Tatimor.**

Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë nga ku u konstatua se:

- *Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 7905/1995 “Kodi i procedurës penale në Republikë e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 7895/1995 “Kodi penal i Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore, i ndryshuar me Ligjin Nr. 25/2019, datë 25.04.2019;*
- *Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;*
- *Vendime të Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme;*
- *Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;*
- *Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 193 datë 22.08.2020.*
- *Manual i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 19/2, datë 28.02.2020.*
- *Akte të tjerë ligjorë, nënligjorë dhe rregullave për funksionimin dhe drejtimin e punës.*

### **Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.**

Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal, të kundërvajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

- Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore;
- Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:
  - a) *mbledhjen e informacionit tatimor;*
  - b) *hetimin tatimor;*
  - c) *zbatimin e masave shtrënguese;*
  - d) *marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.*

Punonjësit e hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

### **Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor.**

Hetimi Tatimor është i organizuar në nivel qendror, në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si më poshtë:

- *Spektori i Hetimit Tatimor;*
- *Spektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave;*
- *Spektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës;*

#### **a) Spektori i Hetimit Tatimor.**

Spektori i Hetimit tatimor është pjesë funksionale e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, e cila sipas ristrukturimit të fundit është organizuar vetëm me një Drejtori të përqendruar në DPT, ndryshe nga organizimi i mëparshëm që përfshinte një Drejtori Qendrore dhe tre Drejtori Rajonale (*Rajoni Qendror, Jugor dhe Verior*).

Spektori i Hetimit Tatimor ushtron funksionet e tij në përputhje me dispozitat e nenit 105 “*Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor, Kreu XII “Hetimi Tatimor”, Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij. Inspektorët e hetimi janë ngarkuar gjithashtu dhe me ndjekjen dhe ezaurimin e praktikave të ardhura nga Rajonet pas centralizimit të strukturës në DPT.*

Struktura e Hetimit tatimor është njësi e specializuar hetimi që ka si funksion parësor mbledhjen e informacioneve dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore lidhur me veprat penale në fushën e tatimeve. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore. Gjithashtu, punonjësit e hetimit tatimor gjatë kryerjes së detyrave mbështeten edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore si:

- *Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar; ndryshuar me ligjin Nr. 25/2019, datë 25.04.2019;*
- *Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e klasifikuar Sekret Shtetëror”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”;*
- *Akteve të tjera nënligjore dalë në zbatim të ligjit material dhe ligjeve të sipërcituara.*

- **Planet e punës dhe ngarkesa për çdo inspektor të Sektorit të Hetimit Tatimor në DPT.**

Spektori Hetimit Tatimor harton planet e punës mujore, të cilat janë miratuara nga Drejtori i Hetimit Tatimore në DPT. Planet e punës të regjistruara në regjistrin e kartotekës janë konfidencial dhe dokumente të klasifikuar, në dispozicion na janë vendosur vetëm protokollat e shkresave konkretisht: Nr. Prot., 92, 117, 174, 198, 237, 247, 277. Qarkullimi i informacionit të klasifikuar dhe dokumentacionit që ka lidhje me hetimin e veprave penale në fushën tatimore, bëhet duke zbatuar dispozitat e legjislationit të fushës në fuqi. Spektori Hetimit Tatimor në DPT ka arkivin e të dhënave të klasifikuara, me protokoll të veçantë me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor, referuar nenit 105.5.4 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Objektivat Strategjike të Drejtorisë për vitin 2021, shprehen bazuar në

Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën 2017-2021, në 3 shtylla kryesore për Drejtorinë e Hetimit Tatimor:

- Objektivi Nr. 1 “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”.
- Objektivi Nr. 2 “Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore dhe hetimi rasteve të mashtrimit tatimor”.
- Objektivi Nr. 3 “Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore”.

Matrica në format Excel e vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar, është ndërtuar në përgjigje të objektivave dhe nën-objektivat e sipër cituara për Drejtorinë e Hetimit Tatimor, bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore.

Për çështjet e referuara në Prokurori, punonjësit Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të cilët gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, urdhërohen për të kryer veprime hetimore proceduriale për dhe në emër të Prokurorit, në të gjitha ato raste që kryejnë referimin e veprave penale, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligj apo të vlerësuara ndryshe nga Prokurori. Nga këta inspektorë (O.P.G.J), me delegim ose urdhër të Prokurorit mund të hetohen edhe çështje të tjera, që nuk janë referuar prej tyre, por që kërkojnë kualifikim të veçantë, në fushën e tatimeve. Kryejnë një sërë veprimesh proceduriale deleguar nga Prokuroria. Në përfundim të hetimeve mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, në bazë të nenit 327/1 “Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit” të Kodit të Procedurës Penale, oficeri i policisë gjyqësore bën relacionin për përfundimin e hetimeve me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. Informacioni për veprimet dhe ngarkesën disponohet nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

Gjithashtu sipas rastit punonjësit e Sektorit të Hetimit Tatimor trajtojnë edhe kërkesa të ndryshme të adresuara në DHT, përcjellin propozimet për vlerësim të situatës financiare dhe kontroll tatimor, ndjekin apo kërkojnë informacion/materiale lidhur me çështjet në ndjekje etj, më konkretisht paraqitur në tabelën si më poshtë:

<b>Regjistri i Shkresave Hyrëse/Dalëse/Referuar/Arshivuar</b>	<b>Nr</b>
<i>Kërkesa të ndryshme</i>	988
<i>Propozimet për vlerësim të situatës financiare dhe kontroll tatimor</i>	220
<i>Referime</i>	85
<i>Arkivime</i>	128
<i>Ezaurim, Kthim Përgjigje, Dërgim Materialesh, Relacione në Prokurori</i>	555
<b>Total</b>	<b>1,976</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

• **Regjistri elektronik i Referimeve në Prokurori Janar- Dhjetor 2021.**

Sektorit të Hetimit Tatimor gjatë vitit 2021 ka referuar në Prokurori vepra penale në fushën e tatimeve dhe taksave në total 85 referime në shumën totale të referuar prej 1,600,212,534 lekë, duke kërkuar fillimin e procedimit penal. Treguesit e rasteve të veprave penale e ndarë sipas vlerave në dëm ekonomik për këto raste, nga Sektorit të Hetimit të Drejtorisë së Hetimit paraqitet si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Vepra Penale</b>	<b>Neni i Kodit Penal</b>	<b>Viti 2021</b>	
			<b>Nr. Ref</b>	<b>Vlera</b>
1	<i>Krijimi i skemave mashtruese me Tvsh</i>	144/a	2	729,500,000
2	<i>Fshehje e të ardhurave</i>	180	42	407,825,448
3	<i>Mospagim taksash dhe tatimesh</i>	181	35	462,887,086

4	Organizim i Llotarive të palejuara	197	0	0
5	Punësim i paligjshëm	170/a	0	0
6	Prishje e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a	1	0
7	Të tjera		5	0
	<b>Shuma</b>		<b>85</b>	<b>1,600,212,534</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- Referimi në Prokurori për veprën penale **"Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar"** parashikuar nga neni 144, germa "a" e Kodit Penal, ku janë referuar 2 raste me vlerë të dyshuar 729,500,000 lekë.
- Referim në Prokurori për veprën penale **"Fshehja e te ardhurave"** parashikuar neni 180 i Kodit Penal, ku janë referuar 42 raste me vlerë të dyshuar 407,825,448 lekë.
- Referimi në Prokurori për veprën penale **"Mospagim taksash e tatimesh"** parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, ku janë referuar 35 raste me vlerë të dyshuar 462,887,086 lekë.
- Referimi në Prokurori për veprën penale **"Prishje e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare"** parashikuar nga neni 182, germa "a" e Kodit Penal.
- Gjithashtu kemi edhe 5 referime në Prokurori për **"Vepra të tjera penale në fushën e tatim-taksave"** sipas parashikimeve të Kodit Penal.
- Nuk ka referime në Prokurori për veprat penale të **"Punësim i paligjshëm"** dhe **"Organizimi i Llotarive të palejuara"** parashikuar nga neni 170, germa "a" dhe neni 197 i Kodit Penal.

- **Regjistri i Çështjeve në hetim paraprak në DPT.**

Nga informacioni i kërkuar nga grupi i auditimit nëpërmjet postës elektronike është kthyer përgjigje dhe jemi informuar se për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2021, janë regjistruar në total 101 çështje për verifikim paraprak.

- **Tabela me informacion në lidhje me afatet e "Verifikimeve Paraprake" që kanë qenë në proces më datë 31.12.2019, atyre që janë filluar dhe janë mbyllur për periudhën 01.01.2021-31.12.2021.**

Bazuar ne Manualin e Hetimit Tatimor paragrafi 3.1, hetimi penal i subjektit, inicohet gjithmonë pas një Hetimi Paraprak. Hetimi ndaj Individit do të zhvillohet bazuar në Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Nr. 24607 Prot., datë 24.10.2017 *“Për saktësimin e procedurave lidhur me vlerësimin tatimor të tatimit mbi të ardhurat personale për të ardhurat e padeklaruar dhe të pa tatuara të individëve”*.

Në lidhje me këtë **proces të klasifikuar**, Sektori i Hetimit Tatimor paraqet evidencë mbi fillimin dhe përfundimin e hetimit paraprak. Nga Sektori i Hetimit në DHT në DPT rezulton se gjatë vitit 2021, ky sektor ka filluar **hetim paraprak për 101 raste**, ka mbyllur hetimin për **N/A raste (të dhënat gjenden në rajone)**, ka **propozuar për kontroll tatimor në DRT Rajonale 220 raste** dhe ka **propozuar për rikontroll tatimor 1 rast**, nga ku kanë përfunduar 63 raste brenda vitit 2021 dhe në 15 raste kanë rezultuar me gjetje, në vlerë detyrimi 128,344,804 lekë dhe vlerë gjobe 25,311,416 lekë.

Përshkrimi/Raste	Në proces 31.12.2020	Filluar viti 2021	Mbyllur viti 2021	Në proces 31.12.2021
Hetime Paraprake (Dosje)		101	N/A	N/A
Propozime për Vlerësim/Kontroll Tatimor		220	63	157
Propozim për Rikontroll Tatimor		1	0	1
<b>Total</b>	-	<b>322</b>	<b>63</b>	<b>158</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në lidhje me veprimtarinë për vitin 2020, mbasi jemi drejtuar me kërkesë zyrtare nëpërmjet postës elektronike na është kthyer kjo përgjigje nëpërmjet email-it të datës 07.04.2022 nga Z. A. C.: “Gjatë vitit 2020 Drejtoria e Hetimit Tatimor ka kaluar procesin e ristrukturimit bazuar në legjislacionin në fuqi. Në zbatim të strukturës së re të administratës tatimore qendrore miratuar me urdhrin e Kryeministrit N. 33 datë 12.02.2020, Drejtoria e Hetimit Tatimor është organizuar në nivel qendror dhe ka në përbërje të saj Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës, Sektorin e Hetimit Tatimor, Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Drejtoria e Hetimit Tatimor përpara ristrukturimit ishte e organizuar në nivel qendror dhe rajonal dhe i gjithë dokumentacioni i Drejtorive Rajonale të Drejtorisë së Hetimit Tatimor është dorëzuar pranë Arkivës së Drejtorisë Rajonale Tatimore në harmoni me parashikimet e Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2020:

- Sektori i Hetimit ka referuar në Prokurori 196 raste me vlerë të dyshuar të evazionit 5,119,406,961 lek.
- Dosjet e deleguara nga ana e Prokurorisë përfunduar në 2020: 39.
- Janë propozuar për kontroll të thelluar operacional dhe vlerësim tatimor: 293 raste nga Sektori i Hetimit
- Korrespondenca me institucione: 122 shkresa.

• **Informacion në lidhje me "Intervista e zhvilluara me subjektin" dhe rezultatet e nxjerra.**

Nga grupi i auditimit është kërkuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet postës elektronike informacion mbi procedurat e zhvilluara me subjektin dhe rezultatet e nxjerra nga këto, por nga ana e përfaqësuesve të Sektorit të Hetimit nuk na janë vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar me pretendimin se: “Veprimet dhe dokumentacioni i administruar në kuadër të verifikimit në funksion të dokumentimit ligjor të shkeljeve tatimore dhe penale, grumbullimi dhe përpunimi sipas përcaktimeve ligjore i fakteve dhe provave që shërbejnë për fillimin e hetimeve penale, janë dokumente konfidenciale apo të klasifikuara. Sektori i Hetimit Tatimor është në pamundësi objektive dhe ligjore të vendosë në dispozicion të audituesve të dhëna konkrete apo dokumentacion lidhur me çështje në hetim pasi çënohet parimi i ruajtjes të sekretit hetimor. Gjithashtu, e cituar edhe në sipër, një pjesë e konsiderueshme e veprimeve procedurale, përfshi edhe administrimin/dokumentimin e provave dhe deklaratave bëhet me kërkesës të organeve të Prokurorisë, struktura të cilat nuk janë subjekt i këtij auditimi”.

• **Informacion mbi Verifikimet Paraprake të cilat kanë nisur me indicie të vet punonjësve të sektorit. Rezultatet e nxjerra.**

Nga grupi i auditimit është kërkuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet postës elektronike informacion mbi rastet e verifikimit paraprakë të cilat kanë nisur me indicie të vet punonjësve të sektorit dhe rezultatet e nxjerra, nga informacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nuk ka raste për hetime të iniciuara me iniciativë të vetë inspektorëve të sektorit, por çështjet hetimore kanë filluar kryesisht me informacion të ardhur zyrtarisht nga por jo vetëm:

- Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës (pjesë funksionale e Drejtorisë së Hetimit),
- Struktura funksionale të administratës tatimore si: Drejtoritë Rajonale, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoritë e Mbledhjes me Forcë të Detyrimeve të Papaguara, Strukturat e Verifikimit në Terren etj
- Institucione të ndryshme ligjzbatuese si: DPPPP, ILDKPKI, DPD etj.
- Prokuroritë etj.

- **Informacion mbi dokumentacionin tatimor dhe ligjor që ka mbledhur me kërkesë nga individët gjatë procesit të verifikimit paraprake që kanë zhvilluar.**

Nga grupi i auditimit është kërkuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet postës elektronike informacion mbi dokumentacionin tatimor dhe ligjor që ka mbledhur me kërkesë nga individët gjatë procesit të verifikimit paraprake që kanë zhvilluar, por nga ana e përfaqësuesve të Sektorit të Hetimit nuk na janë vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar me pretendimin se: “Veprimet dhe dokumentacioni i administruar në kuadër të verifikimit në funksion të dokumentimit ligjor të shkeljeve tatimore dhe penale, grumbullimi dhe përpunimi sipas përcaktimeve ligjore i fakteve dhe provave që shërbejnë për fillimin e hetimeve penale, janë dokumente konfidenciale apo të klasifikuara. Sektori i Hetimit Tatimor është në pamundësi objektive dhe ligjore të vendosë në dispozicion të audituesve të dhëna konkrete apo dokumentacion lidhur me çështje në hetim pasi çënohet parimi i ruajtjes të sekretit hetimor. Gjithashtu, e cituar edhe në sipër, një pjesë e konsiderueshme e veprimeve procedurale, përfshi edhe administrimin/dokumentimin e provave dhe deklaratave bëhet me kërkesë të organeve të Prokurorisë, struktura të cilat nuk janë subjekt i këtij auditimi”.

- **Tabelat Statistike se si është vepruar në lidhje me dosjet që kanë ardhur nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.**

Në lidhje me informacionet dhe rastet që kanë ardhur nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, rezulton se:

<b>Përshkrimi/Raste</b>	<b>Viti 2021</b>
<i>Hetime Paraprake (Dosje)</i>	81
<i>Propozime për Vlerësim</i>	51
<i>Propozim për Kontroll</i>	9
<i>Kthim Përgjigje për Kompetencë</i>	13
<i>Arshivuar</i>	1
<i>Në Verifikim Paraprak</i>	7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### **b) Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave (SPPP).**

“Pastrimi i parave është procesi i fshehjes ose maskimit të parave të pista të fituara nga aktivitete kriminale, të aseteve të fituara nga përdorimi i parave të pista dhe identitetit të pronarit përfitues”.

*Qëllimi kryesor i punës së këtij Sektori*, është parandalimi i fenomenit të pastrimit të parave në fushën e tatim taksave, duke përdorur veprimtarinë tregtare dhe marrja e masave administrative ose penale për këto raste. Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave është një Sektor në varësi të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, i cili përbëhet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Inspektorët.

*Objektiv kryesor të punës Sektori*, ka marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar, luftuar dhe zbuluar shkeljet administrative ose penale, që lidhen me Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Gjithashtu si synim është evidentimi i problematikave të ndryshme në lidhje me mosdeklarime të mundshme nga subjekte ose individë, të cilët kanë potencial të madh për tu përfshirë në deklaratime të ndryshme sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

*Plani i punës dhe raportimi statistikor të Sektorit*. Planet e punës mujore dhe raportimet mbi ecurinë e tij si dhe analiza vjetore, janë miratuar nga Drejtori Drejtorisë së HT dhe Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave si pjese integrale e Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin 2021 objektivat e punës i ka bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën 2017-2021, por ato janë dokumente të “klasifikuara” dhe si të tilla nuk bëhen të disponueshme për grupin e auditimit. Nga informacioni i kërkuar në rrugë zyrtare na janë vendosur në dispozicion statistikat në bazë mujore në



lidhje me administrimin e shkresave të përpunuara nga SPPP, të cila po paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

<b>Përshkrimi</b>	<b>Jan</b>	<b>Shk</b>	<b>Mar</b>	<b>Pri</b>	<b>Maj</b>	<b>Qer</b>	<b>Korr</b>	<b>Gush</b>	<b>Sht</b>	<b>Tet</b>	<b>Nën</b>	<b>Dhj</b>	<b>Total</b>
<i>Shkresa të thjeshta - Kërkesa të ndryshme</i>	13	13	29	1	28	16	40	8	6	29	0	1	184
<i>Propozime për vlerësim tatimor</i>	3	4	0	0	0	0	2	0	2	1	0	13	25
<i>Propozime për kontroll tatimor</i>	0	1	0	1	0	0	0	0	1	3	0	4	10
<i>Shkresa të klasifikuara</i>	3	1	1	3	1	1	2	5	3	12	2	3	37
<i>RAD</i>	0	0	0	0	0	0	0	5	1	1	0	0	7

Burimi: SPPP në DPT

***Nga një analizë e thjeshtë krahasuese rezulton se, sektori qoftë në baza mujore si dhe vjetore angazhohet më së shumti me trajtimin e shkresave të thjeshta duke devijuar nga funksioni dhe objektivi i tij primar, fakt ky që në gjykimin e grupit të auditimit e bën njësi jo efçente dhe jo efikase në plotësimin e objektivit primar të tij.***

***1. Informacion mbi trajtimin e rasteve që kanë ardhura nga DPPP dhe urdhrat e punës për rastet e hetimit në vend.***

Në lidhje me trajtimin e rasteve që kanë ardhura nga DPPP dhe urdhrat e punës për rastet e hetimit në vend, është kërkuar informacion në rrugë zyrtare dhe ka rezultuar se nuk ka pasur raste të ardhura nga DPPP për vitin 2021, e për rrjedhojë nuk kanë dal urdhra pune ose hetime në vend. Ndërkohë shkresa në trajtim dhe të marra nga institucione të tjera ligjzbatuese janë në total 29 praktika të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, ndërkohë rezulton se janë trajtuar/punuar 37 shkresa të klasifikuara “Sekret Shtetëror”.

***2. Informacion mbi praktikën që kanë shqyrtuar në lidhje për hetimin e individëve me të ardhura të padeklaruar dhe pa tatuara.***

Në lidhje me praktikën e shqyrtuar për hetimin e individëve me të ardhura të padeklaruar dhe pa tatuara, kanë rezultuar se janë 25 raste të dërguara për vlerësimi tatimor, raste të cilat kanë të bëjnë me individëve me të ardhura të padeklaruar dhe pa tatuara. Për muajin Dhjetor 2021 rezultojnë 13 propozime për vlerësime tatimore të cilat i janë dërguar 13 Drejtorive Rajonale Tatimor, një liste me një total prej 742 shtetaseve të ndarë sipas DRT-ve përkatëse, bazuar në Rregulloren Nr. 24607, datë 24.10.2017 “Për saktësimin e procedurave lidhur me vlerësimin tatimor mbi të ardhurat personale e padeklaruar dhe të pa tatuara të individëve”. Sipas të dhënave të marra nga sektori rezultojnë se nga përgjigjet e rasteve të propozuara për vlerësim tatimor gjetjet janë në total 24,563,965 lekë.

***3. Informacion në lidhje me praktikën e shqyrtuar dhe të përcjella në lidhje me RAD.***

DHT e raporton në SPPP e cila bën ndërlidhjen (shërben si pikë kontakti) për DPPP për informacionet që vijnë në lidhje me Raportimin e Aktivitetit të Dyshimte (RAD), bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 16, datë 16.02.2009 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Terrorizmit”. Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave trajton RAD e ardhura nga Administratat Tatimore dhe pas analizimit e dërgon në DPPP dhe nga auditimi rezulton se për vitin 2021 janë dërguar në total 7 raste RAD pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, shkresa të cilat janë të klasifikuara “Sekret Shtetëror”.

***4. Informacion në lidhje me hetimin e OJF-ve ku ka dyshime të arsyeshme që kryejnë veprë penale në fushën e taksave.***

Në lidhje me mbikëqyrjen e OJF-ve nga organet tatimore, bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.22, datë 19.11.2014 “Për Mbikëqyrjen e OJF-ve nga organet tatimore në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, SPPP nuk ka hetime të nisura për OJF-të, për të cilat ka dyshime të arsyeshme që kryejnë veprë penale në fushën e taksave.

#### **5. Statistika mbi rastet që janë referuar në Prokurori.**

Nga informacioni i marrë nga grupi i audituesve ky sektor për vitin 2021 nuk ka kaluar në sektorin e hetimit në DHT në DPT *subjekte/raste* me qëllim kallëzim penal në prokurori, për të cilët procedurat ligjore ndiqen nga struktura e kompetencës.

#### **6. Informacion mbi rastet që janë kaluar në DRT për kontroll ose rikontroll tatimor dhe rezultatet që kanë dal nga kontrolli/rikontrolli.**

Për vitin 2021 nga ana e Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave janë propozuar në total 10 raste për kontroll të thelluar, ndërkohë që raste për rikontroll nuk ka, por që nuk ka ende rezultate të dala nga kontrollet e propozuara.

#### **7. Auditimi i rastet kur inspektorët e SPPP kanë iniciuar vet një hetim/verifikim paraprakë për një individë ose subjekt.**

Nga informacioni i marrë nga grupi i audituesve Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave për vitin 2021 nuk ka raste për hetime të iniciuara me iniciativën e vet.

### **D. Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.**

Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë nga ku u konstatua se:

- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7905/1995 “Kodi i procedurës penale në Republikë e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7895/1995 “Kodi penal i Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore, i ndryshuar me ligjin Nr. 25/2019, datë 25.04.2019;
- Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Vendime të Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme;
- Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”, miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave Nr. 193 datë 22.08.2020.
- Manual i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 19/2, datë 28.02.2020.
- Akte të tjerë ligjorë, nënligjorë dhe rregullave për funksionimin dhe drejtimin e punës.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ushtron funksionet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 33, datë 12.02.2020 për Miratimin e Strukturës së Organizative dhe numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qendrore.

Strukturat e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë njësi të specializuara zbatimi në përbërje të administratës tatimore qendrore dhe që kanë si funksion parësor:

- a. Marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.
- b. Zbatimin e masave shtrënguese.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është e organizuar në nivel qendror dhe rajonal në përbërje të DPT, si më poshtë:

- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT;*
- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior;*
- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Qendror;*
- *Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor;*

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, ka në përbërje të saj 3 (tre) sektor:

- a. *Sektori i Trajtimit të Ankesave;*
- b. *Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit (Task-Forcë);*
- c. *Sektori i Koordinimit;*

- Qëllim kryesor i veprimtarisë së kësaj drejtorie është nxitja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve dhe të parandalimi, zbulimi dhe dënimi për shkeljet e legjislacionit tatimor të kryera nga tatimpaguesit, nëpërmjet ushtrimit të kontrolleve dhe verifikimeve në vend të aktivitetit të tyre.
- Drejtimet kryesore të punës, konsistojnë në marrjen dhe aplikimin e masave (dënimeve) administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore dhe në udhëzimin e Ministrisë të Financave dalë në zbatim të tij, që kanë të bëjnë me verifikimin dhe konstatimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomiko-tregtare pa u regjistruar; Mbajtjen, transportimin përdorimin dhe tregtimin e mallrave pa dokumentacionin e duhur tatimor; Punonjës të padeklaruar në organin tatimor etj., pa u kufizuar vetëm në to; Zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin tatimor në bashkëpunim me strukturat përkatëse të mbledhjes së borxhit tatimor, me qëllim mbledhjen e tatimeve dhe taksave të papaguara.
- Objekti i veprimtarisë dhe drejtimet kryesore të punës për strukturat e zbatimit janë verifikimi në terren i regjistrimit ose çregjistrimit; Verifikimi i deklarimit të punonjësve në organin tatimor; verifikimi i instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit; verifikimi i mbajtjes së dokumentacionit tatimor dhe i pajisjes së mallrave me faturë tatimore dhe Verifikimi i përmbushjes së detyrimeve të tjera ligjore të tatimpaguesve

Gjatë vitit 2021, puna e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është bazuar në planet e punës që ka miratuar Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së, paraqitur si më poshtë:

1. **Për periudhën 01-28 Shkurt 2021, Plani Punës Nr. 1804 Prot., datë 01.02.2021.** Ku objekti i punës është:
  - a. *Verifikimi në subjekte tregtare me xhiro vjetore mbi 14 milion lekë që rezultojnë me thyerje të kritereve të përcaktuara sipas listave dërguar nga DMR.*
  - b. *Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.*
2. **Për periudhën 11-31 Janar 2021, Plani Punës Nr. 322 Prot., datë 11.01.2021.** Ku objekti i punës është:
  - a. *Verifikimi në subjekte tregtare me xhiro vjetore mbi 14 milion lekë që rezultojnë me thyerje të kritereve të përcaktuara sipas listave dërguar nga DMR.*
3. **Për periudhën 01-31 Mars 2021, Plani Punës Nr. 3753 Prot., datë 01.03.2021.** Ku objekti i punës është:

- a. Verifikimi në subjekte tregtare me xhiro vjetore mbi 14 milion lekë që rezultojnë me thyerje të kritereve të përcaktuara sipas listave dërguar nga DMR.
- b. Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.
4. **Për periudhën 14-30 Maj 2021, Plani Punës Nr.8576 Prot., datë 14.05.2021.** Ku objekti i punës është:
  - a. Verifikimi i subjekteve tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari ekonomike të fushës së mjekësisë, të tilla si “Klinika Mjekësore”, “Depo Farmaceutike”. “Aktivitete të shërbimit spitalore” etj me kritere risku të thyera sipas listës së nisur nga DMR.
  - b. Verifikimi i subjekteve tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari ekonomike të fushës së ndërtimit dhe nën-kontraktorëve të tyre sipas listave të nisura nga DMR.
  - c. Verifikimi i subjekteve tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari ekonomike të fushës së tregtisë më rënie të qarkullimit për periudhat krahasuese Janar –Mars 2019/ Janar –Mars 2021, sipas listës të nisura nga DMR.
  - d. Monitorimi i qarkullimit të xhiros dhe/ose verifikime për subjekte tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari të shërbimit të Bar-Restorante në zonat me qarkullim me të lartë të qyteteve kryesore të vendit.
  - e. Verifikime të transportit të mallrave në akset kryesore të vendit.
  - f. Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.
5. **Për periudhën Tetor-Dhjetor 2021, Plani Punës Nr. 17825 Prot., datë 04.12.2021.** Ku objekti i punës është:
  - a. Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.
  - b. Verifikimi i listave të tatimpaguesve ardhur nga DMR lidhur me thyerjen e moduleve të riskut.

#### **I. Sektori Taskë Forcë**

Gjatë vitit 2021 Sektori Taskë Forcë ka kryer **945 verifikime ne terren** dhe ka vendosur penalitete për **96 raste** në **shumën 3.825.000 lekë.**

#### **Realizimi Planit Operacional Taskë Force Janar – Dhjetor 2021.**

<i>Plane Pune</i>	<i>Nipte të kontrolluara</i>	<i>Numri i shkeljeve</i>	<i>Shkelje në Vlerë</i>	<i>Efektivitet</i>
Plan Pune 17825 datë 04/10/2022	196	17	845	9%
Plan Pune 1804 datë 01/02/2021	139	4	50	3%
Plan Pune 322 datë 11/01/2021	84	7		8%
Plan Pune 3753 datë 01/03/2021	32	1		3%
Plan Pune 8576 datë 14/05/2021	167	9		5%
Vendimi Nr.23 datë 27/05/2021	327	58	2.930.000	18%
<b>Total</b>	<b>945</b>	<b>96</b>	<b>3.825.000</b>	<b>10%</b>

Burimi: DVKT në DPT.

#### **Realizimi Planit Operacional Taskë Force (Analitik) Janar – Dhjetor 2021.**

Në Lekë

<i>Lloji i Shkeljeve</i>	<i>Numri i Shkeljeve</i>	<i>Shkelje në vlerë</i>
Administrim blloqesh jotatimore	30	
Mall pa faturë tatimore (Gjobë 100% Tvsh munguar)	5	25
Mosafishim të listës së çmimeve BM	1	100
Mosafishim te listës së çmimeve BV	1	50

Moslëshim kuponi tatimor ( <i>Rasti dytë bii</i> )	1	50
Moslëshim kuponi tatimor ( <i>Rasti parë bi</i> )	21	1.050.000
Moslëshim kuponi tatimor ( <i>Rasti parë biii</i> )	1	50
Mospërditësim të dhëna për regjistrim, BV	3	30
Nuk instalon pajisje fiskale ( <i>Hera e parë ai</i> )	1	50
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BM	2	100
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BV	1	10
Nuk mirëmban pajisjen fiskale në gjendje pune	4	160
Punonjës i padeklaruar BM	3	600
Punonjës i padeklaruar BV	15	1.450.000
Sekuestrim printeri/njësie ose asetesh	1	
Subjekt i peregjistruar në organin tatimor	4	
Zhblllokim aktiviteti pas regjistrimit	2	100
<b>Totali</b>	<b>96</b>	<b>3.825.000</b>

Burimi: DVKT në DPT.

Nga grupi i auditimit është realizuar një analizë e thjeshtë e performancës së sektorit të verifikimit dhe koordinimit në terren për periudhën janar 2021-dhjetor 2021. Në analizë është shqyrtuar niveli i gjetjeve dhe shkeljeve të konstatuara i cili është në vlerën 3,825,000 lekë me shpenzimet e fondit të pagave të sektorit ku janë përfshirë *pagat neto + sigurimet shoqërore + sigurimet shëndetësore* në vlerën totale 21,004,339 lekë. Nga kjo analizë ka rezultuar se raporti shpenzime për pagat me shkeljet në vlerë është 5.5 me 1, pra për çdo 1 lek shkelje janë harxhuar 5.5 lekë shpenzime pagash. Nga ku në gjykimin e grupit të auditimit ky sektorë ka vepruar në kushte jo eficece për vitin 2021.

Në Lekë

Muaj	Fondi i Pagave Neto	Sigurime Shoqërore	Sigurime Shëndetësore
Janar 2021	1,164,575	215,793	24,457
Shkurt 2021	1,346,974	251,889	28,547
Mars 2021	1,348,945	250,736	28,417
Prill 2021	1,416,987	264,972	30,030
Maj 2021	1,486,833	278,022	31,509
Qershor 2021	1,486,833	278,022	31,509
Korrik 2021	1,484,047	277,471	31,447
Gusht 2021	1,524,511	284,707	32,267
Shtator 2021	1,527,236	285,245	32,328
Tetor 2021	1,558,965	291,525	33,040
Nëntor 2021	1,574,423	294,279	33,352
Dhjetor 2021	1,471,587	272,030	30,830
<b>Total</b>	<b>17,391,916</b>	<b>3,244,692</b>	<b>367,732</b>

Burimi: DVKT në DPT.

Në Lekë

Përshkrimi	Vlera
Totali Shpenzimeve të Pagave	21,004,339
Shkelje në Vlerë	3,825,000
Raporti Shp Page/Shkeljen në vlerë	5.5

Burimi: DVKT në DPT.

Veprime këto të cila janë në kundërshtim me dispozitat dhe përcaktimet e pikat ç) dhe dh) të neni 12 “Parimet e administrimit tatimor” të Kreut II “Parimet, Organizimi dhe Personeli i Administratës Tatimore” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet konkretisht se:

ç) hartimi i strategjive dhe marrja e masave përkatëse për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;

dh) ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur;

Nëpërmjet postës elektronike na janë vendosur në dispozicion 5 dosje me akt konstatime dhe procesverbale gjobash të mbajtura për “Mallra pa faturë”, për vitin 2021, nga të cila janë përzgjedhur 5 dosje nga grupi i audituesve për kontroll të detajuar, nga ku ka rezultuar si më poshtë:

Në rastin e konstatimit të shkeljeve nga ana e subjektit “A.-A. 2013” Shpk nga ana e inspektorëve nuk është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, konkretisht:

- Nuk është mbajtur procesverbali i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumente tatimore.
- Në akt konstatimin e mbajtur nga ana e inspektorëve citohet se “në pamundësi verifikimi nga sistemi verifikohet nga zyra”, pra në këtë rast nuk është përdorur programi “E-Inspektor” sipas përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.
- Në akt konstatimi nga ana e inspektorëve nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen.
- Nuk është lëshuar faturë tatimore ose faturë e thjesht tatimore për të dokumentuar mallin e gjetur të pashoqëruar me dokumentacion tatimor.
- Në rastin konkret sipas akt konstatimit subjekti nuk ka në përdorim dokumentacion dhe duhet të ishte kryer penalizimi i subjektit sipas nenit 118 “Mosmbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Në akt konstatimi nuk janë shprehur nqs ka pasur të afishuar apo jo listë të çmimeve të produkteve. Dhe nqs nuk i ka të afishuara çmimet të kryhej penalizimi sipas nenit 130 “Mosafishimi i çmimeve të shitjes” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Inspektor:** A. D., H. G., A.M.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve nga ana e subjektit “E. P.” nga ana e inspektorëve nuk është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, konkretisht:

- Në akt konstatimi nga ana e inspektorëve nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen.
- Inventarizimi i mallit gjendje është kryer gabim nga ana e inspektorëve sepse nuk janë fiksuar faturat e fundit të shitjes dhe blerjes.
- Duke shqyrtuar procesverbalin e gjobës të vendosur ndaj subjektit kuptohet që është subjekti i përgjegjësishëm tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe pa TVSH, por nga ana e inspektorëve duhet të ishin zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore të nenit 121 “Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht:

“1. Për tatimpaguesin që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aplikohen masat dhe dënimet si më poshtë: a) Tatimpaguesit të tatimit të thjeshtuar të fitimit, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së. Për qëllim të konstatimit të mos dokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë, sipas nenit 53, të këtij ligji, me qëllim dokumentimin e mallit dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të nenit 124, të këtij ligji”.

- Pra nuk është lëshuar faturë tatimore ose faturë e thjesht tatimore për të dokumentuar mallin e gjetur të pashoqëruar më dokumentacion tatimor.

**Inspektor:** V. M., A. H., A. Gj., A. I.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve nga ana e subjektit “G. G.” nga ana e inspektorëve nuk është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, konkretisht:

- Nuk është mbajtur procesverbali i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumenta tatimore.
- Në akt konstatimin e mbajtur nga ana e inspektorëve citohet se “në pamundësi verifikimi nga sistemi C@ts verifikohet nga zyra”, pra në këtë rast nuk është përdorur programit “E-Inspektor” sipas përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.
- Në akt konstatimi nga ana e inspektorëve nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen.
- Nuk është lëshuar faturë tatimore ose faturë e thjesht tatimore për të dokumentuar mallin e gjetur të pashoqëruar më dokumentacion tatimor.

**Inspektor:** I. I., E. M., E. G.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve nga ana e subjektit “O. Sh. A.” nga ana e inspektorëve nuk është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, konkretisht:

- Është mbajtur vetëm akt-konstatimi në lidhje me shkeljen e “Moslëshim të faturave tatimore”, dhe nuk është mbajtur procesverbal gjobe për këtë rast.
- Nuk është mbajtur procesverbali i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumente tatimore dhe nuk është e qartë në akt konstatim shprehja e inspektorëve mbi “inventarizim të pjesshëm”.
- Nuk është bërë verifikimi nqs subjekti e ka shkelje për herë të parë apo të përsëritur.

**Inspektor:** I. I., E. M., E. N.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve nga ana e subjektit “S. P.” nga ana e inspektorëve nuk është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, konkretisht:

- Nuk është mbajtur procesverbali i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumente tatimore.
- Në akt konstatimi nga ana e inspektorëve nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen.
- Në akt konstatim dhe procesverbal nuk evidentohet afati ligjor 15 ditor për vendosjen e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit dhe më tej zhbllokimi aktivitetit të tatimpaguesit.

**Inspektor:** I. I., E. M.

Nëpërmjet postës elektronike na janë vendosur në dispozicion 21 dosje me akt konstatime dhe procesverbale gjobash të mbajtura për “Moslëshim i kuponit tatimorë-rasti i parë”, për vitin 2021, nga të cila janë përzgjedhur 10 dosje nga grupi i audituesve për kontroll të detajuar, nga ku ka rezultuar si më poshtë:

Subjekti: A. R.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkalar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 13:05-13:45.

**Inspektor:** H. G., A. D.

Subjekti: A. P.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 12:55-13:40.

**Inspektor:** H. G., A. D.

Subjekti: A.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 16:12-17:17.

**Inspektor:** H. G., A. D.

Subjekti: A. A.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 14:30-16:00.

**Inspektor:** A. D., E. G.

Subjekti: B. D.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 12:55-13:50.

**Inspektor:** E. Rr., E. N.

Subjekti: D. M.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 12:55-13:27.

**Inspektor:** H. G., A. D.

Subjekti: Dh. Z.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 20:30-22:20.

**Inspektor:** H. G., E. G.

Subjekti: E. K.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 12:57-13:35.

**Inspektor:** H. G., E. G.

Subjekti: E. Gj.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

Nuk ka bërë përshkrimin e mallit/produktit/shërbimit për të cilin nuk është lëshuar kuponi tatimor në momentin e verifikimit.

Është brenda afatit të qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 14:40-15:10.

**Inspektor:** I. B., E. G., E. M.



Subjekti: F. K.

-Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò n.q.s kjo shkelje është rast i përsëritur apo jo.

-Nuk ka bërë përshkrimin e mallit/produktit/shërbimit për të cilin nuk është lëshuar kuponi tatimor në momentin e verifikimit.

-Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 11:00-11:45.

**Inspektor: I. B., E. M.**

Nëpërmjet postës elektronike na janë vendosur në dispozicion 15 dosje me akt konstatime dhe proces verbale gjobash të mbajtura për òPunonjës i padeklaruar biznesi i vogël”, për vitin 2021, nga të cila janë përzgjedhur 5 dosje nga grupi i audituesve për kontroll të detajuar, nga ku ka rezultuar si më poshtë:

Subjekti: R. M.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò listëpagesën e subjektit me pretendimin se nuk punonte sistemi C@ts.

Nuk ka bërë verifikimin e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore.

Nuk ka marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat.

Është brenda afatit të qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 11:50-12:18.

**Inspektor: E. Rr., E. N.**

Subjekti: R. K.

Nuk ka bërë verifikimin e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore.

Nuk ka marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat.

Është brenda afatit të qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 16:50-17:20.

**Inspektor: E. Rr., E. N.**

Subjekti: L. P.

Nuk ka bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit òE-Inspektorò listëpagesën e subjektit me pretendimin se nuk punonte sistemi C@ts.

Nuk ka bërë verifikimin e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore.

Nuk ka marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 21:30-22:07.

**Inspektor: H. G., E. G.**

Subjekti: L. M.

Nuk ka bërë verifikimin e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore.

Nuk ka marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat.

Është brenda afatit të qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 14:45-15:10. **Inspektor: H. G., E. G.**

Subjekti: K. K.

Nuk ka bërë verifikimin e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore.

Nuk ka marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat.

Ka tejkaluar afatin e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash, sepse e ka qëndruar në intervalin 12:30-13:25. **Inspektor: E. Rr., E. G., E. N.**

Gjithashtu, nga grupi i auditimit është konstatuar se për 48 kontrolle/inspektime nuk kemi informacion se sa është kohëzgjatja e qëndruar në subjekt nga ana e inspektorëve, ora e fillimit të inspektimit, ora e mbarimit të inspektimit, vendndodhja me GPS e kryerjes së inspektimit, paraqitur si më poshtë:

<i>Inspektor/Subjekte</i>	<i>Kohëzgjatja e qëndrimit në subjekt</i>
<b>A. D.</b>	0
A.-A.	0
G.I.	0
<b>A. M.</b>	0
A. K. K.	0
B.	0
J. Sh.	0
K. R.	0
<b>E. Rr.</b>	0
B. D.	0
B.-F.	0
K. K.	0
K. i Gj.	0
N. R.	0
P. V.	0
R. K.	0
R. L.	0
Th. Z.	0
<b>H. G.</b>	0
Dh. Z.	0
E. B.	0
J. H.	0
M. Gj.	0
Nuk u gjend	0
<b>I. I.</b>	0
355&P.	0
B.	0
E. E.	0
F. K.	0
G. G.	0
I.	0
J. H.	0
K. V.	0
L. Shpk	0
S. R. L.	0
S. C.	0
S. P.	0
T.	0
<b>O. C.</b>	0
A. H.	0
A. O.	0
B. M.	0
B. M. I.	0
E- M. O.	0
E. K.	0
G. Q.	0
M. H.	0
O. ó P.	0
P. N.	0
R. B.	0

Burimi: DVKT në DPT

**\*\*\* Gjithashtu në gjykimin e grupit të auditimit me risk paraqitet edhe situata kur në subjekt inspektorët kanë qëndruar 1-5 minuta, gjë që krijon dyshime të arsyeshme mbi**

**cilësinë e kontrollit/inspektimit.**

Nga shqyrtimi i të dhënave elektronike të vendosura në dispozicion nga subjekti i audituar mbi 254 kontrole/inspektime të realizuara gjatë kësaj periudhë 3 mujore (*Qershor, Korrik, Gusht*) nga ana e inspektorëve, rezultuan se 73 kontrole/inspektime janë kryer në shkelje dhe tejkallim të afatit të lejuar të qëndrimit në subjekt prej 30 minutash. Gjithashtu nga këto 73 kontrole theksojmë se në vetëm 15 raste janë verifikuar dhe konstatuar shkelje dhe janë vendosur gjoha në vlerën totale 700,000 lekë (Referuar Aneksit nr. 4 bashkelidhur).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Pikën 2, Nën-pika 5, “Përcaktimi i roleve në programin E-Inspektor dhe aksesit për secilin prej tyre”, Kapitulli VII “Programi E-Inspektor” të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, ku përcaktohet se: **“Inspektori të mos qëndrojë më shumë se 30 minuta në një inspektim”.**

Pika 2 “Përcaktimi i roleve në programin “E-Inspektor dhe aksesit për secilin prej tyre”, paragrafi i dytë faqe 49, ku përcaktohet qartë se: Nëpërmjet aplikacionit inspektori duhet të:

- Të faktojë orën e fillimit të punës mbi një urdhër pune si dhe vendndodhjen me GPS të kryerjes së inspektimit.
- Të faktojë për çdo inspektim të kryer, subjektin tatimor të inspektuar, orën e fillimit të inspektimit, orën e përfundimit të inspektimit si dhe vendndodhjen me GPS të kryerjes së inspektimit.

Përcaktimet dhe procedurat që duhen ndjekur sipas Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, miratuar me Urdhrin Nr. 19/2, datë 28.04.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm, në lidhje me shkeljet e mëposhtme:

- a. Mallra pa faturë;
- b. Moslëshim i kuponit tatimorë-rasti i parë;
- c. Punonjës i padeklaruar-Biznes i vogël.

Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, dalë me Urdhrin Nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrisë të Financave, konkretisht:

Pika 1 dhe 6 të nenit 138 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren”:

1. Siguron funksionimin normal të gjithë strukturës së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, nga qendra në rajone, në mënyrë që çdo punonjës të njohë dhe të zbatojë detyrat e tij funksionale;
4. Drejton dhe kontrollon formulimin dhe zbatimin e planeve operacionale, merr raporte lidhur me zbatimin e tyre dhe përgatit informacion përmbledhës për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve apo dhe Ministrinë e Financave;
6. Bashkërendon punën për formulimin dhe zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve lidhur me problemet e konstatuara dhe përcaktimin e detyrave për përmirësimin e situatës;
16. Kontrollon me grup pune veprimtarinë e drejtorive në Rajone dhe përgatit qarkore për problemet e konstatuara, masat e marra dhe detyrat për të ardhmen;

Pika 2, 7, 8, 12 të nenit 139 Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit:

2. Menaxhon punën e Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit (Task- Forcë) në DPT, ndjek dhe kontrollon zbatimin e detyrave të sektorëve të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Rajone;
7. Bën propozimet për përmirësimin e punës në sektor, rreth problemeve të dala gjatë zbatimit të urdhrave të punës;

8. Kontrollon në mënyrë periodike punën e sektorëve të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren në Rajone me miratimin e drejtorit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren dhe raporton tek drejtori për rezultatet e punës;

Pika 3, 5, 8 të nenit 140 Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit:

3. Mbi bazën e urdhrave të dalë nga instancat eprore, organizon punën për realizimin korrekt të detyrave të dhëna;

5. Merr masa për plotësimin e saktë të dokumentacionit administrativ që përdoret gjatë ushtrimit të detyrave funksionale (Akt-Konstatim, Procesverbal-Gjobe, Procesverbal-Konfiskimi etj);

8. Mban dokumentacionin sipas përcaktimeve të bëra në Urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe sipas kërkesave të rregullores së Kartotekës, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;

Pika 1, 4, 5 të nenit 143 Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Koordinimit:

1. Sektori i Koordinimit ndjek drejtimin metodik të veprimtarisë së sektorëve të verifikimit dhe monitorimit në DPT dhe në Rajone;

4. Kryen kontrole dhe verifikime, të praktikave të mbajtura nga grupet e punës në terren, nëpërmjet të cilave ndihmon në shpërndarjen e eksperiencave dhe praktikave efektive të punës;

5. Kontrollon grupet e punës të Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit nëse janë respektuar procedurat e vendosura për të operuar mbi bazën e urdhrave të punës të lëshuara nga Drejtori i Verifikimit dhe Koordinimit në terren/Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr. 121/42, datë 21.07.2022 ÷ Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit nga punonjësit e DVKT, protokolluar në KLSH me nr. 20/14 Prot., datë 27.07.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Në lidhje me pretendimet e grupit të auditimit sqarojmë se Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar orienton në zbatim vullnetar dhe jo në ngarkim me gjoba apo masa administrative të cilat duhet të mbulojnë shpenzimet për pagat. Në asnjë dispozitë ligjore apo parim ligjor administrativ nuk përcaktohet se DVKT ka për detyrë që të vendos gjoba dhe masa administrative në atë masë sa të mbulojë shpenzimet për pagat e të gjithë punonjësve të administratës. Pagat e punonjësve të DPT janë të parashikuara nga buxheti i shtetit i cili si të ardhura të arkëtueshme për të mbuluar shpenzimet për pagat ka taksat dhe tatimet. Gjokat nuk janë të parashikueshme në buxhet, madje praktika kushtetuese ka mbajtur disa qëndrime mbi gjokat duke i cilësuar e ardhur jo e parashikueshme dhe se gjokat janë kompensim për dëmin e ardhur si pasojë e sjelljes së tatimpaguesit, por qëllimi kryesor i tyre është të ushtrojë presion mbi subjektet tatimpaguese për të përmbushur vullnetarisht detyrimet ligjore dhe t’i ndëshkoj ato për shkeljen e tyre.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Nga subjekti i audituar janë paraqitur të njëjtat observime si në fazën e projekt raportit të auditimit, pa sjellë dokumente justifikues, bazë ligjore apo analiza të reja për të kundërshtuar konstatimin e grupit të auditimit. Gjithashtu nga subjekti pretendohet në lidhje me rekomandimin Nr. 18.1, të Projektraportit për të cilin sqarojmë se vlejné të njëjtat qëndrime sikurse të trajtuara në Projektraport. Nga sa më sipër sqarojmë se observacioni nuk do të merret në konsideratë.

#### Titulli i Gjetjes

Parregullsi në mbajtjen e akt konstatimeve dhe procesverbaleve të gjobës gjatë kryerjes së verifikimeve në terren nga ana e inspektorëve të VKT.

#### Situata 1:

Nga auditimi i dosjeve me akt konstatime dhe procesverbale gjobash të mbajtura në lidhje me raste rastet e shkeljeve: 5 dosje “Mallra pa faturë”, 10 dosje “Moslëshim i kuponit

tatimore- rasti i parë” dhe 5 dosje ÷Punonjës i padeklaruar biznesi i vogël”, të mbajtura në vitin 2021, nga ku kanë rezultuar problematikat si mëposhtë:

- Raste kur nuk është mbajtur procesverbal i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumente tatimore;
- Raste në akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve ku citohet se “në pamundësi verifikimi nga sistemi verifikohet nga zyra”, pra në këtë rast nuk është përdorur programi “E-Inspektor” sipas përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren;
- Raste në akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve ku nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen;
- Raste ku nuk është lëshuar faturë tatimore ose faturë e thjesht tatimore për të dokumentuar mallin e gjetur të pashoqëruar më dokumentacion tatimor;
- Ka rezultuar se sipas akt konstatimeve në disa raste subjekti nuk ka në përdorim dokumentacion dhe duhet të ishte kryer penalizimi i subjektit sipas nenit 118 “Mosmbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Në disa akt konstatime nuk janë shprehur n.q.s ka pasur të afishuar apo jo listë të çmimeve të produkteve. Dhe n.q.s nuk i ka të afishuara çmimet të kryhej penalizimi sipas nenit 130 “Mosafishimi i çmimeve të shitjes” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Në disa raste inventarizimi i mallit gjendje është kryer gabim nga ana e inspektorëve sepse nuk janë fiksuar faturat e fundit të shitjes dhe blerjes.
- Raste kur është mbajtur vetëm akt-konstatimi në lidhje me shkeljen e “Moslëshim të faturave tatimore”, dhe nuk është mbajtur procesverbal gjobe për këtë rast dhe nuk është bërë verifikimi n.q.s subjekti e ka shkelje për herë të parë apo të përsëritur;
- Në disa raste në akt konstatim dhe proces verbal nuk evidentohet afati ligjor 15 ditor për vendosjen e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit dhe më tej zhblokimi aktivitetit të tatimpaguesit;
- Nuk janë bërë verifikimet në sistem nëpërmjet programit “E-Inspektor” n.q.s shkeljet janë rast i përsëritur apo jo;
- Nuk është bërë përshkrimin e mallit/produktit/shërbimit për të cilin nuk është lëshuar kuponi tatimor në momentin e verifikimit;
- Nuk janë bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit ÷E-Inspektorë listëpagesën e subjektit me pretendimin se nuk punonte sistemi C@ts;
- Nuk janë bërë verifikimet e pagës reale dhe deklaratës të sigurimeve shoqërore;
- Nuk janë marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat;
- Janë tejkualuar vazhdimisht afatet e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash.

**Kriteri :** Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ÷Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 118, 119, 121, 124 dhe 130.

Udhëzim Nr. 24, datë 02.09.2008 ÷Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 118, 119, 121, 124 dhe 130.

Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**Ndikimi/Efekti** Parregullsi procedurale në mbajtjen e akt konstatimeve dhe procesverbaleve të gjobës gjatë kryerjes së verifikimeve në terren nga ana e inspektorëve të VKT, të cilat çënojnë parimet e administratës tatimore.

**Shkaku:** Mosrespektim dhe moszbatim përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Rëndësia** E lartë.

**Rekomandimi** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave për mos përsëritjen e parregullsive të konstatuara nga grupi i auditimit të ngrejë një grup pune për rishikimin e akteve të mbajtura nga inspektorët e DVKT për vitin 2021.

**Titulli i Gjetjes** Analiza e efikasitetit të punës së DVKT.

<b>Situata 2:</b>	Nga një analizë e performancës së sektorit të verifikimit dhe koordinimit në terren për periudhën Janar - Dhjetor 2021, mbi nivelin e gjetjeve dhe shkeljeve të konstatuara, i cili është në vlerën 3,825,000 lekë, me shpenzimet e fondit të pagave të sektorit prej 21,004,339 lekë, ku janë përfshirë <u>pagat neto + sigurimet shoqërore + sigurimet shëndetësore</u> në vlerën totale, ka rezultuar se raporti shpenzime për parat me shkeljet në vlerë është 5.5 me 1, pra për çdo 1 lek shkelje janë harxhuar 5.5 lekë shpenzime page, gjë që demonstroi se ky sektor nuk ka vepruar me efektivitet dhe efikasitet për vitin 2021.
<b>Kriteri :</b>	Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 <i>oPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë</i> , i ndryshuar, shkronja ç) dhe dh) të nenit 12. Udhëzim Nr. 24, datë 02.09.2008 <i>oPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë</i> , i ndryshuar shkronja ç) dhe dh) të nenit 12. Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Përdorimin jo me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.
<b>Shkaku:</b>	Ineficenca e punës së DVKT.
<b>Rëndësia</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të ngrejë grup pune për analizimin e shkaqeve të inefficiencës së DVKT, si dhe të shikohet mundësia e ristrukturimit të kësaj drejtorie me qëllim kalimin e saj në baza efikasitet dhe efektiviteti.

## **II. Sektori i Trajtimit të Ankesave.**

Nga auditimi u konstatua se puna e *Sektorit të Trajtimit të Ankesave*, është pjesë e planeve vjetore të cilat dalin nga *DVKT*, por funksionimi i sektorit nuk bazohet kryesisht në një plan pune konkrete, kjo për vetë natyrën dhe specifikën e sektorit, por është në varësi të numrit të denoncimeve që vijnë. Funksioni i *Sektorit të Trajtimit të Ankesave* është që të mbledhë informacionin e të dhënave për rastet abuzive që vijnë nga ankesat dhe burime të ndryshme denoncimi, për shkelje administrative tatimore të kryera nga veprimtaria e tatimpagueseve apo dhe shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksionit nga punonjësit e *Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren* në marrëdhënien me tatimpaguesin. Bazuar dhe në Manualin e DVKT, STA përgatit informacione të evidentuara dhe të detajuara sipas çdo *Rasti Abuziv* dhe ankese që ka administruar duke e raportuar këtë gjë tek Drejtori i DVKT sa herë që kërkohet, me qëllim përcaktimin e mënyrës dhe sektorin përkatës për ndjekjen e mëtejshme të verifikimit, marrjen e masave administrative tatimore për shkeljet e konstatuara dhe raportimin e ankesës, me qëllim rritjen e efektivitetit në kontrollin e zbatimit të Legjislacionit Tatimor dhe në respektim të bashkëpunimit dhe shërbimit ndaj qytetarit. Sektori i Trajtimit të Ankesave është i organizuar vetëm në nivel qendror, në përbërje të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Marrja e informacionit për ankesën/rastin abuziv/denoncimin vijnë në formë të ndryshme si më poshtë vijon:

- Në rrugë elektronike (Telefon, E-mail, Whatsapp, Viber) linja e gjelbërt 0800 14 14, Adresa elektronike e DPT [denoncime@tatime.gov.al](mailto:denoncime@tatime.gov.al)
- Në rrugë postare (Adresa postare e DPT)
- Nga komunikimet e drejtpërdrejta (Takime në DPT)
- Aplikacioni "Stop Informaliteti" pranë Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT (Aplikacion i marrë në administrim nga STA në muajin Korrik 2021).

Për vitin 2021 nga ana e Sektorit të Trajtimit të Ankesave janë mbajtur dhe 2 matrica në lidhje me denoncimet e ardhura, më konkretisht:

*1- Matrica e Rasteve Abuzive me burim informacioni nga E-maili i denoncimeve, Whatsapp, Viber, Takime, Telefon, Adresë Postare.*

2- *Matrica e Platformës së Stop Informalitetit (Që prej datës 01 Korrik 2021), platformë e cila ka funksionuar sipas rregullave të përcaktuara nga Kabineti i DPT.*

<i>Forma e Denoncimit</i>	<i>Denoncimeve të ardhura</i>	<i>Denoncimeve të trajtuara</i>	<i>Denoncimeve në ndjekje</i>
Linja e Gjelbër (08001414) + Ëhats Up + Viber	277	276	1
Adresa Elektronike e DPT (denoncime@tatime.gov.al)	269	266	3
Aplikacioni "Stop Informaliteti"	1,126	1,115	11
Adresa Postare e DPT-së	52	47	5
Takime të drejtëpërdrejta në DPT	83	81	2
Portali "Platforma e Bashkëqeverisjes"	21	21	0
<b>Total</b>	<b>1,828</b>	<b>1,806</b>	<b>22</b>

Programi “E-Inspektor” shërben për regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, pranë DPT dhe në Rajone, nëpërmjet këtij programi kryhet kontrolli, identifikimi dhe regjistrimi i subjekteve të tatueshme.

*-Qëllimi i këtij projekti është sigurimi i një shërbimi për automatizimin dhe monitorimin e inspektorëve të Administratës Tatimore në terren. Me anë të këtij procesi synohet të rrisi edhe efikasitetin e vetë inspektorëve duke i dhënë mundësinë këtyre të fundit të kenë informacionin e duhur në momentin e duhur mbi urdhrat e punës si dhe informacionin e nevojshëm mbi subjektet tatimpaguese në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*-Objekti kryesor i këtij shërbimi është automatizimi dhe monitorimi i inspektimeve në terren në administratën tatimore. Ky projekt synon të thjeshtojë dhe informatizojë punën e përditshme të inspektorëve në zbatimin e urdhrave të punës si dhe në arritjen e objektivave të administratës tatimore në lidhje me luftën kundër informalitetit.*

Kontrata Nr. 3815 prot., datë 18.08.2020 është lidhur midis Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI-t) në rolin e autoritetit kontraktor dhe bashkimit të operatorëve “I. & C. D.” Shpk dhe “I. E.” Shpk. Të cilat sipas nenit 1 të kontratës kontraktuesi merr përsipër realizim e kontratës me objekt “Blerje shërbim automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët” për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Vlera e kontratës është përcaktuar sipas nenit 2 të kontratës dhe është 99,891,000 lekë pa TVSH dhe 119,869,200 lek me TVSH dhe kohëzgjatja e kontratës është 13 muaj në total, ku 1 muaj është faza përgatitore për shërbimin dhe instalimin dhe 12 muaj kohëzgjatja e shërbimit nga nënshkrimi i kontratës.

Nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë dërguar kërkesat për informacion nëpërmjet postës elektronike zyrtare dhe mbas vendosjes në dispozicion të tyre nga ana e subjektit dhe shqyrtimit të tyre kanë rezultuar problematikat të trajtuara në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

*Së pari*, na është vendosur në dispozicion informacion nga programi “E-Inspektor” vetëm për 3 muaj konkretisht *Qershor, Korrik dhe Gusht* dhe jo për gjithë vitin 2021 (Databaza Excel me informacion mbi lëvizjet, kohë qëndrimin e inspektorëve në subjektet e kontrolluara, detajeve, koordinatave gjeografike, pozicionit në hartë etj), por nga verifikimi i urdhër shpenzimeve pagesave të realizuar nga ana e Drejtorisë së Financës rezulton se janë likuiduar për të gjithë muajt konform obligimeve të kontratës që është lidhur me operatorin fitues. Theksojmë se kërkesa për informacion është bërë për të gjithë periudhë objekt auditimi e cila përfshijnë 01.01.2021-31.12.2021, por nga ana e subjektit janë vendosur vetëm për tre muaj dhe duke ngritur pretendimin se nuk kanë më mundësi të kenë akses tek të dhënat e programit ðE-Inspektorë mbas mbarimit të kontratës për të nxjerrë të informacionin për muajt e tjerë të kërkuar.

Gjithashtu theksojmë se, na janë vendosur në dispozicion email-et e dërguara nga posta elektronike zyrtare të printuara nga inspektorët e monitorimit në terren të cilët shprehen se kanë hasur problematika

të shumta të funksionimit normal të programit, sipas kronologjisë rezulton se këto problematika kanë qenë të shtrira përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, gjë që tregon se nuk është dhënë zgjidhje këtyre problematikave.

Nga auditimi i dosjeve të procedurave të likuidimit të kontratës ka rezultuar se komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim të shërbimit mbasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimet e mirëmbajtjes së shërbimit të “Blerje shërbimi i automatizimi dhe monitorimi i inspektoreve”, për periudhat përkatëse specifike, ka marr në dorëzim shërbimin duke u shprehur se shërbimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës, situatë kjo e cila në gjykimin e grupit të auditimit të KLSH nuk është e vërtet, sepse situata ka pas problematika të shumta të cilat janë sqaruar si më sipër.

Në mbarëvajtjen e shërbimeve me bazë *Teknologjinë e Informacionit* mungojnë raportet mbi cilësinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimeve si dhe mungojnë raportet e vlerësimeve mbi performancën e shërbimit, në kundërshtim me *shkronjën ç) dhe dh) të pikës 8 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.*

Për këto veprime dhe mosveprime mban përgjegjësi Komisioni i Mbikëqyrjes dhe Marrjes në dorëzim të shërbimit i përbërë nga Znj. A. F., Znj. A. G. dhe Z. P. P.

Nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer një *Analizë Kosto*” në lidhje me punën e programit “E-Inspektor”, duke kryer krahasimin e nivelit të gjetjeve gjatë gjithë vitit 2021 me koston e programit ÷E-Inspektorë për vitin 2021, nga ku rezulton se:

- a. **Kosto “E-Inspektor” për një Nipt të kontrolluar është 105,704.76 lekë.**
- b. **Kosto “E-Inspektor” për një Shkelje të konstatuar është 1,040,531.25 lekë.**
- c. **Kosto “E-Inspektor” për një lek Penalitet shkeljesh të vendosur është 26.12 lekë.**

<i>Nipte të kontrolluara</i>	<i>Numri i shkeljeve</i>	<i>Shkelje në Vlerë</i>	<i>Efektivitet</i>
196	17	845,000	9%
139	4	50,000	3%
84	7		8%
32	1		3%
167	9		5%
327	58	2,930,000	18%
<b>945</b>	<b>96</b>	<b>3,825,000</b>	<b>10%</b>

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera</i>
Vlera e kontratës pa tvsh	99,891,000
Vlera e kontratës me tvsh	119,869,200
Kohëzgjatja në muaj gjatë 2021	10
Kosto për muaj	9,989,100
Kosto totale për 2021	99,891,000

<i>Raporti</i>	<i>Vlera</i>
Kosto/Nipt Kontrolluar	105,704.76
Kosto/Nr Shkeljesh	1,040,531.25
Kosto/Vlerë Shkeljesh	26.12

Nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer një *Analizë Efektiviteti*” në lidhje me “vlerën e shtuar” të punës së programit “E-Inspektor”, duke kryer krahasimin e nivelit të gjetjeve të vitit 2020 me atë të vitit 2021 (*Po merret ky variabël në analizë sepse është i matshëm në aspektin sasior*), nga ku ka rezultuar se:



Viti	Nipte të kontrolluara	Nr i shkeljeve	Shkelje në Vlerë
2020	1,081	269	10,183,209
2021	945	96	3,825,000
<b>Diferenca</b>	<b>136</b>	<b>173</b>	<b>6,358,209</b>

Nga tabela e mësipërme shikohet qartë se kemi tregues në rënie, pra kemi një rënie të numri të nipteve të kontrolluar, rënie të numrit të shkeljeve dhe rënie të vlerës së shkeljeve nga viti paraardhës. Në këtë situatë regresi të treguesve, shikohet e vështirë vlera e shtuar që ka sjellë aplikimi i programit “E-Inspektor”. Pra grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjykon se veprimet e më sipërme tregojnë që kemi të bëjmë me dështimin e sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe **përdorimit të fondeve publike, pa ekonomicitet dhe në mënyrë joefektive dhe joeficente**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

*Pika 1 dhe 6 të nenit 138 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren” të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore, dalë me Urdhrin Nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, ku përcaktohet se:*

*1. Siguron funksionimin normal të gjithë strukturës së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, nga qendra në rajone, në mënyrë që çdo punonjës të njohë dhe të zbatojë detyrat e tij funksionale;*

*6. Bashkërendon punën për formulimin dhe zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve lidhur me problemet e konstatuara dhe përcaktimin e detyrave për përmirësimin e situatës;*

*Pika 2, 7, 8, e nenit 139 Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore, dalë me Urdhrin Nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, ku përcaktohet se:*

*2. Menaxhon punën e Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit (Task- Forcë) në DPT, ndjek dhe kontrollon zbatimin e detyrave të sektorëve të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Rajone;*

*7. Bën propozimet për përmirësimin e punës në sektor, rreth problemeve të dala gjatë zbatimit të urdhrave të punës;*

*8. Kontrollon në mënyrë periodike punën e sektorëve të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren në Rajone me miratimin e drejtorit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren dhe raporton tek drejtori për rezultatet e punës;*

*Pika 1, 4, 6 të nenit 143 Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Koordinimit*

*1. Sektori i Koordinimit ndjek drejtimin metodik të veprimtarisë së sektorëve të verifikimit dhe monitorimit në DPT dhe në Rajone;*

*4. Kryen kontrole dhe verifikime, të praktikave të mbajtura nga grupet e punës në terren, nëpërmjet të cilave ndihmon në shpërndarjen e eksperiencave dhe praktikave efektive të punës;*

*6. Grumbullimi dhe përpunimi i gjithë informacionit të marrë nga sektorët e koordinimit në Rajone dhe hartimi i evidencave analitike për veprimtarinë e tyre;*

*Për sa më sipër me personat përgjegjës znj. O. U., z. K. Sh., znj. A. F., znj. A. G., z. P. P.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr. 121/42, datë 21.07.2022 ÷ Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit nga punonjësit e DVKT , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Qëllimi i këtij programi konsistonte në automatizimin dhe monitorimin e inspektimeve në terren nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT dhe në Rajone. Ky projekt synonte*

thjeshtëzimin dhe informatizimin e punës së përditshme të inspektorëve në zbatimin e urdhërave të punës si dhe në arritjen e objektivave të administratës tatimore në lidhje me luftën kundër informalitetit. Sipas Manualit të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren miratuar me Urdhërin nr 19/2 datë 28.04.2020 “për Miratimin e Manualit të Hetimit Tatimor dhe Manualit të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren” angazhohen strukturat e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Dpt dhe në Rajone për përdorimin e këtij aplikacioni me qëllim lehtësimin e punës së tyre në subjekt gjithashtu kryerja e monitorimit të punës së grupeve të punës në terren nëpërmjet sistemit GPS.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është e organizuar në këtë mënyrë:

- Struktura e Terrenit pranë DVKT në Dpt (Struktura 1+10)
- Struktura e Terrenit pranë DVKT në Rajoni Qendror (Struktura 1+59)
- Struktura e Terrenit pranë në rajoni Verior (Struktura 1+19)
- Struktura e Terrenit pranë në Rajonin Jugor (Struktura 1+18)

Theksojmë se programi është përdorur nga të gjithë strukturat e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Dpt dhe në Rajone, jo vetëm në Dpt. Përsa i përket analizës së kostos dhe analizës së efektivitetit në lidhje me punën e programit “E-Inspektori” ju bëj me dije se Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ju ka vënë në dispozicion kontrollet e kryera vetëm nga DPT-ja që janë total 945 kontrolle për periudhën Janar-Dhjetor 2021, ndërsa kontrollet totale për të gjithë Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë të ndara sipas drejtorive:

- DVKT në Dpt 945 Kontrolle me 82 shkelje në vlerën 3.825.000 lekë;
- DVKT në Rajonin Qendror 2929 Kontrolle me 263 shkelje në vlerën 13.023.879 lekë;
- DVKT në Rajonin Jugor 924 Kontrolle me 120 shkelje në vlerën 6.545.000 lekë;
- DVKT në Rajonin Verior 682 Kontrolle me 39 shkelje në vlerën 3.245.000 lekë

Siç është sqaruar më sipër në total për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë kryer 5480 kontrolle nga ku janë konstatuar 504 shkelje të legjislacionit tatimor në vlerën prej 26.638.879 lekë por raportimi është bërë vetëm për kontrollet e kryera nga DVKT në DPT pasi dhe në email-in e datës 06.04.2022 (bashkëlidhur email-i) i ardhur nga ana juaj është kuptuar sikur informacioni i kërkuar nga ju do të ishte vetëm për Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT dhe për këtë arsye çdo informacion që ju është vendosur në dispozicion nga drejtoria jonë është vetëm për DVKT në DPT. Në lidhje me krahasimin e numrit të kontrolleve 2020/2021 të bërë nga ju theksojmë se qëllimi i programit ishte automatizimi dhe monitorim i inspektorëve në terren dhe jo numri i kontrolleve apo gjetjeve, pasi ky numër ndryshon gjithmonë nga një vit në tjetrin bazuar kjo në planet e punës dhe organizimin e punës nga drejtuesit. Gjatë gjithë vitit 2021 aplikacioni ka qënë funksional (për të gjithë periudhën që kontrata ka zgjatur) për të gjithë niptet në të cilat është ushtruar kontroll nga strukturat e terrenit në DPT dhe është përdorur në mënyrë të vazhdueshme nga inspektorët e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Dpt dhe Rajone.

Pasi u bë i mundur aksesimi në programin E-Inspektor u shkarkuan të gjithë kontrollet e mbajtura për të gjithë periudhën e kontratës. Bashkëlidhur gjeni CD me kontrollet që gjeneron sistemi për vitin 2021 (Janar-Shtator 2021):

- Raporti i Inspektiveve;
- Raporti i Punës;
- Raporti i Njoftimeve;
- Raporti i çështjeve;
- Raporti i gjobave;
- Penalitetet për rajon;
- Raporti mbi urdhërat e punës;
- Raporti i gjurmimeve;

Nga analiza e kryer nga grupi i audituesve në lidhje me observacionin e kryer nga ana e Znj. A. F. me detyrë inspektore koordinimi, shprehet se nuk merret parasysh informacioni i dërguar në lidhje me të

*gjithë të dhënat e munguara të programit E-Inspektor. Informacionet e munguara janë vënë në dispozicion pas kërkesës së bërë tek AKSHI pasi pas përfundimit të kontratës së programit E-Inspektor ishte i pamundur aksesimi në aplikacion për të gjeneruar të dhënat e kërkuara nga grupi i audituesve. DVKT ka mbajtur të dhënat në excel mbi programin E-Inspektor vetëm për sezonin turistik sepse vetëm për atë periudhë është kërkuar informacion për drejtuesit asokohe, për këtë arsye nuk ju janë vendosur në dispozicion vetëm ato të dhëna pasi në momentin e auditimit nga ana juaj nuk ishte i mundur aksesimi në sistem për të gjeneruar të dhëna totale për të gjithë vitin 2021.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Nga subjekti i audituar janë paraqitur të njëjtat observime si në fazën e projekt raportit të auditimit, pa sjellë dokumente justifikues, bazë ligjore apo analiza të reja për të kundërshtuar konstatimin e grupit të auditimit. Gjithashtu nga subjekti pretendohet në lidhje me rekomandimin Nr. 16.1, të Projektraportit për të cilin sqarojmë se vlejné të njëjtat qëndrime sikurse të trajtuara në Projektraport. Nga sa më sipër sqarojmë se observacioni nuk do të merret në konsideratë.

**Titulli i Gjetjes  
Situata 3:**

Problematika në lidhje me funksionimin normal të Programit e-Inspektor  
Në lidhje me auditimin e funksionimit të Programit “E-Inspektor”, kanë rezultuar problematikat e trajtuara në mënyrë të përmbledhur si më poshtë: Janë vendosur në dispozicion të dhëna (databaza excel me informacion mbi lëvizjet, kohëqëndrimin e inspektorëve në subjektet e kontrolluara, detajeve, koordinatave gjeografike, pozicionit në hartë etj), nga programi “E-Inspektor” vetëm për 3 muaj konkretisht, qershor, korrik dhe gusht dhe jo për gjithë vitin 2021, por nga verifikimi i urdhër shpenzimeve dhe pagesave të realizuar nga ana e Drejtorisë së Financës rezulton se është kryer likuidimi për të gjithë muajt konform obligimeve të kontratës të lidhur me operatorin fitues. Theksojmë se, kërkesa për të dhëna është bërë për të gjithë periudhën objekt auditimi sipas programit të auditimit që përfshin 01.01.2021-31.12.2021, por nga ana e subjektit janë vendosur në dispozicion të dhëna vetëm për tre muaj dhe duke ngritur pretendimin se nuk kanë më mundësi të kenë akses tek programi E-Inspektor mbas mbarimit të vlefshmërisë së kontratës për të nxjerrë të dhënat për muajt e tjerë të kërkuar. Të dhënat e plota nuk janë vendosur në dispozicion deri në përfundimin e punës në terren në datë 13.05.2022, fakt ky që ka ndikuar në kufizimin e punës audituese të grupit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i email-ve të inspektorëve të monitorimit në terren të vendosur në dispozicion, ku shprehen se kanë hasur problematika të shumta të funksionimit normal të programit dhe sipas kronologjisë kohore rezulton se këto problematika kanë qenë të shtrira përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, gjë që tregon se nuk i është dhënë zgjidhje permanente këtyre problematikave të sistemit.

Nga auditimi i dosjeve të procedurave të likuidimit të kontratës ka rezultuar se komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim të shërbimit, mbasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimin e mirëmbajtjes së shërbimit të “Blerje shërbimi i automatizimi dhe monitorimi i inspektoreve”, për periudhat përkatëse, ka marrë në dorëzim shërbimin duke u shprehur se është në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës, situatë kontradiktore kjo e cila në vlerësimin tonë nuk qëndron, pasi programi “E-Inspektor” ka rezultuar me problematika të shumta si më sipër.

**Kriteri :**

Udhëzimi Nr. 1159, datë 17.03.2014 për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit.

**Ndikimi/Efekti  
Shkaku:**

Përdorimin jo me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike. Mungesa e raporteve mbi cilësinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimeve si dhe mungesa e raporteve të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit nga ana e Komisionit të Mbikëqyrjes dhe Marrjes në dorëzim të shërbimit.

**Rëndësia**

E lartë.

**Rekomandimi**

DPT të shikojë mundësinë e vendosjes së një Software/Aplikacioni ku të jenë të

integruar Live-Tracking System, GPS Position System dhe Live Camera System, me qëllim automatizimin dhe monitorimin e punës së inspektorëve të DVKT.

#### **E. Drejtoria e Kontrollit të Specializuar.**

Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operationale, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë nga ku u konstatua se:

- Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 92/2014 datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për të dhënat shtetërore”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 4/2020 “Për shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”;
- Ligji Nr. 112/2020 dhe VKM Nr. 1088, datë 24.12.2020.
- Vendime të Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme;
- Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”, miratuar me - Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 193 datë 22.08.2020.
- Manual i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 19/2, datë 28.02.2020.
- Akte të tjerë ligjorë, nënligjorë dhe rregullave për funksionimin dhe drejtimin e punës.

#### **Objekti i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar.**

Drejtorja e Kontrollit të Specializuar do të ushtojë funksionet e saj në të gjithë administratën tatimore në nivel qendrore dhe rajonal për qasjen e një programi të integruar me qëllim nxitjen e përmbushjes vullnetare të individit në funksion të realizimit të objektivave tatimore.

#### **Organizimi i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar.**

Struktura Organizative e DKS është e organizuar në nivel qendrore në përbërje të DPT-së dhe e organizuar me (1) Drejtor + (9) Inspektorë.

Nëpërmjet postës elektronike zyrtare nga ana e grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë dërguar kërkesa për informacion mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar për periudhën objekt auditimi 01.01.2021-31.12.2021 dhe është kthyer përgjigje nga Znj. P. S., nëpërmjet postës elektronike të datës 25.03.2022, paraqitur si më poshtë:

#### **1. Si janë identifikuar individët me të ardhura personale të padeklaruara dhe të pa tatuara për të gjitha burimet e të ardhurave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë?**

Drejtorja e Kontrollit të Specializuar e krijuar si pasojë e ndryshimeve organizative miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 33, datë 12.02.2020, me fokus nxitjen e përmbushjes vullnetare për individin në funksion të realizimit të objektivave të Administratës Tatimore. Për gjatë gjithë vitit 2021, DKS ka patur të emëruar vetëm 5 nëpunës (4+1) nga 9+1 të cilët janë të parashikuar në organigramën e kësaj drejtorie. Meqenëse stafi ka qenë i reduktuar për vitin 2021, identifikimi burimit të të ardhurave të individëve brenda edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të kryhet në vijim.

**2. Si është mbledhur informacioni nëpërmjet formularëve të hartuar nga DSK dhe si është bërë vlerësimi i riskut?**

Informacioni është mbledhur nga TIK (brenda sistemit tatimor), për deklarimin DIVA dhe vlerësimi i riskut është kryer sipas metodologjisë së përcaktuar në manual.

**3. Procesverbale të intervistimit me individët për risqet e nxjerra?**

Nuk ka patur intervistime për vitin 2021.

**4. Çfarë teknikash vlerësimi janë përdorur për të përllogaritur detyrimet e tatimit mbi të ardhurat personale si dhe çdo detyrim tjetër që ka rezultuar kur tatimpaguesi ka patur detyrimin ligjor për të deklarim por se ka kryer?**

Teknikat e vlerësimit janë parashikuar në Manualin e Kontrollit të Specializuar dhe për Vitin 2021 nuk ka patur vlerësim për të përllogaritur detyrimet e tatimit mbi të ardhurat personale.

**5. Urdhrat e punës të dala për të kryer verifikime të çështjeve të veçanta.**

Për vitin 2021 nuk ka patur urdhra pune.

**6. Rastet që janë përcjellë DRT përkatëse për vlerësime tatimore.**

Për Vitin 2021 nuk ka patur vlerësime tatimore.

**7. A janë krijuar profile për individët bazuar në informacionet e mbledhura? Po dosje për secilin?**

Drejtoria e Kontrollit të Specializuar ka kërkuar nga Drejtoria T.I.K informacion mbi individët me të ardhura më të larta të cilët kanë detyrimin ligjor për të plotësuar DIVA. Sipas informacionit të marrë, nga inspektorët e D.K.S është bërë filtrimi i të dhënave në mënyrë që të renditen individët sipas të ardhurave më të larta. Duke patur parasysh faktin që Drejtoria ka patur vetëm 4 nëpunës për vitin 2021, si edhe bazuar rekomandimeve të FMN jemi udhëzuar që të përzgjedhim vetëm 100 individët me të ardhura më të larta. Dosje për individët nuk ka.

**8. Veprimet që janë ndërmarrë për te nxitur përmbushjen vullnetare tek individët.**

Drejtoria e Kontrollit të Specializuar ka dërguar shkresë institucioneve/palëve të treta me qëllim identifikimin e 100 individëve më të pasur dhe nën asistencën e FMN-së është hartuar plan i përmbushjes vullnetare, i cili pritet që të vendoset në zbatim në vizitën e radhës. Sipas analizave të bëra bazuar në informacionin brenda sistemit tatimor, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar ka dërguar shkresa së bashku me formularët tip për individët me të ardhura të larta dhe deklarues DIVA 2020, kjo sipas problematikave të identifikuar. Shkresa së bashku me formularët tip janë dërguar me qëllim nxitjen e përmbushjes vullnetare dhe brenda 3 mujorit, kohë e cila lejon veprime rregulluese në DIVA dhe pa penalizim.

***Nga përgjigjet e pyetësorit (i cili është vendosur në dispozicion nëpërmjet postës elektronike zyrtare të datës 22.03.2022), të dhënë nga subjekti i audituar, grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit del në konkluzionin se Drejtoria e Kontrollit të Specializuar nuk e ka përmbushur misionin e krijimit të saj, duke qene një strukture jo efçente në përmbushje të përgjegjësi dhe detyrave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i fushës.***

**Titulli i Gjetjes**

Drejtoria e Kontrollit të Specializuar nuk e ka përmbushur misionin e krijimit të saj.

**Situata 4:**

Nga përgjigjet e pyetësorit të dhënë Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, rezulton se nuk janë identifikuar individët me të ardhura personale të padeklaruara dhe të pa tatuara për të gjitha burimet e të ardhurave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Informacioni është mbledhur nga TIK (brenda sistemit tatimor), për deklarimin e DIVA, ndërsa vlerësimi i riskut është kryer sipas metodologjisë së përcaktuar në manual. Procedimi në këtë mënyrë vlerësojmë se është jo korrekt, sepse risku i lartë i evazionit në deklarimin dhe fshehjen e të ardhurave nuk është brenda sistemit tatimor, por jashtë tij. Për vitin 2021 nuk ka patur urdhra pune, nuk janë kryer intervistime, nuk kanë rezultuar raste për ti përcjellë në DRT përkatëse për vlerësime tatimore, nuk janë krijuar profile për individët bazuar në informacionet e mbledhura, si dhe dosje për secilin, por janë dërguar disa formular tip për individët me të ardhura të

larta dhe deklarues të DIVA 2020, kjo sipas problematikave të identifikuar, me qëllim nxitjen e përmbushjes vullnetare të detyrimit për deklarim. Nga sa është konstatuar, arrijmë në konkluzionin se Drejtoria e Kontrollit të Specializuar nuk e ka përmbushur misionin e krijimit të saj, duke qenë një strukturë jo efiçente në përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i fushës, ku shkaku kryesor i kësaj situate është mungesa e akteve ligjore dhe nënligjore për të operuar normalisht në funksion të qëllimit të krijimit të kësaj drejtorie.

<b>Kriteri :</b>	Manuali i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Përdorimin jo me efektivitet, efiçencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e akteve ligjore dhe nënligjore për të operuar normalisht në funksion të qëllimit të krijimit të kësaj drejtorie.
<b>Rëndësia</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi</b>	DPT të marrë masa për hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim vijimin normal të punës, në përmbushje të misionit dhe objektivit të krijimit të kësaj drejtorie

## **2.7. Auditim i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare.**

### **A. Mbi auditimin e veprimtarisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit**

**Programi 01140 “Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore”** ka patur objektiv kryesor progresin organizativ të Administratës Tatimore dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, aplikimin e metodave dhe sistemeve të reja, modernizimin, ofrimin e shërbimeve cilësore dhe reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, si rrjedhojë rritjen e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë. Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut, përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore, mbledhja efikase dhe efektive e borxhit, objektiv ky i cili është përcaktuar më pas nëpërmjet treguesve të performancës:

- Mbledhje të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, me rritje në raport me vlerën e realizuar faktike të vitit të mëparshëm si rezultat i përmirësimit të performancës administrative në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Reduktimi i stokut të borxhit dhe mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.
- Detyrime të pakësuara gjatë vitit/Detyrime të shtuara gjatë vitit nëse % > 50% kemi zbritje të stokut të borxhit

### **Programimi i PBA 2021-2023 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2021**

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe afatmesme 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 28.02.2018, òPër procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe udhëzimeve vjetore. Planifikimi i zërave të shpenzimeve për òFondin e pagave & sigurimeve shoqërore (llog 600 & 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korente (llog 602-

606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit.

✓ **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2021-2023**

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 17, datë 22.4.2020 òPër përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe të afateve për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për vitin 2020, neni 1 i tij, për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga Covid-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nuk do të zbatohen.

✓ **Planifikimi në fazën e II-rë të PBA 2021-2023**

- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2021-2023, janë miratuar me VKM nr. 577 datë 22.07.2020 "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për PBA òsë 2021- 2023", në nivel programi. Totali i shpenzimeve për DPT për këtë fazë të PBA-së është përcaktuar në vlerën 2,853,000 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korente në vlerën 2,550,000 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 303,000 mijë lekë. Në vijim, DPT ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesat buxhetore për periudhën 2021-2023 me shkresën nr. 16997 Prot., datë 31.08.2020.

Totali i kërkesave shtesë në këtë fazë përfundimtare të PBA 2020-2022 për DPT për projektet e investimit rezultojnë si më poshtë:

-òPërmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimitò me një kërkesë shtesë prej 350,853 mijë lekë;

-òPajisje elektronike kompjuterò me një kërkesë shtesë prej 15,000 mijë lekë;

-òRikonstruksion DPTò me një kërkesë shtesë prej 20,000 mijë lekë;

-òRikonstruksion DRT Tiranë dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenjò me një kërkesë shtesë prej 60,000 mijë lekë;

-òRikonstruksion DRT Fierò me një kërkesë shtesë prej 66,000 mijë lekë;

-òRikonstruksion DRT Dibërò me një kërkesë shtesë prej 15,000 mijë lekë;

-òRikonstruksion DRT Shkodërò me një kërkesë shtesë prej 4,000 mijë lekë;

-òRikonstruksion DRT Durrësò me një kërkesë shtesë prej 1,223 mijë lekë;

Detajimi i buxhetit në nivel llogarie për fazën e II-të të PBA-së 2021-2023, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 1

Në mijë lekë

Faza e II e PBA-së 2021-2023 për vitin 2021			
Llog	Emërtimi	Vlera sipas tavanit	Kërkesa shtesë
600	Paga	1,480,000	
601	Sigurime Shoqërore	250,000	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	817,640	1,088
605	Transferta Korente të Huaja	2,360	
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	0	
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korente</b>	<b>2,550,000</b>	<b>1,088</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	303,000	532,077
	<b>Shp. Kapitale me financim te brendshëm</b>	<b>303,000</b>	<b>532,077</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	
	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>303,000</b>	
<b>I+II</b>	<b>Totali I Shpenzimeve</b>	<b>2,853,000</b>	<b>533,165</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa i përket investimeve kapitale të përfshira në fazën II-të të PBA-së 2021-2023, ato paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 2

Në mijë lekë

Nr	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Periudha e ekzekutimit të projektit	Vlera Totale e projektit	Vlera për vitin 2021
1	18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	2019-2021	170,000	58,700
2	M100500	Përmirësimi i modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit	2018-2020	1,727,7952	187,960
3	18AV811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja	2020-2021	80,040	56,340
<b>Totali</b>				<b>17,527,992</b>	<b>303,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në zbatim të ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 dhe Për buxhetin e vitit 2021, dhe shkresës nr. 23724, datë 21.12.2020 dhe Mbi përditësimin e të dhënave në sistemin AFMIS për fazën e tretë të PBA-së 2021-2023 si dhe detajimin e fondeve buxhetore të miratuara për vitet 2021-2023, nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT është përcjellë detajimi i buxhetit vjetor në nivel artikulli dhe produkti sipas njësive shpenzuese të programit, dhe limitet mujore të buxhetit të miratuar sipas njësive shpenzuese të programit.

Në mënyrë të përmbledhur, planifikimi i kryer nga DPT sipas Tavaneve të miratuara me VKM për programin **Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**, deri në fazën e hartimit të Projekt Buxhetit të vitit 2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3

Në mijë lekë

Llog	Emërtimi	Buxheti Faktik 2020	Faza e II PBA 2021	Projekt Buxhet 2021
600	Paga	1,228,606	1,480,000	1,420,000
601	Sigurime Shoqërore	202,471	250,000	250,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	727,263	817,640	767,640
605	Transferta Korente të Huaja	3,132	2,360	2,360
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	12,068,530	0	-
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korente</b>	<b>14,230,002</b>	<b>2,550,000</b>	<b>2,440,000</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	6,250		
231	Kapitale të Trupëzuara	409,266		
	<i>Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT</i>	35,566	58,700	58,700
	<i>Përmirësimi i modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit</i>	350,000	187,960	187,960
	<i>Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja</i>	23,700	56,340	56,340
	<b>Shp. Kapitale me financim te brendshëm</b>	<b>415,516</b>	<b>303,000</b>	<b>303,000</b>
	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>415,516</b>	<b>303,000</b>	<b>303,000</b>
<b>III</b>	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti</b>	<b>2,254,242</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>
<b>I+II +III Totali i Shpenzimeve</b>		<b>16,899,760</b>	<b>2,853,000</b>	<b>2,743,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT



Me shkresën nr. 917, datë 18.1.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT është përcjellë kërkesa për kryerjen e ndryshimeve mbi detajimin e projekteve të investimeve në buxhetin vjetor për vitin 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Konkretisht, në vijim të konkluzioneve të takimit të Ekipit të Menaxhimit të Programit në datën 18.01.2021, lidhur me mungesën e fondeve buxhetore në dispozicion për financimin e projekteve të investimeve është kërkuar ndryshimi i prioriteteve të tyre, referuar rëndësisë së projektit ÷Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit, e cila lidhet me procesin më të rëndësishëm të institucionit, atë të Fiskalizimit, dhe detyrimet e larta mbetur pa likuiduar prej tetorit të vitit 2020 për këtë projekt. Referuar afateve të përcaktuara në kontratën nr. 6756, datë 27.11.2018, faza e implementimit ka përfunduar në datën 27.11.2020 dhe **detyrimi i mbetur i pa likuiduar është 538,813 mijë lekë**. Detajimi i kërkuar nga DPT paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4

Në mijë lekë

Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Vlera
18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	15,000
M100500	Përmirësimi i modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit (FISKALIZIMI)	273,000
18AV811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja	15,000
<b>Total</b>		<b>303,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

### Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2021

Në zbatim të Ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 ÷Për buxhetin e vitit 2021 dhe udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 9, datë 20.03.2018 ÷Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korente për programin Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore të menaxhuar nga Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve është përcjellë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 24104/2, datë 25.01.2021; për shpenzimet kapitale me shkresën nr. 24639/2 Prot., datë 3.2.2021 të MFE. Në vijim të saj Drejtori i Përgjithshëm i DPT ka përcjellë për drejtoritë rajonale tatimore detajimin e fondeve buxhetore për shpenzimet korente 2021-2023 me shkresën nr. 1524/1, prot., datë 05.02.2021.

Ky buxhet paraqitet për vitin 2021 në vlerën 2,743,000 mijë lekë, nga të cilat:

- Shpenzime Korente në vlerën totale 2,440,000 mijë lekë;
- Shpenzime Kapitale në vlerën totale 303,000 mijë lekë.

Në nivel artikujsh, shpenzimet korente janë përcaktuar si më poshtë:

- Llogaria 600 ÷Paga dhe shtesa në vlerën 1,420,000 mijë lekë;
- Llogaria 601 ÷Sigurime shoqërore në vlerën 250,000 mijë lekë;
- Llogaria 602 ÷Blerje mallra e shërbime në vlerën 767,640 mijë lekë;
- Llogaria 605 ÷Transferta të jashtme në vlerën 2,360 mijë lekë.

Krahasuar me projektbuxhetin, në çelje të shpenzimeve korente ka patur një shtesë të fondeve të alokuara në vlerën 60,000 mijë lekë në kodin e projektit 91004AC ÷Vendime gjyqësore të ekzekutuara.

Në nivel projektesh, shpenzimet kapitale janë përcaktuar në çelje sipas shkresës nr. 917, datë 18.1.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT trajtuar më sipër.

Detajimi i ÷Fondit të Veçantë vetëm për aparatën e DPT në vlerën 3,400 mijë lekë, në llogarinë 606 ÷Transferta të buxheteve familjarë & individë është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2300/3 datë 15.02.2021, ÷Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2021.

### Ndryshimet gjatë vitit 2021

#### \*Për shpenzimet kapitale

-Në zbatim VKM-së nr. 218, datë 07.04.2021 ÷Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2021, me shkresën nr. 5892/6 Prot., datë 22.04.2021 të MFE protokolluar në DPT nr. 8232, datë 07.05.2021,

është miratuar alokimi i fondeve shtesë për projektin e investimit me kod M100500 òPërmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimito me vlerë 30,000 mijë lekë. Kjo shtesë e fondeve ka ardhur si rezultat i pakësimit të fondeve të aparatit të MFE, përkatësisht në projektin e investimit 18AY635 òRikonstruksion i shkollës profesionale òNazmi Rushitiö.

- Në zbatim të VKM-së nr. 291, datë 19.05.2021 òPër një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për financimin e projektit òPërmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimito nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit është vendosur financimi i projektit të investimit me kod M100500 òPërmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimito duke alokuar **një shtesë fondi prej 220,858 mijë lekë** në programin buxhetor 01140 ò Menaxhimi i të ardhurave tatimoreö.

### **\*Për shpenzimet korente**

-Në zbatim të shkresës nr. 3117, prot., datë 18.02.2021 të DPT, me shkresën nr. 3536/3, prot., datë 27.05.2021 të MFE, prot., në DPT nr. 9569, datë 28.05.2021 është miratuar transferimi i fondeve të buxhetit të aparatit të DPT nga llogaria 602 në projektin 91004AA òTatimpagues të asistuarö në llogarinë 606 të po këtij projekti në vlerën 384 mijë lekë. Ky ndryshim është kryer nga një llogari në tjetrën, për shkak të një lapsusi në alokimin e fondeve, e cila më pas është sistemuar me këtë alokim.

-Me shkresën nr. 3387, prot., datë 17.05.2021 të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) protokolluar në DPT nr. 3387, datë 17.05.2021, është dërguar për zbatim Kontrata nr. 3339, datë 12.05.2021 me vlerë totale të kontratës 229,586,688 lekë me TVSH për 24 muaj mirëmbajtje, e lidhur nga AKSHI në përfundim të procedurës të prokurimit me objekt òMirëmbajtja e sistemit e-Taxationö për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ku është shpallur fitues operator ekonomik ò i.I.ö. Sipas informacionit, DPT nuk ka patur dijeni për këtë procedurë, cituar kjo edhe nëpërmjet shkresës nr. 4900/1, prot., datë 18.03.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT. Në këtë shkresë i është kthyer përgjigje AKSHI-t, në përgjigje të shkresës nr. 1603, prot., datë 16.03.2021 të AKSHI-t ku është kërkuar informacion lidhur me planifikimin në PBA 2021-2023, të kësaj kontrate. DPT ka sqaruar se kërkesa për realizimin e këtij procesi nuk është përcjellë në DPT brenda afateve ligjore, ndaj nuk është e parashikuar në fondet për vitet 2021-2023. Megjithatë, gjendur brenda faktit ku nga ana e AKSHI-t është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e fondit limit si dhe hartimin e kriterëve të veçanta për këtë procedurë, përfundimin e termave të referencës si dhe në vijim të mos konkludimit të kalimit të përbashkët kapital, është shprehur angazhimi për sigurimin e fondeve për këtë projekt në mundësimin e alokimit të fondeve brenda për brenda zërave buxhetor. Kjo për shkak edhe të faktit se kjo procedurë lidhet me sistemin C@TS, i cili është sistemi baze i tatimeve dhe i rëndësisë së veçantë, si dhe gjendur në një situatë të mungesës së fondeve dhe pamundësisë për alokim shtesë fondesh nga MFE, sikundër konfirmuar nga DPT. DFB ka paraqitur kërkesën për zhvillimin e mbledhjes me GMS dhe EMP ku diskutohej për një vendimmarrje në këtë situatë, por nuk rezultoi të jenë kryer këto mbledhje. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 9439/1, prot., datë 01.06.2021 të DPT është përcjellë pranë MFE kërkesa për rialokimin e fondeve buxhetore brenda shpenzimeve korente, duke pakësuar shpenzimet paga dhe sigurime shoqërore (llog 600 dhe 601) të disa Drejtorive Rajonale Tatimore: DRT Durrës, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Vlorë, VIP, Tiranë, Aparati i DPT (duke përdorur sipas informacionit të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në DPT, fondet e mbetura për muajt për të cilat janë kryer pagesat, deri në ato momente, dhe disponoheshin fonde të pa realizuara për shkak të vakancave), me qëllim alokimin e shtesës prej 60,000 mijë lekë për shpenzime korente të aparatit të DPT në produktin 91004AA për të kryer likuidimet e nevojshme të kontratës trajtuar më sipër. Në vijim të saj, me shkresën nr. 9881/2, prot., datë 16.06.2021 të MFE, prot., në DPT nr. 9881/3, datë 21.06.2021 është miratuar ky transferim i fondeve.

-Nëpërmjet shkresës nr. 11716, prot., datë 25.06.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPT ka përcjellë pranë MFE kërkesën për rialokim fondesh shpenzime korente pas rekomandimit të Institutit të Ndërtimit për marrjen me qira në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, qiraja e së cilës për 6 muaj është planifikuar në vlerën 19,000 mijë leke; dhe për DRT Fier në vijim të ndryshimit të strukturës ku Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Rajoni Jugor është përqendruar në DRT Fier ka lindur domosdoshmëria për marrjen me qira të një ambienti për 6 muaj në vlerën rreth 900 mijë lekë. Në vijim të saj, me shkresën nr. 11518/3, prot., datë 05.07.2021 të MFE, prot., në DPT nr. 12520, datë 06.07.2021 është miratuar transferimi i fondeve të buxhetit nga aparati i DPT dhe DRT Tiranë nga llogaritë e pagave dhe sigurimeve shoqërorë (600,601) të projektit 91004AA ÷Tatimpagues të asistuarë në llogarinë 602 për financimin e shpenzimeve të shërbimeve të po këtij projekti në Aparatin e DPT dhe DRT Fier në vlerën 19,900 mijë lekë:

Tabela nr. 5

Në mijë lekë

Institucioni	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
<i>Pakësohet</i>			
Aparati i DPT	600	91004AA	9,000
Aparati i DPT	601	91004AA	700
DRT Tiranë	600	91004AA	9,500
DRT Tiranë	601	91004AA	700
<b>Total</b>			<b>19,900</b>
<i>Shtohet</i>			
Aparati i DPT	602	91004AA	19,000
DRT Fier	602	91004AA	900
<b>Total</b>			<b>19,900</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

- Nëpërmjet shkresës nr. 11052/2, prot., datë 21.07.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPT ka përcjellë pranë MFE kërkesën për rialokim fondesh shpenzime korente sipas kërkesave të drejtorive rajonale duke propozuar pakësimin e fondeve të aparatit për llog 600 në vlerën 6,000 mijë lekë me qëllim alokimin e fondeve në llog 602 të DRT Korçë, Kukës, Lezhë, Tiranë. Më pas, me shkresën nr. 14423/1, prot., datë 6.8.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm, kërkesave shtesë për fonde në llog 602 të drejtorive rajonale u janë bashkuar edhe DRT Shkodër, Sarandë dhe aparati i DPT, për financimin e të cilave është propozuar pakësimi i fondeve për paga të DPT në vlerën 1,550 mijë lekë. Në zbatim të këtyre dy shkresave, me shkresën nr. 13228/2, prot., datë 23.08.2021 të MFE, prot., në DPT nr. 13228/5, datë 07.09.2021 është miratuar transferimi i fondeve të buxhetit tek llog 602 e aparatit të DPT dhe DRT Korçë, Kukës, Lezhë, Tiranë, Shkodër, Sarandë në projektin 91004AA ÷Tatimpagues të asistuarë, nga llogaria 600 e aparatit të DPT të po këtij projekti në vlerën 7,550 mijë lekë:

Tabela nr. 6

Në mijë lekë

Institucioni	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
<i>Pakësohet</i>			
Aparati i DPT	600	91004AA	7,550
<b>Total</b>			<b>7,550</b>
<i>Shtohet</i>			
DRT Korçë	602	91004AA	1,000
DRT Kukës	602	91004AA	1,000
DRT Lezhë	602	91004AA	1,000
DRT Tiranë	602	91004AA	3,000
DRT Shkodër	602	91004AA	400
DRT Sarandë	602	91004AA	1,000
Aparati i DPT	602	91004AA	150
<b>Total</b>			<b>7,550</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

- Në zbatim të shkresës nr. 17860, prot., datë 5.10.2021 të DPT ku është kërkuar sistemimi i problematikës së konstatuar ku është marrë në mënyrë automatike nga sistemi AFMIS, me shkresën nr. 17076/1, prot., datë 22.10.2021 të MFE, prot., në DPT nr. 19402, datë 25.10.2021 është miratuar transferimi i fondeve të buxhetit tek llog 602 e aparatit të DPT në projektin 91004AA të Tatimpagues të asistuarë, nga llogaria 602 e aparatit të DPT të projektit 911104AB të Inspektimit, hetime tatimore në vlerën 88,902 mijë lekë:

Tabela nr. 7

Në mijë lekë

Institucioni	Llogaria	Kodi i projektit	Shuma
<b>Pakësohet</b>			
Aparati i DPT	602	91004AB	88,902
<b>Total</b>			<b>88,902</b>
<b>Shtohet</b>			
Aparati i DPT	602	91004AA	88,902
<b>Total</b>			<b>88,902</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

- Në zbatim të shkresës nr. 20154, prot datë 8.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT me shkresën nr. 19708/2, prot datë 18.11.2021 të MFE, prot në DPT nr. 19708/3, datë 25.11.2021 është miratuar rialokimi i fondeve korente për pagesën e detyrimeve të vendimeve gjyqësore për DPT, duke pakësuar fondet nga llogaritë e pagave dhe sigurimeve për disa drejtori Rajonale Tatimore për të shtuar fondet e Aparatit të DPT në llogarinë 600 në vlerën 2,000 mijë lekë dhe llogarinë 602 në projektin 91004AC të Vendimeve gjyqësore të ekzekutuara në vlerën 91,240 mijë lekë (pra gjithsej shtesa për DPT është 93,240 mijë lekë).

- Në zbatim të Aktit Normativ nr. 34, datë 03.12.2021, është përcjellë shkresa nr. 22026/2, prot., datë 16.12.2021 e MFR, prot në DPT nr. 22648 datë 20.12.2021, nëpërmjet të cilës janë miratuar ndryshime në shpenzimet korrente të disa institucioneve buxhetore, ku efekti për DPT ka qenë shtesa e fondeve për aparatit të DPT në vlerën 53,624 mijë lekë në llog 602 të projektit 91004AC të Vendimeve gjyqësore të ekzekutuara; shtesa për DRT Durrës në vlerën 2,000 mijë lekë në llog 602 të projektit 91004AA të Tatimpagues të asistuarë; shtesa për DRT Fier në vlerën 60 mijë lekë në llog 602 të projektit 91004AA të Tatimpagues të asistuarë; shtesa për DRT Lezhë në vlerën 1,316 mijë lekë në llog 602 të projektit 91004AA të Tatimpagues të asistuarë.

### Realizimi i planit të buxhetit

Për vitin 2021, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4 mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 9604, prot datë 31.05.2021.

- Raporti i monitorimit 8 mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 17864, prot datë 05.01.2021.

- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2021 është dërguar me shkresën nr. 2051, datë 10.02.2022.

Për sa i përket realizimi në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 01140 të Menaxhimit të ardhurave tatimore, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 8

Në mijë lekë

Llog	Shpenzime Korente	Fakti 2020	Plani Fillestar	Plani i rishikuar	Realizimi	Diferenca
------	-------------------	------------	-----------------	-------------------	-----------	-----------

		1	2	4	5	6=5-4
600	Paga	1,228,606	1,420,000	1,274,770	1,264,587	-10,183
601	Sigurime Shoqërore	202,471	250,000	216,540	210,855	-5,685
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	727,263	767,640	1,002,796	897,174	-105,622
605	Transferta Korente të Huaja	3,132	2,360	2,510	2,227	-283
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	12,068,530	461,306	464,958	463,533	-1,425
<b>I</b>	<b>Totali i Shpenzimeve Korente</b>	<b>14,230,002</b>	<b>2,901,306</b>	<b>2,961,574</b>	<b>2,838,366</b>	<b>-123,208</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara F. B	6,250				
231	Kapitale të Trupëzuar F.B	409,266	303,000	553,858	542,787	-11,071
230-231	Kapitale me Financim të Huaj	0	0	0	0	NA
<b>II</b>	<b>Totali i Shpenzimeve Kapitale</b>	<b>415,516</b>	<b>303,000</b>	<b>553,858</b>	<b>542,787</b>	<b>-11,071</b>
<b>I+II</b>	<b>Totali i shpenzimeve korente dhe kapitale</b>	<b>14,645,518</b>	<b>3,204,306</b>	<b>3,515,432</b>	<b>3,381,152</b>	<b>-134,279</b>
<b>III</b>	<b>Shp. të ardhurat jashtë limiti</b>	<b>2,254,242</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>2,205,690</b>	<b>NA</b>
<b>I+II+ III</b>	<b>Totali i Përgjithshëm</b>	<b>16,899,760</b>	<b>3,204,306</b>	<b>3,515,432</b>	<b>3,586,842</b>	<b>NA</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa i përket të ardhurave jashtë limitit, në vijim të kërkesës së grupit për vendosjen në dispozicion të një plani për këto shpenzime, nga ana e përfaqësuesve të institucionit u bëmë me dije se për këto të ardhura nuk ka një planifikim, pasi shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzime që i përkasin kapitull 6, rritje e autorizuar e cila ndjek këtë rrugë: DPT shpërndan produktet e saj (fatura tatimore etj.) Drejtorive Rajonale të cilat më pas kryejnë shitjen e tyre dhe i derdhin pagesat në buxhetet nëpërmjet kapitullit 6. Pasi rakordohet çdo muaj mbi derdhjet që kryhen nga DRT në Degën e Thesarit, ato përcillen në rrugë zyrtare në DPT. DPT nëpërmjet shkresës zyrtare kërkon rritjen e autorizuar pranë MFE, e cila me pas realizon çeljen e fondit për t'ua përdorur më pas për likuidim faturash të shtypshkronjave të letrave me vlerë.

Realizimi i buxhetit të vitit 2021, krahasuar me planin fillestar, të rishikuar dhe realizimin në vitin paraardhës, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 9

Në mijë lekë

Llog	Shpenzime Korente	Fakti 2020	Plani Fillestar 2021	Plani i rishikuar 2021	Realizimi 2021	Diferenca Realizim/plan i rishik
		1	2	4	5	6=5-4
600	Paga	1,228,606	1,420,000	1,274,770	1,264,587	-10,183
	<i>Nga këto, për DPT</i>	223,419	288,000	259,986	257,346	-2,640
601	Sigurime Shoqërore	202,471	250,000	216,540	210,855	-5,685
	<i>Nga këto, për DPT</i>	36,658	57,000	45,764	42,673	-3,091
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	727,263	767,640	1,002,796	897,174	-105,622
	<i>Nga këto, për DPT</i>	644,735	700,640	942,120	823,927	-118,193
605	Transferta Korente të Huaja	3,132	2,360	2,510	2,227	-283
	<i>Nga këto, për DPT</i>	3,132	2,360	2,510	2,226	-283
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	12,068,530	461,306	464,958	463,533	-1,425
	<i>Nga këto, për DPT</i>	12,067,033	0	463,095	461,671	-1,335
<b>I</b>	<b>Totali i Shpenzimeve Korente</b>	<b>14,230,002</b>	<b>2,901,306</b>	<b>2,961,574</b>	<b>2,838,366</b>	<b>-123,208</b>
	<i>Nga këto, për DPT</i>	<b>12,067,941</b>	<b>1,048,000</b>	<b>1,713,475</b>	<b>1,587,843</b>	<b>-125,543</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara F. B	6,250	0	0	0	NA
	<i>Nga këto, për DPT</i>	6,250	0	0	0	NA
231	Kapitale të Trupëzuar F.B	409,266	303,000	553,858	542,787	-11,071
	<i>Nga këto, për DPT</i>	409,266	303,000	553,858	542,787	-11,071
<b>II</b>	<b>Totali i Shpenzimeve Kapitale</b>	<b>415,516</b>	<b>303,000</b>	<b>553,858</b>	<b>542,787</b>	<b>-11,071</b>
	<i>Nga këto, për DPT</i>	<b>415,516</b>	<b>303,000</b>	<b>553,858</b>	<b>542,787</b>	<b>-11,071</b>
<b>III</b>	<b>Shp. të ardhurat jashtë limiti</b>	<b>2,254,242</b>	<b>NA</b>	<b>NA</b>	<b>2,205,690</b>	<b>NA</b>
	<b>Totali i Përgjithshëm</b>	<b>16,899,760</b>	<b>3,204,306</b>	<b>3,515,432</b>	<b>3,381,152</b>	<b>-134,280</b>
	<i>Nga këto, për DPT</i>	<b>12,483,457</b>	<b>1,654,100</b>	<b>1,806,028</b>	<b>1,669,414</b>	<b>-136,614</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa i përket krahasimit të realizimit të zërit 606 "Trans për Buxhetet e Familjarëve & Individëve" me vitin paraardhës, gjatë vitit paraardhës ky zë për DPT rezultonte me një realizim prej rreth 12,067 milion lekë, krahasuar me vetëm rreth 461 milion lekë për vitin 2022, për shkak të shpenzimeve të kryera në kuadër të pandemisë, përkatësisht rreth 12,052 milion lekë paga lufte, 11.6 milion lekë gjoba të kufirit të vendosura lidhur me masat për situatën e karantinës, dhe vetëm 2.9 milion lekë për shpenzime për transferime për Buxhetet Familjare dhe Individë. Për vitin 2021, nga totali prej rreth

461,671 mijë lekë për vitin 2021, 461,216 mijë lekë janë shpenzime për paga lufte, dhe 455 mijë lekë shpenzime për tjera për transferime të brendshme.

Në nivel projektsh investimi, situata rezulton si më poshtë:

Tabela nr. 10

Në mijë lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përf	PBA 2021-2023	Plani 2021	Realizimi 2021	Realizimi progresiv
M100255	Pagesa kontributit vjetor Fiscalis 2021	31,600	2015	2020				29,367
M100500	Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit	1,727,792	2018	2020	187,960	523,858	512,787	1,701,765
18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	170,000	2019	2021	58,700	15,000	15,000	124,965
18AV811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja	80,040	2020	2020	56,340	15,000	15,000	38,700

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për projektin e fiskalizimit, janë realizuar pagesa në vlerën 512,787 mijë lekë, krahasuar me 187,960 mijë të planifikuara në PBA për vitin 2021, ose pothuajse 3 fish më shumë. Nga sa më sipër rezulton se me ndryshimin e prioriteteve për ekzekutimin e projekteve të investimit nga DPT, me qëllim sigurimin e fondeve në dispozicion për projektin M100500 ÷Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit, i cili është likuiduar i plotë; kjo situatë ka impaktuar realizimin e dy projekteve të tjera të DPT. Kjo problematikë është përcjellë edhe nga DPT pranë MFE, që në momentin e miratimit të tavaneve në fazën e hartimit të PBA-së, ku plani për projektet e investimit të DPT nuk mundëson likuidimin e tyre, dhe kërkesat për investime nuk janë marrë parasysh në totalin e tyre, pasi nuk janë përfshirë në vlerën e fondit të investimit të sistemeve të IT, edhe fondet për mirëmbajtjen e tyre. Nëse krahasojmë nivelin e financimit të planifikuar sipas PBA-së, me atë të alokuar përgjatë vitit 2021, për dy projektet rezulton diferenca prej 85,040 mijë lekë e cila përbën një angazhim kontraktual. Duke gene se nga ana e operatorëve ekonomik nuk është kërkuar kryerja e pagesave, nuk janë krijuar detyrime të prapambetura, **megjithatë kjo situatë përbën një risk për krijimin e tyre**. Më hollësisht, për projektin e investimit 18AV806 ÷Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT, sipas kontratës nr. 7047, datë 28.12.2020 janë planifikuar pagesa për investimin përkatësisht 36,300 mijë lekë në vitin 2020 dhe 54,408 mijë lekë në vitin 2021 dhe mirëmbajtje për 24 muaj në vlerën 35,640 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 janë realizuar fonde në vlerën 15,000 mijë lekë, dhe referuar realizimit progresiv në kësaj kontrate në vlerën 124,965 mijë lekë nuk ka mundur të likuidohet vlera e plotë e këtij projekti, dhe vlera e mbetur prej **45,037 mijë lekë mbetet si detyrim për t'u likuiduar në vitin pasardhës**.

E njëjta situatë rezulton edhe për projektin 18AV811 ÷Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja, ku sipas kontratës nr. 3275, datë 10.07.2020 janë planifikuar pagesa përkatësisht 23,700 mijë lekë në vitin 2020 dhe 56,340 mijë lekë në vitin 2021 dhe mirëmbajtje në vlerën 27,840 mijë lekë për 24 muaj. Për vitin 2021 janë realizuar vetëm 15,000 mijë lekë, dhe referuar realizimit progresiv në kësaj kontrate në vlerën 38,700 mijë lekë, **vlera e mbetur prej 41,340 mijë lekë mbetet si detyrim për t'u likuiduar në vitin 2022**.

- Pagesa kontributit vjetor Fiscalis 2021 është një pagesë vjetore e kryer nga DPT, për të cilën nuk ka detyrim të papaguar për vitin 2021, pasi nuk ka pasur pagese, sepse ende nuk kishte një marrëveshje të konkluduar, po kjo shumë pagese e kryer për çdo vit është objekt përlllogaritjesh dhe në bazë të kursit të këmbimit.

**-Programi 01140 "Menaxhimi i të ardhurave tatimore"** është realizuar në masën **96%**, pra në vlerën 3,381,152 mijë lekë, kundrejt 3,515,432 mijë lekë të planit të rishikuar, ose me një mosrealizim në

vlerën 134,279 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar. Krahasuar me planin fillestar programi 01140 është realizuar në masën 106%, me një mbi realizim në vlerën 176,847 mijë lekë kundrejt planit fillestar (për shkak të realizimit më të lartë të zërit të investimeve).

- Shpenzimet korente janë realizuar në masën 95%, me një mos realizim në vlerën 123,208 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Niveli më i lartë i mos realizimit rezulton në zërin 602, ku shpenzimet janë realizuar 105,622 mijë lekë më pak se plani. Arsyet e mosrealizimit sipas DPT lidhen me moskonkludimin e kontratave të ndryshme të cilat për tu likuiduar duhet të vijnë nga AKSHI pasi janë sisteme IT. Gjithashtu, referuar detajimit të buxhetit të zërit 602 në zëra produktesh buxhetore, për përdorimin e tyre nevojitet rialokim i fondeve nga një produkt në tjetrin, ku nevojat më të mëdha kanë qenë ato nga produkti AA tek AC për të ulur detyrimet. Duke qenë se afati i fundit i kërkesave për rialokim është 15 Nëntor, pas kësaj data është e pamundur të bëhen rialokim të fondeve.

- Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 98%, me një mos realizim në vlerën 11,071 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Shkak për këtë mos realizim është përlllogaritja e kryer në alokimin e fondeve nga Fondi Rezervë për kontratën e investimit, ku sipas VKM-së kjo vlerë ka qenë më e lartë, për shkak të diferencave në kursin e këmbimit gjatë planifikimit dhe alokimit të shtesës.

### **Raportimi i detyrimeve të prapambetura.**

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 37, date 6.10.2020 òPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshmeò, kreu III pika 2 ku citohet se ò*struktura përgjegjëse për thesarin.. çdo muaj, deri në afatin e miratuar për publikimin e të dhënave përfundimtare të treguesve fiskal të konsoliduar, struktura përgjegjëse për Thesarin në degë kryen rakordimin mujor me njësitë shpenzuese, të konfirmuar zyrtarisht nga nëpunësi autorizuesò, dhe Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, me shkresën nr. 3116, prot datë 18.2.2021 është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë një kërkesë për bashkëpunim nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT, ku është kërkuar bashkëpunim për mos raportimin mujor por 6 mujor të detyrimeve për shkak se :*

-Detyrimet e prapambetura të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të administratës duhet të përditësohen çdo muaj për paga të pa marra për rreth 200 punonjës;

-Detyrimet e prapambetura nga shtypshkronja e letrave me vlerë janë rreth 70 fatura;

-Detyrimi që gjenerohet çdo muaj është i papërfillshëm në raport me punën e bërë si nga ana e DPT ashtu edhe nga Dega e Thesarit Tiranë e cila përveç se operon ush për DPT, ngarkohet dhe me rreth 250 urdhra regjistrimi për detyrimet e prapambetura çdo muaj.

Në vijim të kësaj shkrese rezulton se nuk ka patur një kthim përgjigje nga MFE. Raportimet e kryera nga DPT pranë MFE për detyrimet e prapambetura paraqiten si më poshtë:

- Urdhër regjistrimi për detyrimet e prapambetura nr. 206, date 30.06.2021;

-Shkresa nr. 20040, prot datë 5.11.2021 është dërguar nga DPT për konfirmimin e detyrimeve të prapambetura për 10 mujorin 2021;

-Shkresa nr. 1483/1, prot datë 31.01.2022 për konfirmimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, ku këto detyrime paraqiten në vlerën 950,864,110 lekë, konfirmuar edhe nga vlera neto e llogarisë 486 ò shpenzime të periudhave të ardhshmeò në pasqyrat financiare të DPT. Në vijim, edhe me ndryshimet në aktet rregullative ky raportim lidhur me detyrimet e prapambetura do të gjenerohet automatikisht nga sistemi. Për sa i përket raportimit të stokut të rimbursimit të TVSH-së për ato pagesa të cilat nuk kanë mundur të procesohen në fund të vitit 2021, por kanë kaluar procedurat respektive të kontrollit dhe verifikimit nga ana e DPT-së, këto shuma nuk raportohen në totalin e detyrimeve të prapambetura, por në situacionin e muajit Dhjetor të dorëzuar në Degën e Thesarit ato janë raportuar në vlerën 24,100,603 lekë në kolonën me emërtimin òrimbursimeò. Për sa i përket detyrimit prej 91,954

mijë lekë që DPT ka për likuidimin e shtypshkrimeve të ndryshme, të cilat i përkasin jo vetëm vitit 2021, por edhe më parë, objekt likuidimi nga fondet e të ardhurave dytësore, të cilat sigurohen nga shitja e këtyre shtypshkrimeve, një problematikë e hershme e DPT shoqëruar me kosto financiare për buxhetin e shtetit.

Për sa i përket planifikimit të kryer përgjatë vitit 2021, për efekt të hartimit të kërkesave buxhetore të DPT për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 faza e parë është përcjellë nga DPT pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 9241, prot datë 27.05.2021, dhe për fazën e dytë, me shkresën nr. 15927, prot datë 31.08.2021.

### **Procesi i inventarizimit të aktiveve në administratën e DPT**

-Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021 **nuk është kryer** procesi i inventarizimit të aktiveve, në kundërshtim me nenet 8-22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 oPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar dhe në kundërshtim me pikën 15 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, i cili në pikën 1 të tij përcakton se “ Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji duhet të kontrollojnë të paktën 1 herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Në kushtet kur procesi i inventarizimit nuk është kryer, grupi i auditimit nuk mundi të kryente një krahasim me qëllim identifikimin e diferencave të mundshme mes shumave të vlerave të llogarive të aktiveve të raportuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerave të këtyre aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare.

- Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se edhe procesi i inventarizimit të aktiveve kryer një vit më parë është një proces i ndjekur për inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020, pra jo për të gjithë periudhën raportuese për efekt të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2020, duke rezultuar kështu në kundërshtim me pikën 15 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, i cili në pikën 2 të tij përcakton se oOrgani i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe të detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të aktivitetit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare”.

-Për sa i përket procesit të ndjekur për aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi, sipas pikës 95 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar ku citohet se: “ Është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale; pikës 96 ku citohet oProcesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit, në vijim të raportit përfundimtar mbi inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020, ky proces ka inicuar por konstatohet se deri në këto momente ende nuk është finalizuar.

Në referim të shkresës së komisionit të inventarizimit nr. 1402, datë 25.01.2021 për raportin informues mbi verifikimin e gjendjes fizike të vlerave materiale në magazinë dhe zyrave të DPT-së deri në datën



30.11.2020, me shkresën nr. 6927, prot datë 14.04.2021 Drejtori i Përgjithshëm i DPT, znj. D. I. ka urdhëruar ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e DPT-së, me përbërje:

Znj. D. Ç., Kryetar- Drejtorja e Buxhetit dhe Financës

Z. G. S., Anëtar- Drejtorja TIK

Z. J. Sh., Anëtar- Drejtorja Teknike dhe Ligjore

Z. A. K., Anëtar- Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse

Z. O. Xh., Anëtar- Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse

Pikat 9 dhe 10 të urdhrin kanë përcaktuar se komisioni në përfundim të vlerësimit duhet të përgatisë materialin për nxjerrje jashtë përdorimi të vlerave materiale në magazinë, dhe raporti informues do të paraqitet brenda datës 16.04.2021.

Në vijim ka patur një sërë korrespondencash shkresore mes anëtareve të Komisionit të Vlerësimit, duke reflektuar një sërë problematikash lidhur me vështirësitë e hasura për shkak se punonjësit kanë qenë më lejet e zakonshme; Kryetarja e Komisionit ka realizuar observacion mbi urdhrin e titullarit dhe për këtë ka patur një sërë komunikimesh me departamentin juridik, nëse do të vijojë punën pjesa tjetër e komisionit, ku sipas zv. Drejtorit të Përgjithshëm (z. K. Sh.) është përcaktuar se për sa kohë një nga anëtarët e grupit ka ndjekur procedurat ligjore për të kundërshtuar urdhrin e titullarit, pjesa tjetër e grupit nuk duhet të cënohet nga vijueshmëria e punës në kuadër të këtij komisioni. Vonesa të tjera në punën e grupit janë lidhur me faktin se një anëtar i komisionit si IT ka qenë i angazhuar me Help Desk-un e Fiskalizimit; ka patur një kërkesë të komisionit për një ekspert të licencuar për fushën e marangoz/mobilierisë për të bërë vlerësimin e riparimit në vlerë monetare; etj. Për këto arsye, me shkresën nr. 6927/15 prot., datë 9.9.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm është kryer një ndryshim në urdhrin nr. 6927, prot., datë 14.04.2021, duke përcaktuar si afat për përgatitjen e raportit informues datën 15.09.2021. Komisioni i vlerësimit ka përgatitur relacionin e vlerësimit (i pa firmosur nga kryetarja e komisionit por vetëm nga 4 anëtarët e tjerë), ku janë vlerësuar se:

-78 artikuj propozohen për nxjerrje jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material mbeturinë apo asgjësim me vlerë të mbetur 167,129.23 lekë; dhe 1 artikull në vlerë 12,134.4 lekë propozohet të ndiqen rekomandimet e ekspertit.

-Për artikuj elektronik janë 113 artikuj të propozuar për nxjerrje përfundimtare jashtë përdorimi me vlerë të mbetur prej 972,419.11 lekë; 16 artikuj të kësaj natyre me vlerë 119,673.12 lekë mund të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit me vlerë të riparimit prej 440,629 lekë. 6 artikuj me vlerë 5,787 lekë janë në gjendje të mirë po të panevojshëm për njësinë dhe janë propozuar të vijohet sipas pikave 107 dhe 108 të udhëzimit. Në gjendje pune për njësinë kanë rezultuar 139 artikuj me vlerë të mbetur 119,673.13 lekë.

Për shkak të vakumit të krijuar nga emërimi i Titullarit të institucionit në pozicionin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, miratimi për procesverbalin e vlerësimit dhe relacionin e vlerësimit është marrë nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 6127/18, prot., datë 11.10.2021. Më pas, Drejtori i Përgjithshëm, z. C. K., ka ngritur urdhrin për ngritjen e Komisionit të Asgjësimit të Materialeve në Magazinën e DPT me shkresën nr. 6927/20, prot., datë 12.11.2021, duke përcaktuar se brenda afatit 1 muaj ky komision do të hartojë procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, me përbërje:

-Znj. S. M., Kryetare- Drejtorja Teknike dhe Ligjore,

-Znj. R. D., anëtar- Drejtorja e Shërbimit Tatimpagues,

-Znj. A. D., anëtar- Drejtorja për Proceset e Biznesit,

-Znj. G. H., anëtar- Drejtorja për Shërbimet Mbështetëse.

-z. F. O., anëtar- Drejtorja për Proceset e Biznesit,

Pas një sërë komunikimesh shkresore, Komisioni i Asgjësimit të Materialeve ka përcjellë një memo për Drejtorin e Përgjithshëm me shkresën nr. 9927/25, prot., datë 10.12.2021, duke informuar mbi procesin

e ndjekur dhe problematikat e hasura, dhe duke kërkuar një shtyrje të afatit për përfundimin e procesit me dy javë, për sa kohë pritet përgjigja nga Kompania Administruese e Mbetjeve në Landfillin e Sharrës. Deri në përfundimin e fazës së auditimit në terren, ky proces nuk ka përfunduar ende, dhe nuk ka patur një urdhër të dytë nga titullari për shtyrjen e këtij afati.

- Për sa i përket konkluzioneve të komisionit të inventarizimit për vitin paraardhës lidhur me mos kryerjen e inventarizimit të disa aktiveve që janë në ngarkim të personave të cilët nuk kanë qenë prezent për arsye të ndryshme (Covid 19 etj), për të cilat komisioni ka konstatuar se nuk arriti të kryej verifikim fizik të materialeve në magazinë M14 Program , pasi nuk gjenden dhe vlera e këtyre programeve është 423,460 lekë dhe përbëhet nga tre programe; si dhe se disa ish punonjës të cilët janë larguar si pasojë e shkëputjes nga puna në DPT, rezultojnë ende me materiale në ngarkim (në vlerë 773,103 lekë) në kundërshtim me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 13 dhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 òPër pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, në vijim të informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit lidhur me ecurinë e këtij procesi u konstatua se nuk ka patur një urdhër të titullarit për sistemimin e situatës dhe marrjen e masave respektive.

- Nga auditimi konstatohet se edhe përgjatë vitit 2021 në zbatim të VKM nr. 673 ,datë 22.11.2017 për òRiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës të kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Ndër problematikat e diskutuara në takimin e zhvilluar mes dy institucioneve janë evidentuar domosdoshmëria për regjistrimin e të gjitha databazave të DPT-së si databaza shtetërore si parakusht për kalimit kapital të këtyre aseteve për llogari të AKSHI-t; verifikimi i aseteve që nuk përdoren më. Nga ana e përfaqësuesve të dy institucioneve është renë dakord që pjesë e kalimit të kapitalit do të jetë vetëm pjesa e implementimit të sistemit të fiskalizimit; pamundësia për marrjen në dorëzim për disa nga sistemet Nexus, Harta dizhitale, BI, etj; diskutimi nëse do të jenë objekt kalimi kapital disa nga asete që nuk përdoren më, si psh rasti i Nexus (kasat), i cili pas hyrjes në fuqi të ligjit për fiskalizimin nuk do të jetë më funksional nga ana teknike, por i përdorshëm për arkivë.

Mbi procedurën e **inventarizimit të Drejtorive Rajonale Tatimore**, sipas informacionit në dispozicion rezulton se DRT Korçë ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr. 9141/1, prot., datë 20.12.2021; DRT Shkodër ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr. 7712/1 prot., datë 24.12.2021; DRT Gjirokastër ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr.19/1, prot., datë 25.02.2022; DRT Sarandë ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr.3481/1, prot., datë 30.12.2021; DRT Berat ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr.2251/2, prot., datë 30.12.2021; DRT Fier ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr.17001/1, prot., datë 28.01.2022; DRT VIP ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr. 10244/2, prot., datë 18.02.2022; DRT Vlorë ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr. 2521, prot., datë 09.03.2022; DRT Lezhë ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës pa nr, datë 31.12.2022; DRT Elbasan ka përfunduar procesin e inventarizimit sipas shkresës nr.8358/1, prot., datë 15.12.2021. Konstatohet se nuk kanë përfunduar procedurën e inventarizimit DRT Durrës, Tiranë dhe Dibër

### **C. Mbi hartimin e pasqyrave financiare**

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Ligji organik i buxhetit nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 25, datë 13.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshme, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020 òPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme;
- Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 òPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021.

**I. Pasqyrat Financiare të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve** janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 4964, prot., datë 29.0.2022, prot në Degën e Thesarit me nr. 2223, prot., datë 30.03.2022, në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshme. Të gjitha pasqyrat financiare janë të firmosura nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi autorizues, përkatësisht znj. D. Ç. dhe z. C. K.

Pasqyrat financiare të aparatit të DPT-së përmbajnë të gjitha pasqyrat që përcaktohen në pikën 25 dhe 26 të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, konkretisht nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Pasqyra e performancës financiare;
- Pasqyra e flukseve monetare;
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Shënimet shpjeguese, si dhe pasqyrat statistikore;
- Pasqyrat e investimeve dhe burimit të financimit të tyre;
- Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe të ardhurave të rakorduara me degën e Thesarit.

Në zbatim të ligjit të buxhetit, evidentimi i veprimtarisë financiare, mbajtja e kontabilitetit dhe konsolidimi i llogarive vjetore, realizohet në 15 njësitë e sistemit tatimor, 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku administrimi i llogarive të shpenzimeve administrative të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është detyrë funksionale e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Gjendja e llogarive të aktiveve të Aparatit të DPT-së, për vitin 2021, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr. 11*

*Në lekë*

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi Paraardhës 2020	Diferenca 2021-2020
A	<b>A K T I V E T</b>	<b>2,324,208,417</b>	<b>3,120,623,621</b>	<b>-796,415,204</b>
	<b>I.Aktivitet Afat shkurtër</b>	<b>1,183,524,101</b>	<b>1,716,276,925</b>	<b>-532,752,824</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>8,566,397</b>	<b>11,196,327</b>	<b>-2,629,930</b>
520	Disponibilitete ne Thesar	8,566,397	11,196,327	-2,629,930
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>51,401,026</b>	<b>57,842,631</b>	<b>-6,441,605</b>
31	Materiale	47,050,318	52,209,984	-5,159,666
32	Inventar I imët	68,938	75,238	-6,300
35	Mallra	4,281,770	5,557,409	-1,275,639
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>172,692,568</b>	<b>146,617,084</b>	<b>26,075,484</b>
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	769,485	769,485	0
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	171,923,083	145,847,599	26,075,484
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>950,864,110</b>	<b>1,500,620,883</b>	<b>-549,756,773</b>
486	Shpenzime te perudhave te ardhshme	950,864,110	1,500,620,883	-549,756,773
	<b>II.Aktivitet Afat gjatë</b>	<b>1,140,684,316</b>	<b>1,279,299,873</b>	<b>-138,615,557</b>
20	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>26,101,460</b>	<b>30,707,600</b>	<b>-4,606,140</b>
202	Studime dhe kërkime	26,101,460	30,707,600	-4,606,140
21	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,114,582,856</b>	<b>1,248,592,273</b>	<b>-134,009,417</b>
212	Ndërtesa e Konstruksione	107,322,423	112,970,971	-5,648,549
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	883,180,930	1,004,075,118	-120,894,187
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	86,301,756	82,975,312	3,326,444
215	Mjete Transporti	13,927,316	16,006,836	-2,079,520
218	Inventar ekonomik	23,850,432	32,564,036	-8,713,604
	<b>4.Investime</b>	<b>0</b>	<b>125,046,823</b>	<b>-125,046,823</b>
231	Per Aktive Afatgjata materiale	0	125,046,823	-125,046,823

Burimi: DPT

**Totali i Aktivitet** për vitin 2021 është 2,324,208,417 lekë, ku krahasuar me vitin paraardhës rezulton me pakësim në vlerën 796,415,204 lekë. Aktivitet Afatshkurtra paraqiten në shumën 1,183,524,101 lekë, duke zënë rreth 50.92% të totalit të aktiveve, me një pakësim prej 532,752,824 lekë krahasuar me vitin 2020, ndërsa Aktivitet Afatgjatë paraqiten në shumën 1,140,684,316 lekë, duke zënë rreth 49.08% të totalit të Aktivitet, me një pakësim prej 138,615,557 lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto) gjatë vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 12

Në lekë

E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
<b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>	<b>30,707,600</b>	<b>0</b>	<b>30,707,600</b>	<b>0</b>	<b>4,606,140</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>30,707,600</b>	<b>4,606,140</b>	<b>26,101,460</b>
Studime dhe kërkime	30,707,600		30,707,600		4,606,140			30,707,600	4,606,140	26,101,460
<b>II. AAGJ/ MATERIALE</b>	<b>1,878,281,286</b>	<b>629,689,012</b>	<b>1,248,592,273</b>	<b>188,839,822</b>	<b>290,840,910</b>	<b>42,608,856</b>	<b>10,600,527</b>	<b>2,024,512,252</b>	<b>909,929,395</b>	<b>1,114,582,856</b>
Ndërtime e Konstruksione	144,572,338	31,601,366	112,970,972		5,648,549			144,572,338	37,249,915	107,322,423
Rruge, rrjete, vepra ujore	1,273,065,259	268,990,141	1,004,075,118	130,991,527	251,839,715	46,000		1,404,010,786	520,829,856	883,180,930
Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	202,088,046	119,112,734	82,975,312	49,197,780	16,595,062	33,774,732	4,498,458	217,511,094	131,209,338	86,301,756
Mjete transporti	96,487,579	80,480,743	16,006,836	8,650,515	9,689,253	5,102,269	4,061,487	100,035,825	86,108,509	13,927,316
Inventar ekonomik	162,068,064	129,504,028	32,564,036		7,068,331	3,685,855	2,040,582	158,382,209	134,531,777	23,850,432
<b>T O T A L I ( I + II )</b>	<b>1,908,988,886</b>	<b>629,689,012</b>	<b>1,279,299,873</b>	<b>188,839,822</b>	<b>295,447,050</b>	<b>42,608,856</b>	<b>10,600,527</b>	<b>2,055,219,852</b>	<b>914,535,535</b>	<b>1,140,684,316</b>

Burimi: DPT

Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik për aktivitet afatgjatë jo materiale dhe materiale në përputhje me normat e amortizimit në pikën 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme "Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjatë, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve është llogaritur të sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”.

**Aktivitet Afatshkurtra** paraqiten në shumën 1,183,524,101 lekë dhe përbëhen nga:

Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre përfaqësojnë vlerën neto të llogarisë 520 disponibilitete në Thesarë, e cila rezulton të jetë në shumën 8,566,397 lekë, me një pakësim prej 2,629,930 lekë krahasuar me një vit më parë për shkak të likuidimit të një pagese 5% e garancisë së mjeteve në ruajtje në këtë vlerë, e cila rakordon në pasiv me llog 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje. Kjo vlerë është e mbartur nga vitet e kaluara dhe nuk ka dokumentacion për të justifikuar historikun e krijimit të saj.

Gjendje Inventari qarkullues përfaqëson vlerën totale të llogarive 31 *Materiale* (47,050,318 lekë), 32 *Inventar i imët* (68,938 lekë) dhe 35 *Mallra* (4,281,770 lekë) në vlerën totale prej 51,401,026 lekë ose 6,441,605 lekë më pak se një vit më parë, ku pjesën më të madhe të këtij zëri e zë llog 31 *Materiale* e cila përbëhet nga materialet kancelarie dhe të përdorimit të zyrës për punën e përditshme (Lapsa, Stilolapsa, Toner, Letër A4 etj, Shtypshkrime ( Proces-Verbale, Akt-Konstatime, Fatura Tatimore, Fatura të Thjeshta, Fletë Shoqërimi etj), Karburant, Vula të ndryshme.

**Aktivitet Afatgjata** paraqiten në shumën 1,140,684,316 lekë dhe përbëhen nga:

Aktive Afatgjata jo materiale përfaqësojnë vlerën neto të aktiveve afatgjata jo materiale të cilat rezultojnë të jenë në shumën 26,101,460 lekë, me një pakësim prej 4,606,140 lekë krahasuar me një vit më parë për shkak të amortizimit. Kjo llogari përfaqëson kontributin vjetor Fiscalis 2020 apo shpenzime për trajnime në zbatim të ligjit nr. 1/2015, datë 29.01.2015 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen në programin e unionit Fiscalis 2020.

- Aktivitet Afatgjata Materiale përfaqësojnë vlerën neto të aktiveve afatgjata materiale në shumën 1,114,582,856 lekë, e cila vjen si rezultat i zbritjes së amortizimit të këtyre aktiveve në shumën prej 909,929,395 lekë nga kosto historike e tyre prej 2,024,512,252 lekë. Të detajuara sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

Llogaria 212 “*Ndërtim dhe konstruksione*” në vlerën 107,322,423 lekë përfaqëson vlerën e ndërtesës së Aparatit të DPT dhe rezulton me ulje krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 5,648,549 lekë, si rezultat i amortizimit ku norma e amortizimit të aplikuar është 5% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018. Kjo vlerë nuk është mundur të rakordohet me vlerën e inventarizimit të aktiveve për shkak të mos kryerjes së këtij procesi për vitin 2021.

Tabela nr. 13

Në lekë

EMERTIMI	Vlera	Amortizimi akumuluar	Vlera mbetur 31/12/2021
Ndërtesa 123260639	89,368,285.00	27,374,921.05	61,993,363.95
Rikonstruksion ndërtesë 15/12/2016 3637947	3,637,947.00	706,007.28	2,931,939.72
Rikonstruksion DPT tarrace, fasade 31.12.2018 14,549,091	14,549,091.00	2,075,064.10	12,474,026.90
Rikonstruksion DPT vendosje sistemi i kondicionimit 31.12.2018 23,790,788	23,790,788.00	3,393,161.14	20,397,626.86
Muri Rrethues 2007 12925030	13,226,230.00	3,700,765.29	9,525,464.71
<b>Shuma 212</b>	<b>144,572,341.00</b>	<b>37,249,918.85</b>	<b>107,322,422.15</b>

Burimi:DPT

Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujoreë në vlerën 883,180,930 lekë përfaqëson vlerën e programe, softë, licenca informatike së Aparatit të DPT-së dhe rezulton me ulje krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 120,894,187 lekë, si rezultat i përlllogaritjes së amortizimit në vlerën 251,839,714.36 lekë dhe janë bere hyrje 130.991.527 leke investime dhe dalje 46.000 leke, dhëne për DRT Kukës. Për aktivet e llogarisë 213 është aplikuar norma e amortizimit 25%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 86,301,756 lekë përfaqëson vlerën e motogeneratorë, server, HP storage, hard are, kondicionerë, etj informatike të Aparatit të DPT dhe rezulton me rritje krahasuar me vitin e mëparshëm në shumën 3,326,444 lekë si rezultat i shtimit të aseteve të mëposhtme (licenca IT):

Tabela nr. 14

Në lekë

Emërtimi	Vlera
FIREËALL 9413034	18,826,068.00
LICENCE AKSESI 71166	996,324.00
PATCH CORDA 05M 354	99,120.00

Burimi:DPT

Gjithashtu, rritja ka ardhur dhe si rezultat i përlllogaritjes së amortizimit për vitin 2021 në vlerën 16,595,062.35 lekë, ku efekti total është pikërisht kjo diferencë (+) . Janë bere hyrje 49.197 780 leke, janë bere dalje dhënë DRT 33.774.732, per këto artikuj amortizimi ne pakësim 4.498.458 leke. Për aktivet e llogarisë 214 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Llogaria 215 òMjete Transportiö në vlerën 13,927,316 lekë e cila rezulton me rënie krahasuar me vitin 2020 prej 2,079,520 lekë, si rezultat i aplikimit të amortizimit për vitin 2021 në vlerën 5,627,766.42 lekë, hyrjes së 3 makinave nga MFE në shumën 8.650.515 lekë, dhe daljes në shumën 5.102.269 lekë. Për aktivet e llogarisë 215 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Tabela nr. 15

Në lekë

Automjeti	Cope	Vlera	Amortizimi	Vlera e mbetur
Autoveture opel Frontera 3084300	1.00	3,084,300.00	3,084,300.00	-
Autoveture Foristrade 3385235	2.00	6,770,470.00	6,770,470.00	-
Autoveture `Bora` 2500000	1.00	2,500,000.00	2,500,000.00	-
Autovetura tip Volksägen Touareg Tr 0213 N 4400000 Viti 2007	1.00	4,400,000.00	4,400,000.00	-
Autovetura Mitsubishi,V80 (PAJERO)3200 cc 4284000	5.00	21,420,000.00	20,563,200.00	856,800.00
Autovetore NISAN Terrane viti 1999 ndin CAFAO 2145012	1.00	2,490,878.00	2,391,242.88	99,635.12
Autoveture Santa Fe 2868000 v.11/09	1.00	2,868,000.00	2,753,280.00	114,720.00
Automjet AA693LA Volsvagen nr sh ÈV1ZZZ7HZFH089726 2015	1.00	3,187,094.00	3,187,094.00	-
Autovetute Peugeot 308AA368LK Nr Sh VF3LB9HPAFS037494 (2015)	1.00	1,923,208.00	1,923,208.00	-
Autoveture Peugeot 308 AA 827LH Nr Sh VF3LB9HPAFS039559 (2015)	1.00	1,923,208.00	1,094,499.55	828,708.45
Automjet Toyota Rav 4 viti 2016 5102269	8.00	40,818,152.00	30,953,328.88	9,864,823.12
AUTOMJET SCODA 4804099	1.00	4,804,099.00	3,603,074.25	1,201,024.75
AUTOVETURE PEUGEOT 308 AA196LI NR SH VF3LB9HPAFS032716 (2015)	1.00	1,923,208.00	1,442,406.00	480,802.00
AUTOVETURE PEUGEOT 308 AA142LK NR SH VF3LB9HPAFS037494 (2015)	1.00	1,923,208.00	1,442,406.00	480,802.00
<b>Shuma 215</b>		<b>100,035,825.00</b>	<b>86,108,509.56</b>	<b>13,927,315.44</b>

Burimi:DPT

Llogaria 218 òInventar ekonomikö në vlerën 23,850,432 lekë rezulton me rënie krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 8,713,604 lekë, si rezultat i aplikimit të amortizimit në vlerën 5.027.749 lekë dhe daljeve për DRT në shumën 3.685.855 lekë . Për aktivet e llogarisë 218 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

-Investimet përbëhen nga ÷Aktive Afatgjata materiale÷ të cilat këtë vit janë 0, krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 125,046,823 lekë, për shkak të berjes hyrje të investimit i cili u likuidua në vitin 2021.

Gjendja e llogarisë të pasivit të Aparatit të DPT-së, për vitin 2021, krahasuar me vitin paraardhës dhe fondi i konsoliduar paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 16

Në lekë

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi Paraardhës 2020	Diferenca 2021-2020
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>1,132,123,077</b>	<b>1,658,433,994</b>	<b>-526,310,917</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtër</b>	<b>1,132,123,077</b>	<b>1,658,433,994</b>	<b>-526,310,917</b>
	<b>I. Llogari te Pagueshme</b>	<b>1,132,123,077</b>	<b>1,658,434,294</b>	<b>-526,311,217</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	79,107,632	122,640,727	-43,533,095
42	Detyrime ndaj personelit	16,890,594	16,076,626	813,968
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	2,653,531	1,631,865	1,021,666
435	Sigurime Shoqërore	5,140,649	4,824,738	315,911
436	Sigurime Shëndetësore	713,291	673,643	39,648
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	8,566,398	11,196,327	-2,629,929
467	Kreditore te ndryshëm	1,018,281,497	1,500,620,883	-482,339,386
4341	Operacione me shtetin( detyrime)	769,485	769,485	0

Burimi:DPT

#### -Llogari të Arkëtueshme

Llogaria 423,429 ÷Personeli, paradhënie, deficite, gjoba÷ e aktivitet paraqitet në shumën 769,485 lekë dhe rakordon në pasiv me llogarinë 4341 ÷Operacione me shtetin (detyrime)÷, e cila përbëhet nga: llog 423: Debitorë të vjetër në vlera monetare/materiale (O. S., S. J., M. S.); llog 429: Debitorë të vjetër sipas urdhër zhdëmtimeve për mjetet në ngarkim (J. Sh.), etj.

Llogaria 4342 ÷Operacione me shtetin (të drejta)÷ në shumën 171,923,083 lekë, përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të Dhjetorit 2021, e cila së bashku me llog 4342 në shumën 283,884,510 lekë (totali 1,122,787,193 lekë), kuadrojnë me llog:

- Llogaria 401-408 ÷Furnitorë e llogari te lidhura me to÷ në vlerën 79,107,632 lekë;
- Llogaria 42 ÷Detyrime ndaj personelit÷ në vlerën 16,890,594 lekë,
- Llogaria 431 ÷Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa÷ në vlerën 2,653,531 lekë,
- Llogaria 435 “Detyrime për sigurime shoqërore÷ në vlerën 5,140,649 lekë,
- Llogaria 436 ÷Detyrime për sigurime shëndetësore÷ në vlerën 713,291 lekë dhe llog 467 në vlerën 1,018,281,497 lekë.

Sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)÷ është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike te tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë: a) Gjate konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

- Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;
- Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

- Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;
- Kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

Tabela nr. 17

Në lekë

Llogaria	Vlera
----------	-------

Llog 486	950,864,110
Llog 4342	171,923,083
<b>Total</b>	<b>1,122,787,193</b>
Llog 401	79,107,632,000
Llog 421	16,890,594,000
Llog 431	2,653,531
Llog 435	5,140,649
Llog 436	713,291
Llog 438	
Llog 467	1,018,281,497
<b>Total</b>	<b>1,122,787,193</b>

Burimi: Përpunuar sipas të dhënave të DPT

- Të tjera aktive afatshkurtra përfaqëson vlerën neto të llogarisë 486 ÷ Shpenzime te periudhave te ardhshmeö, e cila paraqitet në shumën prej 950,864,110 lekë me përbërjen si vijon:

Tabela nr. 18

Në lekë

Detyrimi	Vlera e detyrimit
F. K. C. F.	581,859,444
B. P. A.	66,393,943
P. C.	12,918,313
I. & C. D.	41,340,000.00
A.	40,142,484.00
Gjyqfituesit	116,255,623
Bileta transporti dhe shtypshkrime	91,954,304
<b>Totali</b>	<b>950,864,111</b>

Burimi: Përpunuar sipas të dhënave të DPT

Në pikën 42 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö, përcaktohet se të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore zërin e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, për të cilat do të përdoret llogaria 486 ÷ Shpenzime për periudhat e ardhshmeö, në varësi të natyrës së tyre. Vlera e detyrimeve të prapambetura rezulton me rënie krahasuar me vitin paraardhës, ku këto detyrimet paraqiteshin në shumën rreth 1,500 milion lekë. Konstatohet se kjo llogari nuk rakordon me vlerën e llogarisë 467 ÷ Kreditorë të ndryshëmö, e cila rezulton në vlerën 1,018,281,497 lekë, pasi në këtë vlerë përveç shumës prej 950,864,111 lekë të llog 486 janë raportuar veçmas edhe 67,417,386 lekë janë shpenzime për shërbime të vitit 2021.

Tabela nr. 19

Në lekë

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi Paraardhës 2020	Diferenca 2021-2020
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,192,085,340</b>	<b>1,462,189,627</b>	<b>-270,104,287</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,192,085,340</b>	<b>1,462,189,627</b>	<b>-270,104,287</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,198,526,945	1,466,270,188	-267,743,243
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	-6,441,605	-4,080,561	-2,361,044
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>2,324,208,417</b>	<b>3,120,623,621</b>	<b>-796,415,204</b>

Burimi: DPT

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore paraqitet në vlerën -6,441,605 lekë.

### Pasqyra e performancës financiare viti 2021:

Tabela nr. 20

Në lekë

Llog	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi Paraardhës 2020
<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>2,554,143,052</b>	<b>14,049,707,970</b>
<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>2,554,143,052</b>	<b>14,049,707,970</b>
<b>720</b>	<b>1.Grant korrent i Brendshëm</b>	<b>2,554,143,052</b>	<b>14,049,707,970</b>
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	1,587,592,169	12,759,502,491
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	794,627,800	969,249,932



7206	Financim I pritshëm nga buxheti	171,923,083	320,955,547
<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>2,560,584,657</b>	<b>14,053,788,531</b>
<b>600</b>	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>259,323,349</b>	<b>223,418,719</b>
6001	Paga, personel I përhershëm	259,323,349	209,787,786
6002	Paga personel I Përkohshëm		13,630,933
<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>42,886,664</b>	<b>36,658,372</b>
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	42,886,664	36,658,372
<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>1,002,504,812</b>	<b>786,388,959</b>
602	Mallra dhe shërbime te tjera	1,002,504,812	786,388,959
	<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>1,255,869,832</b>	<b>13,003,241,920</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>794,375,798</b>	<b>705,480,000</b>
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	794,375,798	
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		705,480,000
<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashtë</b>	<b>2,226,722</b>	<b>3,132,000</b>
6051	Transferime Per Organizatat Ndërkombëtare	2,226,722	3,132,000
<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individë</b>	<b>459,267,312</b>	<b>12,294,629,920</b>
6061	Transferita Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	459,267,312	12,294,629,920
<b>63</b>	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>6,441,605</b>	<b>4,080,561</b>
<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHES</b>	<b>-6,441,605</b>	<b>-4,080,561</b>
	<b>(Rezultati I Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)</b>		

Burimi:DPT

Llogaria 7200 òGrante korrente nga Buxheti Qendrorò është pasqyruar në vlerën 1,587,592,169 lekë.

Llogaria 7206 "Financimi i pritshëm nga buxheti" është paraqitur si kundërpadi e llogarisë 4342 òOperacione me shtetinò në vlerën 171,923,083 lekë si një detyrim që shteti ka kundrejt institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Llogaria 7205 òFinancim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemitò, përbëhet nga shuma e përdorur nga te ardhurat per shpenzime, shuma 794,627,800 leke e cila është bere rritje e autorizuar nga te ardhurat e vitit 2021 në shumën 815,335,679 lekë, dhe diferenca (815,335,679-794,627,800=20,707,879 leke, janë derdhur në buxhet të shtetit).

Nga auditimi i shpenzimeve të pasqyruara në PASH ka rezultuar se në llogaritë 600, 601 dhe 602 janë pasqyruar shpenzimet buxhetore për llogaritë përkatëse në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, duke pasqyruar shpenzimet e vitit 2021 ó shpenzimet e vitit 2020 + shpenzimet e vitit 2021 të cilat do të likuidohen në 2022.

Tabela nr. 21

Në lekë

Llog	viti 2021	viti 2020	viti 2022
600	257.345.988	-17.566.764	19.544.125
601	42.678.832	-5.498.381	5.492.381
602	823.927.315	-122.640.727	301.218.224

Burimi:DPT

## Pasqyra e Flukseve Monetare(Cash Flow)

Tabela nr. 22

Në lekë

EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi Paraardhës 2020
<b>VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT</b>	<b>125,961,760</b>	<b>540,234,817</b>
<b>Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)</b>	<b>1,695,475,980</b>	<b>13,587,806,595</b>
<b>Arkëtime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor</b>	<b>949,537,678</b>	<b>1,002,136,192</b>
Te hyra nga ardhurat jo tatimore (+)	815,335,679	1,002,136,192
Te tjera, arkëtuar(+)	134,201,999.00	
<b>Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente</b>	<b>-2,519,051,898</b>	<b>-14,049,707,970</b>
Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		-320,955,547
Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-1,587,592,169	-12,759,502,491
Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-2,629,930	
Te tjera te paguara (-)	-928,829,799	-969,249,932
<b>VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE</b>	<b>11,071,145</b>	<b>1,484,484</b>
<b>Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)</b>	<b>553,858,088</b>	<b>417,000,000</b>
Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-542,786,943	-415,515,516
<b>TRANSFERTA E TE TJERA</b>	<b>-139,662,835</b>	<b>-541,719,301</b>
Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-20,707,879	-3,795,707
Transferime ne buxhet te Fondeve të pa përdorura(-)	-118,954,956	-508,833,041

Lëvizje e brendshme e transfertave të tjera(+/-)		-29,090,553
<b>Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>-2,629,930</b>	<b>0</b>
<b>Teprica në fillim të vitit ushtrimor</b>	<b>11,196,327</b>	<b>11,196,327</b>
<b>Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor</b>	<b>8,566,397</b>	<b>11,196,327</b>

Burimi: DPT

Në këtë pasqyrë janë pasqyruar fonde buxhetore të akorduara për shpenzime korrente të vitit 2021, shpenzimet e vitit ushtrimor, fondet buxhetore të akorduara për investime dhe shpenzimet e investimeve. Teprica e likuiditetit në fund të vitit ushtrimor është sa vlera e fondeve disponibilitet në thesar.

Nga auditimi konstatohet se në pasqyrat financiare të DPT vijnë të mos jenë llogaritur provigjone, problematikë e trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 6, ÷Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara, pika nr. 47, si dhe ÷Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 34: ÷Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t'u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelit. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë nëse: - Njësia ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur; - Është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të jetë e nevojshme për të përmbushur detyrimin; si dhe - Mund të bëhet një parashikim i besueshëm mbi vlerën e detyrimit. Referuar detyrimeve të DPT, nevoja e parashikimit të provizioneve lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna (116 milion lekë), detyrime për investime (661 milion lekë) ,detyrime për investime (81 milion lekë), etj.

**II. Pasqyrat financiare të konsoliduara** të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 7540, datë 9.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT (NA) dhe miratuar nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ), jo në përputhje me pikën 120 të Udhëzimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i cili përcakton se këto pasqyra duhet të përfundojë brenda muajit Prill të vitit pasardhës. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të firmosura në çdo faqe nga nëpunësi zbatues, por jo nga nëpunësi autorizues, në kundërshtim me UMFEn nr. 8, datë 09.03.2018.

Këto pasqyra hartohen nga DPT duke përmbledhur informacionin respektiv të pasqyrave financiare të hartuara nga DPT, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës pranë DPT dhe DRT Berat, Durrës, Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Vip. NA dhe NZ i DPT nëpërmjet shkresës nr. 6647, prot datë 22.4.2022 kanë dërguar pranë DPT pasqyrat financiare në nivel shpenzimi për DPT dhe 14 Drejtoritë Rajonale. Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës pranë DPT bazuar në raportet e fund vitit në sistemin C@TS ka hartuar pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara të cilat janë dërguar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës me shkresën nr. 4750/1 prot., datë 27.04.2022, dhe është marrë në dorëzim nga DBF datë 28.04.2022.

Nga auditimi u konstatua se vlera e raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara për periudhën paraardhëse paraqitet me **diferenca** krahasuar me atë të raportuar një vit më parë (pra në pasqyrat e konsoliduara të vitit 2020). Nga verifikimi i kryer analitikisht për pasqyrat financiare të përgatitura nga DRT-të, rezulton se kjo diferencë vjen si pasojë e kryerjes së ndryshimeve pas dorëzimit të pasqyrave financiare nga ana e DRT Lezhë, Gjirokastrë, Durrës, cituar edhe në relacionin e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara. Si rezultat, edhe për pasqyrat e konsoliduara periudha paraardhëse paraqitet me ndryshime.

## Aktivitet e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar

Tabela nr. 23

Në lekë

Referencat e Llogarive	EMERTIMI	Viti 2021	Viti 2020 sipas Pasqyrës financiare të vitit 2021 (periudha paraardhëse)	Viti 2020 sipas raportit paraardhës të KLSH
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>	<b>383,373,521,491</b>	<b>352,945,332,272</b>	
	<b>I.Aktivitet Afat shkurtra</b>	<b>381,617,724,613</b>	<b>350,895,616,515</b>	
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>142,668,723,845</b>	<b>115,477,869,082</b>	
520	Disponibilitete në Thesar	142,668,723,845	115,477,869,082	
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>124,818,291</b>	<b>120,749,218</b>	
31	Materiale	78,088,729	93,909,099	
32	Inventar i imët	5,482,504	4,802,490	
35	Mallra	41,247,058	22,037,629	
	<b>3.Llogari të Arketushme</b>	<b>237,873,318,367</b>	<b>233,796,377,332</b>	<b>233,779,789,633</b>
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	805,141	805,141	805,141
468	Debitorë të ndryshëm	139,091,469,226	132,869,508,503	132,891,465,891
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	98,781,044,000	100,926,063,688	100,887,518,601
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>950,864,110</b>	<b>1,500,620,883</b>	<b>1,500,687,133</b>
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	950,864,110	1,500,620,883	1,500,687,133
	<b>II.Aktivitet Afat gjata</b>	<b>1,755,796,878</b>	<b>1,924,668,934</b>	<b>2,049,256,954</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>26,101,460</b>	<b>30,707,600</b>	<b>30,707,600</b>
202	Studime dhe kërkime	26,101,460	30,707,600	30,707,600
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,729,695,418</b>	<b>1,893,961,334</b>	<b>1,893,502,531</b>
210	Toka, Troje, Terrene	16,194,396	16,194,396	16,194,396
212	Ndërtesa e Konstruksione	554,618,393	583,677,730	583,677,730
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	883,228,516	1,004,117,569	1,004,117,569
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	114,709,319	101,078,126	101,045,195
215	Mjete Transporti	55,217,648	72,734,253	72,500,578
218	Inventar ekonomik	104,964,679	115,240,857	115,048,659
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	762,467	602,500	918,404

Burimi:DPT

**Aktivitet Afat shkurtra** të pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT për vitin 2021 paraqiten në vlerën 381,617,724,613, ku krahasuar me vitin paraardhës rezultojnë me rritje në vlerën 30,722,108,098 lekë. Nga detajimi i këtij zëri rezulton se rritja më e lartë vjen nga Mjetet monetare dhe ekuivalent të tyre e cila përbëhet vetëm nga llog **520 “Disponibilitet në Thesar”** e cila paraqitet në vlerën 142,668,723,845 lekë, me një rritje prej 27,190,854,763 lekë krahasuar me vitin paraardhës. Kjo llogari përbëhet nga:

Tabela nr. 24

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për llog 520 “Disponibilitet në Thesar”	PF
59,803	DRT Fier
142,660,097,645	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës
8,566,397	DPT
<b>142,668,723,845</b>	<b>Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar</b>

Burimi:Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Mbi paraqitjen e Llogarisë 466 -Kreditorë për mjete në ruajtje’ dhe llogarisë 520 -Disponibilitete në thesar’ :

Tabela nr. 25

Në lekë

Llog	DRT fier	kontabiliteti	DPT	total	Diferenca
520	59,803	142,660,097,645	8,566,397	142,668,723,845	
466	-	142,654,830,174	8,566,398	142,663,396,572	<b>5,327,273</b>

Burimi:Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Diferenca në shumën 5,267,471 leke vjen si pasojë e raportimit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës tek llogaria 448; dhe 59,803 lekë që sipas informacionit të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në DPT, DRT Fier nuk i ka garanci dhe si pasojë nuk i ka raportuar në llog 466.

Sipas informacionit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, Llogaria 44 *“Institucione të tjera publike”* në shumën 5,267,471, leke paraqet fonde të alokuara nga DPT për në DRT, të të ardhurave në llogarinë 448 për tatim fitimin e thjeshtuar që DRT nuk ia kanë transferuar ende Njësive Vendore deri në 31.12.2021 dhe janë sipas Pasqyrave Financiare të dërguara nga DRT-të:

Tabela nr. 26

Drejtoria Rajonale Tatimore	Shuma totale 31.12.2021	Nga këto mbetur nga 2020	Shtuar gjate 2021
DR Tatimpaguesit e Mëdhenj Tirane	1,996,552.00	1,996,552.00	-
DRT Tirane			-
DRT Vlore	266,238.00	266,238.00	-
DRT Fier	3,004,681.00	2,712,030.00	292,651.00
<b>Shuma</b>	<b>5,267,471.00</b>	<b>4,974,820.00</b>	<b>292,651.00</b>

Shuma prej 4,974,820, lekë janë fonde të pa transferuara nga DRT të mbetura nga viti 2020. Shuma 292,651 lekë janë fonde të çelura në vitin 2021 dhe që rezultojnë të pa transferuara në 31.12.2021 Njësive Vendore.

**Rubrika Inventari qarkullues** në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar të DPT për vitin 2021 paraqiten në vlerën 124.818.291, ku krahasuar me vitin paraardhës rezultojnë me rritje në vlerën 4,069,073 lekë, përbërë nga:

- Llog 31 *“Materiale”* në vlerën 78,088,729 lekë;
- Llog 32 *“Inventar i imët”* në vlerën 5,482,504 lekë;
- Llog 35 *“Mallra”* në vlerën 41,247,058 lekë.

**Rubrika “Llogaritë e Arkëtueshme”** e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT, paraqiten në shumën 237,873,318,367 lekë ku krahasuar me paraardhës rezulton se janë rritur me vlerën 4,076,941,035 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaria 423, 429 *“Detyrime të personelit për paradhënie e gjoha”* në shumën 805,141 lekë;
- Llogaria 468 *“Debitorë të ndryshëm”* në shumën 139,091,469,226, e cila pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera, brenda dhe jashtë sistemit C@TS. Kjo vlerë përbëhet nga:

Tabela nr. 27

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për 468 “Debitorë të ndryshëm”	PF
263,342	DRT Shkodër
4,323,673	DRT Lezhë
139,086,882,211	Pasqyrat financiare të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës
<b>139,091,469,226</b>	<b>Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Nga auditimi konstatohet se llogaria 468 *“Debitorë të ndryshëm”* (139,091,469,226)+423,429 *“Personeli, paradhënie, deficite, gjoha”* (805,141) nuk kuadron me llog 4341 *“Operacione me shtetin - Detyrime”* (139,089,284,367). Diferenca prej 2.990.000 vjen nga Sektori Pagesave dhe Kontabilitetit ku llog 468 = 139,086,882,211 dhe llog 4341 = 139,083,892,211. Sipas informacionit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikave shuma prej 2,990,000 lekë është raportuar në PF të vitit 2021 në DRT Dibër dhe është trashëguar nga vitet e kaluara me përshkrim otë tjera kërkesa debitorë. Në aktive shuma 2,990,000 lekë është e përfshirë në totalin e llogarisë 468 (139,086,882,211) dhe në pasiv në postin e llogarisë 101 dhe pjesë tjetër në llogarinë 4341 (139,083,892,211). Në bazë të udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme”* pika 17 përcakton se *“Për regjistrimin në kontabilitet të*

operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar ndiqet procedura e mëposhtme: Llogaria 101 e klasës I funksionon si më poshtë:

- kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga:
  - ✓ grantet kapitale për aktivet afatgjata të vlera dhe të kapitalizuara;
  - ✓ grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata;
  - ✓ rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata;
  - ✓ anulimet e detyrimeve për t $\alpha$  paguar
  - ✓ të tjera
- debitohet për pakësimet me fondet bazë që vijnë nga:
  - ✓ shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuara me koston historike të blerjes së tyre;
  - ✓ nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve afatgjata
  - ✓ transferimet e dhurimet e aktivet afatgjata
  - ✓ konsumi i aktiveve afatgjata;
  - ✓ rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe
  - ✓ anulimet e të drejtave për t $\alpha$  arkëtuar;
  - ✓ të tjera.

Si rezultat, vlera 2,990,000 nuk përfshihet në postin e llogarisë 101, por veprimi i saj kontabël duhet të ishte mbyllur ose me llogarinë 4342 ose me llogarinë 467.

Vlera **139,086,882,211 lekë** pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera brenda dhe jashtë sistemit C@TS, nga të cilat detyrimet e pasqyruara në sistemin C@TS janë në vlerën 136,371,921,982 lekë ndërsa detyrimet e kontabilizuara por të mbajtura jashtë sistemit C@TS janë në vlerën 2,714,960,228 lekë.

Peshën me të madhe të llogarisë 468 *ōDebitorë të ndryshëmō*, e zë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 48,523,282,338 lekë, Tatimi mbi Fitimin në vlerën 36,818,060,107 lekë, Taksa e Rrugës në vlerën 11,301,030,900 lekë, Sigurime Shoqërore e Shëndetësore në vlerën 18,579,773,933 lekë.

Gjendja e detyrimeve të pasqyruara në kontabilitetin e DPT në C@TS dhe Jashtë Sistemit në DRT për Tatime, Sigurime e Financa më 31.12.2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 28

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrime të pasqyruara në kontabilitetin e DPT në C@TS dhe Jashtë Sistemit në DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime 31.12.2021	Nga të cilat detyrime që i përkasin vitit 2021	Detyrime para vitit 2021
7000	- Tatim mbi të ardhurat personale	2,163,894,618	327,956,046	1,835,938,572
7001	- Tatim mbi fitimin	36,818,060,107	3,975,142,308	32,842,917,799
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	3,109,585,374	225,536,002	2,884,049,372
7009	- Tjera tatime	5,220,081,759	677,546,073	4,542,535,686
7030	- Tatimi mbi Vlerën eShtuar(TVSH)	48,523,282,338	4,014,152,139	44,509,130,199
7031	- Akciza	2,107,792,556	0	2,107,792,556
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	3,498,233,468	34,431,279	3,463,802,189
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	338,224,706	80,154,584	258,070,122
7050	- Taksa e rrugës	11,301,030,900	9,454,021	11,291,576,879
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	21,982,409	1,585,701	20,396,708
7115	- Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	7,110,793,810	203,639,804	6,907,154,006
75	<b>Sigurime shoqërore e shëndetësore</b>	18,579,773,933	4,406,201,679	14,173,572,254
	<b>Sigurime shoqërore</b>	16,546,409,342	3,748,844,478	12,797,564,864
75021	Kontribute shoqërore të punësuar (punëmarrës)	8,515,093,529	998,364,839	7,516,728,690
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	8,031,315,813	2,750,479,639	5,280,836,174
	<b>Sigurime shëndetësore</b>	2,033,364,591	657,357,201	1,376,007,390

75122	Kontribute shëndetësore të punësuar (punëmarrës)	947,989,697	325,092,393	622,897,304
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	1,085,374,894	332,264,808	753,110,086
	<b>Detyrime per te tjera kontribute</b>	0		
	TE TJERA	3,468,220	0	3,468,220
	SHTYPSHKRIME	861,694	180,464	681,230
	1 % Grante	1,593,423	634,472	958,951
	PULLA (ME ÇMIM BLERJEJE)	288,222,896	212,938,913	75,283,982
	<b>Totali</b>	<b>139,086,882,210</b>	<b>14,169,553,486</b>	<b>124,917,328,725</b>

Burimi: DPT

Për sa i përket gjendjes së debitorëve për vitin 2021 sipas llojit dhe periudhës së krijimit të tyre sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, të ndara në Detyrime gjendje me 31.12.2021 të cilat i përkasin vitit 2021 dhe Detyrime gjendje me 31.12.2021, të cilat janë para vitit 2021, nga Drejtorja e Kontabilitetit dhe Statistikave u vendos në dispozicion informacioni sipas çdo zëri, vetëm pas projektraportit. Më hollësisht detyrimet gjendje në 31.12.2021 që i përkasin vitit 2021 janë 14,169,553,485.56 lekë dhe detyrimet gjendje 31.12.2021 para vitit 2021 janë 124,917,328,724.60 lekë.

Gjendja e detyrimeve me 31.12. 2021 ne DRT, në sistemin C@TS paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 29

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrime gjendje në Sistem me 31.12.2021
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	2,105,952,248
7001	- Tatim mbi fitimin	36,815,287,817
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	3,109,521,624
7009	- Tjera tatime	5,202,524,901
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	48,512,673,225
7031	- Akciza	0
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	3,498,233,468
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	338,224,706
7050	- Taksa e rrugës	11,300,865,900
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	21,982,409
7115	- Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	7,100,680,297
75	<b>Sigurime shoqërore e shëndetësore</b>	18,365,975,387
	<b>Sigurime shoqërore</b>	16,370,627,828
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	8,367,410,834
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	8,003,216,994
	<b>Sigurime shëndetësore</b>	1,995,347,559
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	913,808,666
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	1,081,538,893
	<b>Detyrime per te tjera kontribute</b>	
	TE TJERA	
	SHTYPSHKRIME	0
	1 % Grante	0
	PULLA (ME ÇMIM BLERJEJE)	0
	<b>Totali</b>	<b>136,371,921,982</b>

Burimi: DPT

Gjendja e detyrimeve me 31.12. 2021 në DRT, jashtë sistemit C@TS + Sektori shpenzimeve , krahasimisht me vitin 2020, 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 30

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrimet tatimore gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2018	Detyrimet tatimore gjendje jashtë sistemit C@TS, 31.12.2019	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2020	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2021	Diferenca 2021-2020
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	57,942,360	58,993,901	58,993,901.00	56,844,018	(2,149,883.00)
7001	Tatim mbi fitimin	2,883,175	2,883,175	2,772,290.00	2,772,290	-

7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogël		63,750	63,750.00	63,750	-
7009	Tjera tatime	63,750	17,556,858	17,556,858.00	18,655,210	1,098,352.00
7030	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	17,556,858	10,609,113	10,609,113.00	10,609,113	-
7031	Akciza	10,609,113	2,107,792,556	2,107,792,556.00	2,107,792,556	-
7032	Takse mbi shërbimet specifike (Lojëra fati)	2,231,447,296	0	-	-	-
7033	Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie		0	-	-	-
7050	Taksa e rrugës		331,675	165,000.00	165,000	-
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	331,675	0	-	-	-
7115	Gjoha dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime		10,113,513	10,113,513.00	10,113,513	-
75	<b>Sigurime shoqërore e shëndetësore</b>	<b>10,113,513</b>	<b>217,302,943</b>	<b>217,302,943.00</b>	<b>213,798,546</b>	<b>(3,504,397.00)</b>
	<b>Sigurime shoqërore</b>	217,446,554	178,924,414	<b>178,924,414.00</b>	<b>175,781,514</b>	<b>(3,142,900.00)</b>
75021	Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	179,144,135	142,287,358	148,345,324.00	105,016,303	(43,329,021.00)
75121	Kontribute shoqërore punëdhënës	143,343,056	36,136,855	30,579,090.00	70,765,211	40,186,121.00
	<b>Sigurime shëndetësore</b>	<b>35,801,079</b>	<b>38,378,529</b>	<b>38,378,529.00</b>	<b>38,017,032</b>	<b>(361,497.00)</b>
75122	Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	38,302,419	34,283,457	34,031,663.00	35,524,103	1,492,440.00
75022	Kontribute shëndetësore punëdhënës	34,245,402	4,095,072	4,346,866.00	2,492,929	(1,853,937.00)
	Detyrime per te tjera kontribute	4,057,017	0			-
	Të tjera	60,562,530	60,562,530	60,562,530.00	3,468,220	(57,094,310.00)
	Shtypshkrime	1,257,804	1,125,267	1,144,724.00	861,694	(283,030.50)
	1 % Grante	782,460	795,254	1,273,976.00	1,593,423	319,447.12
	Pulla (me çmim blerje)	434,576,110	307,582,788	321,467,297.00	288,222,896	(33,244,401.46)
	<b>Totali</b>	<b>3,045,573,197</b>	<b>2,795,713,322</b>	<b>2,809,818,452</b>	<b>2,714,960,228</b>	<b>(94,858,223.84)</b>

Burimi: DPT

Për diferencat në detyrimet jashtë sistemit C@TS, sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikave, zërat òTë tjeraò, òShtypshkrime dhe pulla me çmim blerjeò, në shumë totale 292,552,910 lekë raportohen nga Sektorët e Financës në DRT, nuk lidhen me të ardhura tatimore por raportohen gjithmonë jashtë sistemit.

Për pakësimin e zërit 7000, ku sipas tabelës së mësipërme diferenca është 2,149,883 lekë, është vendosur në dispozicion vetëm informacioni për pakësimin e kryer nga DRT Lezhë si e hedhur në sistem, në vlerën 1,051,531 lekë, dhe jo për pjesën tjetër të këtij pakësimi.

Për shtesën e zërit 7009 òtë tjera tatimeò, nuk u vendos informacion në dispozicion.

Për pakësimin e zërit 75 në total 3,504,397 lekë, ndryshimi i gjendjes së vitit 2021 me vitin paraardhës sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikave rezulton:

Tabela nr. 31

DRT	Sig.Shoqërore	Sig Shëndetësore
Elbasan	33,811 (shtesë llogarie interesa)	-
Gjirokastrë	-2,628,277	-285,387
Lezhë	-548,734	-76,110
<b>Totali pakësuar</b>	<b>3,142,900</b>	<b>361,497</b>

Detyrimet jashtë sistemit C@TS paraqiten me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën **4,555,928 lekë (313,021,440 lekë në vitin 2021 vs 317,577,368 lekë në vitin 2020)** për pjesën e të ardhurave tatimore për te cilat janë përgjegjës Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektoret e kontrollit nga zyra. Këto detyrime, sikundër trajtuar edhe në auditimin paraardhës do të

**duhet të ishin hedhur në sistemin C@TS**, pasi për këto detyrime ka module përkatëse në sistem, ndërkohë që për vitin 2021 konstatohet se sistemime rezultojnë të jenë kryer vetëm në zërinë Tatim mbi te ardhurat personale i cili paraqitet me një pakësim në vlerën 2,149,883 lekë, por në zërin 0Të tjera kemi edhe një rritje në vlerën 1,098,352 lekë, ku në total detyrimet për këtë grup paraqiten, si në vijim:

Tatim mbi te ardhurat shuma 56,844,018 lekë;

Tatim fitimi shuma 2,772,290 lekë;

Taksa mbi biznesin e vogël shuma 63,750 lekë;

Te tjera tatime (ne burim) shuma 18,655,210 lekë;

Tatim mbi vlerën e shtuar shuma 10,609,113 lekë;

Taksa e rrugës shuma 165,000 lekë;

Gjoha dhe kamate vonesa shuma 10,113,513 lekë;

Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shuma 217,302,943 lekë.

Sipas informacionit të dhënë në auditimet e mëparshme të KLSH, situata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo te gjitha deklaratat tatimore ishin te informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin ne ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore. Pjesën me te madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,107,792,556 lekë i përket vetëm 2 tatimpaguesve, òA.ò sha, me Nipt J.D, në vlerën 2,106,993,328 leke, subjekt i cili është në administrim te DRT Tirane dhe subjekti òI. 99ò, me Nipt J.T, në vlerën 799,228 leke, subjekt i cili është në administrim të DR Tatimpaguesit e Mëdhenj, dhe sipas informacionit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikave nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem.

- *Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"* në shumën 98,781,044,000 lekë së bashku me llog 486 në shumën 950,864,110 rakordojnë me llogaritë kundër parti të pasivit 401-408; 421,431, 435, 436, dhe 467 trajtuar më poshtë.

Tabela nr. 32

Në lekë

Llogaria	Vlera
Llog 486	950,864,110
Llog 4342	98,781,044,000
<b>Total</b>	<b>99,731,908,110</b>
Llog 401	82,838,037.000
Llog 421	87,036,012.000
Llog 431	9,618,066.000
Llog 435	24,885,635.000
Llog 436	3,437,423.000
Llog 467	99,524,092,938.000
<b>Total</b>	<b>99,731,908,111.000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

**Rubrika "Të tjera aktive afatshkurtra** e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT, ka vlerën 950,864,110 lekë dhe përbëhet vetëm nga **Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"** e pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-së .

Nga krahasimi i vlerës së aktiveve afatgjata raportuar në pasqyrën financiare të pozicionit financiar (formati 1), me pasqyrën òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(vlera neto)ò (formati 7/b), rezultojnë diferenca për dy zëra, trajtuar si më poshtë, po pa efekt në totalin e këtyre dy llogarive (diferenca vetëm për 1 lekë).

Tabela nr. 33

Në lekë

	Pasqyra 1	Pasqyra 7 b	Diferenca



Referenca e Llogarive	EMERTIMI			
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	883,228,516	883,209,033	19,483
218	Inventar ekonomik	104,964,679	104,984,161	-19,482
<b>Total</b>		<b>988,193,195</b>	<b>988,193,194</b>	<b>1</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

**Aktivitet Afatgjata** paraqiten në vlerën 1,755,796,878 lekë, kundrejt 2,049,256,954 lekë për vitin 2020 (sipas vlerës së raportuar në auditimin paraardhës), ndërkohë që në pasqyrat e këtij viti, periudha paraardhëse për aktivitet afatgjata raportohet në vlerën 1,924,668,934 lekë.

Ato përbëhen nga:

-aktivitet afatgjata jo materiale në vlerën 26,101,460 lekë,

-aktivitet afatgjata materiale në vlerën 1,729,695,418 lekë.

Në aktiveve afatgjata jo materiale paraqitet llogaria 202 òStudime e Kërkimeo e cila përbëhet vetëm nga vlera e pasqyrave financiare të DPT.

Në aktivitet afatgjata materiale paraqiten:

-llogaria 210 òToka, Troje, Terreneo, në vlerën 16,194,396 lekë,

-llogaria 212 òNdërtesa e konstruksioneo në vlerën 554,618,39 3lekë,

-llogaria 213 òRruge, rrjete, vepra ujoreo në vlerën 883,228,516lekë


-llogaria 214 òInstalime teknike, makineri e pajisjeo në vlerën 114,709,319 lekë,

-llogaria 215 òMjete transportio në vlerën 55,217,648 lekë,

-llogaria 218 òInventar Ekonomiko në vlerën 104,964,679 lekë,

-llogaria 24 òAktive Afatgjata të Dëmtuaro në shumën 762,467 lekë.

Referuar peshës specifike së aktiveve afatgjata të aparatit të DPT-së, rezulton se ato zënë rreth 64 % të aktiveve afatgjata të pasqyrave të konsoliduar:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për aktivitet është llogaritur amortizimi në përputhje me normat e përcaktuara në pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

### Pasivet

Tabela nr. 34

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2020 sipas raportit paraardhës të KLSH
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	381,489,856,521	350,771,817,194	NA
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	381,489,856,521	350,771,817,194	NA
	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	381,489,856,521	350,771,817,494	NA
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	82,838,037	126,931,634	122,640,727
42	Detyrime ndaj personelit	87,036,012	84,441,249	16,076,626
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	9,618,066	7,946,192	1,631,865

435	Sigurime Shoqërore	24,885,635	24,806,975	4,824,738
436	Sigurime Shëndetësore	3,437,423	3,428,865	673,643
44	Institucione te tjera publike	5,267,471	7,913,104	NA
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	142,663,396,572	115,469,896,175	115,458,699,848
467	Kreditore te ndryshëm	99,524,092,938	102,179,099,656	102,170,673,440
4341	Operacione me shtetin( detyrime	139,089,284,367	132,867,353,644	130,052,687,446

Burimi DPT

**Pasivet (detyrimet)** përbehen vetëm nga pasivet afatshkurtra ku sipas rubrikës 1. “Llogari të pagueshme” paraqiten në vlerën 381,489,856,521 lekë në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2021 dhe përbëhet nga:

- Llogaria 401-408 ÷Furnitorë e llogari te lidhura me toë në vlerën 82,838,037 lekë;
- Llogaria 421 ÷Detyrime ndaj personelitë në vlerën 87,036,012 lekë,
- Llogaria 431 ÷Detyrime ndaj shtetit për tatim taksaë në vlerën 9,618,066 lekë,
- Llogaria 435 ÷Detyrime për sigurime shoqëroreë në vlerën 24,885,635 lekë,
- Llogaria 436 ÷Detyrime për sigurime shëndetësoreë në vlerën 3,437,423 lekë.
- Llogaria 44 ÷Institucione te tjera publikeë në vlerën 5,267,471 lekë.

-Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” paraqiten në vlerën 142,663,396,572 lekë në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2021 dhe përbëhet nga:

Tabela nr. 35

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për 466 “Kreditore per mjete ne ruajtje”	PF
8,566,398	DPT
142,654,830,174	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës
<b>142,663,396,572</b>	<b>Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Situata e llogarisë 466 sipas të dhënave të DKS për vlerat e pasqyruara në sistemin C@TS, për vitin 2021, progresive dhe ato që i përkasin vitit 2021 paraqiten në vijim:

Tabela nr. 36

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	PROGRESIVE (31.12.2021)	VITI 2021 (31.12.2021)
<b>4665</b>	<b>Depozitime te tjera (per tu sistemuar ne te Ardhen)</b>	<b>142,639,786,687.00</b>	<b>27,216,803,507.00</b>
4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje , Te vitit ushtrimor	-	-
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	646,951,420.00	85,601,751.00
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit Fitimit	134,463,319,691.00	26,781,094,476.00
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	3,124,668,035.00	188,933,554.00
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	1,892,592,510.00	644,487.00
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	18,688,940.00	1,431,018.00
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojërave të fatit	5,491,353.00	856,420.00
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	50,285,605.00	3,018,928.00
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjobat	38,750,765.00	3,217,486.00
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën ( sigurime shoqërore, shëndetësore dhe TAP )	1,523,579,880.00	124,824,634.00
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	875,458,488.00	27,180,753.00
4665599	Te ardhura ne llogarinë pezull per tatime dhe sigurime	-	-
<b>Total</b>		<b>142,639,786,687.00</b>	<b>27,216,803,507.00</b>

Burimi: DPT

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten në vlerën 99,524,092,938 lekë në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2021 dhe përbëhet nga:

Tabela nr. 37

Në lekë

Vlera e raportuar në PF për 467 “Kreditore te ndryshëm”	PF
262,709	DRT Kukës
8,389,242	DRT Lezhë
98,497,159,490	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës

1,018,281,497	DPT
<b>99,524,092,938</b>	<b>Vlera e raportuar në Pasqyrën Financiare të Konsoliduar</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Përbërja e llogarisë 467 sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës në vlerën 98,497,159,490 lekë (Detyrime të pasqyruara në kontabilitetin e DPT në C@TS dhe Jashtë Sistemit në DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime) paraqitet në tabelën e mëposhtme, krahasuar me situatën në vitin paraardhës:

Tabela nr. 38

Në lekë

Nr llogarisë	Emërtimi	Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2020	Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2021
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	569,959,087	570,058,600.00
7001	- Tatim mbi fitimin	14,148,401,952	13,534,872,951.00
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	1,197,070,177	1,225,812,941.00
7009	- Tjera tatime	1,880,024,664	1,847,871,648.50
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	76,503,499,999	75,342,375,088.00
7031	- Akciza	73,055,913	73,115,289.00
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	68,968,791	69,538,007.00
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	8,181,359	12,433,887.00
7050	- Taksa e rrugës	309,072,651	6,778,058.00
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	22,093,856	6,681,328.00
7115	- Gjoha dhe kamatvonesa, sekuestime e zhdëmtime	79,106,176	82,048,907.00
75	<b>Sigurime shoqërore e shëndetësore</b>	<b>5,627,400,675</b>	<b>5,551,831,823.21</b>
	<b>Sigurime shoqërore</b>	<b>5,581,889,022</b>	<b>5,502,409,649.21</b>
	<b>Sigurime shëndetësore</b>	<b>45,511,653</b>	<b>49,422,174.00</b>
	ARKA RREGJISTRUSE	190,145	190,145.00
	SHTYPSHKRIME	406,181	216,282.00
	PULLA (ME ÇMIM BLERJEJE)	182,562,431	173,334,535.15
<b>Total</b>		<b>100,669,994,057</b>	<b>98,497,159,489.86</b>

Burimi: DPT

Detyrimet Kreditore të pasqyruara në kontabilitetin e DPT jashtë sistemit në DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime dhe ato në C@TS të ndara paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 39

Në lekë

Nr llogarisë	Emërtimi	Jashtë Sistemit në DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime,	Detyrime Kreditore të pasqyruara në C@TS	Detyrime në C@TS dhe Jashtë Sistemit në DRT për Tatime, Sigurime e Financa shpenzime
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	45,534,581.00	524,524,019.00	570,058,600.00
7001	- Tatim mbi fitimin	34,343,591.00	13,500,529,360.00	13,534,872,951.00
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	1,192,592.00	1,224,620,349.00	1,225,812,941.00
7009	- Tjera tatime	12,544,852.00	1,835,326,796.50	1,847,871,648.50
7030	- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	520,620,465.00	74,821,754,623.00	75,342,375,088.00
	Nga kjo Stoku i Rimbursimit të TVSH			476,650,390
7031	- Akciza	73,115,289.00		73,115,289.00
7032	- Takse mbi shërbimet specifike(Lojëra fati)	1,000,000.00	68,538,007.00	69,538,007.00
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	555,723.00	11,878,164.00	12,433,887.00
7050	- Taksa e rrugës		6,778,058.00	6,778,058.00
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore		6,681,328.00	6,681,328.00
7115	- Gjoha dhe kamatvonesa, sekuest	2,175,125.00	79,873,782.00	82,048,907.00

	rime e zhdëmtime			
75	<b>Sigurime shoqërore e shëndetësore</b>	109,280,964.00	5,442,550,859.21	5,551,831,823.21
	<b>Sigurime shoqërore</b>	108,782,524.00	5,393,627,125.21	5,502,409,649.21
	<b>Sigurime shëndetësore</b>	498,440.00	48,923,734.00	49,422,174.00
	ARKA RREGJISTRUSE	190,145.00		190,145.00
	SHTYPSHKRIME	216,282.00		216,282.00
	PULLA (ME ÇMIM BLERJEJE)	173,334,535.15		173,334,535.15
<b>Total</b>		<b>974,104,144.15</b>	<b>97,523,055,345.71</b>	<b>98,497,159,489.86</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Llog 4341 "Operacione me shtetin -Detyrime" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Ajo paraqitet në vlerën 139,089,284,367 lekë dhe rakordon me llogarinë 468 ÷Debitorë te ndryshëm të aktivitetit, detajimi i së cilës është trajtuar më sipër. Në pasiv të pasqyrës vlera e llogarisë 4341 është pasqyruar në shumën prej 139,089,284,367 lekë, me një diferencë në vlerën prej 2,990,000 lekë, e raportuar nga DRT Dibër dhe e trashëguar nga vitet e kaluara. Fondi i konsoliduar i pasqyruar nga Sektori i Pagesave në vlerën prej 2,990,000 lekë nuk përputhet me regjistrimet kontabël të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar, vlerë e cila ka sjellë një paraqitje jo të drejtë të pasqyrës së konsoliduar të DPT.

## Rezultati

Tabela nr. 40

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Viti 2021	Viti 2020
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	1,883,664,970	2,173,515,078
<b>D</b>	<b>FONDII KONSOLIDUAR :</b>	1,883,664,970	2,173,515,078
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,879,595,896	2,181,652,182
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	4,069,074	8,137,104
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	383,373,521,491	352,945,332,271

Burimi: DPT

Nga auditimi konstatohet se vlera e raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara për zërin 101 ÷Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar për vitin 2021 paraqitet në vlerën 1,879,595,896 lekë, ndërkohë analitikisht sipas pasqyrave përbërëse të pasqyrave të konsoliduara ky zë rezulton 1,878,439,285.2 lekë, me një diferencë prej 1,156,610.27 lekë që vjen si pasojë e raportimit të pasaktë të këtij zëri në pasqyrat financiare të DRT Vlorë, më hollësisht:

Tabela nr. 41

Vlera e raportuar në zërin 101 "Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"	DRT
1198526945	DPT
27706860	Berat
64607291	Durrës
28535892	Dibër
27320018	Elbasan
66154168	Fier
31355223	Gjirokastrë
28738061	Korçë
29584454	Kukës
17034605	Lezhe
29553957	Sarandë
52547349	Shkodër
141071414.3	Tiranë
16878505	Vlorë
115834543	VIPA
2990000	Sektori i pagesave dhe kontabilitetit
<b>1,878,439,285.28</b>	<b>Total</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

#### PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE AKTIVET NETO/ FONDET NETO

-Nga auditimi konstatohet se aktivet neto/fondet neto paraqiten në vlerën 2,176,505,077.77, e cila nuk përputhet me mbylljen e vitit paraardhës ka një diferencë, prej 2,990,000 lekë që vjen si rezultat i raportimit të DRT Dibër dhe është e njëjtë me raportimin e periudhës paraardhëse të PF të Konsoliduara të Kontabilitetit.

-Nga auditimi konstatohet se sipas pasqyrës financiare të konsoliduar, zëri 1013 òNga konsumi i AAGJ(-)ò paraqitet në vlerën 347,072,049 lekë, ndërkohë që sipas tabelës së amortizimit kjo vlerë duhet të ishte 347,402,97 lekë që vjen si pasojë e keq raportimit në pasqyrat financiare të DRT Shkodër në vlerën 330.928 lekë, por pa efekt në vlerën totale të raportuar.

#### PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE(CASH FLOW)

Detajimi i zërit òLëvizje e brendshme e transfera te tjera(+)-ò në vlerën 5,261,079 lekë, si pasojë e transferimit të bërë në DRT Berat në vlerën 2.555.643 lekë dhe diferencës në Sektorin e Pagesave dhe Kontabilitetit në vlerën 2.705.436 lekë në pasqyrën F3 tek lëvizje e brendshme dhe transfera të tjera (+-) shuma -2.705.436 lekë është raportuar në PF 2021 transferuar nga DRT Tiranë -2,938,284 dhe DRT Fier në shumën +232,848 lekë.

#### PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE

Në zërin òFinancim i pritshëm nga buxhetiò në vlerën 275,207,884 lekë, janë përfshirë paga & sig shoq për detyrimet e vitit 2021 që do të likuidohen në vitin 2022.

Në zërin òNdryshimi i gjendjes së inventarit të produkteveò në vlerën 1,701,613,85 lekë përfaqësohet nga llogaria 841 që janë të ardhura të anuluar, nga të cilat 1,646,202,422 lekë janë detyrime të Sistemit E-Tax të DPT dhe shuma 55,411,434 është òtituj të ardhurash të anuluar me vendime gjyqësoreò për detyrime jashtë sistemit raportuar nga DRT Fier.

Problematika e trajtuar edhe në auditimet e fundit të KLSH-së lidhur me skemën e kontabilizimit të veprime rregulluese për llogarinë 466 -Kreditorë për mjete në ruajtjeò dhe llogarinë 520 -Disponibilitete në thesarò vijon edhe këtë vit. Më hollësisht, **konstatohet se në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003, më datën 31.12.2021 paraqitet në shumën 134.4 miliardë lekë, ndërsa sipas sistemit C@TS teprica kreditore më datë 31.12.2021 është në vlerën 13.5 miliard.** Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2021. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS por ky veprim nuk gjen pasqyrim në kontabilitet dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti, si një òdetyrimò në pasivin e bilancit të DPT-së me kundërparti òllog.520 disponibilitete në thesarò. Në këto kushte, këto llogari paraqiten në pasqyrat financiare të DPT-së të mbivlerësuara krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme në C@TS, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeò:

Tabela nr. 42

Në lekë

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021
Gjendja Llog.466 më fillim viti	92.5 miliard lekë	115.4 miliard lekë
Arkëtime gjatë vitit	23 miliard lekë	27.2 miliard lekë
Gjendja e llog.466 më fund viti	115.4 miliard lekë	134.4 miliard lekë

<b><i>Nga të cilat:</i></b>		
Arkëtime (Të ardhura) të raportuara për zërin otatim mbi fitimin	21,4 miliard lekë	26.78 miliard lekë
Teprica kreditore sipas C@TS në fund viti	14.1 miliard lekë	13.5 miliard lekë

Për sa është trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 121/42 prot., datë 21.07.2022, prot në KLSH me nr. 20/14, datë 27.07.2022 ku janë shprehur objeksionet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen se DPT nuk ka përgatitur raporte të monitorimit të realizimit të buxhetit në zbatim të Udhëzimit nr.22, datë 17/11/2016 është e qartë që kërkohet raportim monitorimi në nivel kod programi. Kjo rrjedhimisht sjell raportimin për gjithë DPT-në si strukturë pa ndarë më vete aparatit. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit monitoron në mënyrë periodike dhe konstatnte 14 Drejtoritë Rajonale si dhe vet aparatit dhe më pas raporton titullarin e institucionit. Një herë në 4-muaj realizohet procedura e raportimit për DRT-të dhe sjelljen në vëmendje të situatës në aspektin buxhetor, financiar., magazinë, letrat me vlerë, karburanti etj dhe DPT-në në aspektin buxhetor dhe financiar drejtuar titullarit të institucionit edhe si detyrim ligjor që rrjedh nga ligji i MFK-së. I gjithë procesi i sipërpërmendur është i faktuar nëpërmjet shkresave zyrtare dhe komunikimeve elektronike zyrtare. Pra, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit monitor, kontrollon dhe menaxhon në çdo moment si DRT-të edhe DPT-në në nivel raportimi, ndaj gjykojmë se kjo gjetje nuk mund të jetë pjesë e rekomandimeve. Në lidhje me mos regjistrimin e barrës siguruese në R.B.S. për shkak të mungesës së fondeve në buxhetin e alokuar në dispozicion të DPT-së, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është drejtuar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nëpërmjet shkresave kërkesë për shtesë fondi si dhe është vendosur në kërkesat shtesë të PBA-së Faza I-re. Kjo kërkesë është përsëritur edhe në Shkurt dhe Korrik të vitit 2022. Fondet buxhetore për DPT-në, si një nga institucionet në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, alokohen nga MFE sipas tavanëve buxhetore të cilat përcillen si në fazat e realizimit të PBA-së edhe në çelje të çdo viti buxhetor. Kërkesat tona për shpenzimet korrente janë të vazhdueshme dhe gjithmonë gjendemi në pamundësi fondesh për realizimin e qëllimeve kryesore të DPT-së ku një ndër to është edhe mbledhja e borxhit. Vlerat janë tepër të larta dhe kjo situatë nuk mund të zgjidhet nga DPT në momentin kur nuk ka fonde në dispozicion. Për vitin 2021 janë kërkuar 138.000.000 lekë fonde shtesë dhe për vitin 2022 janë kërkuar 175.000.000 lekë fonde shtesë. Pra kjo gjetje nuk mund të pranohet pasi DPT e ka shprehur gjithë angazhimin e saj për fonde por është në pamundësi nqs nuk çelen fonde nga MFE.*

*Në lidhje me mos përlllogaritjen e provigjoneve në pasqyrat financiare të DPT-së në njohje të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, pika 34 përcaktohen se kur do të njihet provigjoni në pasqyrat financiare dhe gjykojmë se kjo gjetje nuk është ende e mundur të zbatohet si në njohje të Udhëzimit por edhe të SKK-ve por është e pamundur edhe në aspektin praktik të saj. DFB nuk e pranon si gjetje, si mënyrë të përsëritur mbi këtë qasje, por nëse është e mundur nga ana e KLSH-së një orientim mbi zbatueshmerinë e saj. Në zbatim të Udhëzimit për njohjen e detyrimeve të prapambetura për të cilën plotësohen kriteret e njohjes së saj si dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura me shkresë zyrtare më Degën e Thesarit Tiranë është vlera 950.861.111 lekë, ndërkohë vlera 67.417.386 lekë është pagesa e faturave të sjella në Dhjetor 2021 për tu paguar në Janar të vitit 2022. Pra nuk janë detyrime të prapambetura sipas përcaktimit të udhëzimit nr.37, por janë detyrime që njihen në bazë të Udhëzimit nr.8. Me qëllim e ndarjes së dy veprimeve , dy koncepteve të cilat trajtohen ndryshe me Udhëzime të ndryshme.*

*-Llogaria 466 nuk përfaqëson arkëtime të pa identifikuar me një detyrim në sistemin e-tax, por për kontabilizimin e të ardhurave në sistemin e tatimeve kryesisht janë pagesa për tatim fitimin e papaguar nga tatimpaguesit në vitin kalendarik, të cilat kontabilizohen në këtë llogari të klasës 4 të të ardhurave me kundërparti klasën 520 sepse detyrimi për tatim fitimin konstatohet si i tillë vitin e ardhshëm kalendarik, brenda datës 31 Mars kur tatimpaguesit dorëzojnë deklaratën vjetore të ardhura/shpenzime për vitin kalendarik paraardhës. Me dorëzimin e kësaj deklarate sistemi merr në konsideratë të gjitha parapagimet e kryera në vitin paraardhës kalendarik dhe bën kontabilizim detyrimi për diferencë nëse parapagimet janë më pak se rezultati tatimor (detyrim për t'u paguar). Tatim paguesi printon urdhër*

pagesën dhe kryen likuidimin në bankë, e cila kontabilizohet menjëherë në klasën 7 të të ardhurave për tatim fitimin. Kjo llogari është specifike për DPT e cila po me këtë skemë, të ardhurat i dërgon në SIFQ. Lidhur me konstatimin se lëvizjet më të mëdha llogaria i ka në muajin Dhjetor nuk ka pasaktësi edhe sipas udhëzimit, pasi muaji dhjetor është afati i fundit për pagesën e kësteve të tatim fitimit dhe prandaj dhe të hyrat për tatim fitimin të llog 466 kanë fluks më të lartë se muajt e tjerë. Grupi i auditimit duhet të japë një rast konkret nipti si pagesë jashtë kësteve të gjeneruara nga sistemi për të argumentuar realizimin fiktiv të të ardhurave nga administrata tatimore për tatimin mbi fitimin. Lidhur me gjetjen tuaj se gjobat që lidhen me tatime dhe taksa janë përfshirë gabimisht në zërin tatime e taksa në shumën 633,826 mijë lekë e keni përsëri gabim. Lidhur me konstatimin se diferenca në llogarinë 468 në llogarinë 4341 prej 2,990,000 lekë vjen nga sektori i pagesave sqarohet se regjistrimi i këtij veprimi kontabël në pasqyrat e DRT Dibër është që nga viti 1999 dhe është vlerë e aktiveve afatgjata të konstatuara në mungesë gjatë inventarit të kryer në këtë DRT në periudha të mëparshme dhe DRT Dibër për këtë diferencë ka ndjekur procedurat e denoncimit në prokurori. Mungesa e këtij aktivi është kontabilizuar nga kjo DRT sipas udhëzimit nr. 8 dhe njëkohësisht është ngritur detyrimi për 2,990 mijë lekë kontabilizuar në llog 468 të tjera kërkesa debitore dhe nuk ka lidhje shtetin dhe as me llogarinë 4342 apo llogarinë 467. Konstatimi juaj se debitorët në 31.12.2021 janë në total dhe jo sipas zërave nuk qëndron (situata si më poshtë).

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

-Për sa trajtuar në observacion lidhur me mos regjistrimin e barrës sigurorese në kushtet kur edhe sipas sqarimeve tuaja kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve, sqarojmë se rekomandimi ka patur si qëllim përcjelljen e problematikës nga ana e DPT pranë MFE në mënyrë që strukturat e saj të mundësojnë një zgjidhje optimale. Lidhur me rekomandimin për hartimin e raporteve të monitorimit 4 mujore sqarojmë se kjo problematikë është trajtuar edhe në auditimin aktual të kryer nga KLSH në MFE ku është rekomanduar hartimi i një manuali/udhëzuesi nga titullari i MFE për të gjitha njësitë e varësisë së saj në mënyrë që të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për monitorimin e buxhetit, sikundër përcakton edhe udhëzimi standard për zbatimin e buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për sa i përket rekomandimit lidhur me përlllogaritjen e provigjoneve, nga grupi i auditimit u mor në konsideratë shqetësimi i përcjellë në observacion dhe u shtua një tjetër rekomandim për përcjelljen e situatës pranë DH/KBFP në MFE në mënyrë që të përcaktohen dhe orientimet përkatëse nga ana e saj.

-Për sa trajtuar në observacion, sqarojmë se vërtet këstet e tatim fitimit janë paraprake dhe nuk janë konstatuar (maturuar) ende me një deklaratë tatimore fillimisht, por ato më pas sistemohen në vitin pasardhës, në momentin që subjekti plotëson deklaratën e tatim fitimit. Gjithashtu, sqarojmë se ky konstatim nuk ka të bëjë me skemën e kontabilizimit të pagesës për këste të tatim fitimit në momentin e pagesës nga klienti, dhe as për akt rakordimin e vërtetuar mes DPT dhe Degës së Thesarit Tiranë për tepricat në llogarinë 466 dhe 520, pra nuk është një çështje rakordimi apo saktësie të vlerës së tatim fitimit në vitin korrent, por konstatimi i grupit lidhet me vlefshmërinë e zërit të pasqyruar në vlerën 134.4 miliard lekë në bilancin e DPT, pasi një pasqyrim aktual lexohet si një detyrim për sistemin tatimor, dhe ka nevojë për një veprim sistemues. Për sa trajtuar për vlerën 2,990,000 lekë të raportuar në PF, grupi i auditimit i qëndron pozicionit të trajtuar në projektraport ku në bazë të udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò pika 17 përcakton se òPër regjistrimin në kontabilitet të operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar ndiqet procedura e mëposhtme: Llogaria 101 e klasës I funksionon si më poshtë:

- kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga:
  - ✓ grantet kapitale për aktivet afatgjata të vlera dhe të kapitalizuara;
  - ✓ grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata;
  - ✓ rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata;
  - ✓ anulimet e detyrimeve për t'u paguar
  - ✓ të tjera
- debitohet për pakësimet me fondet bazë që vijnë nga:
  - ✓ shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuar me koston historike të blerjes së tyre;

- ✓ nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve afatgjata
- ✓ transferimet e dhurimet e aktivet afatgjata
- ✓ konsumi i aktiveve afatgjata;
- ✓ rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe
- ✓ anulimet e të drejtave për t'ua arkëtuar;
- ✓ të tjera.

Si rezultat, vlera 2,990,000 nuk përfshihet në postin e llogarisë 101, por veprimi i saj kontabël duhet të ishte mbyllur ose me llogarinë 4342 ose me llogarinë 467.

Për sa i përket konstatimit se debitorët në 31.12.2021 janë në total dhe jo sipas zërave, sqarojmë se të dhënat sipas zërave u vendosën në dispozicion vetëm nëpërmjet këtij observacioni, dhe grupi ka reflektuar situatën sipas informacioneve deri në fazën e projektraportit. Të dhënat e reja, u pasqyruan në material.

**Titulli i Gjetjes**  
**Situata 1:**

**Ndryshimi i prioriteteve në financimin e projekteve të investimit**

Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPT, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Programit është kërkuar ndryshimi i prioriteteve të projekteve të investimit, referuar rëndësisë së projektit oPërmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit, i cili lidhet me procesin më të rëndësishëm të institucionit, atë të **Fiskalizimit**, për të cilin janë realizuar pagesa në vlerën 512,787 mijë lekë, krahasuar me 187,960 mijë të planifikuara në PBA për vitin 2021, ose pothuajse 3 fish më shumë. Nga sa më sipër rezultojnë se me ndryshimin e prioriteteve për ekzekutimin e projekteve të investimit nga DPT, me qëllim sigurimin e fondeve në dispozicion të këtij projekti; i cili është likuiduar i plotë, është ndikuar realizimi i dy projekteve të tjera të investimit të DPT. Kjo problematikë është përcjellë edhe nga DPT pranë MFE, që në momentin e miratimit të tavanëve në fazën e hartimit të PBA-së, ku plani për projektet e investimit të DPT nuk mundëson likuidimin e tyre, dhe kërkesat për investime nuk janë marrë parasysh në totalin e tyre, pasi nuk janë përfshirë në vlerën e fondit të investimit të sistemeve të IT, edhe fondet për mirëmbajtjen e tyre.

Nga krahasimi i nivelit të financimit të planifikuar sipas PBA-së, me atë të alokuar përgjatë vitit 2021, për dy projektet rezultojnë diferenca prej 85,040 mijë lekë e cila përbën një angazhim kontraktual. Duke qene se nga ana e operatorëve ekonomik nuk është kërkuar kryerja e pagesave, nuk janë krijuar detyrime të prapambetura, **megjithatë kjo situatë përbën një risk për krijimin e tyre**. Më hollësisht, për projektin e investimit 18AV806 *oKrijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center)*, *sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT*, sipas kontratës nr. 7047, datë 28.12.2020 janë planifikuar pagesa për investimin përkatësisht 36,300 mijë lekë në vitin 2020 dhe 54,408 mijë lekë në vitin 2021 dhe mirëmbajtje për 24 muaj në vlerën 35,640 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 janë realizuar fonde në vlerën 15,000 mijë lekë, dhe referuar realizimit progresiv në kësaj kontrate në vlerën 124,965 mijë lekë nuk ka mundur të likuidohet vlera e plotë e këtij projekti, dhe vlera e mbetur prej **45,037 mijë lekë mbetet si detyrim për t'u likuiduar në vitin pasardhës**. E njëjta situatë rezultojnë edhe për projektin 18AV811 *oNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja*, ku sipas kontratës nr. 3275, datë 10.07.2020 janë planifikuar pagesa përkatësisht 23,700 mijë lekë në vitin 2020 dhe 56,340 mijë lekë në vitin 2021 dhe mirëmbajtje në vlerën 27,840 mijë lekë për 24 muaj. Për vitin 2021 janë realizuar vetëm 15,000 mijë lekë, dhe referuar realizimit progresiv në kësaj kontrate në vlerën 38,700 mijë lekë, **vlera e mbetur prej 41,340 mijë lekë mbetet si detyrim për t'u likuiduar në vitin 2022**.

**Kriteri:**

Neni 40, 43 dhe neni 50 Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 oPër procedurat e menaxhimit të investimeve publike, pikën 64 të Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 oPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit; Ligji nr. 137, datë



	16.11.2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò,
<b>Efekti:</b>	Kryerja e rishikimeve të shpeshta, me impakt pakësimit e fondeve të disa projekteve investimi për të shtuar fondet në projekte të tjera
<b>Shkaku:</b>	Ndryshimi i prioriteteve, që në këtë rast janë fokusuar në finalizimin e procesit të fiskalizimit
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandimi:</b>	DPT në bashkëpunim me MFE të marrin masat për kryerjen e një planifikimi më efektiv në drejtëm të disiplinimit të angazhimeve buxhetore me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta, ku pakësimi i fondeve për disa projekte investimi mund të shoqërohet me efekte financiare dhe risk të shtuar nëse se nga ana e operatorëve ekonomik do të kërkohet likuidimi për obligimet kontraktuale, pavarësisht se në rastin konkret nuk ka ndodhur.
<b>Afati:</b>	Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi
<b>Titulli i Gjetjes</b>	<b>Ndërmarrja e angazhimeve nga ana e AKSHI-t për projektin e mirëmbajtjes së sistemit e-taxation, fondet për të cilat nuk ishin parashikuar</b>
<b>Situata 2:</b>	Nga auditimi konstatohet se kontrata nr. 3339, datë 12.05.2021 me vlerë totale 229,586,688 lekë me TVSH për 24 muaj mirëmbajtje, e lidhur nga AKSHI me objekt òMirëmbajtja e sistemit e-Taxationò për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk është e parashikuar në fondet për vitet 2021-2023, pasi sipas DPT kërkesa për realizimin e këtij procesi nuk është përcjellë brenda afateve ligjore. Megjithatë, duke qenur se kjo procedurë lidhet me sistemin C@ts, i cili është sistemi bazë i tatimeve dhe i rëndësisë së tij veçantë, si dhe gjendur në një situatë të mungesës së fondeve dhe pamundësisë për alokim shtesë fondesh nga MFE është kryer rialokimi i fondeve buxhetore brenda shpenzimeve korente, duke pakësuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llog 600 dhe 601) të disa Drejtorive Rajonale Tatimore: DRT Durrës, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Vlorë, VIP, Tiranë, Aparati i DPT (duke përdorur fondet e mbetura për muajt për të cilat janë kryer pagesat deri në ato momente, dhe disponoheshin fonde të pa realizuara për shkak të vakancave), me qëllim alokimin e shtesës prej 60,000 mijë lekë për shpenzime korente të aparatit të DPT në produktin 91004AA për të kryer likuidimet e nevojshme të kontratës trajtuar më sipër. Në vijim të saj, me shkresën nr. 9881/2 prot., datë 16.06.2021 të MFE dhe DPT nr. 9881/3 prot., datë 21.06.2021 është miratuar ky transferim i fondeve.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 40 Ligji nr. 137, datë 16.11.2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò, VKM 185, datë 29.03.2018 òPër procedurat e menaxhimit të investimeve publikeò, VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për òRiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò , i ndryshuar. Udhëzimi nr.9 dt. 20.3.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, pika 64
<b>Efekti:</b>	Kryerja e rishikimeve të shpeshta të fondeve buxhetore
<b>Shkaku:</b>	Kryerja e procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës nga AKSHI pa marrë fillimisht miratimin nga DPT për fondet e nevojshme; Mungesa e koordinimit mes këtyre dy institucioneve
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Strukturat drejtuese pranë DPT dhe AKSHI-t të rrisin bashkëpunimin ndër institucional, në mënyrë që të kryhet në mënyrë të plotë dhe të saktë planifikimi i fondeve që në fazën e hartimit të PBA-së për ato asete, procedurat e prokurimit të cilave do të kryhen nga AKSHI, në mënyrë që të shmangët fenomeni i ndërmarjes së

angazhimeve pa fonde në dispozicion nga ky i fundit, shoqëruar me efekte financiare apo rishikime të shpeshta të buxhetit të DPT.

**Afati:** Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

**Titulli i Gjetjes** **Mos regjistrimi i barrës siguroese në R.B.S për shkak të mungesës së fondeve në buxhetin e alokuar në dispozicion të DPT.**

**Situata 3:** Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, çështja 4.4.6 òNjoftimi për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguroeseò, përcakton se me qëllim sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, administrata tatimore duhet të vendosë për marrjen e masave të sigurimit për ekzekutimin e detyrimit duke vendosur masa sigurimi të pasurisë nëpërmjet barrave siguroese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPT nuk është siguruar regjistrimi i barrës siguroese në Regjistrin e Barrëve Siguroese (RBS) nga ana e strukturave përgjegjëse. Kjo për shkak se, referuar Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nr. 486, datë 29.05.2009, shërbimet që kryhen në RBS bëhen kundrejt tarifave dhe këto shpenzime nuk kanë mundur të mbulohen me buxhetin e alokuar në dispozicion të DPT. Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar akordimi i fondeve të nevojshme për të kryer këto shërbime, pasi mos kryerja e pagesave ka kushtëzuar vendosjen e barrëve hipotekore dhe siguroese. Në vijim të tyre nga ana DPT këto kërkesa janë parashikuar tek fondet shtesë drejtuar MFE, por për të cilat nuk janë çelur fonde, duke mos mundur të arrihet një zgjidhje optimale për këtë situatë.

**Kriteri:** -Ligji nr.8537 datë 18.10.1999 "Për barrët siguroese", Kreu IV, Regjistri i barrëve siguroese, neni 25;  
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 91;  
-Rregulloren e Barrëve Siguroese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikes dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006.

**Efekti:** Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPT nuk është siguruar regjistrimin e barrës siguroese në R.B.S nga ana e strukturave përgjegjëse

**Shkaku:** Mos çelja e fondeve të nevojshme apo ofrimit të një zgjidhjeje optimale për këtë situatë

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** - Titullari i DPT të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe strukturat përgjegjëse të marrin masat për alokimin e fondeve të nevojshme për këto shpenzime, reflektuar në tavanet përfundimtare të miratuara në buxhetin e DPT, apo dakordësimin e një tjetër zgjidhjeje optimale për këtë situatë në kushtet kur kemi të bëjmë me pagesa të kryera nëpërmjet dy institucioneve shtetërore.

**Afati:** Brenda vitit 2022

**Titulli i gjetjes:** **DPT nuk ka përgatitur raporte të monitorimit të realizimit të buxhetit për produktet e menaxhuara vetëm nga institucioni (si aparat) por i ka përfshirë këto të dhëna në raportet e monitorimit të hartuara për programin e të ardhurave tatimore, ku përfshihen edhe DRT-të.**

**Situata 4:** Nga auditimi u konstatua se DPT, si njësi shpenzuese, nuk harton raporte monitorimi 4-mujore për të ndjekur vetëm realizimin e produkteve të buxhetit të DPT, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe për të bërë të mundur ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së

politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Gjithashtu, nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin vetëm për DPT, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. Ky monitorim kryhet në total për të gjithë programin ÷Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore÷, ku përfshihet edhe buxheti i alokuar për DPT, së bashku me atë të DRT-ve.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë÷, i ndryshuar, neni 19, etj;  
ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin÷ Pika 23/1 e nenit 4

**Ndikimi/efekti:** Mangësi në drejtim të procedurave të monitorimit të buxhetit të DPT

**Shkaku:** Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit për programet e menaxhuara nga DPT si njësi shpenzuese, por përfshirja e tyre në raportin përmbledhës të hartuar i cili përfshin programin bashkë me DRT-të.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në DPT, në zbatim të udhëzimeve të MFE për procedurat që duhet të ndiqen nga njësitë shpenzuese për zbatimin dhe monitorimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit për DPT për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

**Afati:** Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

**Titulli i Gjetjes** **Problematika të konstatuara në procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2021**

**Situata 5:** Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021 **nuk është kryer** procesi i inventarizimit të aktiveve, në kundërshtim me nenet 8-22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin÷, i ndryshuar dhe *në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷, i ndryshuar, pika 1. Gjithashtu, konstatohet se nuk kanë përfunduar procedurën e inventarizimit DRT Durrës, Tiranë dhe Dibër. Në kushtet kur procesi i inventarizimit nuk është kryer, grupi i auditimit nuk mundi të kryente një krahasim me qëllim identifikimin e diferencave të mundshme mes shumave të vlerave të llogarive të aktiveve të raportuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerave të këtyre aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare.*

- Nga auditimi konstatohet se edhe procesi i inventarizimit të aktiveve kryer një vit më parë është një proces i ndjekur për inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020, pra për një periudhë të ndërmjetme **dhe jo për të gjithë periudhën raportuese** për efekt të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2020, duke rezultuar kështu në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷, i ndryshuar, pika 2.

- Për sa i përket procesit të ndjekur për aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi, sipas pikës 95 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, në vijim të raportit përfundimtar mbi inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020, ky proces nuk ka përfunduar ende, dhe nuk ka patur një urdhër të dytë nga titullari për shtyrjen e këtij afati.

Gjithashtu, për sa i përket konkluzioneve të komisionit të inventarizimit për vitin paraardhës lidhur me mos kryerjen e inventarizimit të disa aktiveve që janë në ngarkim të personave të cilët nuk kanë qenë prezent për arsye të ndryshme (Covid 19

etj.), për të cilat komisioni ka konstatuar se nuk arriti të kryej verifikim fizik të materialeve në magazinë M14 Program, pasi nuk gjenden; dhe se disa ish punonjës të cilët janë larguar si pasojë e shkëputjes nga puna në DPT, rezultojnë ende me materiale në ngarkim në kundërshtim me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 13 dhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, në vijim të informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit lidhur me ecurinë e këtij procesi, u konstatua se nuk ka patur një urdhër të titullarit për sistemimin e situatës dhe marrjen e masave respektive.

**Kriteri:** -Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, nenet 8-22  
-VKM nr. 124, datë 17.2.2016 për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30  
-Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, pika 15, çështja 1 dhe 2; pika 95 dhe 96

**Efekti:** Institucioni përballet me riskun potencial të mos menaxhimit administrimit dhe humbjeve të vlerave materiale. Në kushtet kur procesi i inventarizimit nuk është kryer, apo kur procesi i inventarizimit nuk është kryer për një vit të plotë, ai nuk i shërben periudhës raportuese për efekt të hartimit të pasqyrave financiare të vitit dhe grupi i auditimit nuk mundi të kryente një krahasim me qëllim identifikimin e diferencave të mundshme mes shumave të vlerave të llogarive të aktiveve të raportuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerave të këtyre aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare. Mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve si rezultat i mungesave të konstatuara në aktive dhe nxjerrjen e përgjegjësisë respektive; mangësi në procesin e ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve; Problematika të shfaqura në punën e komisionit të nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në vitin paraardhës; mos inicimi i një urdhri nga ana e titullarit për mungesat e konstatuara në procesin e inventarizimit për vitin paraardhës

**Shkaku:** Mos inicim i procesit të inventarizimit nga ana e titullarit të institucionit

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Titullari i DPT të marrë masat për inicimin e procesit të inventarizimit për vitin 2021 dhe për çdo vit pasardhës për një vit të plotë që përfshin të gjithë periudhën raportuese për efekt të hartimit të pasqyrave financiare dhe jo periudhave të ndërmjetme, në mënyrë që të garantohet saktësia e informacionit të gjeneruar nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, në mos shpërdorimin dhe humbjet e tyre.

-Titullari i DPT, të marrë masat respektive për sistemimin e situatës së konstatuar për inventarizimin e vitit paraardhës, si dhe për finalizimin e procesit të ndjekur për aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi.

**Afati:** Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

**Titulli i Gjetjes** **Mos finalizim i kalimit të aseteve respektive nga DPT tek AKSHI**

**Situata 6:** Nga auditimi konstatohet se edhe përgjatë vitit 2021 në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës të kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Ndër problematikat e diskutuara në takimin e zhvilluar mes dy institucioneve janë evidentuar domosdoshmëria për regjistrimin e të gjitha databazave të DPT-së si databaza shtetërore, si parakusht për kalimin kapital të këtyre aseteve për llogari të AKSHI-t;

verifikimi i aseteve që nuk përdoren më. Nga ana e përfaqësuesve të dy institucioneve është renë dakord që pjesë e kalimit të kapitalit do të jetë vetëm pjesa e implementimit të sistemit të fiskalizimit; pamundësia për marrjen në dorëzim për disa nga sistemet Nexus, Harta digjitale , BI etj.; diskutimi nëse do të jenë objekt kalimi kapital disa nga asete që nuk përdoren më, si p.sh rasti i Nexus (kasat), i cili pas hyrjes në fuqi të ligjit për fiskalizimin nuk do të jetë më funksional nga ana teknike, por i përdorshëm për arkivë. Megjithatë, deri në përfundim të auditimit, nuk është mundur të finalizohet ky proces.

<b>Kriteri:</b>	VKM nr. 673, date 22.11.2017 për òRiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò , i ndryshuar, neni IV pika 18
<b>Efkti:</b>	Mos finalizimi i procesit për kalimin e aseteve për AKSHI-t në mënyrë që të garantohet dhe administrimi i tyre nga ana e këtij institucioni, konform kuadrit rregullator.
<b>Shkaku:</b>	Problematikat e shfaqura gjatë këtij procesi, evidentuar edhe në takimet e zhvilluara mes këtyre institucioneve
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandimi:</b>	Strukturat përgjegjëse pranë DPT dhe AKSHI-t të marrin masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për kalimin e aseteve nga DPT tek AKSHI, me qëllim finalizimin sa më të shpejtë të këtij procesi.
<b>Afati:</b>	Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

**Titulli i Gjetjes  
Situata 7:**

**Mos përlllogaritja e provigjoneve në pasqyra financiare të DPT**

Nga auditimi konstatohet se në pasqyrat financiare të DPT vijnë të mos jenë llogaritur provizione, problematikë e trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 6, òProvizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuaraò, pika nr. 47, si dhe òUdhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 34. Referuar detyrimeve të DPT, nevoja e parashikimit të provizioneve lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna në shumën 116 milion lekë, detyrime për investime në shumën 661 milion lekë, detyrime për mallra e shërbime në shumën 81 milion lekë, etj.

<b>Kriteri:</b>	Standardin Kombëtar të kontabilitetit nr.6, òProvizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuaraò, pika nr. 47, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 34
<b>Efkti:</b>	Mos pasqyrimi në kontabilitet i saktë i detyrimeve të cilat faktikisht janë të njohura nga njësia dhe për të cilat do të jetë e nevojshme alokimi i burimeve ekonomike për përmbushjen e këtyre detyrimeve
<b>Shkaku:</b>	Vështirësitë e shfaqura për të plotësuar këtë kriter në sektorin publik
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	DPT t'aj bëjë të ditur MFE që të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ku konkretisht Sektori i Kontabilitetit të kësaj drejtorie të marrë masat për shqyrtimin e situatës, në mënyrë që të përcaktohen edhe procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike.
<b>Afati:</b>	Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

**Titulli i Gjetjes**

**Konstatime lidhur me pasqyrat financiare të konsoliduara**

**Situata 8:**

Nga auditimi u konstatua se vlera e raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara për periudhën paraardhëse paraqitet me diferenca krahasuar me atë të raportuar një vit më parë (pra në pasqyrat e konsoliduara të vitit 2020). Nga verifikimi i kryer analitikisht për pasqyrat financiare të përgatitura nga DRT-të, rezulton se kjo diferencë vjen si **pasojë e kryerjes së ndryshimeve pas dorëzimit të pasqyrave financiare nga ana e DRT Lezhë, Gjirokastrë, Durrës**, konstatuar edhe në relacionin e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara. Si rezultat, edhe për pasqyrat e konsoliduara periudha paraardhëse paraqitet me ndryshime duke kryer kështu veprime korrigjuese në periudhat pas mbylljes, në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018.

- Nga auditimi konstatohet se llogaria 468 *Debitore të ndryshëm* (139,091,469,226) + 423,429 *Personeli, paradhënie, deficite, gjoba* (805,141) nuk kuadron me llog 4341 *Operacione me shtetin -Detyrime* (139,089,284,367). Diferenca prej 2,990,000 lekë vjen nga Sektori Pagesave dhe Kontabilitetit ku llog 468 = 139,086,882,211 lekë dhe llog 4341 = 139,083,892,211 lekë. Fondi i konsoliduar i pasqyruar nga Sektori i Pagesave në vlerën prej 2,990,000 lekë nuk përputhet me regjistrimet kontabël të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar, vlerë e cila ka sjellë një paraqitje jo të drejtë të pasqyrës së konsoliduar të DPT.

- Nga auditimi konstatohet se vlera e raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara për zërin 101 *Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar* për vitin 2021 paraqitet në vlerën 1,879,595,896 lekë, ndërkohë analitikisht sipas pasqyrave përbërëse të pasqyrave të konsoliduara ky zë rezulton 1,878,439,285.2 lekë, me një diferencë prej 1,156,610.27 lekë që vjen si pasojë e raportimit të pasaktë të këtij zëri në pasqyrat financiare të DRT Vlorë.

- Për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara nëpunësi autorizues dhe zbatues i DPT duhet të përmbledhin informacionin e hartuar nga vetë DPT (si aparat), DRT-të, dhe Sektori i Pagesave dhe Kontabilitetit pranë DPT. Nga auditimi konstatohet se duke qenë se këto dokumente hartohen në kufijtë e afatit kohor për dorëzimin e pasqyrave përcaktuar në pikën 120 të Udhëzimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, i cili përcakton se këto pasqyra duhet të përfundojë brenda muajit prill të vitit pasardhës; nuk mundësohet kryerja e të gjitha verifikimeve/saktësimeve apo rakordimeve të nevojshme mes strukturave të DPT/DRT në mënyrë që ky dokument të raportojë në mënyrë të saktë dhe të drejtë situatën, apo dhe reflektimin e të gjitha komenteve në mënyrë të hollësishme në shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

**Kriteri:**

Ligji nr. 25, datë 11.05.2018 *Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*, neni 10, pika 1: *Bazat dhe parimet mbështetëse*:

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, pika 3.7 *Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale, konkretisht sipas përcaktimeve të nën-pikave 83, 84, 85 pika 17.*

**Efkti:**

Keq raportim në pasqyrat financiare të konsoliduara

**Shkaku:**

Raportimi në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 për disa llogari të pasqyrave financiare

**Rëndësia:**

E mesme

**Rekomandimi:**

- Titullari i DPT të ngrëjë një grup pune me përfaqësues nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikave, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, etj., i cili të marrë masat për verifikimin dhe kryerjen e analizave të ndryshimit të fondit neto për DRT-të, si dhe problematikën e tjera trajtuar më sipër si dhe reflektuar në pasqyrën e konsoliduar, me

qëllim marrjen e masave për një pasqyrim më të drejtë të situatës financiare dhe rezultatet e tyre të pasqyrohen në shënimet shpjeguese.

Në kuadër të konsolidimit të pasqyrave financiare, titullari i DPT, nëpërmjet një sqarueseje apo guide udhëzuese të përcaktojë afatet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga vetë DPT: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, nga Drejtoria e Pagesave dhe Kontabilitetit, si dhe nga DRT-të për pasqyrat financiare të hartuara nga këto njësi duke parashikuar edhe takime mes palëve. Gjithashtu, të shqyrtojë edhe mundësinë e ri organizimit të strukturave në rast konstatimit të mbivendosjes së përgjegjësisë, për sa kohë autoriteti për miratimin e pasqyrave mbetet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të DPT.

**Afati:** Brenda vitit 2022

**Titulli i Gjetjes** **Problematika të konstatuara në skemën e kontabilizimit të të ardhurave nga tatim fitimi**

**Situata 9:** Nga auditimi konstatohet se ka lidhur me skemën e kontabilizimit të veprimeve rregulluese për llogarinë 466 -Kreditorë për mjete në ruajtje dhe llogarinë 520 -Disponibilitete në thesarë Më hollësisht, konstatohet se në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003, më datën 31.12.2021 paraqitet në shumën 134.4 miliardë lekë, ndërsa sipas sistemit C@ts teprica kreditore më datë 31.12.2021 është në vlerën 13.5 miliard lekë. Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2021. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@ts, por ky veprim nuk gjen pasqyrim në kontabilitet dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti, si një ÷detyrimo në pasivin e bilancit të DPT-së me kundërparti ollog.520 disponibilitete në thesarë. Në këto kushte, këto llogari paraqiten në pasqyrat financiare të DPT-së të mbivlerësuar krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme në C@ts, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme.

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021
<b>Gjendja Llog.466 më fillim viti</b>	<b>92.5 miliard lekë</b>	<b>115.4 miliard lekë</b>
Arkëtime gjate vitit	23 miliard lekë	27.2 miliard lekë
<b>Gjendja e llog.466 më fund viti</b>	<b>115.4 miliard lekë</b>	<b>134.4 miliard lekë</b>
<b>Nga të cilat:</b>		
Arkëtime (Të ardhura) të raportuara për zërin otatim mbi fitimin	21,4 miliard lekë	26.78 miliard lekë
Teprica kreditore sipas C@TS në fund viti	14.1 miliard lekë	13.5 miliard lekë

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Udhëzimi i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar; Ligji nr. 25, datë 11.05.2018 ÷Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, neni 10, pika 1: ÷Bazat dhe parimet mbështetëse.

**Efekti:** Konfuzion mbi vlefshmërinë e zërit të pasqyruar në vlerën 134.4 miliard lekë në bilancin e DPT, pasi një pasqyrim aktual lexohet si një detyrim për sistemin tatimor, dhe ka nevojë për një veprim sistemues.

**Shkaku:** Skema e kontabilizimit të aplikuar nga DPT, evidentuar edhe në 3 auditimet e fundit të KLSH-së.

**Rëndësia:** E mesme

- Rekomandimi:** - DPT të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE, të shqyrtojë situatën e mësipërme duke parashikuar në udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshme, skemën e kontabilizimit të duhur, në mënyrë që të garantohet raportimi i të dhënave të plota dhe me vërtetësi në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT.
- Afati:** Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

## 2.8 Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion.

Në zbatim të këtij drejtim auditimi u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Rregullore e brendshme e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore;
- Baza ligjore e nënligjore që specifikon trajtimin e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Listëpagesat e pagave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- Dosjet e personelit;
- Vendimet e gjykatës për punonjësit e larguar nga shërbimi civil, si dhe masat e marra nga institucioni në rastin ku punonjësi i larguar ka marrë një vendim të formës së prerë për pagesën e pagës deri në rikthimin e tij në punë;
- Komunikimi me Departamentin e Administratës Publike.

### Struktura organizative dhe marrëdhëniet e punës

#### 1. Struktura organizative

Struktura e Administratës Tatimore Qendrore është përcaktuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, i ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 152, datë 19.11.2020, “Për një ndryshim në miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. Nëpërmjet këtij ndryshimi është shtuar pozicioni *Koordinator në Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion*. Rrjeti i Koordinatorëve Anti-Korrupsion është një strukturë nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar kundër korrupsionit, Ministrit të Drejtësisë. Me Urdhërin e Kryeministrit nr. 106, datë 25.07.2019, *“Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion”*, të ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 86, datë 25.06.2020, përcaktohet krijimi dhe funksionimi i kësaj strukture, ku çdo institucion që është pjesë e këtij rrjeti ka në përbërjen e tij një koordinator.

Sipas urdhrave të sipërpërmendur të miratimit të strukturës, në Administratën Tatimore Qendrore, struktura organizative përmban 1 450 punonjës, nga ku 308 janë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe pjesa tjetër janë punonjës në Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT) si dhe në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM).

Referuar realizimit të strukturës, përgjatë vitit 2021, u konstatua, si më poshtë:

**Tabela nr. 1: Krahësimi plan-fakt i punonjësve në DPT për vitin 2021**

Muaji	Të punësuar	Planifikim	Fakt	Realizim në %
<b>Janar</b>		308	239	78%
<b>Shkurt</b>		308	251	81%
<b>Mars</b>		308	253	82%



<b>Maj</b>	308	256	83%
<b>Korrik</b>	308	256	83%
<b>Shtator</b>	308	256	83%
<b>Tetor</b>	308	260	84%
<b>Nëntor</b>	308	262	85%
<b>Dhjetor</b>	308	249	81%

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Konstatohet se përgjatë gjithë vitit, struktura organike është plotësuar në nivelin prej 84%. Vijueshmëria e mungesës së arritjes së realizimit të numrit të punonjësve sipas strukturës organike nga ana e DPT shfaq problematika në mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore për këtë institucion dhe për vijueshmërinë e punës në përgjithësi, atë të funksionimit institucional.

## 2. Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në Administratën Tatimore Qendrore rregullohen përmes Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Rregullores për marrëdhëniet e punës së personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 10, datë 31.01.2020, dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore për nëpunësit e shërbimit civil dhe ata jashtë shërbimit civil në ATQ.

Në zbatim të VKM nr. 1151, datë 24.12.2021 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, Titullari i Institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 3, datë 21.01.2021 “Për detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, pjesë e administratës tatimore”, si dhe Urdhrin nr. 3/1, datë 21.01.2021, “Për përcaktimin e kritereve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, pjesë e Administratës Tatimore”.

## 3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet shprehimisht në ligj që një vendim/akt administrativ i caktuar, që ka të bëjë me marrëdhëniet e shërbimit civil, është në kompetencën e një nëpunësi apo një organi tjetër posaçërisht të krijuar sipas këtij ligji, siç është Komisioni i Posaçëm i ngritur në zbatim të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015. Objekti i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është të ndjekë, zbatojë dhe sigurojë procedura për rekrutim, zhvillimin profesional dhe motivimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim arritjen e objektivave operacionale dhe objektivave të përcaktuara në planin strategjik të Administratës Tatimore dhe detyrave funksionale të Institucionit.

Detyrat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë:

- Ndjekja dhe sigurimi i hedhjes në sistemin *online* të Departamentit të Administratës Publike të vendeve vakante në ATQ dhe të procedurave të rekrutimit sipas shpalljeve të Departamentit të Administratës Publike për punonjësit e shërbimit civil dhe rekrutimin e punonjësve, të cilëve marrëdhëniet e punës u rregullohen sipas Kodit të Punës;
- Ndjekja dhe garantimi i një procesi real të vlerësimit të punës së nëpunësve/punonjësve të Administratës Tatimore Qendrore, sipas përcaktimeve në formularin e përshkrimit të punës dhe objektivave specifike dhe të përgjithshme, respektivisht të strukturës përkatëse dhe institucionit;
- Sigurimi i ngritjes profesionale të stafit të DPT-së, nëpërmjet një procesi trajnimi dhe zhvillimi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, që ka të bëjë me evidentimin e dobësive dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve;

- Mbikëqyrja për zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e masave disiplinore për nëpunësit/punonjësit për të cilët konstatohet shkelje e dispozitave ligjore në fuqi, gjatë ushtrimit të detyrës funksionale.

**Tabela nr.2: Struktura e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Dhjetor 2021**

<b>Drejtoria e Burimeve Njerëzore</b>			
<b>Pozicioni</b>	<b>Numër</b>		<b>Kategoria e pagës</b>
<b>Drejtor Drejtorie</b>	1		III-a
<b>Spektori i Rekrutimit dhe Promovimit</b>	<b>6</b>		
Përgjegjës Spektori	1	Vakant	III-a/1
Specialist	1		IV- a
Specialist	1		IV- a
Specialist	1		IV- a
Specialist	1		IV- a
Specialist	1	Vakant	IV- a
<b>Spektori i Trajnimit dhe Vlerësimit</b>	<b>4</b>		
Përgjegjës Spektori	1		III-a/1
Specialist	1		IV- a
Specialist	1		IV- a
Specialist	1	Vakant	IV- a

*Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit*

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka të përcaktuar në strukturë 11 pozicione pune dhe është e organizuar në dy sektore:

1. *Spektori i Rekrutimit dhe Promovimit* (1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë) me 2 vakanca në fund të muajit dhjetor 2021.
2. *Spektori i Trajnimit dhe Vlerësimit* (me 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë) me 1 vakancë në fund të muajit dhjetor 2021.

Përgjatë vitit 2021 rezultoi se DBNJ ka ushtruar veprimtarinë e saj me 3 vende vakante të paplotësuara gjatë gjithë periudhës së audituar. Në këtë mënyrë, kjo drejtori nuk ka funksionuar me maksimumin e kapaciteteve të saj, por ka vepruar vetëm me rreth 72% të kapacitetit. Kjo mungesë stafi sjell ulje të efektivitetit dhe efencës në punë për DBNJ.

#### **4. Administrimi i pagave**

Sa i përket pagave të punonjësve të sistemit të tatimeve, ato përcaktohen në VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8 dhe për punonjësit me arsim të mesëm në VKM nr. 717 datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore”, i ndryshuar, lidhja 1.

Grupi i auditimit, për të verifikuar rregullshmërinë e kryerjes së pagesave të punonjësve në raport me përcaktimet e akteve të sipërpërmendura, përzgjedhi listëpagesat e muajve Janar dhe Dhjetor 2021. Në listëprezencat e audituara, të muajve Janar dhe Dhjetor 2021, rezultuan të nënshkruara nga titullarët e drejtorive dhe të shoqëruara me raporte mjekësore, në raste të mungesës shëndetësore të punonjësit.

**Tabela nr. 3: Të dhënat për pagat në DPT 2021 (Në lekë)**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Janar</b>	<b>Dhjetor</b>
1	Shpenzime për pagat	15.748.041	17.322.852
2	Kontribute shoqërore & shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat personale	3.875.100	4.040.219

	<b>TOTAL</b>	<b>19.417.541</b>	<b>20.625.702</b>
--	--------------	-------------------	-------------------

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, përmes shkresës nr. 146 Prot., datë 07.01.2021, i është kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të vihet në dispozicion vjetërsia e pagueshme për 53 punonjës të DPT. Gjithashtu, përmes shkresave nr. 7875/1 Prot., datë 06.05.2021, dhe nr. 8176 Prot., datë 06.05.2021, konstatohet se përcjellja e informacionit mbi arsimimin dhe vjetërsinë për efekt pagese, është realizuar me vonesë nga ana e DBNJ dhe jo direkt në momentin e emërimit të punonjësve të rinj, që mund të sjellë risqe në ekzekutimin e buxhetit. Pavarësisht se niveli arsimor përcaktohet në aktin e emërimit të punonjësit, mbetet e nevojshme që drejtoritë përkatëse të kontrollojnë informacionin mbi arsimin, me qëllim verifikimin e tij për të pasqyruar sa më qartë realitetin. Përgjatë vitit konstatohet vonesa e korrespondencave mes DFB dhe DBNJ, lidhur me informacionin e nevojshëm për arsimimin dhe vjetërsinë në punë për efekt page, në rastet e emërimeve, ndryshimeve të pozicionit apo largimeve. Përgjatë vitit 2021 me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, ka patur korrespondenca lidhur me informacionin për vjetërsinë në punë pasqyruar me memot nr. 15142 Prot., datë 27.01.2021, nr. 7875 Prot., datë 30.04.2021, nr. 12057 Prot., datë 20.06.2021, nr. 17458/1 Prot., datë 29.09.2021, nr. 20028 Prot., datë 05.11.2021, nr. 21351 Prot., datë 26.11.2021.

### **5. Dosjet e personelit**

Për të audituar administrimin e dosjeve të personelit, në raport me kërkesat e Lidhjes 1 *ōTē dhēnat dhe dokumentacioni i dosjes së personelitō* të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *ōPër rregullat e hollēsishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit, grupi i auditimit përzgjedhi 23 dosje personeli.*

Nga auditimi u konstatua se në dosjet e personelit vihen re mungesa të dokumentacionit të nevojshëm të dosjes, si librezat e punës, ndërsa në rastet e dosjeve të punonjësve që janë larguar, vihet re mungesa e aktit të dorëzimit të punës së tyre përpara largimit. Nga 16 dosje të punonjësve të larguar, vetëm 8 prej tyre kishin të inventarizuar aktin e dorëzimit të dokumentacionit dhe punës përpara largimit, pra vetëm 50%. Në të njëjtën kohë, vlerësimet vjetore të punonjësve për vitin 2021, nuk janë të vendosur në dosjet e personelit, pasi janë mbajtur në dosje të veçanta përgjatë vitit. Lidhur me vlerësimet që janë kërkuar nga ana e grupit të auditimit, janë vënë në dispozicion vetëm një pjesë e tyre, ku sërish shfaqen mangësi.

Grupi i auditimit konstaton se dosjet e personelit nuk kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të Lidhjes 1 *ōTē dhēnat dhe dokumentacioni i dosjes së personelitō* të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *ōPër rregullat e hollēsishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelitō.*

### **6. Përshkrimi i punës**

Kreu IV *ōProcedura dhe formati i përshkrimit të punësō* të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, *ōPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavaruraō*, i ndryshuar, përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësive kryesore të pozicionit respektiv të punës. Ai shërben, ndër të tjera, për përcaktimin e kërkesave të veçanta për çdo pozicion pune. Pika 14 e VKM-së përcakton se përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni. Germa *ōcō* e pikës 18 të VKM-së përcakton se përshkrimi i punës miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, për ministrinë dhe institucionet në varësi të ministrit.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga DBNJ përmes databazës në format elektronik për përshkrimet e punës të Drejtorisë së Hetimit Tatimor dhe Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, vihen re se në 3 raste është deklaruar “*Përshkrim i ri pune*” në pozicionet:

1. Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ó DPT (përshkrim i ri);
2. Përgjegjës Sektori në Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës, Drejtoria e Hetimit Tatimor ó DPT (përshkrim i ndryshuar);
3. Inspektor Hetimi në Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës, Drejtoria e Hetimit Tatimor ó DPT (përshkrim i ri).

Duke qenë se përgjatë vitit 2021, nuk ka patur ndryshime në strukturën e ATQ-së, në rregulloren e funksionimit, apo në mënyrën e organizimit të DPT, konstatohet se këto ndryshime nuk janë në përputhje me pikën 14 të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura, i ndryshuar.*

Nga auditimi u konstatuan raste që, për të njëjtin pozicion pune, me përshkrim pune të njëjtë, të ketë kërkesa të veçanta të ndryshme në nivelin e arsimit të kërkuar, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ka në strukturën e saj 24 vende, ku 20 prej tyre janë Inspektor i Parë me pagë të nivelit III-b. Nga këto 20 vende, 15 prej tyre kanë si kriter pasjen e një diplome minimalisht Master Shkencor, ndërsa 5 prej tyre diplomën Master Profesional. Gjithashtu, vihen re diferencime në përshkrimet e punës në fushën e studimit, ku nga 20 vende Inspektor i Parë, 18 kanë si kriter diplomën në Shkenca ekonomike/juridike dhe vetëm 2 prej tyre kanë kriter diplomën në Shkenca Shoqërore. Diferencimet e tilla në nivelin arsimor dhe në fushën e studimit janë të paargumentuara, përderisa inspektorët kryejnë të njëjtin funksion dhe kanë të njëjtin përshkrim pune, sidomos kur janë punonjës të të njëjtit sektor. Lidhur me numrin minimal të viteve të punës si kriter punësimi, të gjithë inspektorët e kësaj Drejtorie kanë të njëjtin kriter: minimalisht 2 vite eksperiencë të mëparshme pune.

Përsa i përket Drejtorisë së Hetimit Tatimor, kjo drejtori ka në organikën e saj 60 vende, ku kriteret arsimore dhe ato të eksperiencës së mëparshme të punës variojnë edhe brenda sektorëve. Në Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës, struktura përmban 11 pozicione pune Inspektor i Parë me nivelin e pagës III-b, ku 6 prej tyre kanë si kriter pasjen e një diplome Master Shkencor dhe 5 me diplomë Master Profesional. Përsa i përket eksperiencës së punës, përshkrimi i punës i një prej pozicioneve Inspektor i Parë brenda këtij sektori kërkon 0 vite të mëparshme eksperiencë punë, ndërkohë që 10 përshkrimet e tjera kërkojnë minimalisht 2 vite si eksperiencë të mëparshme pune për t'u punësuar në këtë pozicion.

Spektori i Hetimit Tatimor ka në organikë 42 pozicione pune si Inspektor i Parë me pagën e nivelit III-b. Prej tyre në 33 pozicione, përshkrimet e punës kërkojnë si kriter minimal pasjen e një diplome të nivelit Master Shkencor, ndërsa në 9 pozicione përshkrimet e punës kërkojnë nivelin e arsimimit Master Profesional. Në këtë sektor, në rastet kur niveli minimal i kërkuar i arsimimit është Master Profesional, kërkohet minimalisht 1 vit eksperiencë e mëparshme pune, ndërsa në rastet e kriterit Master Shkencor, përshkrimi përmban kriterin e minimalisht 2 viteve eksperiencë punë.

Në Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, organika përmban 3 pozicione si Inspektor me pagën e nivelit IV-a, ku niveli minimal i arsimimit është diploma në Master Profesional dhe minimalisht 2 vite eksperiencë të mëparshme pune.

Në nivelin Drejtor Drejtorie dhe Përgjegjës Sektori, nuk ka diferencime në kriteret e përshkrimit të punës në të dyja këto Drejtori.

**Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme pune.**

**1.Rekrutimi**

Për periudhën objekt auditimi, emërimet në DPT, janë kryer duke u bazuar në:

- Urdhërin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, òPër miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013 òPër nëpunësin civil, i ndryshuar;
- Kodi i Punës në RSH, ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar;
- VKM nr. 586, datë 30.8.2019 òPër punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, i ndryshuar;
- VKM nr. 47, datë 22.01.2020, òPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore;
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 10, datë 31.01.2020 òPër miratimin e regullores për marrëdhëniet e punës së personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore;
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 3, datë 21.01.2021 òPër detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, pjesë e Administratës Tatimore dhe Urdhër nr. 3/1, datë 21.01.2021, òPër përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, pjesë e Administratës Tatimore.

Grupi i auditimit, përgjatë shqyrtimit të databazave të punonjësve, si dhe të dokumentacioneve shoqëruese, ka konstatuar se, për vitin 2021, në Administratën Tatimore ka patur 212 rekrutime, nga ku 165 punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe 47 punonjës me Kod Pune. Evidentohet se degët me numrin më të lartë të rekrutimeve janë DPT me 71 rekrutime, DRT Tiranë me 51 rekrutime dhe DRT Fier me 25 rekrutime.

**Tabela nr. 4: Përmbledhje e emërimeve të reja në ATQ për vitin 2021**

<b>DPT</b>	<b>Shërbim Civil</b>	<b>42</b> 32 emërimet nga DAP; 9 emërimet bazuar në vendime gjyqate; 1 emërim në nivel drejtues.
	<b>Me kod pune</b>	<b>29</b> 19 emërimet të reja në nivel Inspektor/Inspektor i Parë, nga ku 5 janë punonjës ekselentë; 9 emërimet në nivel drejtues; 2 punonjës mirëmbajtje; 1 protokollist.
<b>DRT</b>	<b>Shërbim Civil</b>	<b>123</b> 59 emërimet nga DAP; 64 emërimet bazuar në vendime gjyqate.
	<b>Kod Pune</b>	<b>18</b> 9 emërimet të reja në nivel Inspektor; 3 llogaritarë/arkëtarë; 2 shoferë; 1 korrier; 1 sekretare; 1 protokollist/arkivist; 1 magazinier.

*Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve brenda shërbimit civil, konstatohet se procedurat e ndjekura për konkurrim dhe shpalljen fitues janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke qenë se këto lloj emërimesh kalojnë përmes dy institucioneve: DPT dhe DAP. Në këto emërimë bëjnë pjesë dhe emërimet përmes Thirrjes nr. 3 të Ekselencës.

### 1.1.Punonjësit pjesë të shërbimit civil

Procedura e rekrutimit në Administratën Tatimore Qendrore për punonjësit pjesë të shërbimit civil rregullohet nga Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.


Në zbatim të pikës 4 të VKM nr. 108 datë 26.02.2014 *“Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”*, ku citohet se çdo institucion i administratës shtetërore përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, nga auditimi rezultoi se:

DAP përmes shkresës nr. 6336 Prot., datë 27.11.2020, i ka kërkuar DPT planifikimin e nevojave për pranin në shërbimin civil për vitin 2021. DPT në përgjigje të kësaj kërkesë, ka dorëzuar pranë DAP planifikimin vjetor të vendeve vakante. Shkresa e DPT nr. 24611 Prot., datë 21.12.2020, specifikon këtë plan rekrutimi. Rezulton se shkresa citon nevojat për rekrutim, si më poshtë: *“130 vende vakante në të gjithë ATQ, të cilat priten të përmbushen përgjatë vitit 2021. Nga këto 130 vende vakante, 38 vende vakante i përkasin DPT, ndërsa pjesa tjetër prej 92 vendesh vakante u përkasin DRT.”* Ky planifikim i referohet planifikimit për pozicione në shërbim civil.

Gjatë vitit 2021, DAP ka nxjerrë 61 shpallje për vendet vakante në ATQ. Nga këto 61 shpallje për 62 vende vakante, 11 prej tyre nuk kanë fitues, 7 prej tyre janë në proces. Pjesa tjetër prej 44 vendesh vakante, janë plotësuar me fituesit e shpallur.

Pra, nga shpalljet në DAP të vendeve vakante në ATQ, janë plotësuar rreth 70% e tyre. Nga të gjitha shpalljet, 8 prej tyre janë të nivelit Drejtor Drejtorie/Drejtor Rajonal/Zv. Drejtor i Përgjithshëm i DPT, 5 janë të nivelit Përgjegjës Sektori, 20 të nivelit Inspektor i Parë, 18 të nivelit Inspektor i Dytë dhe 10 të nivelit Specialist. Ndër këto, 5 shpallje janë pjesë e Thirrjes 3 të Ekselencës, ku bëjnë pjesë 4 shpallje Inspektor i Parë dhe 1 shpallje Specialist.

Grafiku 1: Përbërja e shpalljeve nga DAP për vendet vakante të ATQ përgjatë 2021



Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Duke qenë se për të gjitha pozicionet vakante brenda shërbimit civil, procedura e rekrutimit ndiqet në DAP, për vitin 2021, DPT ka kërkuar gjithsej 130 shpallje për vendet vakante në ATQ. Ndërkohë DAP ka realizuar 61 shpallje përgjatë gjithë vitit, pra rreth 47% të nevojave për rekrutim. Nga 130 vende vakante janë plotësuar 44 prej tyre, pra 34%.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve brenda shërbimit civil, konstatohet se procedurat e ndjekura për konkurrim dhe shpalljen fitues janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke qenë se këto lloj emërimesh kalojnë përmes dy institucioneve: DPT dhe DAP. Në këto emërimë bëjnë pjesë dhe emërimet përmes Thirrjes nr. 3 të Ekselencës.

## **1.2. Punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil**

Përpos stafit nga shërbimi civil, ATQ ka edhe staf që rregullohet me kod pune, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës dhe nga Rregullorja për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore, e miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT nr. 10, datë 31.01.2020, përkatësisht në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe në drejtoritë, si më poshtë:

1. Drejtoria e Hetimit Tatimor;
2. Drejtoria e Verifikimit dhe e Koordinimit në Terren;
3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen përmes Kodit të Punës, janë evidentuar problematikat si më poshtë.

Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në strukturat përkatëse të tyre në Rajonet Qendrore, Veriore dhe Jugore, vihet re një nivel i lartë i ndryshueshmërisë së punonjësve përmes Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve oLirim dhe emërim në detyrë. Për vitin 2021, grupi i auditimit nga të dhënat e vendosura në dispozicion ka konstatuar se vetëm në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT dhe strukturat e hetimit në DRT ka patur 6 Lirime dhe emërimë në detyrë, si dhe 5 largime. Ndërkohë në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe në struktura përkatëse në DRT ka patur 9 Lirim dhe emërim në detyrë, dhe 10 largime përgjatë vitit 2021. Niveli i konsiderueshëm i ndryshueshmërisë të këtyre pozicioneve është justifikuar në memo-t përkatëse me nevojat e punës në këto struktura. Megjithatë, këto ndryshime të shpeshta tregojnë se menaxhimi i burimeve njerëzore dhe planifikimi nuk ka qenë efikas.

Referuar nenit 72 të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore, drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ka për detyrë përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë menaxhuese dhe planeve operacionale për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim, sipas vendeve të lira të krijuara, në bashkëpunim me zv. Drejtorin e Përgjithshëm. Nga auditimi u konstatua se një akt i tillë nuk është hartuar për punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohet përmes Kodit të Punës, por është hartuar vetëm planifikimi i vendeve vakante për punonjësit e shërbimit civil që është përcjellë në DAP. Ky akt do të ishte akti i vetëm në cilësinë e një planifikimi ose strategjie, ku do të përfshiheshin edhe strukturat, punonjësit e të cilave nuk janë pjesë e shërbimit civil. Mungesa e këtij plani operacional dhe strategjie menaxhuese, ka sjellë lëvizje të shpeshta brenda këtyre strukturave, që çënon mbarëvajtjen e punës dhe efektivitetin e këtyre strukturave.

## **1.3. Emërimet e punonjësve me kontrata shërbimi**

Në zbatim të VKM nr. 1151, datë 24.12.2021, oPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore, Titullari i Institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 3, datë 21.01.2021, oPër detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, pjesë e administratës tatimore, si dhe Urdhrin nr. 3/1, datë 21.01.2021, oPër përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, pjesë e Administratës Tatimore.

Bazuar në VKM nr. 1151/2021, si dhe në Urdhrat e Titullarit të DPT, për vitin 2021, janë planifikuar gjithsej 372 punonjës me kontratë shërbimi për ATQ, specifikisht 328 punonjës shërbimi me kontratë 6 mujore 8 orë në ditë, 40 punonjës shërbimi me kontratë vjetore 6 orë në ditë, si dhe 4 sanitarë me

kontratë vjetore 6 orë në ditë. Përsa i përket aparatit të DPT, ndahen si në vijim: 35 punonjës shërbimi me kontratë 6 mujore 8 orë në ditë, 6 punonjës shërbimi me kontratë vjetore 6 orë në ditë, si dhe 2 sanitarë me kontratë vjetore 6 orë në ditë. Mbi këtë planifikim, ATQ-ja ka përdorur burimet e saj financiare për të punësuar punonjës me kontrata shërbimi përgjatë vitit 2021. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga DPT, përgjatë vitit 2021 janë nënshkruar 336 kontrata shërbimi, që do të thotë se ka patur kontrata shërbimi të pashfrytëzuara përgjatë vitit. Rreth 90% e planifikimit vjetor për punonjësit me kontratë është realizuar nga ana e DPT.

## 2.Largimet

Përgjatë vitit 2021 janë larguar nga puna gjithsej 68 punonjës, prej të cilëve 35 punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe 33 të punësuar me kod pune. Ashtu siç është evidentuar edhe në tabelën nr. 1, kryeson DPT me 25 largime në total, e pasuar nga DRT Tiranë me 17 largime.

Sipas tabelës së mëposhtme me të dhëna të përmbledhura, përgjatë vitit 2021 në DPT janë larguar 25 punonjës gjithsej, ndërsa nga DRT janë larguar 43 punonjës.

**Tabela nr. 5: Përmbledhje e largimeve në ATQ për vitin 2021**

<b>DPT</b>	<b>Shërbim Civil</b>	<b>12</b> 10 të liruar nga detyra me kërkesën e tyre; 1 i liruar nga detyra; 1 i liruar nga shërbimi civil me nismë të DPT.
	<b>Me kod pune</b>	<b>13</b> 7 të larguar nga detyra me kërkesën e tyre; 6 të larguar me zgjidhje të menjëhershme të kontratës nga ana e punëdhënësit.
<b>DRT</b>	<b>Shërbim Civil</b>	<b>23</b> 17 të liruar nga detyra me kërkesën e tyre; 2 të liruar nga shërbimi civil; 1 i larguar me masë disiplinore ÷Largim nga shërbimi civil; 2 të liruar nga shërbimi civil për shkak të ndarjes nga jeta; 1 i liruar nga shërbimi civil për shkak të paaftësisë shëndetësore.
	<b>Kod Pune</b>	<b>20</b> 8 të liruar nga detyra me kërkesën e tyre; 6 të larguar me zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës; 2 të liruar nga detyra; 3 të larguar me masë disiplinore ÷Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës; 1 i larguar me zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.

*Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit*

Procedura e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit që nuk janë pjesë të shërbimit civil rregullohet nga Kodi i Punës dhe Rregullorja për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore, e miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT nr. 10, datë 31.01.2020.

### Të larguarit me Kod Pune nga strukturat e Hetimit Tatimor

Drejtorja e Hetimit Tatimor është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila ka në organigramën e saj 60 vende pune. Në Janar 2021, Drejtoria e Hetimit Tatimor paraqitet me 6 vende vakante dhe në fund të Dhjetorit 2021, me 7 vende të paplotësuara. Përgjatë vitit 2021 ka patur disa lëvizje në sektorët e kësaj drejtorie. Hetimi Tatimor është një strukturë, punonjësit e së cilës punësohen në bazë të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës së RSH, i ndryshuar. Vendimmarrja për largimin nga puna është kompetencë e titullarit, në cilësinë e punëdhënësit. Nga kjo strukturë konstatohet se janë larguar 4 punonjës përgjatë vitit 2021. Sipas shkresave për zgjidhjen e kontratave të



punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, këto largime janë kryer për shkak të kërkesës së vetë punonjësit në 3 raste dhe për mospërputhje arsimit në njërin prej rasteve. Në dosjet e shqyrtuara në këtë drejtori, nuk janë konstatuar parregullsi për largimet përgjatë vitit 2021.

Ndërkohë, struktura e Hetimit Tatimor, Rajoni Verior, ka patur një largim përgjatë vitit 2021 që ka ardhur si pasojë e ecurisë disiplinore për punonjës të K.K., procedurë e inicuar nga DIBA.

**Tabela nr. 6: Punonjësit e larguar nga strukturat e Hetimit Tatimor përgjatë vitit 2021**

Nr.	Punonjësi	Struktura
1	K.K.	DVKT ó Rajoni Verior, DRT Shkodër (larguar si pasojë e ecurisë disiplinore)
2	E.S.	Spektori i Hetimit Tatimor, Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT (larguar me kërkesën e tij)
3	E.K.	Spektori i Hetimit Tatimor, Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT (larguar me kërkesën e tij)
4	E.S.	Spektori i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT (zgjidhje e kontratës për mospërputhje arsimit)

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

### Të larguarit me Kod Pune nga Drejtoria e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren

Drejtoria e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren është një strukturë pjesë e DPT-së, e cila ka si objekt pune zbulimin dhe dënimin e shkeljeve të legjislacionit tatimor të kryera nga tatimpaguesit, duke u mbështetur plotësisht në ligjin e procedurave tatimore, mbledhjen e informacioneve mbi rastet e ankesave dhe trajtimin tyre, si dhe pasqyrimin e të gjitha të dhënave analitike mbi kontrollet e kryera. Njëjtë si Drejtoria e Hetimit Tatimor, edhe kjo strukturë bazohet në Kodin e Punës së RSH-së lidhur me rekrutimet apo largimet e punonjësve. Rrjedhimisht vendimmarrja për largimin nga puna është kompetencë e titullarit. Nga kjo drejtori në DPT ka patur 5 largime përgjatë vitit 2021, dhe 3 largime nga DVKT Rajoni Jugor, të cilat janë analizuar nga grupi i auditimit si vijon.

Nga auditimi me përzgjedhje të 25 praktikave të largimeve nga puna, u konstatuan 8 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sikurse cituar në vendimet përkatëse, òPër arsye performance të ulët në punë dhe ankesave të ardhura, si më poshtë:

**Tabela nr. 7: Dosjet e punonjësve të larguar për arsye performance dhe ankesa të tatimpaguesve nga strukturat e VKT, përgjatë vitit 2021**

Nr.	Punonjësi	Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të DPT
1	I.I.	Nr. 257, datë 12.11.2021
2	E.Rr.	Nr. 256, datë 12.11.2021
3	K.Sh.	Nr. 255, datë 12.11.2021
4	E.M.	Nr. 252, datë 12.11.2021
5	H.G.	Nr. 253, datë 12.11.2021
6	K.I.	Nr. 43, datë 17.02.2021
7	D.F.	Nr. 247, datë 12.11.2021
8	A.B.	Nr. 248, datë 12.11.2021

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

- Sa i përket vlerësimit të performancës:

Neni 37 òVlerësimi i performancës ò i Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT nr. 10, datë 31.01.2020, përcakton se òSistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave. që realizohet brenda vitit kalendarik, dhe neni 39 òSistemi i vlerësimit ò përcakton se òAta punonjës të cilët vlerësohen jokënaqshëm (4) propozohen për zgjidhje të kontratës në punë.

Deri në datën e vendimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, janë analizuar vlerësimet e mëparshme të punës për këta punonjës, të cilat nuk përbëjnë bazë për ndërprerjen e kontratës së punës pasi nuk janë vlerësuar me òjokënaqshëm.

Grupit të auditimit u janë vënë në dispozicion vlerësimet vjetore të këtyre punonjësve, që u përkojnë datës 31.12.2021, por këto vlerësime janë të nënshkruar vetëm nga eprori direkt dhe titullari, e jo nga vetë punonjësi.

- Sa i përket vlerësimit të ankesave, Neni 32 i Rregullores parashikon se *“Eprori direkt kryesisht, ose nëpërmjet ankesave, rekomandimeve, bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara, përkundrejt punonjësit në varësi të tij dhe i propozon Titullarit të administratës tatimore fillimin e procedimit disiplinorë. Bashkëlidhur Vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënies të punës nuk kishte një praktikë të tillë.*

Në vendimet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, veç të tjerash, vendoset:

- T’u jepet punonjësit shpërblim për lejen takuese të pakonsumuar;
- T’u jepet punonjësit shpërblim sipas nenit 144 pika 5 të Kodit të Punës;
- T’u jepet punonjësit shpërblim për afatin e njoftimit në masën e 1 ose 2 pagash mujore, bazuar në kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, në varësi të rastit.

Neni 144 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë përcakton procedurën dhe afatet që duhet të ndiqen për zgjidhjen e kontratës nga punëdhënësi dhe, pika 5 e këtij neni, që është dhe referenca ligjore e përmendur në vendimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, citon se *“Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e parashikuar në këtë nen, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera.*

Sa i takon shpërblimit për vjetërsi, neni 145 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë përcakton se *“Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm, për shkaqe të arsyeshme.*

Sa më sipër, konstatohet se procedurat e ndjekura për ndërprerjen e marrëdhënies të punës nuk janë në përputhje me parashikimin në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për më tepër, ky numër të larguarish me vendime që nuk janë të mirëarsyetuara dhe mirëbazuara në ligj, përbën risk potencial për rritjen e detyrimeve nga vendimet gjyqësore të DPT në të ardhmen.

### **Mbi largimet nga puna me komision disiplinor**

Neni 37 i Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë pika 3 dhe Neni 12 Masat Disiplinore të Kontratës Individuale të punës, citojnë se llojet e masave disiplinore janë:

- a. Vërejtje me shkrim
- b. Vërejtje me paralajmërim, për largim nga detyra
- c. Largim nga detyra

Përgjatë vitit 2021, janë shqyrtuar 43 raste të shkeljeve disiplinore nga ana e Komisionit Disiplinor në DPT, nga ky 27 kanë qenë raste të punonjësve brenda shërbimit civil dhe 16 të tjera raste të punonjësve jashtë shërbimit civil, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet përmes Kodit të Punës. Nga këto raste të shqyrtuara, vetëm 4 prej tyre kanë marrë masën maksimale të zgjidhjeve të menjëhershme të kontratës së punës dhe të largimit nga shërbimi civil, përkatësisht për punonjësit: K.K. ó Inspektor në DVKT ó Rajoni Verior, DRT Shkodër; E.A. ó Inspektor në DVKT ó Rajoni Jugor, DRT Fier; G.M. ó Inspektor në DVKT ó Rajoni Jugor, DRT Fier; dhe P.O. ó Drejtorja e Kontrollit, DRT Tiranë.

Ndërkohë në 12 raste të tjera, është ndërprerë ecuria disiplinore duke përfunduar në këtë mënyrë procedurën. Nga të 43 rastet e shkeljeve të shqyrtuara përgjatë vitit 2021, janë mbyllur si procedurë 36 prej tyre, 3 janë në proces vendimmarrje, për 3 raste është kërkuar zgjatje afati, dhe 1 rast gjendet nën hetim administrativ.

Përveç eprorëve direktë, drejtorive ku punonjësi bën pjesë, ose Drejtorisë së Kontrollit, DIBA është një nga propozuesit për marrjen e masave disiplinore me qëllim inicimin e procedurës, duke propozuar 10 raste: 7 raste propozuar nga DIBA dhe 3 raste propozuar nga DIBA në bashkëpunim me DVKT ó Rajoni Verior.

### Mbi transferimet e përkohshme dhe të përhershme

Në DPT përgjatë vitit 2021, ka patur 23 transferime të punonjësve në shërbim civil në ATQ, prej të cilëve:

Në DPT: 1 transferim i përkohshëm dhe 3 transferime të përhershme;

Në DRT: 8 transferime të përkohshme dhe 11 transferime të përhershme.

Dy transferime të përhershme në DPT dhe 3 transferime të përhershme në DRT kanë ardhur si rezultat i ristrukturimit të ATQ në vitin 2020, efekte të cilat janë shtrirë edhe në vitin 2021. Nga auditimi konstatohet se nuk është tejkaluar afati i parashikuar për transferimin e përkohshëm të nëpunësve civil.

Tabela nr. 8: Përmbledhje e transferimeve në ATQ për vitin 2021

<i>Punonjësi</i>	<i>DPT/DRT</i>	<i>Lloji i transferimit</i>	<i>Data e vendimit</i>
J. D.	DRT Durrës	Transferim i përkohshëm 6 muaj	28.01.2021
A. L.	DRT Tiranë	Transferim i përkohshëm 6 muaj	11.01.2021
E. Ç.	DTM	Transferim i përkohshëm 6 muaj	15.02.2021
A. Ç.	DRT Tiranë	Transferim i përkohshëm 6 muaj	09.02.2021
E. D.	DRT Tiranë	Transferim i përkohshëm 6 muaj	10.03.2021
A. P.	DRT TPM	Transferim i përkohshëm 6 muaj	06.04.2021
A. L.	DRT Korçë	Transferim i përkohshëm 6 muaj	21.05.2021
J. D.	DRT Korçë	Transferim i përhershëm	13.12.2021
B. LL.	DRT Tiranë	Transferim i përhershëm (Ristrukturim)	26.01.2021
Y. S.	DTM	Transferim i përhershëm	07.01.2021
SH. A.	DRT Tiranë	Transferim i përhershëm (Ristrukturim)	06.01.2021
S. G.	DRT Berat	Transferim i përhershëm (Ristrukturim)	07.01.2021
M. R.	DRT Tiranë	Transferim i përhershëm	15.02.2021
E. M.	DRT Gjirokastrë	Transferim i përhershëm	06.04.2021
V. Ç.	DRT Fier	Transferim i përhershëm	07.06.2021
M. X.	DRT Tiranë	Transferim i përhershëm	13.07.2021
A. D.	DRT Tiranë	Transferim i përhershëm	23.08.2021
D. I.	DTM	Transferim i përhershëm	16.12.2021
I. B.	DRT Tiranë	Transferim i përhershëm	29.12.2021
H. H.	DPT	Transferim i përkohshëm 6 muaj	13.10.2021
O. O.	DPT	Transferim i përhershëm (Ristrukturim)	06.01.2021
M. A.	DPT	Transferim i përhershëm (Ristrukturim)	06.01.2021
F. K.	DPT	Transferim i përhershëm	17.03.2021

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

### Trajnimi i punonjësve të ATQ

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, punonjësit e ATQ janë trajnuar përmes platformës online Zoom, ku është përcaktuar edhe kalendarin i trajnimeve ku përcaktohet data dhe kohëzgjatja e trajnimit. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përcakton programe trajnimi në përmbushje të detyrave e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të ATQ për DBNJ, Neni 70, pika 2, “Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore” si dhe në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 3.1. *Mjedisi i kontrollit të brendshëm, në paragrafet “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”*. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka përcaktuar trajnimet që duhet të ndiqen nga punonjësit. Për vitin 2021 janë organizuar 28 trajnime online ku specifikohen: 9 trajnime online për punonjësit e rinj në periudhë prove, 13 trajnime për punonjësit e nivelit vazhdues, dhe 6 trajnime për punonjësit e nivelit drejtues. Tematikat e trajnimeve variojnë nga Procedurat Tatimore, Fiskalizimi, Sistemi C@ts, Legjislacioni mbi Procedurat Tatimore, dhe deri tek Kontabiliteti.

### Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë

Urdhri i Ministrit të Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike nr. 5151, datë 28.10.2015 *“Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”* citon se “Çdo institucion i administratës shtetërore ka detyrimin të krijojë dhe përditësojë databazën e të dhënave gjyqësoreë.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka krijuar dhe përditësuar këtë databazë vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Për vitin 2021, rezultojnë 51 çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë. Prej këtyre, 49 janë padi ku palë e paditur është DPT, dhe 2 çështje ku DPT është palë paditëse dhe palë e paditur është KMSHC.

Nga këto 49 çështje të reja në total për vitin 2021, 11 janë padi të ngritur nga ish-nëpunës me status të nëpunësit civil, 37 nga punonjës të larguar, marrëdhënia e punësimit të cilëve ka qenë e rregulluar me kod pune, dhe 1 çështje e ngritur nga Albtelecom ndaj DPT për pagim faturash.

Nga këto 53 padi të reja, 11 u përkasin ish-punonjësve me status të nëpunësit civil dhe 37 ish-punonjësve të punësuar sipas procedurave të Kodit të Punës. Paditë e mbetura (tre të tilla) janë padi administrative, ku në dy raste DPT ka paditur Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe në rastin tjetër kompania Albtelecom ka paditur DPT për pagim faturash.

Tabela nr. 9: Përmbledhja e çështjeve gjyqësore për ish-punonjësit me status

<i>Nr. i çështjeve</i>	<i>Statusi i procesit ligjor</i>
11 - Shkalla e I në proces	Çështje në proces - 11
97 - Shkalla e II në proces (+1 Pushuar)	Çështje në proces Apel - 83
4 - Formë e prerë	(79 në proces + 4 formë e prerë) Ish-punonjës me status civil

Burimi: Drejtoria e Teknikës dhe Ligjore, përpunuar nga grupi i auditimit

Përgjatë vitit 2021, kanë rezultuar 11 vendimmarrje të formës së prerë nga gjykata, ku 10 padi janë ngritur nga ish inspektorë të ATQ dhe 1 padi e ngritur nga një ish specialist i ATQ.

Tabela nr. 10: Likuidimet e vitit 2021 për vendimet gjyqësore të formës së prerë për ATQ

<b>Nr. Total kreditori</b>	<b>Likuidimi neto i gjyqfituesit Prill 2021</b>	<b>Likuidimi neto i gjyqfituesit Dhjetor 2021</b>	<b>Likuiduar në total 2021</b>
<b>196</b>	<b>28.467.305</b>	<b>157.998.933</b>	<b>186.466.238</b>

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është vënë në dispozicion databaza e pagesave të kryera deri në vitin 2021 si dhe përgjatë vitit 2021. Deri në vitin 2021, janë likuiduar 165 individë, nga ku janë paguar në total 975,113,715 lekë të cilat ndahen në 790,630,245 lekë shpenzime për gjyqfituesit, 44,946,396 lekë shpenzime përmbartimore dhe 139,530,074 lekë tatim në burim. Gjatë vitit 2021 janë paguar nga DPT shpenzime gjyqësore për 196 ish punonjës gjithsej në vlerën **186,466,238 lekë**, të ndara në dy këste: një këst në periudhën Prill 2021, dhe një këst tjetër në periudhën Dhjetor 2021. Kjo vlerë cilësohet si efekt negativ për buxhetin e shtetit, duke marrë në konsideratë faktin që për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i ri i rekrutuar, kjo situatë paraqitet më problematike, si dhe me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit.

**Radha e likuidimit të shpenzimeve gjyqësore – FIFO.**

Në bazë të përcaktimeve të udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, kryhet mënyra e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit e njësisve të qeverisjes së përgjithshme. Udhëzimi në pikën 4, përcakton se ònjësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit databazën e vendimeve gjyqësore dhe përlllogaritjen e detyrimit për çdo gjyqfitues. Sipas procedurës së ndjekur nga DPT, këta pagesa realizohen me këste: një në muajin Prill dhe një në muajin Dhjetor sipas tabelës 10.

### **Mbi Komisionin e Posaçëm.**

Urdhri i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151, datë 28.10.2015 òPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò ka si qëllim përcaktimin e rregullave mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore. Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është i mbikëqyrur nga Departamenti i Administratës Publike.

Referuar këtij urdhri, pranë çdo institucioni të administratës shtetërore krijohet Komisioni i Posaçëm, organ kolegjal, me përbërje si vijon:

- Sekretari i Përgjithshëm, kryetar;
- Përfaqësues që mbulon çështjet juridike, anëtar;
- Përfaqësues që mbulon çështjet financiare ó buxhetore, anëtar;
- Përfaqësues që mbulon çështjet e burimeve njerëzore, anëtar.

Në rastin e ATQ, ky Komision ka në përbërje:

1. Drejtor i Përgjithshëm i DPT ó kryetar;
2. Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore ó anëtar;
3. Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzoreó anëtar;
4. Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës ó anëtar;
5. Përfaqësues i DAP (në rolin e mbikëqyrësit);
6. Sekretariati Teknik.

Komisioni i Posaçëm në DPT ka pësuar një ndryshim përmes Urdhrit të Titullarit të DPT nr. 21, datë 18.03.2021, ku është bërë zëvendësimi i emrit të Drejtorit të Drejtorisë Teknike dhe Ligjore, duke qenë se fillonte periudha e lejes së barrëlindjes së saj. Përgjatë vitit 2021, ky Komision ka pësuar një sërë ndryshimesh, ku përmes Urdhrit nr. 72, datë 17.09.2021, është bërë ndryshimi i emrit të Titullarit të DPT-së pas largimit të tij, duke u zëvendësuar me z. K. Sh. si i autorizuar për firmë. Ndërkohë, përmes Urdhrit nr. 85, datë 04.11.2021 është ngritur KP për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Administrata Tatimore, me përbërjen si më poshtë:

1. Z. C. K. ó Drejtor i Përgjithshëm i DPT;
2. Znj. V. T. ó Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore;
3. Znj. I. K. ó Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore;
4. Znj. D. Ç. ó Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Komisioni i Posaçëm thirret nga kryetari, brenda 2 ditëve punë nga depozitimi i kërkesës/ lajmërimit me shkrim të kreditorit, të përfaqësuesit ligjor të tij, ose të përmbaruesit gjyqësor, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke vënë në dijeni DAP-in.

Komisioni ngarkohet me këto detyra:

- a) Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqësor;
- b) Shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitore, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- c) Shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqfituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda institucionit nga ku është larguar, apo në një institucion të varësisë së tij.

Përgjatë vitit 2021, kanë qenë 36 gjyqfitues në proces ekzekutimi ku 3 prej tyre janë propozuar nga DAP në institucione të tjera jashtë ATQ-së. Ndërkohë gjatë vitit 2021, janë ekzekutuar 74 praktika me rikthim në punë të gjyqfituesve. Përpos tyre, 6 praktika janë ekzekutuar me përfundim të marrëdhënies nga shërbimi civil, duke qenë se individët kanë mbushur moshën e pensionit. Në DPT kanë mbërritur edhe 4 praktika të reja përgjatë vitit. Nga auditimi evidentohet si në vijim:

- Me shkresën nr. 111231 Prot., datë 18.06.2021, KP është mbledhur në vijim të shqyrtimit të databazës së gjyqfituesve për muajin Dhjetor 2020 dhe ka vendosur të rimarrë në shqyrtim praktikën e plota të gjyqfituesve ish nëpunës civilë të renditur sipas kronologjisë së përcjellë nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore, për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në këtë mbledhje KP, nga 95 raste të shqyrtuara gjithsej, janë paraqitur propozimet për risistemim të 65 gjyqfituesve. Në 1 rast, gjyqfituesi ka qenë i punësuar për herë të fundit në një pozicion jashtë shërbimit civil, ndaj del jashtë juridiksionit të KP për risistemim. Për 1 gjyqfitues KP pret daljen e projekt-raportit të KMSHC me qëllim rishqyrtimin e rastit. Për 1 rast, Gjykata është shprehur se i takon DAP të shprehet për risistemimin e gjyqfituesit. 3 raste të tjera janë mbushin moshën e daljes në pension gjatë vitit 2022.
- Me shkresën nr. 11754/4 Prot., datë 01.10.2021, KP është mbledhur dhe ka rimarrë në shqyrtim rastin e gjyqfitueses S.S, për të cilën ka propozuar risistemim qysh në mbledhjen e datës 18.06.2021. Në këtë procesverbal, KP është shprehur për risistemimin e S.S. në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.
- Me shkresën nr. 18396 Prot., datë 13.10.2021, KP është mbledhur dhe ka marrë në shqyrtim rastin e gjyqfitueses E. Xh., për të cilën ka propozuar risistemim në DPT gjatë mbledhjes së datës 18.06.2021. Pasi E. Xh. ka shprehur mospëlqimin për propozimin e KP, atëherë KP ka propozuar risistemimin e saj në DRT Elbasan.

Vlen të përmendet se përgjatë gjithë vitit 2021, janë rikthyer në punë si gjyqfitues në ATQ 73 ish punonjës të shërbimit civil, të cilët janë punësuar në vijim të propozimeve të KP si dhe bashkëpunimit ndërmjet DPT dhe DAP.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë pa numër, datë 20.07.2022, òMbi Projekt-Raportin e auditimit të KLSHò, protokolluar në KLSH me nr. 20/13 Prot., datë 21.07.2022, nga znj. V. T. dhe observacioni me shkresë nr. 121/42 Prot., datë 21.07.2022, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 20/14, datë 27.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

- *Drejtori i Burimeve Njerëzore (BNJ) pretendon se nga grupi i KLSH nuk është bërë një analizë e*

*gjetjeve dhe atashimit të përgjegjësive sipas funksionit për problematikën e vlerësimit të performancës.*

- Drejtori i BNJ pretendon se është penguar për të ushtruar detyrën në mënyrë eksplicite dhe se grupi i auditimit nuk ka marrë në konsideratë argumentimin për përjashtim nga përgjegjësia personale. Gjithashtu rikërkon marrjen në konsideratë të komunikimit përmes email të datës 28.07.2020, 19.01.2021, 01.02.2021, 30.08.2021 si dhe 20.12.2021.*
- Lidhur me përshkrimin e punës, Drejtori i BNJ pretendon se nuk është përgjegjësi e tij ndryshimi apo përcaktimi i kriterëve, të cilat janë përcaktuar në vitin 2020 sipas relacionit të hartuar nga dy zv. Drejtorët e Përgjithshëm me nr. 3259/9 Prot., datë 03.04.2020, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.*
- Përsa i takon strategjisë menaxhuese dhe planit të rekrutimit, Drejtori i BNJ shprehet se nuk ka kompetencë të hartojë e të nënshkruajë strategji. Planet e rekrutimit dhe planifikimit i janë dërguar DAP. Për pjesën e vendeve jashtë shërbimit civil është hartuar një rregullore rekrutimi, ku bashkëlidhur observacionit janë korrespondencat datë 01.08.2017-09.08.2017, 15.10.2020. Gjithashtu pretendohet se nuk qëndron argumenti mbi mungesën e një strategjie menaxhuese sepse për mënyrën e rekrutimit të stafit me Kod Pune ka në fuqi një rregullore shumë të mirë. Problem serioz që cenon efektshmërinë e kësaj strategjie dhe rregulloreje përbën mungesa e zbatimit nga ana e punëdhënësve bazuar në të drejtën e njëanshme për të përcaktuar mënyrën sesi rekruton, lëviz apo largon nga puna, etj. Bashkëlidhur gjenden korrespondencat për planet operationale ndër vite.*
- Lidhur me pjesën e Komisionit të Posaçëm, Drejtori i BNJ konsideron që në dokumentacionin me memo dhe korrespondenca për informimin e Komisionit që duhet të thirret nga Kryetari, janë prova të pakontestueshme që detyra është kryer përtej detyrimit ligjor.*
- Lidhur me rekomandimin nr. 1.1 të masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike të Projekt-Raportit të Auditimit, subjekti pretendon se nga Komisioni i Posaçëm gjatë shqyrtimit të vendimeve gjyqësore për zbatimin e tyre evidentohen problematikat dhe shkaqet për largim nga puna. Për 74 vendim gjyqësore të formës së prerë të shqyrtuar nga të cilët janë rikthyer në punë 64 punonjës, rezulton se vendimmarrja për largim nga puna është vendimmarrje e komisionit të disiplinës dhe është përtej kompetencës së DPT nxjerrja e përgjegjësive.*
- Në rastet kur konstatohet se punonjësit nuk i përgjigjen vazhdimisht kërkesës për plotësimin me dokumentacion personal të dosjes së personelit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek procedurat e mosdhënies së pagës për këta punonjës.*
- Në rastet kur punonjësit nuk dorëzojnë detyrën sipas ligjit në fuqi, njësia e Burimeve Njerëzore merr masa në mosvënien në dispozicion të dokumentacionit personal ose mosdhënien e librezës së punës për shkak të problematikës së sipërcituar. Lidhur me inventarizimin e dosjeve të personelit subjekti pretendon se është proces që vijon rregullisht dhe është kryer në nivelin 90% pasi ATQ ka një organikë të madhe me 1450 punonjës të miratuar. Shkak i moskryerjes në kohë është edhe numri i vogël i punonjësve dhe vendeve vakante të strukturës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.*
- Bazuar në Rregulloren "Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore", miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, vlerësimi i rezultateve në punë për punonjësit që trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, është vjetor dhe bëhet në fund të vitit kalendarik. Vlerësimet e punonjësve si dhe sqarimet përkatëse në lidhje me vlerësimet, dosjet e të cilëve janë marrë në shqyrtim nga grupi auditues i KLSH, janë vënë në dispozicion edhe me anë të email dërguar në datë 15.04.2022.*
- Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit/punonjësit e Drejtorive Rajonale Tatimore, administrohen nga Drejtoria/Spektori i Shërbimeve Mbështetëse pranë DRT-ve përkatëse, në dosjet e personelit të secilit prej tyre, duke dërguar pranë DPT të dhënat në lidhje me vlerësimet për secilin nëpunës/punonjës. Ndërsa formularët e vlerësimit për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkak të volumit të madh të dokumentacionit të ndodhur në dosjet personale, nuk vendosen në dosje personale, por administrohen pranë zyrës (arkivës) së dosjeve të personelit.*
- Bazuar në Urdhrin e titullarit të DPT, nr. 10, datë 31.01.2020, neni 4, pika e, si dhe në zbatim të objektivave të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në përmbushje të detyrave funksionale si dhe duke pasur*

*parasysh se, gjatë hetimit, verifikimit dhe monitorimit të subjekteve tatimpaguese me aktivitet ekonomik financiar në fusha të ndryshme të zhvillimit të biznesit, nga inspektorët e këtyre strukturave, është parë e nevojshme që të përfshihen personel me njohuri në fusha të ndryshme.*

- *Lidhur me konstatimin se për punonjësën H. K dhe ish-punonjësën E. Rr nuk përputhet arsimimi me kriterin pozicionit të punës, subjekti ka dorëzuar dokumentacion vërtetues të diplomave të punonjësve ku argumenton se arsimimi i tyre është në përputhje me kriteret e pozicionit.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

- Lidhur me pretendimet e Drejtorit të Burimeve Njerëzore (BNJ) se grupi i auditimit nuk ka nxjerrë përgjegjësi sipas funksionit për problematikat, sqarojmë se lidhur me ato problematika që janë evidentuar si të rëndësishme dhe që ndikojnë në ecurinë dhe performancën e ATQ-së, grupi i KLSH ka lënë rekomandimet përkatëse duke përcaktuar edhe personat/strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre.
- Mbi pretendimet e drejtorit të BNJ mbi shpalljet e vendeve vakante në DAP, grupi i auditimit sqaron se mbetet përgjegjësi e drejtuesit të DBNJ korrespondenca me DAP, pasi të ketë kryer koordinimin me strukturat e tjera brenda ATQ.
- Lidhur me pretendimin se nuk është përgjegjësi e Drejtorit të DBNJ përcaktimi i kriterëve në përshkrimet e punës, grupi i auditimit sqaron se përshkrimet e punës nënshkruhen nga Titullari i Institucionit dhe Drejtori i Drejtorisë përkatëse, por mbetet përgjegjësi e DBNJ që të sigurohet se këto përshkrime pune janë të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe me punën që do të kryhet nga punonjësi.
- Përsa i takon strategjisë menaxhuese dhe planit të rekrutimit, grupi i auditimit thekson se bazuar në Nenin 72 të Rregullores së Brendshme të ATQ-së, i cili citon *“Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore: Përgatit dhe zbaton strategjinë menaxhuese dhe planet operationale për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim, sipas vendeve të lira të krijuara në bashkëpunim me Zv/Drejtorin e Përgjithshëm”*, është përgjegjësi e Drejtorit të DBNJ hartimi dhe zbatimi i strategjisë së menaxhuese dhe planit operacional për rekrutim, ku përfshihen jo vetëm pozicionet me status civil, por edhe ato jashtë shërbimit civil.
- Lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm, grupi i auditimit shprehet se bazuar edhe në rekomandimet e lëna nga KLSH, i takon DPT të kryejë analizimin e situatës në rastet e largimeve të padrejta nga puna, me qëllim përcaktimin e shkaqeve për të minimizuar probabilitetin e ndodhjes së ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.

*Sa më sipër, kjo pjesë e observacioneve nuk merret parasysh, pasi nuk është e bazuar në aktet ligjore/nënligjore dhe nuk sjell asnjë dokumentacion të ri, prandaj komentet **nuk merren në konsideratë** dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.*

- Pretendimet e subjektit lidhur me mangësitë në dosjet e personelit, dorëzimin e detyrës jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, inventarizimi i dosjeve të personelit, vlerësimet e performancës në punë së bashku me formularët e vlerësimit, si dhe përshkrimet e punës jo të unifikuara për pozicionet jashtë shërbimit civil, grupi i auditimit sqaron se janë të njëjta me pretendimet e sjella përmes observacionit me shkresë nr. 121/23, datë 20.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 20/5 Prot., të cilat janë trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, ndaj nuk merren parasysh dhe qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.
- Lidhur me argumentimin e dhënë nga DPT se arsimimi i E. Rr dhe H. K përputhet me kriteret e pozicionit të punës, nga dokumentacioni i sjellë përmes observacionit me shkresë nr. 121/42 Prot., datë 21.07.2022, që nuk ka qenë në dispozicion të grupit të KLSH-së përgjatë periudhës së auditimit, konstatohet se:



1. Për vendin e punës të punonjësit E. Rr. sipas databazës së vënë në dispozicion nga DBNJ përgjatë periudhës së auditimit, kriteri arsimor ishte i nivelit Master Shkencor. Sipas formularit të përshkrimit të punës pa numër protokollit dhe pa datë, të sjellë përmes observacionit, kriteri arsimor është i nivelit Master Profesional. Diploma e zotëruar nga punonjësi E. Rr. është e nivelit Master Profesional.
2. Për vendin e punës së punonjësit H. K. sipas databazës së vënë në dispozicion nga DBNJ përgjatë periudhës së auditimit, kriteri arsimor ishte i nivelit Master Profesional. Sipas formularit të përshkrimit të punës pa numër protokollit dhe pa datë, të sjellë përmes observacionit, kriteri arsimor është i nivelit Bachelor. Diploma e zotëruar nga punonjësi E. Rr. është e nivelit Master Profesional, e cila është vënë në dispozicion përmes observacionit.

Sa më sipër, grupi i auditimit **merr në konsideratë dokumentacionin e ri** të sjellë nga subjekti, duke reflektuar ndryshimet përkatëse në material. Megjithatë grupi i auditimit nuk ndryshon qëndrimin e tij lidhur me problematikën e përshkrimeve të punës të paunifikuara dhe ndryshimeve të paargumentuara të kriteve të pozicioneve jashtë shërbimit civil.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Numër i lartë i vendeve vakante pjesë e shërbimit civil në ATQ përgjatë vitit 2021
<b>Situata 1:</b>	Gjatë vitit 2021, ATQ ka hartuar planin e nevojave për rekrutim, nga ku i ka përcjellë DAP nevojën për plotësimin e 130 vendeve vakante. Nga këto 130 vende vakante, DAP ka shpallur 62 prej tyre, ku vetëm 44 janë plotësuar me fituesit e shpallur. Vihet re se, përgjatë gjithë vitit ka patur vende vakante të paplotësuara për një kohë të gjatë, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, u konstatuan ndryshime të shpeshta të stafit, situatë kjo që mbart riskun për cënimin e funksionimit e drejtorive të ndikuara nga këto situata për shkak të kapacitetit jo të plotë të stafit aktual.
<b>Kriteri</b>	Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, <i>“Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”</i> .
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Mosplotësimi i vendeve vakante për periudha të gjata kohore sjell performancë të ulët në punë dhe cënon përmbushjen e objektivave institucionale.
<b>Shkaku Rëndësia</b>	Mungesa e plotësimit të vendeve vakante përgjatë vitit 2021. E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i DPT, në bashkëpunim edhe me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020.
<b>Afati</b>	Në vijimësi
<b>Titulli i Gjetjes</b>	Nivel i lartë i emërimeve/largimeve/transferimeve në strukturat e Hetimit Tatimor/Verifikimit dhe Koordinimit në Terren
<b>Situata 2:</b>	Përgjatë vitit 2021, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në strukturat përkatëse të tyre në Rajonet Qendrore, Veriore dhe Jugore, vihet re një nivel i lartë i ndryshueshmërisë së punonjësve përmes Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve òLirim dhe emërim në detyrë. Për vitin 2021, është konstatuar se vetëm në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT dhe strukturat e hetimit në DRT ka patur 6 lirime dhe emërim në detyrë, si dhe 5 largime nga 60 gjithsej punonjës. Ndërkohë në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në struktura përkatëse në DRT ka patur 9 lirime dhe emërim në detyrë, dhe 10 largime përgjatë vitit

	<p>2021, nga 24 punonjës gjithsej. Gjithashtu, konstatohet se strategjia menaxhiale dhe plani operacional për rekrutim nuk është hartuar për punonjësit, marrëdhënia e të cilëve rregullohet përmes Kodit të Punës, por është hartuar vetëm planifikimi i vendeve vakante për punonjësit e shërbimit civil që është përcjellë në DAP, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 të nenit 72 të Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore citon se <i>“Drejtori i DBNJ përgatit dhe zbaton strategjinë menaxhuese dhe planin operative për rekrutimin, duke evidentuar nevojat për punësim, sipas vendeve të lira të krijuara në bashkëpunim me Zv/Drejtorin e Përgjithshëm”</i>.</p>
<b>Kriteri</b>	<p>- Pika 4 e nenit 72 i Rregullores së Brendshme të ATQ;          -Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, <i>“Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”</i>.</p>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<p>Mungesa e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese për punonjësit jo pjesë të shërbimit civil, ka sjellë lëvizje të shpeshta brenda këtyre strukturave, që çënon mbarëvajtjen e punës dhe efektivitetin e këtyre strukturave.</p>
<b>Shkaku</b>	<p>Mungesa e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese për punonjësit jo pjesë të shërbimit civil.</p>
<b>Rëndësia</b>	<p>E lartë</p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Drejtori i DBNJ të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për të minimizuar lëvizjet e shpeshta brenda strukturave, që do të çënonin mbarëvajtjen e punës dhe efektivitetin e tyre..</p>
<b>Afati</b>	<p>31.12.2022</p>
<b>Titulli i Gjetjes</b>	<p>Parregullsi në procedurat e largimeve të punonjësve që nuk janë pjesë e shërbimit civil</p>
<b>Situata 3:</b>	<p>Nga auditimi me përzgjedhje i 25 praktikave të largimeve nga puna, u konstatuan 8 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sikurse cituar në vendimet përkatëse, òPër arsye performancë të ulët në punë dhe ankesave të ardhura, ndërkohë që në dosjet e personelit nuk rezulton asnjë dokument justifikues i këtij pretendimi që është bërë shkak për ndërprerjen e kontratës së punës nga ana e DPT-së. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të Kreut II të Ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar: <i>“Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiency”</i>.</p>
<b>Kriteri</b>	<p>Kodi i Punës në RSH, nenet 144 dhe 145;          Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, Pika 1 e nenit 8 të Kreut II.</p>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<p>Mosargumentimi i drejtë i motivacionit për ndërprerjet e marrëdhënies së punës dhe mosndjekja e procedurave të parashikuara në nenin 144 të Kodit të Punës në RSH mund të rrisin efektet negative në buxhetin e shtetit sa i përket shpenzimeve të gjyqfituesve.</p>
<b>Shkaku</b>	<p>Ndërprerje e njëanshme e kontratës së punës e pabazuar në akte ligjore/nënligjore.</p>

<b>Rëndësia</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Titullari i DPT të marrë masa që të ndiqen procedurat dhe afatet e parashikuara në Kodin e Punës në RSH për ndërprerjen e njëanshme të marrëdhënieve të punës, si dhe të mbështesë motivacionet e ndërprerjeve të punës në dokumentacion vërtetues, në rastet e ankesave dhe performancës së ulët.
<b>Afati</b>	Në vijimësi
<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në procedurat e largimeve të punonjësve pjesë të administratës tatimore, duke sjellë efekte negative në buxhet. Gjatë vitit 2021 nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në mënyrë të pa drejtë, në vlerën <b>186,466,238 lekë</b> , për 196 punonjës, për periudhën 2005-2021, të paguara në dy këste, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar proceset gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve nga puna ka qenë i pa rregullt dhe nga institucioni i DPT nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për këtë proces. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të proceseve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga DPT në proceset e largimit të punonjësve nga puna.
<b>Situata 4:</b>	
<b>Kriteri</b>	Pika nr. 60, të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, <i>“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”</i> , i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Largimet e padrejta nga puna ndër vite dhe pamundësia e risistemimit të tyre në strukturat e ATQ kanë sjellë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit prej <b>186,466,238 lekë</b> .
<b>Shkaku</b>	Largimet e padrejta nga puna, moszbatimi i procedurave të përcaktuara në ligj për ndërprerjen e njëanshme të marrëdhënieve të punës. Mungesa e analizimit të arsyeve të humbjeve të proceseve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative.
<b>Rëndësia</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Titullari i DPT të marrë masa për evidentimin e arsyeve të largimeve të padrejta nga puna me qëllim përmirësimin e procedurave të kryera gabim duke sjellë kështu minimizim të shpenzimeve gjyqësore në të ardhmen dhe përdorim me efektivitet të fondeve buxhetore.
<b>Afati</b>	Në vijimësi
<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Parregullsi në përshkrimet e punës të punonjësve jashtë shërbimit civil. Nga auditimi i përshkrimeve të punës për punonjësit jashtë shërbimit civil për Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, rezultoi se u konstatuan raste ku për të njëjtin përshkrim pune me të njëjtat detyra funksionale, të ndryshonte kriteri i nivelit të arsimimit apo fushës së edukimit. Diferencimet e tilla në nivelin arsimor dhe në fushën e studimit janë të paargumentuara, përderisa inspektorët kryejnë të njëjtin funksion dhe kanë të njëjtin përshkrim pune, sidomos kur janë punonjës të të njëjtit sektor. Këto veprime dhe mos veprime janë në kundërshtim me Kreun IV të VKM nr. 142, datë
<b>Situata 5:</b>	

12.03.2014, ku përcaktohet: “Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit respektiv të punës”, dhe pikës 1 të nenit 9 të Rregullores së brendshme të ATQ “Përzgjedhja e kandidatëve për punësim në administratën tatimore kryhet si rregull nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në plotësimin e kërkesave nga kandidatët për punësim”

Për më tepër nga auditimi i 23 dosjeve të personelit u konstatua se në dosjet e tyre mungojnë dokumenta si: librezat e punës, akti i dorëzimit të punës përpara largimit të punonjësit, etj, në kundërshtim me kërkesat të Lidhjes 1 të dhënave dhe dokumentacioni i dosjes së personelit të VKM nr. 833, datë 28.10.2020. Në 16 raste të largimeve nga puna nga puna, në 8 prej tyre mungonte praktika e dorëzimit të dokumentacionit dhe pajisjeve apo mjeteve të punës. Gjithashtu në shumicën e dosjeve të personelit nuk administrohej praktika e rekrutimit për pozicionet specifike të punës.

**Kriteri**

Kreu IV të Procedurës dhe formati i përshkrimit të punës të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, të Përshkrimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura, i ndryshuar;

Pika 1 e nenit 9 e Rregullores “Për marrëdhëniet e punës së personelit nëpunës jo-civil, në Administratën Tatimore Qendrore”.

**Ndikimi/Efekti**

Përshkrimet e paunifikuara të punës mund të sjellin procedura të pabarabarta konkurrimi.

**Shkaku**

Mungesa e unifikimit të kriterëve të kërkuara arsimore për punonjësit jashtë shërbimit civil, si dhe mospërputhja e kriterëve të përcaktuara në përshkrimin e punës me ato të fituesit të procedurës së përzgjedhjes.

**Rëndësia**

E mesme

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kriterëve arsimore kur detyrat funksionale janë të njëjta, si dhe që fituesit e procedurës së konkurrimit të kenë nivel dhe fushë arsimore në përputhje me kriteret e përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës.

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore të plotësojë dhe përditësojë të gjitha dosjet e punonjësve me dokumentacionin e nevojshëm.

**Afati**

Në vijimësi.

**2.9. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallrave dhe shërbime.**

Referuar regjistrin të prokurimeve (Bashkëlidhur) nga DPT për vitin 2021 janë parashikuar të realizohen prokurime për punë, mallra e shërbime gjithsej në shumën 252,500 mijë lekë dhe janë prokuruar e lidhur kontrata në shumën 303,000 mijë lekë me TVSH, ku peshën më të madhe e zënë investimet dhe shërbimet e kryera nga AKSHI për llogari të DPT, si dhe prokurimet e përqëndruara të kryera nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara pranë Ministrisë së Brendshme, të cilat janë kontrata dy e shumëvjeçare e në disa raste të mbartura dhe nga 2018, si dhe zbatimin e kontratave për prokurimet e realizuara në MB, pasi ka kontrata të mbartura nga 2020 (kontrata disa vjeçare).

Për vitin 2021 nga vetë DPT është kryer vetëm një procedurë prokurimi me mjete elektronike me të dhënat e mëposhtme:

-Procedura e prokurimit me objekt “**Sigurimi i godinave në administrim të DPT-së për vitin 2021**”:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit :		
Urdhër Prokurimi Nr 11285, datë 21.06.2021	Urdhër nr. 11285/1, datë 30.06.2021 <b>Komisioni i vlerësimit të ofertave</b> E. Ll., Kryetar, E. C., antar, A. S., antar(jurist).	Urdhër Prokurimi Nr 11285, datë 21.06.2021 <b>Njësia e prokurimit</b> B. H. A. K. J. M., Jurist
Lloji i Procedurës së Prokurimit: Tender i hapur- i Thjeshtuar		

<b>Fondi Limit (pa TVSH)</b> 8,000,000 lekë	<b>Oferta ekonomike</b> 7,997,000.lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> BOE A. K.C & A. shpk Nipt K.V
<b>Lidhja e Kontrates</b> Nr. 11285/7, datë 27.08.2021	Vlera kontratës per vitin 2021 7,970,000 lekë me TVSH	

#### Hartimi i fondit limit.

Nga Sektori i Shërbimeve të Brendshme është paraqitur kërkesa nr. 7653, datë 26.04.2021, për shërbimin që do prokurohet për vitin 2021, për “*Sigurimi i godinave në administrim të DPT-së*” bazuar në vlerën e inventarëve të DRT-ve dhe DPT-së. Nga Sektori i Prokurimeve ka filluar procedura *“Sigurimi i godinave në administrim të DPT-së”* dhe është hartuar Urdhëri me nr. 8561 prot., datë 12.05.2021, për krijimin e komisionit të hartimit të termave të referencës, të cilët më datë 13.05.2021 kanë plotësuar *deklaratën e konfliktit të interesit*. Me shkresën nr. 8561/1, datë 08.06.2021, ky komision ka paraqitur termat e referencës. Për hartimin e fondit limit janë marrë tre oferta, përkatësisht nga E., A. dhe S. dhe më datën 16.06.2021, është përlogaritur fondi limit me vlerë 8,000,000 lekë.

#### Zhvillimi i procedurës.

Me shkresën nr. 11285 prot., datë 21.06.2021, është nxjerrë urdhri i prokurimit nga titullari i institucionit.

Bazuar në Udhëzimin e APP nr. 2, datë 09.05.2021, pika 1 dhe 2, janë dërguar për asistencë procesverbali i argumentave të termave dhe DST dhe bazuar në sugjerimet e APP-së më datë 05.07.2021 dokumentat standarde janë hedhur në SPE, duke mbajtur procesverbalin përkatës, si dhe njoftimi i kontratës me shkresën nr. 11285/1 prot., datë 30.06.2021, me nr. Ref -00018-07-05-2021, duke përcaktuar si datë të hapjes së ofertave datën 16.07.2021.

Në datën 16.07.2021 ora 12:00, KVO-ja pasi ka plotësuar më parë deklaratën e konfliktit të interesit ka hapur procedurën në sistem, ku është paraqitur vetëm një ofertë nga BOE ðA.ö & ðA.ö, si dhe ka plotësuar procesverbalin e hapjes dhe me shkresën nr. 11285/3 prot., datë 21.07.2021, ka njoftuar njësinë e prokurimit që ka mbyllur këtë procedurë në SPE për vazhdimin e hapave të tjerë të kësaj procedure.

Me shkresën nr. 11285/4 prot., datë 27.07.2021 është hartuar formulari i fituesit për BOE ðA.ö & ðA.ö, me ofertën vlerë 7,997,000 lekë. Në datën 29.07.2021, me shkresën nr. 11285/5, është miratuar Raporti Përmbledhës i përgatitur nga KVO-ja dhe i është drejtuar BOE në SPE me kërkesën për paraqitje për sigurim kontrate dhe dokumentat orgjinale ose të noteruara që ka hedhur në SPE.

Në datën 05.08.2021, nga KVO, pas paraqitjes nga OE të dokumentacionit, është plotësuar provesverbali i pranimit të dokumentave që operatori ka hedhur në sistem.

Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi fitues ka bërë sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës totale të kontratës përfshirë TVSH, me nr. serial 16/0101/062193, datë 03.08.2021.

#### Zbatimi i kontratës me nr. 11285/7, datë 27.08.2021

Autoriteti kontraktor, DPT ka lidhur kontratën nr. 11285/7, datë 27.08.2021 për vitin 2021, për *“Sigurimi i godinave në administrim të DPT-së”*, me operatorin fitues, me vlerën 7,970,000 lekë për shërbimin, në përputhje me dokumentet e tenderit dhe ofertën fituese.

Me Autorizimin nr. 15728 prot., datë 26.08.2021, është caktuar z. E. Ç., për mbikqyrjen e zbatimit të kontratës, *“Sigurimi i godinave në administrim të DPT-së”*. Formulari i njoftimit të kontratës është dërguar në APP në sistem, me shkresat nr. 11285/8, datë 27.08.2021 dhe nr. 11285/9, datë 27.08.2021. Pagesa është kryer më datë 20.09.2021 në vlerën 7,997,000 lekë.

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 8 blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën 4,430,905 lekë pa TVSH dhe 5,310,086 lekë me TVSH. Në përfundim të procedurave të zhvilluara në SPE janë lidhur 8

kontrata, me vlerë 3,886,500 lekë pa TVSH dhe 4,663,800 lekë me TVSH, ku nga auditimi i tyre rezultoi se janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave për procedurat e zhvilluara nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (minikontratat) nuk rezultuan problematika.

## **2.10. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimitarisë së auditit të brendshëm.**

### **A. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

Për vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, grupi i auditimit shqyrtoi, si më poshtë:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Manuali për MFK;
- Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 193, datë 12.08.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”;
- Shkresat përcjellëse për përcaktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues;
- Regjistri i Riskut;
- Deklarata e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm;
- Raporti Vjetor i Cilësisë dhe Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (në vijim DPT) u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në kuptimin e ligjit të lartpërmendur, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Nga auditimi i realizuar për periudhën objekt auditimi, funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit paraqitet si vijon:

**1.** Strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale të DPT-së janë bazuar në òStrategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën 2017-2021ò. Nga auditimi rezulton se politikat institucionale të DPT-së janë bazuar në òPlanin Strategjik 2017 ó 2021ò/òStrategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën 2017-2021ò. Objektivat dhe masat për zbatimin e misionit të Administratës Tatimore Qendrore, mbështeten në bindjen se përmbushja vullnetare mundësohet vetëm atëherë kur të gjitha funksionet për shërbimin ndaj tatimpaguesit, kontrollit tatimor dhe mbledhjes së detyrimeve të prapambetura do të trajtohen si një tërësi veprimesh të ndërvarura dhe të mbështetura në modelin e menaxhimit të riskut. Strategjia parashikon që në pesë vitet në fjalë 2017 ó 2021 të vijojë përmirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj tatimpaguesit duke u mbështetur në modelin e përmbushjes vullnetare.

**2.** Për vitin 2021 rezulton të jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin e Titullarit të Institucionit nr. 11, datë 15.02.2021, “Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)”, i kryesuar nga Titullari i Institucionit dhe në cilësinë e anëtarëve janë caktuar zv/drejtorët e Përgjithshëm dhe të gjithë menaxherët e nivelit të lartë drejtues, ku mungon prania e vëzhguesit dhe Nëpunësit

Zbatues (NZ). Ndërkohë, përmes Urdhrit të Titullarit të Institucionit nr. 20, datë 17.03.2021, “Për disa korrigjime në Urdhrin nr. 11, datë 15.02.2021 “Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)”, është caktuar Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (DFB) si NZ, si dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (DAB) në rolin e vëzhguesit, veprim ky në përputhje me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut II, pika 2.2.6 të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, ku nënvizohet se:

*“GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike”.*

Dokument i rëndësishëm i GMS është plani i veprimit i MFK miratuar dhe dërguar në MFE me shkresën nr. 23191/1, datë 22.02.2022. Me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 50, datë 10.03.2021, òPër ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetoreò janë ngritur grupet e menaxhimit të programeve buxhetore për PBA 2022-2024, pjesë e së cilës është edhe grupi i menaxhimit të programit 01140 òMenaxhimi i të Ardhurave Tatimoreò që i përket DPT, i cili përbëhet nga:

- Znj. D. B., Drejtues Ekipi;
- Z. A. Ç., Anëtar;
- Znj. D. Ç., Anëtar;
- Z. K. Sh., Anëtar;
- Znj. I. A., Anëtar.

3. Nga auditimi u konstatua se, DPT e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, të cilat rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimeve të organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 193, datë 12.08.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”. Në rregulloren e brendshme trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, rregullat e përgjithshme, rregullat e administrimit, funksionet dhe detyrat e tyre. Kjo rregullore vendos rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

Pika 2 e nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 òPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò përcakton se òRregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tijò. Referuar nenit 1 të Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë 193, datë 12.08.2020, objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe detyrave të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet njësive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në DPT dhe DRT, si dhe të vendosë rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të DPT dhe DRT.

Nga auditimi u konstatua se, kjo rregullore detajon përgjegjësitë dhe detyrat e pozicioneve specifike, p.sh. drejtorit/ përgjegjësve të sektorëve/ specialistëve të njësive të caktuara, ndërkohë që parashikimi i objektit dhe detyrave të vetë njësive (drejtorive) është shumë i përgjithshëm në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e vetë drejtorit të këtyre drejtorive, ndërsa, në rastin e sektorëve, ky përshkrim i fushëveprimit, objektit dhe detyrave mungon në çdo rast.

Përpos ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve specifike pjesë e strukturave të caktuara, rregullorja duhet të parashikonte qartë fushëveprimin, kompetencat, detyrat e përgjegjësitë e njësive

(drejtorive dhe sektorëve specifikë), e më tej të vijojej me ndarjen e detajuar të punës te pozicionet e caktuara.

Mospërcaktimi i detyrave të qarta të njësive, përpara përcaktimit të detyrave të vetë nëpunësve që drejtojnë këto njësi, mund të krijojë konfuzion në rastet e vakancave në këto pozicione, çka nuk duhet të ndikojë në realizimin e objektivave nga ana e njësive.

Administrata Tatimore Qendrore përgjatë vitit 2021 ka vepruar në përputhje me strukturën organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, urdher i cili është ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 152, datë 19.11.2020, “Për një ndryshim në miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, përmes të cilit është shtuar pozicioni Koordinator në Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion. Rrjeti i Koordinatorëve Anti-Korrupsion është një strukturë nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar kundër korrupsionit, Ministrit të Drejtësisë. Me urdhrin nr. 106, datë 25.07.2019 të Kryeministrit, *“Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion*, të ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 86, datë 25.06.2020, përcaktohet krijimi dhe funksionimi i kësaj strukture, ku çdo institucion që është pjesë e këtij rrjeti ka në përbërjen e tij një koordinator.

Sipas urdhrave të miratimit të strukturës, në Administratën Tatimore Qendrore, struktura organizative përmban 1 450 punonjës, nga ku 308 janë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe pjesa tjetër janë punonjës në Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT) si dhe në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM).

Për vitin 2021, DPT ka pasur ndryshim të titullarit të institucionit si më poshtë:

- Me shkresën nr. 16952, datë 17.09.2021, “Zbatim Vendimi nr. 506, datë 17.09.2021 të Këshillit të Ministrave” është bërë lirimi nga detyra i znj. D. I. si Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, duke ndërprerë menjëherë marrëdhëniet financiare.

- Me shkresën nr. 19419/1 prot. datë 25.10.2021, “Zbatim Vendimi nr. 625, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave”, është bërë emërimi i z. C. K., Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve.

4. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021 kanë kryer funksione si nëpunës autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ), si vijon:

- Përmes shkresës nr. 13628/1, datë 18.07.2019, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është caktuar Nëpunës Autorizues për DPT, znj. D. I., Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së.
- Përmes shkresës nr. 18332/1, datë 08.11.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është caktuar Nëpunës Autorizues për DPT, z. C. K., Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së, pas emërimit të tij në krye të institucionit.
- Me shkresën e MF nr.2192/1, datë 27.02.2017, është caktuar Nëpunës Zbatues për DPT, znj. D. Ç., Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Në funksion të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Nëpunësi Zbatues, është niveli menaxherial në varësi direkte të Nëpunësit Autorizues. Në përputhje me kërkesat e Nenit 12/2 të ligjit në fuqi, në funksionet e tij, Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë. Aktualisht znj. D. Ç. kryen funksionet e përcaktuara më sipër jo në përmbushje të kërkesave të Nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. Në institucion, NZ nuk është në varësi direkte të NA, sipas strukturës së miratuar, kjo në kundërshtim me Kapitullin 2 të Manualit të MFK, ku thuhet se “Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga Nëpunësi Autorizues i njësisëo.



Konkretisht, NZ nuk gjendet në varësinë direkte të NA dhe lidhur me këtë problematikë, Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit i është drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve, përmes shkresës nr. 24579/10 Prot., datë 14.01.2021, me qëllim përcaktimin e varësisë, ku nga ana e DBNJ nuk rezulton të ketë një kthim përgjigje.

5. Nga ana e DPT-së janë përgatitur pyetëtori i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Plani i Veprimit të MFK-së për vitin 2021, së bashku me Deklaratën e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Raportin Vjetor të Cilësisë dhe Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, dokumente të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 23191/1 Prot. dhe nr. 23191/2 Prot., datë 22.02.2022. Pyetëtori i Vetëvlerësimit është plotësuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me urdhrin nr. 117, datë 01.04.2019, *“Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike”* i ndryshuar, dhe elementet sipas vlerësimit paraqiten të strukturuar kundrejt modelit COSO. Nga 111 pyetje pyetëtori nuk u jep përgjigje 4 pyetjeve, ose 3.6% të pyetjeve gjithsej.

Nga auditimi rezulton se, nga ana e NA të DPT-së Deklarata e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Raporti Vjetor i Cilësisë dhe Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2021 janë hartuar dhe dorëzuar brenda afateve ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se *“deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i dërgohen Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”*.

6. Në mbështetje të pikës 2, neni 11 ÷Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar, si dhe pika 2.5.2, Kapitulli III ÷Menaxhimi i Riskut në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me shkresën nr. 3642 Prot., datë 26.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar dhe përcjellë në MFE Regjistri i riskut. Risqet kryesore të evidentuara në të, janë:

- Mungesa e një instrumenti analize të të dhënave jashtë modelit të riskut, i cili do të plotësonte dhe do të ndihmonte për analizën e riskut;
- Risku i stafit të ri;
- Mungesa e kryqëzimit të informacionit me palë të treta;
- Gabim në database, si pasojë e mënyrës së mbajtjes nga ana e tatimpaguesve të të dhënave të faturave, në librat e shitjes dhe të blerjes, që Administrata Tatimore e ka të vështirë ti gjurmtojë se ku qëndron problematika.

Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në DPT ekzistojnë risqet që kërcënojnë objektivat, struktura e DPT ka mbartur **vende vakante** përgjatë periudhës objekt auditimi, ndaj në këto kushte **riskohet moszbatimi i objektivave**.

Në planin operacional për vitin 2021, janë parashikuar aktivitetet për realizim për vitin 2021 për të gjithë drejtoritë përkatëse të DPT.

7. Në DPT, është mbajtur 1 (një) takim i Ekipit të Menaxhimit të Programeve Buxhetore (EMP) për fondin e investimeve për vitin 2021, në datë 18.01.2021, në zbatim të Pikës 44, germa ÷a të Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 ÷Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, si dhe në zbatim të Urdhrit të MFE nr. 7752 Prot., datë 30.04.2020.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë ÷Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm

2022-2024ö për DPT përmes Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 50, datë 10.03.2021, òPër ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve Buxhetore (EMP)ö.

**8.** Referuar detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të DPT, parashikuar në pikën 8, neni 8, të Ligjit nr. 10296 dhe nenin 3 të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 193, datë 12.08.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”, konstatohet se:

- Është përgatitur plani strategjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të objektivave për ATQ, dhe monitorimin e zbatimit të tij;
- Është përgatitur dhe miratuar planin vjetor të punës dhe planit të të ardhurave tatimore për çdo DRT;
- Vendosijen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, etj.

Në lidhje me strukturën është përgjegjësi menaxheriale e titullarit propozimi i një strukture të përshtatshme organizative. Për vitin 2021, ka funksionuar struktura e miratuar që në vitin 2020, megjithatë disa nga efektet në emërimet për pozicionet e kësaj strukture janë shtrirë edhe në vitin 2021

**Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:** Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.” Nga ana e NZ të DPT është përgatitur dokumenti përfundimtar i buxhetit detyrim ky që rrjedh nga: Përcaktimet e pikës 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë ku punojnë”.

#### **Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm**

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, òKomponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollitö, neni 19 citohet: *Titullarët e njësisë të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

**Mjedisi i kontrollit** është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve. Mjedisi i kontrollit ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë si dhe nga marrëdhëniet e llogaridhënies. Mjedisi i kontrollit ka një ndikim të gjithanshëm në vendimet dhe aktivitetet e një njësie dhe hedh themelet e të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm.

Bazuar në nenin 9 òPërgjegjshmëria Menaxheriale e Nëpunësit Autorizuesö, pika 4/a, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe Manualin për MFK, Kap. IV òZbatimi i MFKö, pika 4.2.10 òRoli i nëpunësit autorizues të njësisëö, është hartuar

Plani Strategjik 2017-2021, i cili përmban objektivat strategjike dhe arritjet e tyre, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

DPT funksionon në përputhje me Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të MFE nr. 193, datë 12.08.2020. Në rregulloren e brendshme trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, rregullat e përgjithshme, rregullat e administrimit, funksionet dhe detyrat e tyre. Kjo rregullore vendos rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore. Institucioni disponon rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në DPT”, miratuar me urdhrin nr. 14, datë 21.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe Rregulloren “Për marrëdhënien e punës të personelit jo nëpunës civilë, në ATQ”, miratuar me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, institucioni vepron në përputhje me Kodin e Etikës së Administratës Tatimore, miratuar me vendimin nr. 22, datë 17.12.2020, në mbledhjen e Komitetit të Reformave.

Konstatohet se një pjesë e punonjësve të DPT, të larguar nga detyra, nuk kanë kryer dorëzimin e pajisjeve dhe mjeteve të punës në ngarkim të inventarit personal. Veprim ky në kundërshtim me pikën 13, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, si dhe të Kreut II, Standardet Bazë të Sjelljes, të Kodit Etik, që citon:

*Pika 2.1.19. Kur nëpunësi largohet nga detyra (kur jep dorëheqjen, largimit/lirimit nga shërbimi civil apo largohet nga puna), nëpunësi civil brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimit/largimit, është i detyruar të bëjë dorëzimin e detyrës e të gjithë dokumenteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës në inventar. Mosrespektimi i këtij parashikimi përbën shkelje disiplinore sipas legjislacionit për shërbimin civil si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Administratës Tatimore Qendrore.*

b) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.

Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin në DPT, rregullohen në bazë të ligjit 152/2013 òPër nëpunësin civilò; i ndryshuar, Kodin e Punës në RSH, Rregullores për marrëdhëniet e punës së personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 10, datë 31.01.2020, dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore për nëpunësit e shërbimit civil dhe ata jashtë shërbimit civil në ATQ, si dhe dispozitat e tjera ligjore si: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; ligji nr. 7971, datë 26.07.1995, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, lejojnë Titullarin e Institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave, të ndërmarrë hapat e duhura.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

DPT funksionon në përputhje me Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të MFE nr. 193, datë 12.08.2020. Ndryshimi i fundit në strukturë, është bërë me urdhrin 152, datë 19.11.2020, të Kryeministrit, me shtimin e pozicionit të Koordinatorit për Rrjetin Antikorrupsion, i cili është finalizuar në datë 26.02.2021. Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar numrin e punonjësve gjithsej, pozicionin e vendit të punës si dhe kategorinë për çdo pozicion. Struktura përcakton përgjegjësitë dhe kalimin e informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Drejtori i Përgjithshëm deri te specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. Drejtori i Përgjithshëm është dhe Nëpunësi Autorizues i njësisë. Sipas strukturës së njësisë, Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është Nëpunësi Zbatues dhe përgjegjës për

zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor me synim arritjen e qëllimeve dhe politikave të programit. Drejtori i Përgjithshëm ka në varësi të tij tre Zv/Drejtorët e Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën, me qëllim realizimin e objektivave të programuara dhe mbikëqyrur menaxhimin e funksioneve të veçanta në Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Delegimet e detyrave në DPT, bëhen me urdhër të Titullarit të Institucionit dhe/ose me propozim të Drejtuesit të Drejtorisë përkatëse. Lidhur me delegimin e kompetencave, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, siç kërkohet nga ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 15 òRregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave, si dhe Kapitulli III òDelegimi i detyrave, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

ç) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të Institucionit janë përcaktuar rregullat dhe detyrat e organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve, ndërmjet njësisë të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore. Institucioni i ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etikën, komunikimin e paraqitjen, shkeljet disiplinore, orarin dhe qëndrimin gjatë orarit të punës, etj.

d) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, punonjësit e ATQ janë trajnuar përmes platformës online Zoom, duke përcaktuar edhe kalendarin e tyre. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përcakton programe trajnime siç kërkohet edhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 3.1. *Mjedisi i kontrollit të brendshëm, në paragrafet “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”*. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka përcaktuar trajnimet që duhet të ndiqen nga punonjësit. Për vitin 2021 janë organizuar 28 trajnime online ku specifikohen: 9 trajnime online për punonjësit e rinj në periudhë prove, 13 trajnime për punonjësit e nivelit vazhdues, dhe 6 trajnime për punonjësit e nivelit drejtues. Tematikat e trajnimeve variojnë nga Procedurat Tatimore, Fiskalizimi, Sistemi C@ts, Legjislacioni mbi Procedurat Tatimore, dhe deri tek Kontabiliteti.

## **Menaxhimi i riskut**

Pas planifikimit të fondeve buxhetore, Institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në mbështetje të pikës 2, neni 11 òPërgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, si dhe pika 2.5.2, Kapitulli III òMenaxhimi i Riskut në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me shkresën nr. 3642 prot, datë 26.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar dhe përcjellë në MFE, Regjistri i riskut. Risqet kryesore të evidentuara në të, janë:

- Mungesa e një instrumenti analize të të dhënave jashtë modelit të riskut, i cili do të plotësonte dhe do të ndihmonte për analizën e riskut;
- Risku i stafit të ri;
- Mungesa e kryqëzimit të informacionit me palë të treta;
- Gabim në database, si pasojë e mënyrës së mbajtjes nga ana e tatimpaguesve të të dhënave të faturave, në librat e shitjes dhe të blerjes, që Administrata Tatimore e ka të vështirë ti gjurmtojë se ku qëndron problematika.

Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në DPT ekzistojnë risqet që kërcënojnë objektivat, struktura e DPT ka mbartur **vende vakante** përgjatë periudhës objekt auditimi, ndaj në këto kushte **riskohet moszbatimi i objektivave**.

### **Aktivitetet e kontrollit**

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësive lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi. Proceset kryesore të punës operationale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston ndarja e detyrave, megjithatë si është përmendur më sipër, konstatohet se në rregulloren e brendshme ka nevojë për përmirësime në shprehjen e detyrave funksionale të drejtorive dhe sektorëve përkatës të tyre.

"Veprimtari të kontrollit", përkufizohen si kontrole para faktit dhe pas faktit. Ato përfshijnë kontrollin e ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë dhe marrin parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Nëpunësi zbatues në bazë të ligjit për buxhetin, merr përsipër angazhimet për realizimin e programeve buxhetore. Në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet, ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare, kalon në dy procese. Specialisti e harton, përgjegjësi e kontrollon dhe më pas miratohet nga NZ, i cili ia përcjell NA. Transaksionet financiare në këtë institucion kryen në bazë të rregullave të vendosura nga MFE. Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit excel dhe në programin financiar ALPHA.

### **Informacioni dhe komunikimi**

Titullari i Institucionit informohet vazhdimisht nga zv.drejtorët dhe drejtorët e drejtorive, mbi aktivitetin e strukturave që ata drejojnë me anë të mbledhjeve periodike, informacioneve, evidencave të ndryshme. NZ raporton periodikisht tek nëpunësi autorizues, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin në funksion të realizimit të objektivave. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare. Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka shfaqur probleme në drejtim të koordinimit midis strukturave. Mekanizmat e dedikuar për ankesat për korrupsion, janë numri jeshil: 08001414, adresë email-i: [denoncime@tatime.gov.al](mailto:denoncime@tatime.gov.al), stop informaliteti etj. Të gjitha ankesat për korrupsion dërgohen për verifikime pranë Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion). Struktura përkatëse për ankesat në DPT ndodhet në varësi të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Sektorin e Trajtimin të Ankesave, e cila administron dhe shpërndan për trajtim ankesat lidhur me shkelje të legjislacionit tatimor dhe ankesave të ndryshme për veprime korruptive.

Sistemi i IT-së është i pajisur me një sistem rezervë (backup) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ri përfitim të tyre, në rast aksidenti për shërbimet financiare.

### **Monitorimi**

Në DPT, Titullari informohet vazhdimisht nga drejtuesit e lartë, të mesëm, dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve apo informacioneve. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike janë dërguar në MFE. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike janë dërguar në MFE, por nuk rezultojnë të publikuara në faqen e web-it të institucionit ose të MFE-së.

**Titulli i Gjetjes  
Situata 1:**

Mangësi të konstatuara në funksionimin e GMS

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2021, GMS nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje, ndërkohë që Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 *“Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike”* parashikon se GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Në këtë situatë, rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) nuk ka patur mangësi në ushtrimin e rolit të tij të rëndësishëm për sa i përket integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sjelljen sipas etikës. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë, nuk i janë parashtruar GMS, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Në funksion të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, Nëpunësi Zbatues, është niveli menaxherial në varësi direkt të Nëpunësit Autorizues. Nga auditimi rezultoi se, në DPT, funksionin e NA e kryen Drejtori i Përgjithshëm, ndërkohë që funksionin e NZ e kryen Drejtori i Financës dhe Buxhetit. Në kapitullin 2 të Manualit përcaktohet se *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkt nga Nëpunësi Autorizues i njësisë”*. Referuar strukturës organizative të DPT, Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e NZ, nuk është në varësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm, në cilësinë e NA.

**Kriteri**

Neni 27 i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*;

Pika 2.2.4 e Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 *“Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësitë publike”*.

**Ndikimi/Efekti**

Mospërbushje e qëllimit të krijimit të GMS, si element integral i përgjegjësisë publike dhe qeverisjes dhe rolit të këtij organi në drejtim të integritetit të informacionit financiar të njësisë dhe sistemin e saj të kontrollit të brendshëm.

**Shkaku**

Mungesa e zhvillimit të mbledhjeve nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik

**Rëndësia**

E mesme

**Rekomandim**

GMS të zhvillojë mbledhjet në periodicitetin e përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përmbushjen e qëllimit për garantimin e funksionimit të komponentëve të MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut në institucion.

Titullari i DPT të marrë masa për caktimin e NZ në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

**Afati**

Në vijimësi

**Titulli i Gjetjes**

Problematika të konstatuara në garantimin e varësisë direkte mes Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues

**Situata 2:**

Në funksion të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për*

	<p><i>menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>” i ndryshuar, Nëpunësi Zbatues, është niveli menaxherial në varësi direkte të Nëpunësit Autorizues.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se, në DPT, funksionin e NA e kryen Drejtori i Përgjithshëm, ndërkohë që funksionin e NZ e kryen Drejtori i Financës dhe Buxhetit. Në kapitullin 2 të Manualit përcaktohet se “<i>Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga Nëpunësi Autorizues i njësisë</i>”.</p> <p>Referuar strukturës organizative të DPT, Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e NZ, nuk është në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, në cilësinë e NA.</p>
<b>Kriteri</b>	Nenit 12/1, “ <i>Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues</i> ” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar;
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Kapitulli 2 i Manualit të MFK.
	Problematika në garantimin e zbatimit të urdhrave të NA së linjës, kryerjes së kontroleve efektive, si dhe ruajtjes së ekuilibrit në zbatimin e një operacioni/transaksioni, në kushtet kur varësia nuk është direkt, në kundërshtim me përcaktimet në Manualin e MFK-së.
<b>Shkaku</b>	Mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore për përcaktimin e NZ
<b>Rëndësia</b>	E mesme
<b>Rekomandim</b>	Titullari i DPT të marrë masa për caktimin e nëpunësit zbatues në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
<b>Afati</b>	31.12.2022

### **B. Përputhshmëria ligjore, analiza dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm**

Për vlerësimin e auditimit të brendshëm, grupi i auditimit shqyrtoi, si më poshtë:

- Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e auditimit publik;
- Rregulloren e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore;
- Strukturën e njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe aktivitetin e saj;
- Plani Strategjik dhe Plani Vjetor i Auditimit 2021 (së bashku me ndryshimet);
- Raporti Vjetor i DAB për vitin 2021;
- Karta e Auditit të Brendshëm;
- Dosje auditimi.

Neni 5 i Kreut II të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” citon se misioni i auditit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, veprimtaria e Auditimit të Brendshëm duhet të kryhet në përputhje me:

- Standardet Ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të njohura dhe të zbatuara në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara nga Ministri i Financave;
- Këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës, Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i Financave, si dhe akte të tjera për kryerjen e shërbimit të auditimit, pra zbatimi i standardeve është detyrim ligjor.

Referuar nenit 6 të Kreut II të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, DAB duhet të japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, duke përgatitur plane strategjike dhe vjetore auditimi bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar, si dhe duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontroleve, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
- përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
- ruajtjen e asetëve;
- kryerjen e veprimtarisë së njësisë me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
- duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;
- duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna, etj.

Nga auditimi i realizuar për vitin 2021, për aktivitetin e ushtruar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DPT, është konstatuar se qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara në dokumentet themeluese të njësisë, siç janë Karta e Auditimit dhe Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit të ATQ, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 193, datë 12.08.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”. Me urdhrin nr. 72, datë 24.09.2020, “Për miratimin e Kartës së Auditit të Brendshëm, së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, është kryer miratimi nga Titullari i Institucionit, si dhe me shkresën nr. 20411 prot., datë 20.10.2020, është dërguar në DHAB, në MFE.

Njëësia e Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është ngritur dhe funksionon në nivel Drejtorie, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe përcaktimet e standardit 1100 òPavarësia dhe objektiviteti, në Manualin e Auditimit të Brendshëm. DAB në DPT, e realizon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në:

- 14 Drejtori në DPT;
- 14 Drejtori Rajonale Tatimore;
- 6 Drejtori sipas Rajoneve.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm (DAB) në aspektin organizativ dhe funksional përgjigjet përpara titullarit të institucionit. Për vitin 2021, veprimtaria e DAB është kryer përgjithësisht në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, “Planifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëm”, Kapitulli IV, “Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit”, Kodit të Etikës, Standardeve Ndërkombëtare dhe praktikave profesionale të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik të pranuar për zbatim në RSH, dhe Rregullores për funksionimin e ATQ-së.

Në përputhje me strukturën e miratuar, DAB ka në përbërjen e saj dy sektorë:

1. Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave (strukturë me 1 përgjegjës sektori + 4 inspektorë);
2. Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit (strukturë me 1 përgjegjës sektori + 2 inspektorë).

Përmes organigramës së vënë në dispozicion nga DBNJ, në muajin Janar 2021, kjo Drejtori ka patur një vend vakant në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, vakancë e cila nuk është plotësuar përgjatë gjithë vitit 2021.

**Tabela nr. 1: Organigrama e DAB, Dhjetor 2021**

Pozicioni	Kategoria e pagës	Vende
<b>DAB</b>		<b>9</b>
Drejtor Drejtorie	III-a	1
<b>Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave</b>		<b>5</b>
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1
Inspektor i Parë	III-b	1



Inspektor i Parë	III-b	1	
Inspektor i Parë	III-b	1	
Inspektor i Parë	III-b	1	
<b>Spektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit</b>		<b>3</b>	
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	Vakant
Inspektor i Parë	III-b	1	
Inspektor i Parë	III-b	1	

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT

Mosplotësimi përgjatë gjithë vitit i vendit vakant të Përgjegjës të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, ka bërë që DAB të funksionojë në  $\frac{8}{9}$ -tat e kapacitetit të saj, pra në rreth 90% të kapacitetit të strukturës së saj. Duke patur parasysh rëndësinë e kësaj Drejtorie, e cila konsiderohet si një filtër i domosdoshëm për t'ia dhënë titullarit të njësisë publike, nivelin e sigurisë mbi saktësinë e aktivitetit ekonomiko-financiar të njësisë shpenzuese të varësisë, si dhe bazuar në faktin që auditimi i brendshëm në njësitë publike është një nga tre shtyllat e kontrollit të brendshëm financiar publik (sipas standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm Kuadri COSO dhe sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit), mungesa dhe mosplotësimi i vendeve vakante në këtë Drejtori për një periudhë të gjatë kohore mund të sjellë mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit të saj. Në Raportin Vjetor 2021 të DAB-së, mungesa e burimeve njerëzore përmendet si një nga arsyet që ka ndikuar në ecurinë e auditimeve të planifikuara dhe realizuara përgjatë vitit 2021.

### **Certifikimi i DAB**

Përsa i përket certifikimit të punonjësve të DAB-së, grupi i auditimit pas shqyrtimit të dosjeve të personelit, konstatoi se i gjithë personeli i kësaj Drejtorie është i certifikuar si ÷Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik.

Nga auditimi u konstatua se punonjësit i përshtaten kërkesave të veçanta për pozicionin e punës, ku 7 prej tyre rezultojnë me arsim bazë ekonomist dhe 1 jurist. Përsa i përket eksperiencës dhe vjetërsisë në strukturat e auditimit ndarja rezulton si më poshtë:

- Vjetërsi pune deri në 5 vite: 4 punonjës
- Vjetërsi pune mbi 5 vite: 4 punonjës

Lidhur me rritjen e kapaciteteve të stafit të DAB-së, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE ka zhvilluar trajnime të vijueshme të cilat janë zhvilluar *online* për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 dhe në këto trajnime kanë marrë pjesë 8 auditues. Përpos trajnimit nga DHAB në MFE, audituesit kanë marrë pjesë dhe në trajnimet *online* për fiskalizimin që janë organizuar nga vetë DPT.

### **Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2021**

Përmes shkresës nr. 20412 prot., datë 20.10.2020, Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së ka miratuar Planin Vjetor të Auditimeve për vitin 2021, ku zgjedhja për auditim është bazuar kryesisht në bazë të vlerësimit të riskut. Në Planin Vjetor të Auditimit 2021 janë planifikuar 11 auditime:

- 5 auditime përputhshmërie;
- 4 auditime të kombinuara;
- 1 auditim financiar;
- 1 auditim mbi zbatimin e rekomandimeve.

Me shkresën nr. 20410 prot., datë 20.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është miratuar hartimi i Planit Vjetor 2021 dhe Plani Strategjik i Auditimit 2021-2023. Gjithashtu, këto plane janë dërguar brenda muajit Tetor, sipas përcaktimit në Manualin e Auditimit, pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DHAB) në MFE, me shkresën nr. 20412 prot., datë 20.10.2020. Pas dërgimit nga ana e DPT drejt MFE të Planit Vjetor 2021 dhe atij Strategjik 2021-2023 përmes shkresës nr. 19040 Prot, datë 30.09.2020, Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka dhënë

**mendimin dhe rekomandimin pozitiv** për planin vjetor 2021 dhe planin strategjik 2021-2023, përmes vendimit nr. 17, datë 09.10.2020.

Nëpërmjet shkresës nr. 2308 prot., datë 14.02.2022, është dërguar në MFE, Raporti i Veprimtarisë së DAB-së për vitin 2021, së bashku me pyetësozin e vetëvlerësimit, në të cilin nga 40 pyetje në total, 7 kanë vlerësim “përputhshmëri e pjesshme” dhe 33 të tjerat “përputhshmëri e plotë”, pra përputhshmëria e pjesshme rezulton 17.5% dhe ajo e plotë 82.5%.

Nga ana e MFE, Me Vendimin nr. 6, datë 25.01.2021, Komisioni i Auditimit ka dhënë **mendim dhe rekomandim pozitiv** për raportin vjetor të veprimtarisë së DAB pranë DPT për vitin 2020, duke përcjellë procesverbalet e mbajtura në mbledhjet e datave 22.01.2021 dhe 25.01.2021.

Nëpërmjet shkresës nr. 19083 prot., datë 20.10.2021, DPT ka përcjellë drejt Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në MFE, njoftimin për një ndryshim në planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2021, duke u bazuar në Nenin 12, shkronja 0çö të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 *öPër auditimin e brendshëm në sektorin publikö*, në Kapitullin III *öPlanifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëmö*, në pikën 3.5 *öRishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm në sektorin publikö* të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, datë 25.10.2016.

Kjo kërkesë është iniciuar nga titullari i DAB-së me arsyetimin e shmangies së auditimit paralel duke qenë se në periudhën në fjalë këto drejtori kanë qenë në proces auditimi nga KLSH, dhe është kryer heqja nga Plani i Auditimeve për vitin 2021 i auditimeve, si më poshtë:

- DRT Durrës (auditim i kombinuar);
- Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (auditim përputhshmërie);
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPT (auditim financiar); si dhe
- Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT (auditim përputhshmërie).

**Tabela nr. 2: Ndryshimet në Planin Vjetor të Auditimeve për vitin 2021**

Plani fillestar			Plani pas ndryshimit			Statusi në fund të vitit
Nr.	Subjekti	Lloji i Auditimit	Nr.	Subjekti	Lloji i Auditimit	
1	DTM	Auditim përputhshmërie	1	DTM	Auditim përputhshmërie	<i>Përfunduar</i>
2	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Qendror	Auditim përputhshmërie	2	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren - Rajoni Qendror	Auditim përputhshmërie	<i>Në proces</i>
3	Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së	Auditim përputhshmërie	3	DRT Tiranë	Auditim përputhshmërie	<i>Përfunduar</i>
4	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Jugor	Auditim përputhshmërie	4	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Qendror	Auditim përputhshmërie	<i>Anuluar</i>
5	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Qendror	Auditim përputhshmërie	5	DRT Shkodër	Auditim përputhshmërie	<i>Përfunduar</i>
6	DRT Durrës	Auditim i kombinuar	6	DRT Dibër	Auditim përputhshmërie	<i>Në proces</i>
7	DRT Elbasan	Auditim i	7	DRT Vlorë	Auditim	<i>Përfunduar</i>

		kombinuar			përputhshmërie	
8	DRT Berat	Auditim i kombinuar	8	DRT Korçë	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
9	DRT Sarandë	Auditim i kombinuar	9	DRT Sarandë	Auditim i kombinuar	Përfunduar
10	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, DPT	Auditim financiar	10	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Jugor	Auditim i kombinuar	Në proces
11	Zbatimi i rekomandimeve	Auditim përputhshmërie	11	DRT Berat	Auditim i kombinuar	Përfunduar
			12	DRT Elbasan	Auditim i kombinuar	Përfunduar
			13	Zbatimi i rekomandimeve	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
<b>Total</b>		<b>11</b>	<b>Total</b>		<b>13</b>	

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPT, përpunuar nga KLSH.

Me qëllim shmangien e mbivendosjes, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 71, datë 07.10.2021, dalë në zbatim të rekomandimit të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dërguar në DPT përmes shkresës nr. 333/16 prot., datë 30.10.2020 òMbi verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin, me qëllim vlerësimin e vijueshmërisë dhe saktësisë së shumës së rimbursuarò kanë ndodhur ndryshimet si më poshtë, ku nga 11 auditime të planifikuara, numri ka shkuar në 13:

1. Anulohet auditimi i kombinuar në DRT Durrës, ai i përputhshmërisë në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së dhe ai financiar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (DPT);
2. Shtohet auditim përputhshmërie tematik në DRT Tiranë, DRT Dibër, DRT Shkodër, DRT Vlorë, DRT Korçë.

Plani i ri Vjetor për vitin 2021 ka konsistuar në 9 auditime përputhshmërie dhe 4 auditime të kombinuara.

Përmes shkresës së DAB nr. 7112 prot., datë 16.04.2021, është njoftuar për fillimin e angazhimit të auditimit në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së, dhe më pas përmes shkresës nr. 7112/1 Prot., datë 20.05.2021 është kryer njoftimi për pezullim të përkohshëm të fillimit të angazhimit të auditimit me pretendimin se subjekti po auditohet nga KLSH në atë periudhë. Me anë të shkresës nr. 7112/2 Prot., datë 29.10.2021, është njoftuar Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT për mbylljen e procedurave të auditimit.

Me anë të shkresës nr. 7113 prot., datë 16.04.2021, DAB ka njoftuar Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në DPT mbi fillimin e angazhimit të auditimit. Më pas, përmes shkresës nr. 7113/6 prot., datë 20.05.2021, është njoftuar DFB për pezullim të përkohshëm të fillimit të angazhimit të auditimit dhe për mbylljen e procedurave të auditimit përmes shkresës nr. 7113/8 prot., datë 29.20.2021.

Nga auditimi rezulton se ndryshimi i Planit Vjetor të Auditimit është dokumentuar me shkresë dhe është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, por jo sipas përcaktimeve të nenit 12 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, dhe përcaktimeve të kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, ku përcaktohet se: “Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit”.

E njëjta situatë ka ndodhur në rastin e dërgimit të Planit Vjetor të Auditimit 2022 dhe Planit Strategjik 2022-2024 pranë DHAB në MFE përmes shkresës nr. 18920 prot., datë 19.10.2021. Duke qenë se Komiteti i Auditimit nuk ka qenë funksional në këtë periudhë, përmes shkresës 18920/1, është miratuar Plani Vjetor dhe Plani Strategjik i Auditimit nga vetë Titullari i DPT.

Mungesa e mendimit nga Komiteti i Auditimit ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të këtij komiteti pranë MFE. DAB ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit, komunikimin elektronik me Drejtorinë e Auditimit në MFE, ku sqarohet se Komitetit të Auditimit të Brendshëm i ka përfunduar mandati i përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 211, datë 07.06.2019. Sipas këtij komunikimi, në datën 11.10.2021, DAB është udhëzuar të procedojë me miratimin e Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm nga Titullari i Institucionit.

### **Analiza e Planit Vjetor për vitin 2021**

Plani Vjetor i Auditimeve i ndryshuar, kishte në përbërjen e tij 13 auditime të planifikuara për vitin 2021, ndërkohë që nga viti 2020 ka patur 3 auditime të kombinuara të mbartura për DRT Gjirokastrë, DRT Kukës dhe DRT Fier. Përgjatë vitit, janë përfunduar 12 auditime, 1 është anuluar dhe 3 kanë qenë në proces. Evidentohet se DAB nuk e ka arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor të ndryshuar, duke mos përfunduar dot 3 auditime.

Gjithashtu nga analiza e ngarkesës së punës audituese të audituesve të DAB përgjatë vitit, konkludohet se DAB ka planifikuar me rezervë angazhimin e burimeve njerëzore, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesës shumë të ulët të disa audituesve të tjerë. Ndarja e ngarkesës në varësi të programeve të auditimit të realizuara përgjatë vitit 2021, varion në auditues të ndryshëm, ku dy auditues kanë marrë pjesë në 42% dhe 58% të auditimeve, krahasimisht me 17% apo 33% të një audituesi tjetër. Pra, 7 auditues kanë realizuar 12 auditime, me ngarkesa jo të ngjashme. Grupi i auditimit konstaton se diferencimi i ngarkesës së punës ka ardhur si pasojë e planifikimit joeficient të burimeve njerëzore nga ana e DAB, si dhe për shkak të mungesës së plotësisht të vendit vakant të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit.

Mënyra e zgjedhjes për auditim është bazuar kryesisht në bazë të vlerësimit të riskut.

Për auditimet e planifikuara, vlerësimi i riskut paraqitet si vijon:

- 8 subjekte janë vlerësuar me risk të lartë;
- 2 subjekte janë vlerësuar me risk të mesëm.

Për vitin 2021, vlerësimi i fushave me risk jepet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 3: Vlerësimi i fushave me risk për vitin 2021**

<b>Identifikimi i risqeve</b>	<b>Risku</b>
<i>Sistemi i kontrollit tatimor</i>	I lartë
<i>Sistemi i shërbimit ndaj tatimpaguesve</i>	I mesëm

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DPT

Bazuar në metodologjitë e përdorura për vlerësimin e riskut, janë programuar dhe audituar ato që kanë rezultuar me një nivel të lartë dhe të mesëm të riskut. Përmbledhja e punës së DAB përgjatë vitit 2021 paraqitet si në vijim:

- **Auditime të përfunduara, të mbartura nga viti 2020:**
  - ✓ Auditim i kombinuar në DRT Gjirokastrë;
  - ✓ Auditim i kombinuar në DRT Kukës;
  - ✓ Auditim i kombinuar në DRT Fier.
- **Auditime të përfunduara për vitin 2021:**
  - ✓ Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve;

- ✓ Auditim i kombinuar në DRT Berat;
- ✓ Auditim i kombinuar në DRT Sarandë;
- ✓ Auditim i kombinuar në DRT Elbasan;
- ✓ Auditim përputhshmërie në DRT Shkodër;
- ✓ Auditim përputhshmërie në DRT Tiranë;
- ✓ Auditim përputhshmërie në DRT Vlorë;
- ✓ Auditim përputhshmërie në DRT Korçë;
- ✓ Auditim përputhshmërie në DTM.
- **Auditime në proces për vitin 2021:**
  - ✓ Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Jugor (*përfunduar puna në terren*);
  - ✓ Auditim përputhshmërie në DRT Dibër (*përfunduar puna në terren*);
  - ✓ Auditim përputhshmërie në Drejtorinë Rajonale të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ó Rajoni Qendror (*në proces auditimi*).

Nga auditimi u konstatua se, referuar Planit Vjetor të Auditimit 2021, i ndryshuar, miratuar nga Titullari i DPT-së, nuk është realizuar auditimi i përputhshmërisë në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Qendror, duke qenë se në të njëjtën kohë ky subjekt ka nisur të auditohet nga KLSH dhe në këto kushte, pas miratimit nga titullari, subjekti është njoftuar mbi moskryerjen e auditimit nga DAB.

Fillimisht kjo Drejtori është njoftuar përmes shkresës nr. 20500 prot., datë 05.11.2021, për fillimin e angazhimit të auditimit, dhe pas njoftimit përmes email nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Qendror, se në këtë drejtori po ushtronte auditim edhe KLSH, Drejtori i DAB-së ka paraqitur memon nr. 20500/1 prot., datë 16.12.2021, ku i kërkon Titullarit të Institucionit, mbylljen e procedurave të auditimit për këtë subjekt. Përmes shkresës nr. 20500/2 prot., datë 21.12.2021, Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Qendror është njoftuar për mbylljen e procedurave të auditimit.

Nga parashikimi vjetor, DAB nuk ka arritur të përfundojë sipas planit auditimet në subjektet:

1. Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Jugor;
2. DRT Dibër;
3. Drejtorja Rajonale e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ó Rajoni Qendror.

Këto dosje nuk u vunë në dispozicion të grupit të auditimit, pasi në periudhën audituese, këto procese ishin ende të papërfunduara. Konstatohet se DAB nuk ka arritur të përmbushë objektivat e saj vjetorë.

Nga 15 praktikat e audituara, vihet re se nga rekomandimet e lëna nga KLSH gjatë auditimit të zhvilluar në DPT, është iniciuar auditimi në disa DRT me qëllim verifikimin e procedurave të rimbursimit për tatim-fitimin si më poshtë:

1. Drejtorja Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj;
2. DRT Korçë;
3. DRT Vlorë;
4. DRT Shkodër;
5. DRT Dibër.

Këto auditime kanë patur të njëjtin objekt òVerifikim i procedurave të rimbursimit për tatim-fitiminò, janë zhvilluar në të njëjtën periudhë 11.10.2021 ó 19.10.2021, dhe kanë dalë në të njëjtin qëndrim òZbatim i saktë i procedurave të rimbursimit për tatim-fitiminò. Përfundim këtu bën DRT Dibër, e cila nuk është mbyllur në kohë si të gjitha auditimet e sipërpërmendura. Duke qenë se objekti dhe arsyeja e

auditimit kanë qenë të njëjta për të gjitha subjektet e sipërpërmendura, konstatohet se DAB duhej të kishte mbyllur auditimin në DRT Dibër paralelisht me DRT e tjera. Mosmbyllja në kohë e auditimit në DRT Dibër konstatohet si problematik, duke qenë se auditimet në DRT e tjera që kanë patur të njëjtin objekt auditimi janë mbyllur në kohë.

Përsa i përket koordinimit mes Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Kontrollit, vihet re një mungesë rakordimi i punës së tyre. Gjatë realizimit të planit vjetor të secilës prej drejtorive, vihet re se 2 Drejtori Rajonale janë kontrolluar nga DKT dhe audituar nga DAB në periudha të afërta përgjatë vitit 2021. Në DRT Shkodër, është ushtruar kontroll nga DKT në periudhën 15.01.2021 ó 15.03.2021 dhe auditim në periudhën 21.03.2021 ó 31.03.2021. Ndërsa në DRT Korçë, për periudhën 10.02.2021 ó 05.03.2021 është kryer auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna, ndërkohë që është ushtruar kontroll pas përfundimit të auditimit, në periudhën 30.03.2021 ó 13.07.2021.

Konstatohet nevoja e një rakordimi mes dy drejtorive pas nxjerrjes së planeve të tyre vjetore, me qëllim shmangien e kontroleve dhe auditimeve të afërta në kohë, përpos rasteve kur ka informacione lidhur me problematika të caktuara që kanë nevojë për kontroll ose auditim nga strukturat përkatëse.

### **Gjetjet kryesore në auditimet e realizuara nga DAB për vitin 2021**

Gjetjet që kanë ardhur si rezultat i auditimeve nga DAB për vitin 2021, vijnë kryesisht nga zbatimi i gabuar apo i pjesshëm i legjislacionit tatimor. Kryesisht gjetjet më të shumta kanë rezultuar në sistemin e kontrollit tatimor, sistemin e shërbimit ndaj tatimpaguesit, funksionimin e kontrollit të brendshëm, etj.

- ✓ **Gjetjet e auditimit në vlerë** janë gjetje me efekte tatimore në shumën **118,568,000 lekë**, e cila ndahet sipas DRT:
  - 100,841,000 lekë ó DRT Elbasan;
  - 8,893,000 ó DRT Fier;
  - 5,370,000 lekë ó DRT Berat;
  - 3,464,000 ó DRT Kukës.

**Në krahasim me vitin 2020, gjetjet në vlerë kanë rezultuar 1.44 herë më të larta.**

- ✓ **Gjetjet sipas fushës ose sistemeve** rezultojnë 137 në total, të gjitha në sistemet e tatimeve, taksave, doganave, të cilat ndahen sipas DRT-ve në vijim:
  - 31 ó DRT Berat;
  - 30 ó DRT Kukës;
  - 26 ó DRT Elbasan;
  - 23 ó DRT Fier;
  - 15 ó DRT Sarandë;
  - 12 ó DRT Gjirokastrë.
- ✓ **Gjetje të tjera:**
  - Mungesë e analizës së plotë të tatimpaguesve me humbje;
  - Raste të mospërputhjes ndërmjet TVSH-së së paguar në doganë me atë të deklaruar në tatime;
  - Problematika me cilësinë e kontrollit ku nuk janë analizuar blerjet dhe TVSH e zbtrishme, shitjet dhe TVSH e llogaritur, nuk është bërë analizë e tepricës kreditore të TVSH, etj;
  - Raste të mos mbajtjes së gjobave për mosrespektimin e afateve të pagesës së kësteve të tatimit për periudhën 2016-2020;
  - Lënia e vendeve vakante për një kohë relativisht të gjatë;
  - Mangësi në procesin e ndarjes së punës;
  - Mangësi në dokumentacionet e praktikave të kontrollit operacional për Formularët 1, 2, 3 dhe 5.

- Mospërputhje në qëndrimet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit nga zyra për vlerësimet tatimore.

Nga auditimet e kryera në vitin 2021, rezulton që asnjë çështje nuk është dërguar për investigim, pra sipas DAB asnjë gjetje nuk ka rezultuar të përbjë vepër penale.

### **Rekomandimet e dhëna nga DAB për vitin 2021**

Në bazë të gjetjeve nga DAB për auditimet e kryera në vitin 2021 janë dhënë rekomandimet përkatëse për sistemimin dhe përmirësimin e punës në të ardhmen. Rekomandimet e dhëna lidhen me:

- Marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale;
- Mbikqyrjen e administrimit të riskut dhe kontroleve;
- Promovimin e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda njësisë publike;
- Sigurimin e administrimit efektiv të punës organizative dhe përgjegjësisë;
- Komunikimin e informacionit mbi riskun dhe kontrollin, në sistemet e duhura të njësisë publike.

Këto rekomandime ndahen sipas kategorive të mëposhtme duke rezultuar në 127 të tilla:

- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor ó 1;
- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve ó 12;
- Rekomandime të karakterit organizativ ó 41;
- Rekomandime të tjera ó 73.

Rekomandimet janë pranuar nga subjektet e audituara në masën 100%.

### **Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga DAB për vitin 2021**

Nga dosjet e mara në shqyrtim, lidhur me rekomandimet e lëna dhe të pranuar në masën 100%, tabela e mëposhtme detajon shkallën e zbatimit të tyre nga ana e subjekteve të audituara. Nga analiza, është konstatuar që niveli i zbatimit të tyre konsiderohet *i ulët* me vetëm **13.4%**.

**Tabela 4: Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të lëna për vitin 2021**

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Në proces	Zbatuar	Realizimi në %
Mbi përmirësimin e sistemeve	12	12	7	5	41.7%
Mbi përmirësimin e kuadrit ligjor	1	1	1	-	-
Me karakter organizativ	41	41	38	3	7.3%
Të tjera	73	73	64	9	12.3%
<b>Total</b>	<b>127</b>	<b>127</b>	<b>110</b>	<b>17</b>	

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPT, përpunuar nga KLSH.

DAB ka kërkuar ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, duke planifikuar auditim mbi verifikimin e zbatimit të tyre, ndërsa në disa raste DAB i ka vendosur si çështje në programet e angazhimeve të auditimeve të realizuara.

### **Inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve**

DAB pas përfundimit të çdo auditimi, ka kryer procesin e inventarizimit të dosjeve, për çdo subjekt të audituar. Inventarizimi është bazuar në kërkesat e përcaktuara në Manualin e Auditimit. Në zbatim të kërkesave të parashikuara në “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën Shqipërisë*”, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), DAB i ka dorëzuar pranë sekretarisë së DPT.

Nga dosjet e marra në shqyrtim nga grupi i auditimit, rezulton se janë të inventarizuara dhe firmosur nga audituesit, drejtuesi i DAB dhe marrësi në dorëzim. Këto dosje përmbajnë dokumentat përkatës të nevojshëm në një dosje auditimi si: Autorizimi, Deklarata e Konflikti të Interesit të Audituesve të Brendshëm, Njoftimi për Fillimin e Angazhimit të Auditimit, Programin e Angazhimit të Auditimit, ndarja e detyrave, Projekt-Raporti, Observacionet e Njesisë së Audituar, Raporti Përfundimtar i Auditimit, Rishikimi i Cilësisë nga Përgjegjësi i Grupit dhe nga Drejtuesi i Njesisë, Memo për Titullarin, etj.

Gjithashtu, për auditimet që janë anuluar, janë bashkëlidhur shkresat e njoftimit të anulimit të tyre, së bashku me memot përkatëse, të përgatitura për Titullarin e DPT-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 121/42, datë 21.07.2022, òMbi Projekt-raportin e Auditimitò, protokolluar në KLSH me nr. 20/14 Prot., datë 27.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

- Lidhur me konstatimin se DAB nuk ka arritur objektivin e përmbushjes së planit vjetor duke mos përfunduar 3 auditime, subjekti pretendon se 3 auditimet e papërfunduara në vitin 2021 janë përfunduar brenda 4 mujorit të parë të vitit 2022. Një pjesë e fondit të kohës audituese për vitin 2021 është shpenzuar në përfundimin e tre auditimeve në proces mbartur nga viti 2020. Ndikim gjithashtu në mospërfundimin e auditimeve kanë pasur edhe faktorë objektivë si mosfunksionimi me kapacitet të plotë të DAB-së sipas strukturës së miratuar dhe pandemia që shoqëroi vitin 2021.
- Lidhur me konstatimin se DAB ka planifikuar me rezervë angazhimin e burimeve njerëzore, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve, subjekti pretendon se lidhur me shpërndarjen efektive të kohës në auditime janë marrë parasysh madhësia e subjektit që do të auditohet, fushat dhe sistemet që do të auditohen, përvoja e gjithsecilit auditues etj, që e bëjnë të vështirë ndarjen e barabartë të ngarkesës individuale për secilin inspektor. Ndikim ka pasur gjithashtu edhe pandemia që shoqëroi vitin 2021.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga shqyrtimi i observacioneve të sjella duke i ballafaquar dhe me dokumentacionin e vënë në dispozicion për auditim rezulton se:

- Auditimet e raportuara si në proces, nuk janë përfunduar deri në fund të vitit 2021, duke i klasifikuar ato si të papërfunduara. Faktorët e cituar nga DAB nuk duhet të bëhen shkak për cenimin e performancës së Drejtorisë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga DAB, është konstatuar se ngarkesa e audituesve nuk ka qenë e barabartë përgjatë vitit 2021, edhe pse inspektorët kanë pasur të njëjtin pozicion dhe përshtetshëm pune, çka do të thotë se konsiderohen në kushte të barabarta pune.

Sa më sipër, pretendimet e subjektit janë të njëjta me ato të paraqitura përmes observacionit me shkresë nr. 121/25, datë 20.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 20/3 Prot., datë 24.05.2022, të cilat janë trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, ndaj **nuk merren parasysh**, dhe qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Titulli i Gjetjes  
Situata 1:**

Parregullsi në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm DAB nuk ka arritur të përmbushë objektivat e saj vjetorë, pasi nuk ka përfunduar sipas planifikimit vjetor auditimin në 3 subjekte: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Jugor; DRT Dibër; Drejtoria Rajonale e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ó Rajoni Qendror. Me pretendimin e shmangies së mbivendosjes me auditimet e KLSH-së kanë ndodhur ndryshimet si më poshtë, ku nga 11 auditime të planifikuara, numri ka shkuar në 13 duke anuluar auditimin e kombinuar në DRT Durrës, atë të përputhshmërisë në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-



së dhe atë financiar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (DPT) dhe duke shtuar auditim përputhshmërie tematik në DRT Tiranë, DRT Dibër, DRT Shkodër, DRT Vlorë, DRT Korçë. Plani i ri Vjetor për vitin 2021 ka konsistuar në 9 auditime përputhshmërie dhe 4 auditime të kombinuara.

Nga auditimi, konstatohet se gjatë realizimit të planit vjetor të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Kontrollit në DPT, vihet re se 2 Drejtori Rajonale janë kontrolluar nga DKT dhe audituar nga DAB në periudha të afërta përgjatë vitit 2021 (DRT Shkodër, DRT Korçë). Neni 25 i Kreut VIII të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, citohet “*Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm dhe njësitë e auditimit të brendshëm bashkëpunojnë me Kontrollin e Lartë të Shtetit bazuar në parimet e komunikimit të vazhdueshëm, angazhimit, mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë. Mbi bazën e këtyre parimeve, fushat kryesore të bashkëpunimit janë: a) shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve; b) shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit; c) zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe trajnimi i përbashkët.*” Neni 24 i Kreut III të Ligjit nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, përcakton bashkëpunimin dhe bashkërendimin në administratën shtetërore

- DAB ka planifikuar me rezervë angazhimit e burimeve njerëzore, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesën shumë të ulët të disa audituesve të tjerë. Ndarja e ngarkesës në varësi të programeve të auditimit të realizuara përgjatë vitit 2021, varion në auditues të ndryshëm, ku dy auditues kanë marrë pjesë në 42% dhe 58% të auditimeve, krahasimisht me 17% apo 33% të një audituesi tjetër. Pika 1 e Nenit 13 të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ATQ-së përcakton se Drejtori i DAB ka përgjegjësi dhe detyrë, organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.

Është konstatuar se diferencimi i ngarkesës së punës ka ardhur edhe si pasojë e planifikimit joefiçent të burimeve njerëzore nga ana e DAB, si dhe për shkak të mungesës së plotësisht të vendit vakant të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit

**Kriteri**

-Ligji nr. 114, datë 22.10.2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 25 i Kreut VIII;

-Ligji nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, neni 24 i Kreut III;

- Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016.

- Rregullore e Brendshme e Funksionimit të ATQ-së, Pika 1 e Nenit 13.

**Ndikimi/Efekti**

Problematika në përmbushjen në kohë të angazhimeve në planin vjetor të auditimit

**Shkaku**

Planifikim me rezerva për vitin 2021

**Rëndësia**

E mesme

**Rekomandimi:**

DAB marrë masa për bashkëpunimin me strukturat e tjera kontrolluese brenda DPT dhe me KLSH-në, me qëllim bashkërendimin dhe shkëmbimin e planeve të konsoliduar, duke synuar shmangien e mbivendosjeve të angazhimeve të auditimit, si dhe për planifikimin në mënyrë efikente të angazhimeve të auditimit duke patur parasysh ndër të tjera ndarjen e ngarkesës mes audituesve.

Drejtori i Përgjithshëm i DPT të marra masa në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, me qëllim plotësimin e vendit vakant të Përgjegjës të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit.

**Afati**

Në vijimësi

### **2.11. Auditimi i çështjeve të tjera të cilat mund të rezultojnë gjatë auditimit.**

Mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, *mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien e autorizimeve për përjashtimin e TVSH-së në procesin e rindërtimit.*

Për këtë çështje të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Praktikat dokumentare për lëshimin e autorizimeve gjatë vitit 2021;

-Korrespondencat e tatimpaguesve lidhur me kërkesat për pajisjen me autorizim për përjashtimin nga TVSH;

-Lista e autorizimeve të miratuara në vitin 2021.

#### Baza ligjore:

-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar Ligji nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar,

-VKM nr. 143, datë 13.02.2020 òPër procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit, i ndryshuar me VKM nr. 804, datë 30.09.2020 dhe VKM nr. 1108, datë 28.12.2020.

-Urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37, datë 22.05.2020 òPër ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të subjekteve të rindërtimit që aplikojnë për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, ndryshuar me urdhërat nr. 41, datë 19.06.2020, nr. 48, datë 09.07.2020, nr. 90, datë 15.12.2020, nr.13, datë 18.02.2021, nr.77, datë 7.10.2021 dhe nr. 86, datë 02.12.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion është konstatuar:

Në zbatim të VKM nr. 143, datë 13.02.2020 òPër procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit, i ndryshuar, nga Drejtori i Përgjithshëm znj. D. I. me urdhrin nr. 37, datë 22.05.2020, me ndryshime është ngritur Grupi i Punës, me objekt të tij shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të subjekteve që aplikojnë për pajisjen me autorizim për procesin e rindërtimit. Në këtë urdhër është miratuar dhe procedura që duhet të ndjekë Grupi i Punës në procesin e lëshimit të autorizimeve për procesin e rindërtimit.

Për vitin 2021, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 02.12.2021 ka funksionuar Grupi i Punës i përbërë nga: Kryetar znj. I. Xh. (nga data 01.01.2021 deri më datë 07.10.2021) dhe z. B. T. (nga data 07.10.2021 deri më datë 02.12.2021), dhe antarët znj. A. Ll., z. M. B., znj. P. S. (nga data 01.01.2021 deri më datë 18.02.2021), z. A. Ç., z. E. L. dhe z. A. K., me titullar të institucionit znj. D. I., ndërsa për muajin Dhjetor 2021 ka funksionuar Grupi i Punës me këtë përbërje: znj. I. D., Kryetar dhe antarët znj. A. Ll. dhe z. M. B., me Titullar të institucionit z. C. K.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për vitin 2021 janë lëshuar për tatimpaguesit 1180 autorizime për përjashtimin nga TVSH për procesin e rindërtimit dhe që i përkasin 581 NIPT-eve. Nga

Grupi i Auditimit u përzgjedhën për auditim autorizimet e lëshuara në muajt Prill dhe Nëntor 2021, gjithsej 153 autorizime sipas listës bashkëlidhur.

Nga auditimi i këtyre praktikave dokumentare rezultoi:

-Nga Grupi i Punës dhe Titullari i DPT në lëshimin e autorizimeve **është tejkaluar afati 5 ditor**, konkretisht: në muajin Prill në 74 raste nga 94 autorizime të lëshuara gjithsej në këtë muaj, ndërsa në muajin Nëntor në 55 raste nga 58 autorizime të lëshuara gjithsej (referuar listës bashkëlidhur) në kundërshtim me nenin 5 të VKM nr.143, datë 13.02.2020, me ndryshime, ku përcaktohet: òDrejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor.

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmenduar, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga paraqitja e kërkesës, lëshon autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit.

Në lëshimin e autorizimeve Grupi i Punës nuk ka respektuar dhe pikën 5 të urdhrit nr. 37, datë 22.05.2020, me ndryshimet e mëvonshme.

- Nga auditimi i praktikave dokumentare të përzgjedhura, konstatohet se nga Grupi i Punës në shqyrtimin e kërkesave, verifikimin e dokumentacionit dhe i ka rekomaduar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit në mosplotësim të dokumentacionit, në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, i ndryshuar, konkretisht, për autorizimet e muajit Prill 2021 nr. 256, 266, 269, 272, 274, 276, 287, 278, 279, 292, 293, 297, 307, 313, 318, 321, 324, 327, 333, 335 dhe të muajit Nëntor me nr. 974, 975, 977, 978, 985, 990, 1006, 1014, 2017, 1018, 1020, 1021 dhe 1026, të cilët u takojnë subjekteve nënkontraktore dhe furnizuese në procesin e rindërtimit. Bashkëlidhur këtyre praktikave mungojnë kontratat bazë dhe preventivat e subjekteve që kanë marrë pjesë në procesin e prokurimit e kanë lidhur kontrata me njësinë zbatuese (Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Tiranë, etj.) kjo me qëllim evidentimin e saktë të punëve, shërbimeve apo materialeve që do të kryhen nga këta subjekte.

Në kontratat e lidhura me këto njësi, përcaktohet që, **nënkontraktimi nuk lejohet, përveçse kur jepet miratim me shkrim nga autoriteti, por në asnjë rast nuk ka miratim me shkrim të këtyre autoriteteve** për lejimin e nënkontraktimeve me subjektet që kanë lidhur kontrata nënsipërmarrje me ndërtuesit/kontraktorët subjekte të rindërtimit, të cilët janë pajisur me autorizime për përjashtimin nga TVSH, duke krijuar risk të shtuar në monitorimin e këtij procesin nga të gjithë aktorët, në deformimin e procesit të prokurimit, por dhe krijimin e risqeve potenciale për shmangie të pagesës së TVSH-së.

Për të orientuar DRT në këtë proces, nga DPT është dërguar shkresa sqaruese nr. 4985/3prot., datë 04.03.2020, ku përcaktohet procedura që do të ndiqet prej tyre.

Me urdhrin nr. 48, datë 9.07.2021 òPër një ndryshim në urdhrin nr. 37, datë 22.05.2020.ò, është shtuar pika 6.1 me këtë përmbajtje: òGrupi i Punës monitoron zbatimin e procedurës së ndjekur nga ana e DRT-ve saktësuar shkresës sqaruese nr. 4985/3, datë 04.03.2020”, por nga auditimi rezulton **se nga grupi për vitin 2021 nuk është kryer procesi i monitorimit ndaj DRT** për zbatimin e kësaj procedure, gjithashtu prej tij nuk dihet e raportohet se sa është vlera e investimeve që lidhen me procesin e rindërtimit të përjashtuar nga TVSH, duke e lënë këtë proces të pamonitoruar e duke krijuar risqe të shtuara në administrimin e të ardhurave nga TVSH-ja, pavarësisht se me Planin Sektorial të Rindërtimit janë marrë në shqyrtim 399 subjekte për periudhën Gusht 2020- Prill 2021.

Nga verifikimi i dokumentacionit në Sektorin e Protokollit rezultoi se, subjekteve u janë përcjellë dorazi autorizimet e lëshuara në 71 raste (60 raste në muajin Prill dhe 11 raste në muajin Nëntor) dhe njëkohësisht me vonesë nga data e lëshimit të autorizimit nga 1 ditë punë në 11 ditë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar neni 23.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi titullarët e institucionit, sipas kohës në detyrë, kryetarët e grupit të punës dhe anëtarët e tij.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 121/42, datë 21.07.2022, òMbi Projekt-raportin e Auditimitò, protokolluar në KLSH me nr. 20/14 Prot., datë 27.07.2022, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

- **Lidhur me afatin e hartimit të autorizimeve sqaroj:**

Shkaqet objektive të cilat kanë sjellë vonesë në hartimin e autorizimeve në kohë kanë qenë (i) numri i lartë i kërkesave të ardhura për trajtim, (ii) volumi i madh i dokumentacionit që përmban secila prej praktikave që duhet të shqyrtohen (iii) anëtarët e grupit të punës përveç detyrave të ngarkuara më këtë urdhër kryenin dhe kryejnë detyrat funksionale sipas pozicionit të punës (iiii) gjatë periudhës anëtarë të grupit të punës vendin e punës sipas emërimit e kanë patur jo në DPT, por në DRT Tiranë dhe DTM.

Vlen të theksoj se, gjatë muajit tetor 2021 për shkak të ndryshimit të titullarit të DPT-së ka patur ndryshime në stafin menaxherial dhe drejtues në DPT. Në këto kushte koha e përpunimit të shkresave si në hyrje dhe në dalje për shkak të fluksit të tyre nuk ka qenë optimale për shkaqe objektive të pavarura nga grupi punës.

- **Lidhur me nënkontraktimet, mungesa e marrëveshjes kuadër të dokumentacioni i furnizuesve/nënkontraktorëve sqaroj:**

Në VKM nr. 804, datë 30.9.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 143 datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “. u shtuan si subjekte për tu pajisur me autorizim edhe i nënkontraktorëve dhe konkretisht citohet

“ç) nënkontraktorët, të cilët kanë lidhur kontrata me ndërtuesit/kontraktorët e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, për furnizimin e proceseve të ndërtimit, si dhe furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar.”

Pra, si subjekte të rindërtimit të autorizuar për përjashtimin nga TVSH-ja, përveç ndërtuesve/kontraktorëve, u përfshinë edhe të gjithë nënkontraktorët, të cilët kanë lidhur kontratë **direkt** me ndërtuesit/ kontraktorët, për furnizimin e proceseve të ndërtimit si dhe furnizuesit e mallrave ose shërbimeve që furnizojnë **direkt ndërtuesit e pajisur** me autorizim për përjashtimin nga TVSH nga Drejtori i Përgjithshëm e Tatimeve.

Për të zbatuar këtë ndryshim të aktit nënligjor, nga DPT është bërë njoftim publik ku përcaktohet se, për t’u pajisur me autorizim, subjektet furnizuese dhe nënkontraktorët duhet të bëjnë aplikim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku si pjesë të kërkesës duhet të paraqesin dokumentacionin ..

Në rastin kur kërkesat për autorizim janë si furnizues/ nënkontraktor, nuk kërkohet marrëveshja kuadër e përcaktuar në shkronjën b), të nenit 4 të VKM-së nr.143 datë 13.2.2020. Marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës, **në rastin e ndërtuesit/kontraktorëve;**

Pra kjo marrëveshje kërkohet si pjesë e dokumentacionit në rastin kur aplikuesi për autorizim është ndërtues/kontraktor sipas shkronjës b) të nenit 3, pra për subjektet që kanë lidhur marrëveshje me njësinë zbatuese. Gjithashtu, ju bëj me dije se kjo marrëveshje është edhe në dosjen e autorizimit të ndërtuesit/kontraktorit me të cilin furnizuesi/ nënkontraktori ka lidhur kontratën.

Gjithashtu, sipas VKM Nr. 804, datë 30.09.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.143, Datë 13.2.2020 nënkontraktorët janë autorizuar për përjashtim nga TVSH-ja bazuar në autorizimet e

ndërtuesve për të cilët kane dorëzuar të gjitha dokumentat sipas VKM 143, datë 13.02.2020, ku është edhe kontrata bazë edhe preventivat e subjekteve që kanë marrë pjesë në procesin e prokurimit e kanë lidhur kontrata me njësitë zbatuese.

- **Lidhur me nën kontraktimin sqaroj:**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucion zbatues dhe për procesin e pajisjes së subjekteve me autorizime DPT zbaton dispozitat e parashikuara nga Vendimi nr. 143, datë 13.02.2020, i ndryshuar.

Ky vendim në nenin 4, të tij përcakton procedurat dhe dokumentacionin që dorëzohet pranë DPT-së. Në këtë nen, nuk është parashikuar se pjesë e dokumentacionit duhet të jetë aprovimi paraprak me shkrim i autoritetit përgjegjës. Sqaroj se, autorizimi për nënkontraktorin, nuk jepet për të përjashtuar një vlerë të re sepse punimet që do të kryejë nënkontraktori janë brenda vlerës së përcaktuar në kontratën kryesore midis njësisë zbatuese dhe ndërtuesit.

Vlen të theksoj se, nënkontraktorët e pajisur me autorizim monitorohen njësoj si ndërtuesit, bazuar në shkresën sqaruese nr. 4985/3 prot., datë 04.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm e cila përveçse parashikon në mënyrë të detajuar procedurën e monitorimit të të gjitha subjekteve të pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja është e detyrueshme të zbatohet nga Drejtoritë rajonale dhe tatimpaguesit bazuar në ligjin nr. 9920/2008, "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, pra nga kjo pikëpamje nuk përbën risk për shmangie të pagesës së TVSH-së.

- **Lidhur me monitorimin e DRT-ve sqaroj se:**

Në urdhrin nr. 48 datë 09.07.2020, përcaktohet se Grupi i punës monitoron zbatimin e procedurës së ndjekur nga ana e DRT-ve saktësuar me shkresën sqaruese nr. 4985/3 prot., datë 04.03.2020.

Me qëllim të njohjes së ecurisë së procesit si nga ana e problematikave ashtu dhe për gjetjet e mundshme nga inspektorët e drejtorive rajonale, në ambientet e DPT-së janë zhvilluar takime të vazhdueshme me DRT-të me fokus orientimin e tyre në lidhje me zbatimin e detyrave të përcaktuara në shkresën sqaruese.

Theksoj se, bazuar në legjislacionin tatimor dhe në shkresën sqaruese nr. 4985/3 prot., datë 04.03.2020 janë Drejtoritë Rajonale Tatimore ato të cilat e monitorojnë zbatimin e ligjit nga ana e tatimpaguesit në procesin e rindërtimit sepse DPT nuk ka tagër të kontrollojë tatimpaguesin.

Lidhur me mënyrën e tërheqjes së shkresave nga DPT, apo vonesave në dërgim pasi shkresa ka marrë numër protokolli, sqaroj se kjo nuk është në kompetencë apo detyrë e Grupit të Punës, prandaj nuk mund të jap argumenta.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Nga shqyrtimi i komenteve të bëra subjekti i audituar, konstatojmë se janë të njëjta me observacionet e sjella për Akt Konstatimin nr. 15, datë 15.07.2022, të cilat janë shqyrtuar dhe janë trajtuar hollësisht në Projektraportin e Auditimit. Gjithashtu, nga subjekti nuk ka argumenta apo dokumentacion shtesë për të mbështetur pretendimet e tij, e për rrjedhojë observacioni nuk merret në konsideratë dhe nuk ndryshon opinionin e Grupit të Auditimit.

**Titulli i Gjetjes:**

Mangësi në lëshimin e autorizimeve për përjashtimin nga TVSH-ja për procesin e rindërtimit.

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit, konstatohet se, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për vitin 2021 janë lëshuar për tatimpaguesit 1180 autorizime për përjashtimin nga TVSH për procesin e rindërtimit dhe që i përkasin 581 NIPT-eve. Nga Grupi i Auditimit u përzgjedhën për auditim autorizimet e lëshuara në muajt Prill dhe Nëntor 2021, gjithsej 153 autorizime (sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Nga auditimi i këtyre praktikave dokumentare rezultoi:

- Nga Grupi i Punës dhe Titullari i DPT në lëshimin e autorizimeve **është tejkaluar afati 5 ditor**, konkretisht: në muajin Prill në 74 raste nga 94 autorizime të lëshuara gjithsej në këtë muaj, ndërsa në muajin Nëntor në 55 raste nga 58 autorizime të lëshuara gjithsej, në kundërshtim me nenin 5 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, me ndryshime, ku përcaktohet: òDrejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditorë.

- Për lëshimin e autorizimeve Grupi i Punës nuk ka respektuar dhe kërkesat e urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37, datë 22.05.2020 òPër ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të subjekteve të rindërtimit që aplikojnë për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuarë, me ndryshimet e mëvonshme, pika 5, ku përcaktohet afati 5 ditor për shqyrtimin e dokumentacionit dhe lëshimin e autorizimeve.

- Grupi i Punës në shqyrtimin e kërkesave, verifikimin e dokumentacionit dhe duke i rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit ka vepruar në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit, në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, i ndryshuar, konkretisht, për 33 raste gjithsej, për autorizimet e muajit Prill 2021 me nr. 256, 266, 269, 272, 274, 276, 287, 278, 279, 292, 293, 297, 307, 313, 318, 321, 324, 327, 333, 335 dhe të muajit Nëntor me nr. 974, 975, 977, 978, 985, 990, 1006, 1014, 2017, 1018, 1020, 1021 dhe 1026, të cilët u takojnë subjekteve nënkontraktore dhe furnizuese në procesin e rindërtimit. Bashkëlidhur këtyre praktikave mungojnë kontratat bazë dhe preventivat e subjekteve që kanë marrë pjesë në procesin e prokurimit e kanë lidhur kontrata me njësinë zbatuese (Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Tiranë, etj.) kjo me qëllim evidentimin e saktë të punëve, shërbimeve apo materialeve që do të kryhen nga këta subjekte.

Në kontratat e lidhura me këto njësi, përcaktohet që, **nënkontraktimi nuk lejohet, përveçse kur jepet miratim me shkrim nga autoriteti, por në asnjë rast nuk ka miratim me shkrim të këtyre autoriteteve** për lejimin e nënkontraktimeve me subjektet që kanë lidhur kontrata nënsipërmarrje me ndërtuesit/ kontraktorët subjekte të rindërtimit, të cilët janë pajisur me autorizime për përjashtimin nga TVSH, duke krijuar risk të shtuar në monitorimin e këtij procesi nga të gjithë aktorët, në deformimin e procesit të prokurimit, por dhe krijimin e risqeve potenciale për shmangie të pagesës së TVSH-së.

Për të orientuar DRT në këtë proces, nga DPT është dërguar shkresa sqaruese nr. 4985/3 prot., datë 04.03.2020, ku përcaktohet procedura që do të ndiqet prej tyre.

Me urdhrin nr. 48, datë 9.07.2021 òPër një ndryshim në urdhrin nr. 37, datë 22.05.2020.ò, është shtuar pika 6.1 me këtë përmbajtje: òGrupi i Punës monitoron zbatimin e procedurës së ndjekur nga ana e DRT-ve saktësuar shkresës sqaruese nr. 4985/3, datë 04.03.2020”, por nga auditimi rezulton **se nga Grupi i punës për vitin 2021 nuk është kryer procesi i monitorimit ndaj DRT** për zbatimin e kësaj procedure, gjithashtu prej tij nuk dihet e raportohet se sa është vlera e investimeve që lidhen me procesin e

rindërtimit të përjashtuar nga TVSH, duke e lënë këtë proces të pamonitoruar e duke krijuar risqe të shtuara në administrimin e të ardhurave nga TVSH-ja, pavarësisht se me Planin Sektorial të Rindërtimit janë marrë në shqyrtim 399 subjekte për periudhën Gusht 2020- Prill 2021.

- Nga verifikimi i dokumentacionit në Sektorin e Protokollit rezultoi se, subjekte u janë përcjellë dorazi autorizimet e lëshuara në 71 raste (60 raste në muajin Prill dhe 11 raste në muajin Nëntor) dhe njëkohësisht me vonesë nga data e lëshimit të autorizimit nga 1 ditë punë në 11 ditë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar neni 23.

**Kriteri:**

-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar, neni 23,

-Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar, neni 23,

-VKM nr. 143, datë 13.02.2020 òPër procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimitò, i ndryshuar me VKM nr. 804, datë 30.09.2020 dhe VKM nr. 1108, datë 28.12.2020, nenet 4 dhe 5

-Urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37, datë 22. 05.2020 òPër ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimit të kushtëve të subjekteve të rindërtimit që aplikojnë për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuarò, ndryshuar me urdhërat nr. 41, datë 19.06.2020, nr. 48, datë 09.07.2020, nr. 90, datë 15.12.2020, nr.13, datë 18.02.2021, nr.77, datë 7.10.2021 dhe nr. 86, datë 02.12.2021.

**Ndikimi/Efekti:**

Proces e parregullt në lëshimin e autorizimeve dhe risqe për shmangie të pagesës së TVSH-së nga subjektet e rindërtimit.

**Shkaku:**

Mungesa e monitorimit të procesit të përjashtimit të procesit të rindërtimit nga pagesa e TVSH-së,

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandimi:**

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa të menjëhershme për monitorimin e procedurave të lëshimit të autorizimit, si dhe marrjen e masave për kontrollin e DRT lidhur me zbatimin e kërkesave të shkresës sqaruese nr. 4985/3prot., datë 04.03.2020, drejtuar DRT-ve.

**Afati:**

Menjëherë

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 298/16 prot., datë 13.10.2021, protokolluar në DPT me nr. 8715/44 prot., datë 15.10.2021 është konstatuar se, DPT me shkresën nr. 8715/45, datë 11.11.2021 òNjofitim mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeveò, bashkëlidhur planin e masave, ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në tejkallim të afatit kohor prej 20 ditë, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, si dhe nuk ka raportuar për ecurinë e realizimit të tyre në afatin 6-mujor, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm konstatohet se, nga 37 rekomandime të lëna subjekti ka pranuar plotësisht 31 rekomandime, ose 83.8% e tyre dhe ka pranuar pjesërisht 5 rekomandime, ose 13.5% të tyre.

Janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime ose 21.6%, janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime ose 16.2%, janë në proces 11 rekomandime ose 29.7% dhe nuk janë realizuar 12 rekomandime ose 32.4% e tyre, si më poshtë:

- Janë rekomanduar 2 masa òPropozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqiò, të pranuar, nga të cilat një rekomandim nuk është zbatuar dhe një rekomandim është në proces;

- Janë lënë 32 rekomandime òMasa Organizativeò nga të cilat janë pranuar 26 rekomandime janë pranuar pjesërisht 5 rekomandime dhe nuk është pranuar një rekomandim;

Nga 26 rekomandime të pranuar, 6 rekomandime janë realizuar; 8 rekomandime janë në proces, 2 rekomandime janë në pjesërisht të realizuara dhe 10 rekomandime nuk janë realizuar;

Nga 5 rekomandime të pranuar pjesërisht rezulton se: një rekomandim është zbatuar, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe një rekomandim është në proces;

- Janë lënë dy masa òPër eliminimin e efekteve negative financiareò të cilat janë pranuar dhe një rekomandim është në proces dhe tjetri është i pazbatuar;

- Është lënë në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm vlerësimi i shkeljeve të konstatuara nga auditimi dhe dhënia e masave disiplinore, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se titullari ka vendosur mosfillimin e procedimit disiplinor.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 18-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe të vijojë marrja e masave nga DPT për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe të pa zbatuara.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, pavarësisht realizimit bruto të të ardhurve nga tatimet në masën 103.3% kundrejt planit, të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për shumën 7,134,393 mijë lekë, ose janë arkëtuar më pak në masën 4.7%, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor, konkretisht:



- Për vitin 2021 të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore, në terma bruto u realizuan në shumën 54,461,470 mijë lekë, ose në masën 93.4% të planit, me një mosrealizim në shumën 3,848,530 mijë lekë, ndërsa të ardhurat në terma neto, janë realizuar në shumën 30,359,348 mijë lekë nga shuma 41,310,000 mijë lekë që ishin programuar, pra me një mosrealizim në vlerë prej 10,950,652 mijë lekë, ose 26.5% më pak. Ndikim në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat ka patur jo vetëm mosarkëtimi i të ardhurave nga TVSH e krijimi i detyrimeve të reja, ndikimi i dy fenomeneve (tërmetit të vitit 2019 dhe Covid 19), por dhe tejkalimi i planit të rimbursimit me 42% të tij.

- Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 14,215,000 mijë lekë dhe janë arkëtuar në vlerën 13,429,960 lekë, me një mosrealizim prej 785,040 mijë lekë ose 5.5% më pak, ndërsa të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, nga vlera 20,500,000 mijë lekë të programuara, janë arkëtuar në shumën 19,706,202 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 793,798 mijë lekë, ose 3.9% më pak, në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 137/2020, datë 16.11.2020 òPër buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar, si dhe shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi planin e të ardhurave tatimore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 34-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre llojeve të ardhurave, përfshirë dhe çështjet e planifikimit, me qëllim marrjen e masave për arritjen e objektivave të institucionit dhe shmangien e situatave të tilla në të ardhmen.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe të raportimit të të ardhurave tatimore konstatohet se, raportohen si të ardhura gjordat e vendosura nga sistemi tatimor gjatë vitit 2021 në shumën 633,826 mijë lekë, ndërsa sipas klasifikimit ekonomik gjordat që lidhen me tatimet dhe taksat përfshihen në titullin e të ardhurave jo tatimore, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 34-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim saktësimin e vlerës së të ardhurave gjithsej dhe atyre tatimore në mënyrë analitike sipas llojit të tatimeve/taksave të shprehur në raportimet e DPT-së.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën rreth 122,468 milion lekë që i përket një numri prej 168,851 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit **2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 134,935 milion lekë që i përket një numri prej rreth 192,701 subjektsh debitorë.** Pra, nga krahasimi i situatës në fund të vitit 2021 me atë të fillimit të vitit, rezulton një **rritje** prej rreth 12.5 miliard lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 23,850 të numrit të debitorëve të shtuar në fund të vitit. Krahasuar me një vit më parë (ku rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2020 në 21.12.2020 ishte me rreth 5.4 miliard lekë dhe 17,609 subjekte debitorë) kjo rritje paraqitet e konsiderueshme, si në drejtim të vlerës së detyrimeve të papaguara, ashtu edhe në numër subjektsh debitorë. Krahasuar me vitin paraardhës, gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2021 rezulton **12,467 milion lekë më shumë të vlerës së detyrimeve dhe me një rritje prej 23,850 të numrit të subjekteve debitorë.**

Nga auditimi konstatohet gjithashtu se **stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mblidhet) veçanërisht nga subjektet që administrohen nga DRT Qendrore ku vlera e detyrimeve të shtuara është rreth 2-fish më shumë se e atyre të pakësuara.**

Me rritje rezultojnë edhe numri i subjekteve debitorë në proces gjyqësor, i cili deri në fund të vitit 2021 paraqitet në 1,592 subjekte me një vlerë prej rreth 14,298 milion lekë të detyrimeve të papaguara, pra rreth 130 subjekte më shumë se një vit më parë dhe me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuar në gjykatë prej rreth 576 milion lekë më shumë. Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve, situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankimuar prej rreth 9,247 miliard lekë për 1,142 subjekte, ndjekur nga DRT VIP me rreth 3,138 miliard lekë për 96 subjekte.

Gjithashtu, rezulton se evidencat e raportimit të borxhit janë tepër sintetike, gjë e cila nuk mundëson kryerjen e analizave të detajuara në nivel DRT-je, ku edhe në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për të dhënat analitike të detyrimeve tatimore të pa paguara në rang subjektesh debitorë/tatimpaguesish sipas vlerave respektive të këtyre detyrimeve, me qëllim analizimin e subjekteve që përbëjnë edhe pjesën më të konsiderueshme të këtij stoku, ky informacion nuk u vendos në dispozicion përgjatë periudhës së auditimit në terren.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masat për të luajtur një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit dhe marrjen e masave konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar për uljen e borxhit tatimor, i cili gjatë periudhës objekt auditimi paraqitet me një trend rritës.

- Titullari i DPT të marrë masat për të siguruar nga DRT-të informacionin analitik lidhur me subjektet debitorë, që i përket të dhënave statistikore të raportuara në total nga këto struktura pranë DMDTP, në mënyrë që të kryhet një analizë më e hollësishme nga ana e drejtorisë lidhur me numrin e subjekteve që përbëjnë stokun më të lartë të detyrimeve të papaguara; implementimin e masave shtrënguese nga ana e tyre, duke nxjerrë përgjegjësinë e zyrtarëve përkatës në këtë drejtim.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor jashtë sistemit C@TS në vlerën **2,714,960,228 lekë**, i cili paraqitet me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën **94,858,223 lekë (2,809,818,452 lekë në vitin 2020)**, e cila përbëhet nga detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo të gjitha deklaratat tatimore ishin të informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin në ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore.

Pjesën më të madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket periudhës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,107,792,556 lekë i përket vetëm 2 tatimpaguesve, òA.ò SHA në vlerën 2,106,993,328 lekë, subjekt i cili është në administrim të DRT Tiranë dhe subjekti òI. 99ò, në vlerën 799,228 lekë, subjekt i cili është në administrim të DR Tatimpaguesit e Mëdhenj, dhe sipas informacionit të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikave nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem.

Detyrimet jashtë sistemit C@TS për pjesën e të ardhurave tatimore (kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shumën 217,302,943 lekë; tatim mbi të ardhurat personale në shumën 56,844,018 lekë; tatim fitimi në shumën 2,772,290 lekë; të tjera tatime në burim 18,655,210 lekë, etj.), për të cilat janë përgjegjës Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektorët e kontrollit nga zyra. Këto detyrime më 31.12.2021 paraqiten në vlerën **313,021,440 lekë, të cilat duhej të ishin hedhur në sistemin C@TS**, pasi për to ka module përkatëse, por nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2021 të jenë kryer sisteme vetëm për një pjesë të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoritë e Kontrollit Tatimor pranë tyre dhe me inspektorët e kontrollit nga zyra të marrë masat për të hedhur në sistemin C@TS detyrimet prej 313,021,439 lekë, për të cilat ka module përkatëse në sistem, proces ky i monitoruar në DPT.

- Nga ana e DPT të merren masa që të ndiqen sipas dispozitave ligjore në fuqi ndjekja deri në arkëtim e detyrimeve të akcizës të mbajtura jashtë sistemit C@TS në shumën prej 2,107,792,556 lekë, që i përket 2 subjekteve të sipërpërmendur, për të cilët sistemi ekzistues nuk disponon modulin e posaçëm për hedhjen e këtij detyrimi.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se me rishikimin e Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ndër të tjera është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e **marrëveshjeve me këste**. Këto ndryshime argumentohet se janë kryer në kuadër të riorganizimit të drejtorisë (DMDTP) pasi ky rol nuk do të kryhet më nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, por do të jetë nën kompetencën e Drejtorive të Kontrollit në Rajone. Nga auditimi rezulton se këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë këto drejtori apo edhe Drejtoria e Kontrollit në DPT dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezulton i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cënuar kështu veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë e Teknikave Ligjore të marrin masat për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve të pagesës me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore, duke shqyrtuar mundësinë për të përfshirë në manualin ekzistues edhe procedurat përkatëse, apo reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të Drejtorive Rajonale Tatimore, ku Drejtoria e Kontrollit në DPT të kryejë rolin e saj si udhëheqëse metodologjike e funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimin e punës së DRT-ve për zbatimin, implementimin dhe cilësinë e kryerjes së kontrollit konform legjislacionit në fuqi.

**Brenda vitit 2022**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në zbatim të Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Kreu 2.1.1 i Inspektimit, me shkresën nr. 17897 Prot., datë 05.10.2021 është miratuar programi i inspektimit nga Z/v. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me objekt **Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara për Rajonin Verior dhe Qendror, për periudhën 01.08.2020-31.08.2021**. Inspektimi për Rajonin Verior është kryer në periudhën 11.10.2021-25.10.2021 dhe Projektraporti është dërguar në datën 16.02.2022. Inspektimi për Rajonin Verior është kryer në periudhën 08.11.2021-22.11.2021 dhe Projektraporti është dërguar në datën 25.02.2022. Nga auditimi konstatohet se programet e inspektimit për këtë periudhë, nuk kanë përfshirë Rajonin Jugor dhe VIP. Gjithashtu, referuar faktit se edhe një vit më parë nuk janë kryer inspektimet në 4 Rajonet/Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM pranë Drejtorive Rajonale, me argumentin e shpalljes së gjendjes së okarantinës për Covid-19, kjo situatë përbën një risk të shtuar për realizimin e misionit dhe objektiveve të DPT në drejtim të maksimizimit të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara në të gjithë territorin e vendit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat për finalizimin e inspektimeve për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, në përmbushje të planit operacional, si dhe të garantojë një mbulim sa më të plotë të këtij procesi në të gjithë rajonet.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së (DRTVSH), me qëllim automatizimin e procesit të rimbursimit në kohë të kërkesave të regjistruara pranë DRTVSH-së dhe uljen e numrit të kërkesave të cilat dërgohen për kontroll para rimbursimit, ka propozuar ndryshime/lehtësime në kriteret që analizohen gjatë procedurës së rimbursimit nga DRTVSH, por disa prej tyre nuk kanë mbështetje ligjore.

Kështu, në Rregulloren e Drejtorisë së Rimbursimit miratuar me vendimin nr. 27, datë 13.10.2021 të Komitetit të Përmbushjes, në mënyrën e trajtimit të kërkesës për rimbursim dhe kontrollet që duhet të kryhen, konstatohet se: Kontrolli nr. 2 òA është referuar në Prokurori tatimpaguesi gjatë 5 viteve të fundit nga strukturat kompetente hetimore bazuar në dyshimet e konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave apo evazionit fiskalë dhe Kontrolli nr. 4 òA është kërkesa për rimbursim më e madhe se 100 milion lekë, nuk bazohen në kërkesat e VKM nr. 953, datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, duke krijuar hallka të tepërta në këtë proces.

Gjithashtu, në këtë rregullore, por dhe në rregulloren e miratuar më urdhrin nr. 19/1, datë 28.04.2020, e ndryshuar, në rastet e përcaktimit të subjekteve me risk, kalohen për kontroll **në vend** dhe për kontroll **nga zyra**, ku ky i fundit vlerësojmë se është thjesht formal, pasi nuk kryhet procesi i inventarizimit në subjekt, si një ndër proceset kryesore të kontrollit, kjo duke ju referuar dhe 381 kontrolleve nga zyra për rimbursimin e TVSH-së me një vlerë të kërkuar prej 1,254 milion lekë, ku gjetjet nga këto kontrolle nuk janë materiale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të ndërmarrë masat e nevojshme për rishikimin e Rregullosës së Drejtorisë së Rimbursimit, duke hequr: Kontrollin nr. 2 dhe nr. 4, me qëllim eliminimin e hallkave të tepërta në këtë proces e sjelljen e tij në komizën ligjore. Gjithashtu, të hiqet edhe paragrafi i kontrollit nga zyra, në rastet kur subjektet me risk kalohen për kontroll **në vend** dhe për kontroll **nga zyra**, ku ky i fundit është thjesht formal, pasi nuk kryhet procesi i inventarizimit në subjekt, si një ndër proceset kryesore të kontrollit.

**Brenda vitit 2022**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është **programuar në shumën 17,000,000 mijë lekë**, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është **realizuar në shumën 24,100,604 mijë lekë**, duke rezultuar **me tejkalim në shumën 7,101,604 mijë lekë**, ose **42%** më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

Gjithashtu, konstatohet se në 7 Drejtori Rajonale është tejkualuar plani i rimbursimit, konkretisht në: DRT Tiranë, DTM, Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë dhe Vlorë, të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale 7,596,852 mijë lekë, ose ka tejkualuar fondet e parashikuara për rimbursimin e TVSH-së, ndërsa 7 DRT nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për shumën 496,248 mijë lekë.

Referuar sa më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën 16,651,143 mijë lekë, ose 69%, të totalit të realizimit faktik në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën 158.6% e ndjekur më pas më DRT Tiranë, e cila ka paguar shumën 2,816,584 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 142%, ose e ka tejkualuar atë në shumën 831,854 mijë lekë, veprime këto në

kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar, neni 14; ligjin nr. 137/2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò, i ndryshuar dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se mund të procedohet me kryerjen e pagesave, në bashkëpunim me MFE, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve të rimbursimit.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së me shkresën nr. 1293 prot., 27.01.2022 ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit në shumën 476,650 mijë lekë në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT për datën 31.12.2021, në zbatim të Udhëzimit nr. 8, të MFE òPër përgatitjen e pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes qendroreò.

Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, rezultojnë **69 kërkesa** për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për **1,893,609 mijë lekë**, të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 75/1, òRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika 1, dhe VKM nr. 953, datë 29.12.2014 òPër dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4. ***Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit më 31.12.2021 sipas vlerësimit tonë më së paku është 2,370,259 mijë lekë.***

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut konstatohet se, moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2015, vit në të cilin është implementuar, sepse ky modul shqyrton automatikisht aspekte të veçantë të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi. Ky azhormim bëhet i domosdoshëm për të qenë në koherencë me gjithë ndryshimet që ka pësuar legjislacioni fiskal ndër vite, vetë administrata tatimore por edhe profili i tatimpaguesve. Kjo me qëllim identifikimin dhe verifikimin e tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial në harmoni me procedurat ligjore në fuqi dhe ndihmon administratën tatimore të zbulojë evazionin dhe mashtrimin tatimor;

- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës;

- Megjithëse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën Drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, ose janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale;

- Renditjen e subjekteve me të njëjtin numër rregullash të thyera;

- Për vitin 2021 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 278 kontrole nga 1975 kontrole të planifikuara, ose rreth 14% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë dhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale;

Referuar Manualit të riskut, Drejtoritë Rajonale Tatimore i dërgojnë Drejtorisë së Kontrollit në DPT, brenda datës 10 të çdo muaji, raportin mbi aktivitetin e kontrollit të muajit të kaluar, përfshirë kontrollet e plota dhe vizitat fiskale. Drejtoria e Kontrollit në DPT përpilon raportin mujor i cili shqyrtohet dhe nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut për qëllime të objektit të punës në lidhje me kriteret e riskut. Mbi këtë bazë Drejtoria e Menaxhimit të Riskut raporton rregullisht brenda datës 20 të çdo muaji te Nëndrejtori i Përgjithshëm i varësisë, por nga auditimi konstatohet mungesa e dokumentimit të raportimit mujor të DMR-së, në kundërshtim me kapitullin 7 ÷Përpunimi i të dhënave, pika 7.1 ÷Nxjerrja e raporteve, nënpika 4 e Manualit të Menaxhimit të Riskut.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme Tatimore të marrë masa për:

-Të përditësuar dhe përmirësuar modulën e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore.

- Të përditësuar dhe përmirësuar modulën e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore për të zbuluar evazionin dhe mashtrimin tatimor.

- Plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

-Standardizimin dhe dokumentimin e raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundësuar unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara. Në çdo rast të përgatiten raporte përgjithësuese në mënyrë periodike me problematikat më të shpeshta të hasura dhe me mendime për përmirësimin e kriterëve të risqeve.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT konstatohet se, grupet e kontrollit në pikat nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5 të programit të kontrollit, përmbajnë konstatime përgjithësuese, pa problematikë të veçantë, ku të evidentohen shkelje të afateve procedurale.

- Trajtohet në përgjithësi pa analiza konkrete pika 2 ÷Kontrolli i afateve në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit të Kontrollit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit, në zbatim të neneve 83 dhe 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2009, i ndryshuar, me komentin se do të trajtohet në pikën 6 të programit. Në programin e kontrollit, nuk përfshihen ato çështje që paraqesin risk, dhe është një program përgjithësues, pikat e të cilit mund të verifikohen lehtësisht nga zyra sipas të dhënave dhe dokumenteve të ngarkuara në sistemin C@ts.

- Grupi kontrollit për realizimin e pikës 6 ÷Shqyrtimi dhe verifikimi i cilësisë së raporteve të kontrollit sipas inspektoreve të kontrollit ka trajtuar subjektet në të cilat janë përshkruar saktësitë e raportit të kontrollit dhe parregullsitë e konstatuara në të.

- Nga grupi i auditimit nuk është dokumentuar evidenca mbi të cilën Drejtoria e Kontrollit ka kryer përzgjedhjen e subjekteve për kontroll dhe mënyra e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll.

Për vitin 2021 konstatohen tejkallime të afateve të evadimit të Raportit të Kontrollit për DRT Shkodër dhe Sarandë, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, si dhe - konstatohet se është pezulluar kontrolli i planifikuar në Drejtorinë Rajonale Tiranë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të ngrejë një grup pune për përmirësimin e Manualit të Kontrollit ku të përcaktohen kriteret e përzgjedhjes dhe metodat e kampionimit të subjekteve për kontroll që në fazën e planifikimit.

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të urdhërojë përfundimin e kontrollit të ndërprerë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, në bazë të autorizimit nr. 16946, datë 17.09.2021, si dhe të marrë masat e nevojshme për realizimin e evadimit të kontrolleve brenda afateve të përcaktuara.

**Menjëherë e në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë për verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet, kontrollohet dhe analizohen çështje të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e DK në DRT si: situata kreditore debitore e tatimpaguesve për sigurimet; efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra; nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve; si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit; për kështet e tatimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi; për kontrollet nga zyra; për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit; sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur sërka apelime; si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT; gjendja kreditore të TVSH-së; mbi situatat e parregullta sa janë dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët e kontrollit nga zyra; se ku bazohen dhe si zgjidhen rastet për kontroll nga inspektorët e kontrollit në DRT.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor të hartojë praktika verifikimi nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga sistemi C@ts, nëpërmjet analizave të situatave kreditor-debitor të tatimpaguesve për sigurimet shoqërore; të zbatimit të procesit të rimbursimit; të gjendjes kreditore të TVSH-së; analiza për kështet e tatim fitimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi, kryqëzimin me të dhënat nga sistemi doganor, etj., me qëllim identifikimin e problematikave dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.

**Menjëherë e në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se nga Drejtoria e Kontrollit nuk janë përfunduar kontrole nga viti 2015, pasi deri në fund të dhjetorit të vitit 2021 janë gjithsej 678 kontrole të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë:

- Në 278 kontrole të pa filluara nga administrata tatimore janë përfshirë edhe kontrollet e planifikuara për muajin Dhjetor 2021, të cilat u janë nisur njoftimi për kontroll, kjo bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në RSHö, i ndryshuar dhe Udhëzimit në mbështetje të tij, neni 81.1/1;

- 14 kontrole janë të pezulluar;

- 291 kontrole janë në fazë projekt raporti;

- 87 kontrole janë në fazën e raportit përfundimtar.

- 1 kontroll është në fazën e evadimit.

Kontrollet e mësipërme janë jashtë afateve përkatëse të kryerjes së kontrollit, projekt-raportit, raportit përfundimtar apo dhe evadimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e përcaktuara me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të

funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të të gjitha Drejtorive Rajonale Tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor.

## Menjëherë e në vijimësi

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga përgjigjet e pyetësorit të dhënë Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, rezulton se nuk janë identifikuar individët me të ardhura personale të padeklaruara dhe të pa tatuara për të gjitha burimet e të ardhurave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Informacioni është mbledhur nga TIK (brenda sistemit tatimor), për deklarimin e DIVA, ndërsa vlerësimi i riskut është kryer sipas metodologjisë së përcaktuar në manual. Procedimi në këtë mënyrë vlerësojmë se është jo korrekt, sepse risku i lartë i evazionit në deklarimin dhe fshehjen e të ardhurave nuk është brenda sistemit tatimor, por jashtë tij. Për vitin 2021 nuk ka patur urdhra pune, nuk janë kryer intervistime, nuk kanë rezultuar raste për të përcjellë në DRT përkatëse për vlerësime tatimore, nuk janë krijuar profile për individët bazuar në informacionet e mbledhura, si dhe dosje për secilin, por janë dërguar disa formular tip për individët me të ardhura të larta dhe deklarues të DIVA 2020, kjo sipas problematikave të identifikuara, me qëllim nxitjen e përmbushjes vullnetare të detyrimit për deklarim. Nga sa është konstatuar, arrijmë në konkluzionin se Drejtoria e Kontrollit të Specializuar nuk e ka përmbushur misionin e krijimit të saj, duke qenë një strukturë jo efiçente në përmbushjen e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i fushës, ku shkak kryesor i kësaj situate është mungesa e akteve ligjore dhe nënligjore për të operuar normalisht në funksion të qëllimit të krijimit të kësaj drejtorie.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1.Rekomandimi:** DPT të marrë masa për hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim vijimin normal të punës në përmbushje të misionit dhe objektivit të krijimit të kësaj drejtorie.

## Menjëherë

**16. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me auditimin e funksionimit të Programit “E-Inspektor”, kanë rezultuar problematikave të trajtuara në mënyrë të përmbledhur si më poshtë: Janë vendosur në dispozicion të dhëna (*data baza excel me informacion mbi lëvizjet, kohëqëndrimin e inspektorëve në subjektet e kontrolluara, detajeve, koordinatave gjeografike, pozicionit në hartë etj*), nga programi “E-Inspektor” vetëm për 3 muaj konkretisht, *qershor, korrik dhe gusht* dhe jo për gjithë vitin 2021, por nga verifikimi i urdhër shpenzimeve dhe pagesave të realizuar nga ana e Drejtorisë së Financës rezulton se është kryer likuidimi për të gjithë muajt konform obligimeve të kontratës të lidhur me operatorin fitues. Theksojmë se, kërkesa për të dhëna është bërë për të gjithë periudhën objekt auditimi sipas programit të auditimit që përfshin *01.01.2021-31.12.2021*, por nga ana e subjektit janë vendosur në dispozicion të dhëna vetëm për tre muaj dhe duke ngritur pretendimin se nuk kanë më mundësi të kenë akses tek programi E-Inspektor mbas mbarimit të vlefshmërisë së kontratës për të nxjerrë të dhënat për muajt e tjerë të kërkuar. Të dhënat e plota nuk janë vendosur në dispozicion deri në përfundimin e punës në terren në datë 13.05.2022, *fakt ky që ka ndikuar në kufizimin e punës audituese të grupit.* Gjithashtu, nga shqyrtimi i email-eve të inspektorëve të monitorimit në terren të vendosur në dispozicion, ku shprehen se kanë hasur problematika të shumta të funksionimit normal të programit dhe sipas kronologjisë kohore rezulton se këto problematika kanë qenë të shtrira përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, gjë që tregon se nuk i është dhënë zgjidhje permanente këtyre problematikave të sistemit.

Nga auditimi i dosjeve të procedurave të likuidimit të kontratës ka rezultuar se komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim të shërbimit, mbasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimin e mirëmbajtjes së shërbimit të “*Blerje shërbimi i automatizimi dhe monitorimi i inspektoreve*”, për periudhat përkatëse,



ka marrë në dorëzim shërbimin duke u shprehur se është në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës, situatë kontradiktore kjo e cila në vlerësimin tonë nuk qëndron, pasi programi “E-Inspektor” ka rezultuar me problematika të shumta si më sipër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1.Rekomandimi:** DPT të shikojë mundësinë e vendosjes së një Software/Aplikacioni ku të jenë të integruar Live-Tracking System, GPS Position System dhe Live Camera System, me qëllim automatizimin dhe monitorimin e punës së inspektorëve të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT).

## Menjëherë

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve me akt konstatime dhe procesverbale gjobash të mbajtura në lidhje me rastet e shkeljeve, konkretisht: 5 dosje “Mallra pa faturë”, 10 dosje “Moslëshim i kuponit tatimorë- rasti i parë” dhe 5 dosje “Punonjës i padeklaruar biznesi i vogël”, të mbajtura në vitin 2021, kanë rezultuar problematikat si mëposhtë:

- Raste kur nuk është mbajtur procesverbal i inventarizimit të mallit të gjetur të pashoqëruar me dokumente tatimore;
- Raste në akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve ku citohet se “në pamundësi verifikimi nga sistemi verifikohet nga zyra”, pra në këtë rast nuk është përdorur programi “E-Inspektor” sipas përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren;
- Raste në akt konstatimet e mbajtura nga ana e inspektorëve ku nuk është përmendur se çfarë përgjegjësie tatimore ka tatimpaguesi i cili ka kryer shkeljen;
- Raste ku nuk është lëshuar faturë tatimore ose faturë e thjeshtë tatimore për të dokumentuar mallin e gjetur të pashoqëruar me dokumentacion tatimor;
- Ka rezultuar se sipas akt konstatimeve në disa raste subjekti nuk ka në përdorim dokumentacion dhe duhet të ishte kryer penalizimi i subjektit sipas nenit 118 “Mosmbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Në disa akt konstatime nuk janë shprehur n.q.s ka pasur të afishuar apo jo listë të çmimeve të produkteve. Dhe n.q.s nuk i ka të afishuara çmimet, të kryhej penalizimi sipas nenit 130 “Mosafishimi i çmimeve të shitjes” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Në disa raste inventarizimi i mallit gjendje është kryer gabim nga ana e inspektorëve sepse nuk janë fiksuar faturat e fundit të shitjes dhe blerjes.
- Raste kur është mbajtur vetëm akt-konstatimi në lidhje me shkeljen e “Moslëshim të faturave tatimore” dhe nuk është mbajtur procesverbal gjobe për këtë rast, si dhe nuk është bërë verifikimi n.q.s subjekti e ka shkelje për herë të parë apo të përsëritur;
- Në disa raste në akt konstatim dhe proces verbal nuk evidentohet afati ligjor 15 ditor për vendosjen e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit dhe më tej zhbllokimi aktivitetit të tatimpaguesit;
- Nuk janë bërë verifikimet në sistem nëpërmjet programit “E-Inspektor” n.q.s shkeljet janë rast i përsëritur apo jo;
- Nuk është bërë përshkrimin e mallit/produktit/shërbimit për të cilin nuk është lëshuar kuponi tatimor në momentin e verifikimit;
- Nuk janë bërë verifikimin në sistem nëpërmjet programit “E-Inspektor” mbi listëpagesën e subjektit me pretendimin se nuk punonte sistemi C@ts;
- Nuk janë bërë verifikimet e pagës reale dhe deklarimit të sigurimeve shoqërore;
- Nuk janë marrë deklaratë me shkrim nga tatimpaguesi në lidhje me pagat;

- Janë tejkaluar vazhdimisht afatet e qëndrimit në subjekt prej 30 minutash.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave për mos përsëritjen e parregullsive të konstatuara nga grupi i auditimit të ngrejë një grup pune për rishikimin e akteve të mbajtura nga inspektorët e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT) për vitin 2021.

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga një analizë e performancës së sektorit të verifikimit dhe koordinimit në terren për periudhën Janar - Dhjetor 2021, mbi nivelin e gjetjeve dhe shkeljeve të konstatuara, i cili është në vlerën 3,825,000 lekë, me shpenzimet e fondit të pagave të sektorit prej 21,004,339 lekë, ku janë përfshirë pagat neto + sigurimet shoqërore + sigurimet shëndetësore në vlerën totale, ka rezultuar se raporti shpenzime për paratë me shkeljet në vlerë është 5.5 me 1, pra për çdo 1 lek shkelje janë harxhuar 5.5 lekë shpenzime page, gjë që demonstroi se ky sektor nuk ka vepruar me efektivitet dhe efikasitet për vitin 2021.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 84-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të ngrejë një grup pune për analizimin e shkaqeve të inefficencës së DVKT, si dhe të shikohet mundësia e ristrukturimit të kësaj drejtorie me qëllim kalimin e saj në baza efikaciteti dhe efektiviteti.

**Menjëherë**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPT, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Programit është kërkuar ndryshimi i prioritetëve të projekteve të investimit, referuar rëndësisë së projektit òPërmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimitò, i cili lidhet me procesin më të rëndësishëm të institucionit, atë të **Fiskalizimit**, për të cilin janë realizuar pagesa në vlerën 512,787 mijë lekë, krahasuar me 187,960 mijë të planifikuara në PBA për vitin 2021, ose pothuajse 3 fish më shumë. Nga sa më sipër rezulton se me ndryshimin e prioritetëve për ekzekutimin e projekteve të investimit nga DPT, me qëllim sigurimin e fondeve në dispozicion të këtij projekti, i cili është likuiduar i plotë, është ndikuar realizimi i dy projekteve të tjera të investimit të DPT. Kjo problematikë është përcjellë edhe nga DPT pranë MFE, që në momentin e miratimit të tavanëve në fazën e hartimit të PBA-së, ku plani për projektet e investimit të DPT nuk mundëson likuidimin e tyre, dhe kërkesat për investime nuk janë marrë parasysh në totalin e tyre, pasi nuk janë përfshirë në vlerën e fondit të investimit të sistemeve të IT, edhe fondet për mirëmbajtjen e tyre.

Nga krahasimi i nivelit të financimit të planifikuar sipas PBA-së, me atë të alokuar përgjatë vitit 2021, për dy projektet rezulton diferenca prej 85,040 mijë lekë, e cila përbën një angazhim kontraktual, duke krijuar risk të shtuar për krijimin e detyrimeve të prapambetura, pavarësisht se nga ana e operatorëve ekonomik nuk është kërkuar kryerja e pagesave. Më hollësisht, për projektin e investimit 18AV806 òKrijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRTò, sipas kontratës nr. 7047, datë 28.12.2020 janë planifikuar pagesa për investimin përkatësisht 36,300 mijë lekë në vitin 2020 dhe 54,408 mijë lekë në vitin 2021 dhe mirëmbajtje për 24 muaj në vlerën 35,640 mijë lekë. Gjatë vitit 2021, janë realizuar fonde në vlerën 15,000 mijë lekë, dhe referuar realizimit progresiv në kësaj kontrate në vlerën 124,965 mijë lekë nuk ka mundur të likuidohet vlera e plotë e këtij projekti, dhe vlera e mbetur prej **45,037 mijë lekë mbetet si detyrim për t'u likuiduar në vitin pasardhës**. E njëjta situatë rezulton edhe për projektin 18AV811 òNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, ku sipas kontratës nr. 3275, datë 10.07.2020 janë planifikuar pagesa përkatësisht 23,700 mijë lekë në vitin 2020 dhe 56,340 mijë lekë në vitin 2021 dhe mirëmbajtje në vlerën 27,840 mijë lekë për 24 muaj. Për vitin 2021

janë realizuar vetëm 15,000 mijë lekë, dhe referuar realizimit progresiv në kësaj kontrate në vlerën 38,700 mijë lekë, **vlera e mbetur prej 41,340 mijë lekë mbetet si detyrim për t'u likuiduar në vitin 2022.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1.Rekomandimi:** DPT në bashkëpunim me MFE të marrin masat për kryerjen e një planifikimi më efektiv në drejtim të disiplinimit të angazhimeve buxhetore me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta, ku pakësimi i fondeve për disa projekte investimi mund të shoqërohet me efekte financiare dhe risk të shtuar nëse nga ana e operatorëve ekonomikë do të kërkohej likuidimi për obligimet kontraktuale, pavarësisht se në rastin konkret nuk ka ndodhur.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se kontrata nr. 3339, datë 12.05.2021 me vlerë totale 229,586,688 lekë me TVSH për 24 muaj mirëmbajtje, e lidhur nga AKSHI me objekt **mirëmbajtja e sistemit e-Taxation** për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk është e parashikuar në fondet për vitet 2021-2023, pasi sipas DPT kërkesa për realizimin e këtij procesi nuk është përcjellë brenda afateve ligjore. Megjithatë, duke qenë se kjo procedurë lidhet me sistemin C@ts, i cili është sistemi bazë i tatimeve dhe i rëndësishëm së tij veçantë, si dhe gjendur në një situatë të mungesës së fondeve dhe pamundësisë për alokim shtesë fondesh nga MFE është kryer rialokimi i fondeve buxhetore brenda shpenzimeve korente, duke pakësuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (llog 600 dhe 601) të disa Drejtorive Rajonale Tatimore: DRT Durrës, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Vlorë, VIP, Tiranë, Aparati i DPT (duke përdorur fondet e mbetura për muajt për të cilat janë kryer pagesat deri në ato momente, dhe disponoheshin fonde të pa realizuara për shkak të vakancave), me qëllim alokimin e shtesës prej 60,000 mijë lekë për shpenzime korrente të aparatit të DPT në produktin 91004AA për të kryer likuidimet e nevojshme të kontratës trajtuar më sipër. Në vijim të saj, me shkresën nr. 9881/2 prot., datë 16.06.2021 të MFE dhe DPT nr. 9881/3 prot., datë 21.06.2021 është miratuar ky transferim i fondeve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese pranë DPT dhe AKSHI-t të rrisin bashkëpunimin ndër institucional, në mënyrë që të kryhet në mënyrë të plotë dhe të saktë planifikimi i fondeve që në fazën e hartimit të PBA-së për ato asete, procedurat e prokurimit të cilave do të kryhen nga AKSHI, në mënyrë që të shmangjet fenomeni i ndërmarrjes së angazhimeve pa fonde në dispozicion nga ky i fundit, shoqëruar me efekte financiare apo rishikime të shpeshta të buxhetit të DPT.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se DPT, si njësi shpenzuese, nuk harton raporte monitorimi 4-mujore për të ndjekur vetëm realizimin e produkteve të buxhetit të DPT, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe për të bërë të mundur ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Gjithashtu, nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin vetëm për DPT, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. Ky monitorim kryhet në total për të gjithë programin **Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**, ku përfshihet edhe buxheti i alokuar për DPT, së bashku me atë të DRT-ve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1.Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në DPT, në zbatim të udhëzimeve të MFE për procedurat që duhet të ndiqen nga njësitë shpenzuese për zbatimin dhe monitorimin të buxhetit, të marrin masa për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit për DPT për produktet e

buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

### **Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021 **nuk është kryer** procesi i inventarizimit të aktiveve, në kundërshtim me nenet 8-22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër menaxhimin financiar dhe kontrollin*, i ndryshuar dhe *në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, i ndryshuar, pika 1. Gjithashtu, konstatohet se nuk kanë përfunduar procedurën e inventarizimit DRT Durrës, Tiranë dhe Dibër. Në kushtet kur procesi i inventarizimit nuk është kryer, grupi i auditimit nuk mundi të kryente një krahasim me qëllim identifikimin e diferencave të mundshme mes shumave të vlerave të llogarive të aktiveve të raportuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerave të këtyre aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare.

- Nga auditimi konstatohet se edhe procesi i inventarizimit të aktiveve kryer një vit më parë është një proces i ndjekur për inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020, pra për një periudhë të ndërmjetme **dhe jo për të gjithë periudhën raportuese** për efekt të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2020, duke rezultuar kështu *në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, i ndryshuar, pika 2.

- Për sa i përket procesit të ndjekur për aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi, sipas pikës 95 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, në vijim të raportit përfundimtar mbi inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020, ky proces nuk ka përfunduar ende, dhe nuk ka patur një urdhër të dytë nga titullari për shtyrjen e këtij afati.

Gjithashtu, për sa i përket konkluzioneve të komisionit të inventarizimit për vitin paraardhës lidhur me mos kryerjen e inventarizimit të disa aktiveve që janë në ngarkim të personave të cilët nuk kanë qenë prezent për arsye të ndryshme (Covid-19 etj.), për të cilat komisioni ka konstatuar se nuk arriti të kryej verifikim fizik të materialeve në magazinë M14 Program, pasi nuk gjenden; dhe se disa ish punonjës të cilët janë larguar si pasojë e shkëputjes nga puna në DPT, rezultojnë ende me materiale në ngarkim në kundërshtim me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, pika 13 dhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 *oPër pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*, pikat 27 deri 30. Në vijim të informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit lidhur me ecurinë e këtij procesi, u konstatua se nuk ka patur një urdhër të titullarit për sistemimin e situatës dhe marrjen e masave respektive.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1.Rekomandimi:** Titullari i DPT të marrë masat për inicimin e procesit të inventarizimit për vitin 2021 dhe për çdo vit pasardhës për efekt të hartimit të pasqyrave financiare dhe jo periudhave të ndërmjetme, në mënyrë që të garantohet saktësia e informacionit të gjeneruar nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, në mos shpërdorimin dhe humbjet e tyre.

-Titullari i DPT, të marrë masat respektive për sistemimin e situatës së konstatuar për inventarizimin e vitit paraardhës, si dhe për finalizimin e procesit të ndjekur për aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi.

### **Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se edhe përgjatë vitit 2021 në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 për *oRiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*, i

ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është mundur të realizohet finalizimi i procedurës të kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Ndër problematikat e diskutuara në takimin e zhvilluar mes dy institucioneve janë evidentuar domosdoshmëria për regjistrimin e të gjitha databazave të DPT-së si databaza shtetërore, si parakusht për kalimin kapital të këtyre aseteve për llogari të AKSHI-t; verifikimi i aseteve që nuk përdoren më. Nga ana e përfaqësuesve të dy institucioneve është rënë dakord që pjesë e kalimit të kapitalit do të jetë vetëm pjesa e implementimit të sistemit të fiskalizimit; pamundësia për marrjen në dorëzim për disa nga sistemet Nexus, Harta digjitale, BI, etj.; diskutimi nëse do të jenë objekt kalimi kapital disa nga asete që nuk përdoren më, si p.sh rasti i Nexus (kasat), i cili pas hyrjes në fuqi të ligjit për fiskalizimin nuk do të jetë më funksional nga ana teknike, por i përdorshëm për arkivë. Megjithatë, deri në përfundim të auditimit, nuk është mundur të finalizohet ky proces.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1.Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DPT dhe AKSHI-t të marrin masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për kalimin e aseteve nga DPT tek AKSHI, me qëllim finalizimin sa më të shpejtë të këtij procesi.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në pasqyrat financiare të DPT vijoje të mos jenë llogaritur provizione, problematikë e trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 6, ÷Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara, pika nr. 47, si dhe ÷Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 34. Referuar detyrimeve të DPT, nevoja e parashikimit të provizioneve lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna në shumën 116 milion lekë, detyrime për investime në shumën 661 milion lekë, detyrime për mallra e shërbime në shumën 81 milion lekë, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**24.1.Rekomandimi:** DPT t'aj bëjë të ditur MFE që të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ku konkretisht Sektori i Kontabilitetit të kësaj drejtorie të marrë masat për shqyrtimin e situatës, në mënyrë që të përcaktohen edhe procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se vlera e raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara për periudhën paraardhëse paraqitet me diferenca krahasuar me atë të raportuar një vit më parë (pra në pasqyrat e konsoliduara të vitit 2020). Nga auditimi i kryer analitikisht për pasqyrat financiare të përgatitura nga DRT-të, rezulton se kjo diferencë vjen si **pasojë e kryerjes së ndryshimeve pas dorëzimit të pasqyrave financiare nga ana e DRT Lezhë, Gjirokastrë, Durrës**, konstatuar edhe në relacionin e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara. Si rezultat, edhe për pasqyrat e konsoliduara periudha paraardhëse paraqitet me ndryshime duke kryer kështu veprime korrigjuese në periudhat pas mbylljes, në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018.

- Nga auditimi konstatohet se llogaria 468 ÷Debitorë të ndryshëm (139,091,469,226) + 423,429 ÷Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” (805,141) nuk kuadron me llog 4341 ÷Operacione me shtetit-Detyrime” (139,089,284,367). Diferenca prej 2,990,000 lekë vjen nga Sektori Pagesave dhe Kontabilitetit ku llog 468 = 139,086,882,211 lekë dhe llog 4341 = 139,083,892,211 lekë. Fondi i konsoliduar i pasqyruar nga Sektori i Pagesave në vlerën prej 2,990,000 lekë nuk përputhet me

regjistrimet kontabël të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar, vlerë e cila ka sjellë një paraqitje jo të drejtë të pasqyrës së konsoliduar të DPT.

- Nga auditimi konstatohet se vlera e raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara për zërin 101 ÷ Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluarë për vitin 2021 paraqitet në vlerën 1,879,595,896 lekë, ndërkohë analitikisht sipas pasqyrave përbërëse të pasqyrave të konsoliduara ky zë rezulton 1,878,439,285.2 lekë, me një diferencë prej 1,156,610.27 lekë që vjen si pasojë e raportimit të pasaktë të këtij zëri në pasqyrat financiare të DRT Vlorë.

- Për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara nëpunësi autorizues dhe zbatues i DPT duhet të përmbledhin informacionin e hartuar nga vetë DPT (si aparat), DRT-të, dhe Sektori i Pagesave dhe Kontabilitetit pranë DPT. Nga auditimi konstatohet se duke qenë se këto dokumente hartohen në kufijtë e afatit kohor për dorëzimin e pasqyrave përcaktuar në pikën 120 të Udhëzimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshme, i cili përcakton se këto pasqyra duhet të përfundojë brenda muajit prill të vitit pasardhës; nuk mundësohet kryerja e të gjitha verifikimeve/saktësimeve apo rakordimeve të nevojshme mes strukturave të DPT/DRT në mënyrë që ky dokument të raportojë në mënyrë të saktë dhe të drejtë situatën, apo dhe reflektimin e të gjitha komenteve në mënyrë të hollësishme në shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**25.1.Rekomandimi:** Titullari i DPT të ngrëjë një grup pune me përfaqësues nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikave, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, etj., i cili të marrë masat për verifikimin dhe kryerjen e analizave të ndryshimit të fondit neto për DRT-të, si dhe problematikat e tjera trajtuar më sipër, reflektuar në pasqyrën e konsoliduar, me qëllim marrjen e masave për një pasqyrim më të drejtë të situatës financiare dhe rezultatet e tyre të pasqyrohen në shënimet shpjeguese. Në kuadër të konsolidimit të pasqyrave financiare, titullari i DPT, nëpërmjet një sqarueseje apo guide udhëzuese të përcaktojë afatet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga vetë DPT: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, nga Drejtoria e Pagesave dhe Kontabilitetit, si dhe nga DRT-të për pasqyrat financiare të hartuara nga këto njësi duke parashikuar edhe takime mes palëve. Gjithashtu, të shqyrtojë edhe mundësinë e ri organizimit të strukturave në rast konstatimit të mbivendosjes së përgjegjësive, për sa kohë autoriteti për miratimin e pasqyrave mbetet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të DPT.

### **Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se ka lidhur me skemën e kontabilizimit të veprimeve rregulluese për llogarinë 466 ÷ Kreditorë për mjete në ruajtje dhe llogarinë 520 ÷ Disponibilitete në thesarë. Më hollësisht, konstatohet se në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003, më datën 31.12.2021 paraqitet në shumën 134.4 miliardë lekë, ndërsa sipas sistemit C@ts teprica kreditore më datë 31.12.2021 është në vlerën 13.5 miliard lekë. Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2021. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@ts, por ky veprim nuk gjen pasqyrim në kontabilitet dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti, si një ÷detyrimo në pasivin e bilancit të DPT-së me kundërparti ÷llog.520 disponibilitete në thesarë. Në këto kushte, këto llogari paraqiten në pasqyrat financiare të DPT-së të mbivlerësuara krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme në C@ts, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**26.1.Rekomandimi:** DPT të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE, të shqyrtojë situatën e mësipërme duke parashikuar skemën e kontabilizimit të duhur, në mënyrë që të garantohet raportimi i të dhënave të plota dhe me vërtetësi në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT.

**Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, çështja 4.4.6 ÷ Njoftimi për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese, përcakton se me qëllim sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, administrata tatimore duhet të vendosë për marrjen e masave të sigurimit për ekzekutimin e detyrimit duke vendosur masa sigurimi të pasurisë nëpërmjet barrave siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPT nuk është siguruar regjistrimi i barrës siguruese në Regjistrin e Barrëve Siguruese (RBS) nga ana e strukturave përgjegjëse. Kjo për shkak se, referuar Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nr. 486, datë 29.05.2009, shërbimet që kryhen në RBS bëhen kundrejt tarifave dhe këto shpenzime nuk kanë mundur të mbulohen me buxhetin e alokuar në dispozicion të DPT. Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar akordimi i fondeve të nevojshme për të kryer këto shërbime, pasi mos kryerja e pagesave ka kushtëzuar vendosjen e barrëve hipotekore dhe siguruese. Në vijim të tyre nga ana DPT këto kërkesa janë parashikuar tek fondet shtesë drejtuar MFE, por për të cilat nuk janë çelur fonde, duke mos mundur të arrihet një zgjidhje optimale për këtë situatë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 134-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**27.1.Rekomandimi:** Titullari i DPT të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe strukturat përgjegjëse të marrin masat për alokimin e fondeve të nevojshme për këto shpenzime, reflektuar në tavanet përfundimtare të miratuara në buxhetin e DPT, apo dakordësimin e një tjetër zgjidhjeje optimale për këtë situatë në kushtet kur kemi të bëjmë me pagesa të kryera nëpërmjet dy institucioneve shtetërore.

**Brenda vitit 2022**

**28. Gjetje nga auditimi:** Gjatë vitit 2021, ATQ ka hartuar planin e nevojave për rekrutim, nga ku i ka përcjellë DAP nevojën për plotësimin e 130 vendeve vakante. Nga këto 130 vende vakante, DAP ka shpallur 62 prej tyre, ku vetëm 44 janë plotësuar me fituesit e shpallur. Vihet re se, përgjatë gjithë vitit ka patur vende vakante të paplotësuara për një kohë të gjatë, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, u konstatuan ndryshime të shpeshta të stafit, situatë kjo që mbart riskun për cënimin e funksionimit e drejtorive të ndikuara nga këto situata për shkak të kapacitetit jo të plotë të stafit aktual.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 176-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1.Rekomandim:** Titullari i DPT, në bashkëpunim edhe me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020.

**Në vijimësi**

**29. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë vitit 2021, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në strukturat përkatëse të tyre në Rajonet Qendrore, Veriore dhe Jugore, vihet re një nivel i lartë i ndryshueshmërisë së punonjësve përmes Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve ÷ Lirim dhe emërim në detyrë. Për vitin 2021, është konstatuar se vetëm në

Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT dhe strukturat e hetimit në DRT ka patur 6 lirime dhe emërimë në detyrë, si dhe 5 largime nga 60 gjithsej punonjës. Ndërkohë në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe në struktura përkatëse në DRT ka patur 9 lirime dhe emërimë në detyrë, dhe 10 largime përgjatë vitit 2021, nga 24 punonjës gjithsej. Gjithashtu, konstatohet se strategjia menaxheriale dhe plani operacional për rekrutim nuk është hartuar për punonjësit, marrëdhënia e të cilëve rregullohet përmes Kodit të Punës, por është hartuar vetëm planifikimi i vendeve vakante për punonjësit e shërbimit civil që është përcjellë në DAP, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 të nenit 72 të Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 176-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1.Rekomandimi:** Drejtori i DBNJ të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për të minimizuar lëvizjet e shpeshta brenda strukturave, që do të çënonin mbarëvajtjen e punës dhe efektivitetin e tyre.

**Deri më 31.12.2022**

**30. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i 25 praktikave të largimeve nga puna, u konstatuan 8 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sikurse cituar në vendimet përkatëse, òPër arsye performancë të ulët në punë dhe ankesave të ardhuraò, ndërkohë që në dosjet e personelit nuk rezultuan asnjë dokument justifikues i këtij pretendimi që është bërë shkak për ndërprerjen e kontratës së punës nga ana e DPT-së. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të Kreut II të Ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 176-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**30.1.Rekomandimi:** Titullari i DPT të marrë masa që të ndiqen procedurat dhe afatet e parashikuara në Kodin e Punës në RSH për ndërprerjen e njëanshme të marrëdhënies së punës, si dhe të mbështesë motivacionet e ndërprerjeve të punës në dokumentacion vërtetues, në rastet e ankesave dhe performancës së ulët.

**Në vijimësi**

**31. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i përshkrimeve të punës për punonjësit jashtë shërbimit civil për Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, rezultoi se u konstatuan raste ku për të njëjtin përshkrim pune me të njëjtat detyra funksionale, të ndryshonte kriteri i nivelit të arsimit apo fushës së edukimit. Diferencimet e tilla në nivelin arsimor dhe në fushën e studimit janë të paargumentuara, përderisa inspektorët kryejnë të njëjtin funksion dhe kanë të njëjtin përshkrim pune, sidomos kur janë punonjës të të njëjtit sektor. Këto veprime dhe mos veprime janë në kundërshtim me Kreun IV të VKM nr. 142, datë 12.03.2014.

Për më tepër nga auditimi i 23 dosjeve të personelit u konstatua se në dosjet e tyre mungojnë dokumenta si: libreza e punës, akti i dorëzimit të punës përpara largimit të punonjësit, etj, në kundërshtim me kërkesat të Lidhjes 1 *òTë dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelitò* të VKM nr. 833, datë 28.10.2020. Në 16 raste të largimeve nga puna nga puna, në 8 prej tyre mungonte praktika e dorëzimit të dokumentacionit dhe pajisjeve apo mjeteve të punës. Gjithashtu në shumicën e dosjeve të personelit nuk administrohej praktika e rekrutimit për pozicionet specifike të punës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 176-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**31.1.Rekomandimi:** Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kriterëve arsimorë kur detyrat funksionale janë të njëjta, si dhe që fituesit e procedurës së konkurrimit të kenë nivel dhe fushë arsimore në përputhje me kriteret e përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës.

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore të plotësojë dhe përditësojë të gjitha dosjet e punonjësve me dokumentacionin e nevojshëm.

**Në vijimësi**



**32. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2021, GMS nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje, ndërkohë që Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 *“Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike”* parashikon se GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Në këtë situatë, rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) nuk ka patur mangësi në ushtrimin e rolit të tij të rëndësishëm për sa i përket integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sjelljen sipas etikës. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë, nuk i janë parashtruar GMS, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave. Në funksion të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, Nëpunësi Zbatues, është niveli menaxherial në varësi direkt të Nëpunësit Autorizues. Nga auditimi rezultoi se, në DPT, funksionin e NA e kryen Drejtori i Përgjithshëm, ndërkohë që funksionin e NZ e kryen Drejtori i Financës dhe Buxhetit. Në kapitullin 2 të Manualit përcaktohet se *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkt nga Nëpunësi Autorizues i njësisë”*. Referuar strukturës organizative të DPT, Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e NZ, nuk është në varësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm, në cilësinë e NA.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 198-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**32.1.Rekomandimi:** GMS të zhvillojë mbledhjet në periodicitetin e përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përmbyshjen e qëllimit për garantimin e funksionimit të komponentëve të MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut në institucion.

- Titullari i DPT të marrë masa për caktimin e NZ në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

**Brenda 31.12.2022 e në vijimësi**

**33. Gjetje nga auditimi:** DAB nuk ka arritur të përmbushë objektivat e saj vjetorë, pasi nuk ka përfunduar sipas planifikimit vjetor auditimin në 3 subjekte: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ó Rajoni Jugor; DRT Dibër; Drejtoria Rajonale e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ó Rajoni Qendror. Me pretendimin e shmangies së mbivendosjes me auditimet e KLSH-së kanë ndodhur ndryshimet si më poshtë, ku nga 11 auditime të planifikuara, numri ka shkuar në 13 duke anuluar auditimin e kombinuar në DRT Durrës, atë të përputhshmërisë në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së dhe atë financiar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (DPT) dhe duke shtuar auditim përputhshmërie tematik në DRT Tiranë, DRT Dibër, DRT Shkodër, DRT Vlorë, DRT Korçë. Plani i ri Vjetor për vitin 2021 ka konsistuar në 9 auditime përputhshmërie dhe 4 auditime të kombinuara.

Nga auditimi, konstatohet se gjatë realizimit të planit vjetor të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Kontrollit në DPT, vihet re se 2 Drejtori Rajonale janë kontrolluar nga DKT dhe audituar nga DAB në periudha të afërta përgjatë vitit 2021 (DRT Shkodër, DRT Korçë). Neni 25 i Kreut VIII të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, citohen bashkëpunimin mes strukturave audituese me qëllim shmangien e mbivendosjes. Neni 24 i Kreut III të Ligjit nr. 90/2012, përcakton bashkëpunimin dhe bashkërendimin në administratën shtetërore.

- DAB ka planifikuar me rezervë angazhimin e burimeve njerëzore, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesën shumë të ulët të disa audituesve të tjerë. Ndarja e ngarkesës në varësi të programeve të auditimit të realizuara përgjatë vitit 2021, varion në auditues të ndryshëm, ku dy auditues kanë marrë pjesë në 42% dhe 58% të auditimeve, krahasimisht me 17% apo 33% të një audituesi tjetër. Pika 1 e Neni 13 të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ATQ-së përcakton se Drejtori i DAB ka përgjegjësi dhe detyrë, organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.

Është konstatuar se diferencimi i ngarkesës së punës ka ardhur edhe si pasojë e planifikimit joefiçent të burimeve njerëzore nga ana e DAB, si dhe për shkak të mungesës së plotësimit të vendit vakant të Përgjegjës të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 198-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**33.1.Rekomandimi:** DAB marrë masa për bashkëpunimin me strukturat e tjera kontrolluese brenda DPT dhe me KLSH-në, me qëllim bashkërendimin dhe shkëmbimin e planeve të konsoliduar, duke synuar shmangien e mbivendosjeve të angazhimeve të auditimit, si dhe për planifikimin në mënyrë efikente të angazhimeve të auditimit duke patur parasysh ndër të tjera ndarjen e ngarkesës mes audituesve.

- Drejtori i Përgjithshëm i DPT të marra masa në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, me qëllim plotësimin e vendit vakant të Përgjegjës të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit.

**Në vijimësi**

**34. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit, konstatohet se, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për vitin 2021 janë lëshuar për tatimpaguesit 1180 autorizime për përjashtimin nga TVSH për procesin e rindërtimit dhe që i përkasin 581 NIPT-eve. Nga Grupi i Auditimit u përzgjedhën për auditim autorizimet e lëshuara në muajt Prill dhe Nëntor 2021, gjithsej 153 autorizime (sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Nga auditimi i këtyre praktikave dokumentare rezultoi:

- Nga Grupi i Punës dhe Titullari i DPT në lëshimin e autorizimeve **është tejkaluar afati 5 ditor**, konkretisht: në muajin Prill në 74 raste nga 94 autorizime të lëshuara gjithsej në këtë muaj, ndërsa në muajin Nëntor në 55 raste nga 58 autorizime të lëshuara gjithsej, në kundërshtim me nenin 5 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, me ndryshime, ku përcaktohet afati pesëditor.

- Për lëshimin e autorizimeve Grupi i Punës nuk ka respektuar dhe kërkesat e urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37, datë 22.05.2020 për ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të subjekteve të rindërtimit që aplikojnë për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuarë, me ndryshimet e mëvonshme, pika 5, ku përcaktohet afati 5 ditor për shqyrtimin e dokumentacionit dhe lëshimin e autorizimeve.

- Grupi i Punës në shqyrtimin e kërkesave, verifikimin e dokumentacionit dhe duke i rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit ka vepruar në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit, në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 143, datë 13.02.2020, i ndryshuar, konkretisht, për 33 raste gjithsej, për autorizimet e muajit Prill 2021 me nr. 256, 266, 269, 272, 274, 276, 287, 278, 279, 292, 293, 297, 307, 313, 318, 321, 324, 327, 333, 335 dhe të muajit Nëntor me nr. 974, 975, 977, 978, 985, 990, 1006, 1014, 2017, 1018, 1020, 1021 dhe 1026, të cilët u takojnë subjekteve nënkontraktore dhe furnizuese në procesin e rindërtimit. Bashkëlidhur këtyre praktikave mungojnë kontratat bazë dhe preventivat e subjekteve që kanë marrë pjesë në procesin e prokurimit e kanë lidhur kontrata me njësinë zbatuese (Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Tiranë, etj.) kjo me qëllim evidentimin e saktë të punëve, shërbimeve apo materialeve që do të kryhen nga këta subjekte.

Në kontratat e lidhura me këto njësi, përcaktohet që, **nënkontraktimi nuk lejohet, përveçse kur jepet miratim me shkrim nga autoriteti, por në asnjë rast nuk ka miratim me shkrim të këtyre autoriteteve** për lejimin e nënkontraktimeve me subjektet që kanë lidhur kontrata nënsipërmarrje me ndërtuesit/kontraktorët subjekte të rindërtimit, të cilët janë pajisur me autorizime për përjashtimin nga

TVSH, duke krijuar risk të shtuar në monitorimin e këtij procesi nga të gjithë aktorët, në deformimin e procesit të prokurimit, por dhe krijimin e risqeve potenciale për shmangie të pagesës së TVSH-së.

Për të orientuar DRT në këtë proces, nga DPT është dërguar shkresa sqaruese nr. 4985/3 prot., datë 04.03.2020, ku përcaktohet procedura që do të ndiqet prej tyre.

Me urdhrin nr. 48, datë 9.07.2021 òPër një ndryshim në urdhrin nr. 37, datë 22.05.2020.ò, është shtuar pika 6.1 me këtë përmbajtje: *òGrupi i Punës monitoron zbatimin e procedurës së ndjekur nga ana e DRT-ve saktësuar shkresës sqaruese nr. 4985/3, datë 04.03.2020”*, por nga auditimi rezultoi **se nga Grupi i punës për vitin 2021 nuk është kryer procesi i monitorimit ndaj DRT** për zbatimin e kësaj procedure, gjithashtu prej tij nuk dihet e raportohet se sa është vlera e investimeve që lidhen me procesin e rindërtimit të përjashtuar nga TVSH, duke e lënë këtë proces të pamonitoruar e duke krijuar risqe të shtuara në administrimin e të ardhurave nga TVSH-ja, pavarësisht se me Planin Sektorial të Rindërtimit janë marrë në shqyrtim 399 subjekte për periudhën Gusht 2020- Prill 2021.

- Nga verifikimi i dokumentacionit në Sektorin e Protokollit rezultoi se, subjekte u janë përcjellë dorazi autorizimet e lëshuara në 71 raste (60 raste në muajin Prill dhe 11 raste në muajin Nëntor) dhe njëkohësisht me vonesë nga data e lëshimit të autorizimit nga 1 ditë punë në 11 ditë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHö i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në RSHö, i ndryshuar neni 23.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 2.11, faqe 218-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**34.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa të menjëhershme për monitorimin e procedurave të lëshimit të autorizimit, si dhe marrjen e masave për kontrollin e DRT lidhur me zbatimin e kërkesave të shkresës sqaruese nr. 4985/3prot., datë 04.03.2020, drejtuar DRT-ve.

**Menjëherë**

## **B.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjatë vitit 2021 nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në mënyrë të pa drejtë, në vlerën **186,466,238 lekë**, për 196 punonjës, për periudhën 2005-2021, të paguara në dy këste, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar proceset gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve nga puna ka qenë i pa rregullt dhe nga institucioni i DPT nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për këtë proces. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime, në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitö, i ndryshuar. Analizimi i arsyeve të humbjeve të proceseve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonin pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga DPT në proceset e largimit të punonjësve nga puna.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 2.8, faqe 176-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i DPT të marrë masa për evidentimin e arsyeve të largimeve të padrejta nga puna me qëllim përmirësimin e procedurave të kryera gabim duke sjellë kështu minimizim të shpenzimeve gjyqësore në të ardhmen dhe përdorim me efektivitet të fondeve buxhetore.

**Në vijimësi**

## **D. MASA DISIPLINORE**

Bazuar në Kreun X të Disiplinës në Shërbimin Civil të ligjit nr. 153/2013 për nëpunësin civil, i ndryshuar, nenet 57, 58 dhe 59, *i rekomandohet* Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënie masash disiplinore nga **Vërejtje** deri **Largim nga shërbimi civil**, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkohet fillimin e dhënies së masave disiplinore nga **Vërejtje** deri në **Largim nga puna** për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

V. ANEKSE.

**Aneksi nr. 1**

**Parashikimi dhe realizimi i prokurimeve për vitin 2021**

Nr	Viti	I ri/I modifikuar	Objekti i Prokurimit	Kontrate /Mareveshje kuader	Tipi I Kontrates/Mareveshje kuader	Fondi I perlogarit ur pa tvsh	Lloji I procedures se prokurimit	Koha e planifikuar per shpalljen e procedures	Organi qe zhvillon procedur en e prokurimit	Kontrata 2021 me tvsh
1	2021	I Ri	Shpenzime per mirembajtje te mjeteve te transportit	Kontrat MK	Sherbim	2,500,000	MinikontraMK	nga 2020	ABP	3,000,000
2	2021	I Ri	Shpenzime blerje, gome	Kontrat MK	Mall	1,250,000	MinikontraMK	2021	ABP	1,500,000
3	2021	I Ri	Karburant dhe vaj	Kontrat MK	Mall	14,052,500	MinikontraMK	nga 2020	ABP	16,863,000
4	2021	I Ri	Shpenzime blerje materiale të tjera zyre (Tonera)	Kontrat MK	Mall	16,666,667	MinikontraMK	nga 2019	ABP	20,000,000
5	2021	I Ri	Shpenzime blerje (leter)	Kontrat MK	Mall	6,250,000	MinikontraMK	2021	ABP	7,500,000
6	2021	I Ri	Shpenzime blerje ( kancelari)	Kontrat MK	Mall	2,000,000	MinikontraMK	Dhjetor nga 2020	ABP	2,400,000
7	2021	I Ri	Blerje kuti Arkive	Kontrat MK	Mall	3,760,000	MinikontraMK	nga 2020	DPA	4,512,000
8	2021	I Ri	Materiale për pastrim shërbim e ngrohje	Kontrat	Mall	375,000	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	450,000
9	2021	I Ri	Shpenzime per materiale tjera zyre dhe te pergjithshme	Kontrat	Mall	208,333	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	250,000
10	2021	I Ri	Shpenzime blerje dokumentacioni	Kontrat	Mall	83,333	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	100,000
11	2021	I Ri	Kosto e sigurimit te mjeteve te transportit	Kontrat	Sherbim	600,000	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	600,000
12	2021	I Ri	Shpenzime te tjera operative	Kontrat	Mall+Sherbim	83,333	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	100,000
13	2021	I Ri	Sherbim monitorim mediatik	Kontrat	Sherbim	800,000	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	960,000
14	2021	I Ri	Prodhim materiale informuese ,vidio	Kontrat	mall	800,000	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	960,000
15	2021	I Ri	Shpenzime per mirembajtje per objekte ndertimore	Kontrat	Pune	800,000	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	960,000
16	2021	I Ri	Shpenzimeper mirembajtje aparate ,pajisje teknike dhe vend pune	Kontrat	Pune	750,000	Prokurim BV	Dhjetor	AKSHI	900,000
17	2021	I Ri	Mirembajtje kondicionimi	Kontrat	Sherbim	416,667	Prokurim BV	Dhjetor	AKSHI	500,000
18	2021	I Ri	Sigurimi i godinave të AT	Kontrat	Sherbim	8,000,000	Tender I hapur I thjeshtezuar	Dhjetor	DPT	8,000,000
19	2021	I Ri	Shpenzime per materiale dhe sherbime speciale	Kontrat	Sherbim	12,500	Prokurim BV	Dhjetor	DPT	15,000
20	2021	I Ri	Mirëmbajtje dhomë serverash,sistem telefonik voip dhe monitorimi I qëndërzuar për DPT/DRT	Kontrat	Sherbim	9,625,200	Tender i hapur	Nga viti 2020	AKSHI	11,550,240
21	2021	I Ri	Mirëmbajtje dhomë serverash,sistem telefonik voip dhe monitorimi I qëndërzuar për DPT/DRT (kontrat e re)	Kontrat	Sherbim	14,850,000	Tender i hapur	Nga viti 2020	AKSHI	17,820,000
22	2021	I Ri	Mirëmbajtje sistemit "Permirësimi I modulit të Manaxhimit të Kontrollit të Faturimit"	Kontrat	Sherbim	215,000,000	Tender i hapur	Nga viti 2020	AKSHI	258,000,000

23	2021		Mirëmbajtje infrastrukturës hostuese E-Taxation	Kontrat	Sherbim	29,582,383	Tender i hapur		AKSHI	35,498,860
24	2021	I Ri	Nexus- Mirëmbajtje kasa fiskale	Kontrat	Sherbim	5,000,000	Tender i hapur	Dhjetor	AKSHI	6,000,000
<b>Nr</b>	<b>Viti</b>	<b>I ri/I modifikuar</b>	<b>Objekti i Prokurimit</b>	<b>Kontrate /Mareveshje e kuader</b>	<b>Tipi I Kontrates/Mareveshje e kuader</b>	<b>Fondi I perlogarit ur pa tvsh Behet</b>	<b>Lloji I procedures se prokurimit</b>	<b>Koha eplanifikuar per shpalljen e procedures</b>	<b>Organi qe zhvillon procedur en e prokurimit</b>	<b>2021 me tvsh</b>
1	2021	I ri	Permirësimi I modulit të Manaxhimit të Kontrollit të Faturimit	Kontrate	sistem	156,633,333	Tender i hapur	27.11.2018	AKSHI	187,960,000
2	2021	I ri	Krijimi i nje mjedisi te ri dhomë serverash(data center),sistem telefonik voip dhe monitorimi I qëndëruar për DPT/DRT	Kontrate	mall	48,916,667	Tender i hapur	11.06.2019	AKSHI	58,700,000
3	2021	I ri	Ngritja e sistemit per shkembimin e informacionitfinanciar me entitetet e huaja	Kontrate	sistem	46,950,000	Tender i hapur	28.12.2020	AKSHI	56,340,000
						<b>252,500,000</b>				<b>303,000,000</b>

## Aneksi nr.2:

Autorizimet e lëshuara nga DPT në mujat Prill dhe Nëntor 2021

Nr	Emri I tatimpaguesit	NIPTI	Nr. Autoriz	Data	Data Hyrjes	Nr.Prot	Dergimi	Data Dergimit
257	M.-2017	L.P	250	01.04.2021	2021-03-30	5971/2	Poste	2021-04-02
258	D. P. 2007	K.S	251	01.04.2021	2021-03-25	5742/2	Dorazi	2021-04-02
259	T.	K.M	252	01.04.2021	2021-03-23	5539/2	Dorazi	2021-04-01
260	T.	K.M	253	01.04.2021	2021-03-19	5483/2	Dorazi	2021-04-01
261	A.-P.	L.D	254	02.04.2021	2021-03-11	4563/2	Dorazi	2021-04-06
262	D.-05	K.B	255	07.04.2021	2021-02-24	3528/2	Dorazi	2021-04-13
263	XH.	K.I	256	07.04.2021	2021-02-23	3147/3	Poste	2021-04-07
264	A. S.	M.J	257	07.04.2021	2021-03-25	5720/2	Dorazi	2021-04-07
265	SH. H.	M.R	258	07.04.2021	2021-03-30	5968/2	Dorazi	2021-04-08
266	SH. H.	M.R	259	07.04.2021	2021-03-23	16410/5	Dorazi	2021-04-08
267	A. CO. & CO	K.A	260	07.04.2021	2021-03-18	5417/2	Dorazi	2021-04-07
268	E.	J.T	261	07.04.2021	2021-03-25	5745/2	Dorazi	2021-04-07
269	S.	J.Q	262	07.04.2021	2021-03-25	5748/2	Dorazi	2021-04-07
270	S.	J.Q	263	07.04.2021	2021-03-25	5747/2	Dorazi	2021-04-07
271	P.	L.C	264	07.04.2021	2021-03-26	5776/2	Poste	2021-04-07
272	A.-G.	J.D	265	09.04.2021	2021-03-23	5605/2	Poste	2021-04-09
273	L. K.	K.H	266	09.04.2021	2021-03-25	5706/2	Dorazi	2021-04-12
274	N. M.	K.M	267	12.04.2021	2021-03-17	5331/2	Poste	2021-04-12
275	A. M.	L.Q	268	12.04.2021	2021-03-17	5330/2	Poste	2021-04-12
276	XH.	K.I	269	12.04.2021	2021-03-23	5607/2	Poste	2021-04-12
278	S. A.	L.O	270	12.04.2021	2021-03-09	5481/2	Dorazi	2021-04-12
279	P.	J.A	271	13.04.2021	2021-03-31	6075/2	Dorazi	2021-04-13
280	A. B.	J.A	272	13.04.2021	2021-03-30	6002/2	Dorazi	2021-04-13
281	Sh. 18	L.D	273	13.04.2021	2021-04-08	6494/2	Poste	2021-04-14
282	E.V.	K.A	274	13.04.2021	2021-03-23	3974/4	Dorazi	2021-04-13
283	A.-B.	J.C	275	14.04.2021	2021-03-26	3945/4	Dorazi	2021-04-14
284	H.-T. D.	L.I	276	14.04.2021	2021-03-16	4999/2	Dorazi	2021-04-13
285	A.-I.	K.I	277	14.04.2021	2021-04-14	5792/2	Dorazi	2021-04-14
286	A..	K.L	278	15.04.2021	2021-03-31	6059/2	Dorazi	2021-04-15
287	S. & N.	M.P	279	15.04.2021	2021-04-13	6832/2	Dorazi	2021-04-16
288	N. C.	L.Q	280	15.04.2021	2021-03-16	4895/2	Dorazi	2021-04-16
289	N. C.	L.Q	281	15.04.2021	2021-04-02	6178/2	Dorazi	2021-04-16
290	B.-I.	K.A	282	15.04.2021	2021-04-12	6654/3	Dorazi	2021-04-15

291	B.-I.	K.A	283	15.04.2021	2021-03-29	5888/2	Dorazi	2021-04-15
292	B.-I.	K.A	284	15.04.2021	2021-03-25	5723/2	Dorazi	2021-04-15
293	B.	J.B	285	19.04.2021	2021-03-24	5645/2	Dorazi	2021-04-19
294	E.	J.T	286	19.04.2021	2021-02-19	3176/2	Dorazi	2021-04-19
295	E.	L.M	287	15.04.2021	2021-03-30	5952/2	Dorazi	2021-04-19
296	S. A.	L.Q	288	19.04.2021	2021-04-06	6349/2	Dorazi	2021-04-19
297	D.	L.D	289	19.04.2021	2021-04-06	6295/2	Poste	2021-04-20
298	E.	K.P	290	19.04.2021	2021-04-14	6864/2	Poste	2021-04-20
299	A.	J.N	291	20.04.2021	2021-03-26	5783/2	Dorazi	2021-05-04
300	A. K.	L.F	292	20.04.2021	2021-04-07	6399/2	Dorazi	2021-04-20
301	D.	J.I	293	20.04.2021	2021-04-14	6866/2	Poste	2021-04-20
302	D.	K.Ë	294	20.04.2021	2021-04-12	6677/2	Poste	2021-04-20
303	C.	J.S	295	20.04.2021	2021-04-12	6688/2	Dorazi	2021-04-20
304	U.	K.Q	296	20.04.2021	2021-04-20	7294/2	Poste	2021-04-20
305	G. C.	J.V	297	20.04.2021	2021-03-29	5938/2	Dorazi	2021-04-27
306	B. B. G.	M.A	298	23.04.2021	2021-04-07	4356/4	Dorazi	2021-04-22
307	S.T. K.	L.U	299	23.04.2021	2021-03-12	4729/2	Poste	2021-04-26
308	B.	L.F	300	23.04.2021	2021-03-16	5013/2	Dorazi	2021-05-04
309	I.	K.D	301	23.04.2021	2021-03-25	5719/2	Poste	2021-04-26
310	S. M.	L.M	302	23.04.2021	2021-04-02	6170/2	Poste	2021-04-26
311	U.	K.L	303	23.04.2021	2021-04-08	6440/2	Poste	2021-04-26
312	B.	J.B	306	23.04.2021	2021-04-08	6445/2	Poste	2021-04-26
313	M. K.	L.H	307	23.04.2021	2021-04-09	6616/2	Poste	2021-04-26
314	R.	J.E	308	23.04.2021	2021-04-09	6558/2	Poste	2021-04-26
315	M. B.	K.C	309	23.04.2021	2021-04-09	6628/2	Poste	2021-04-26
316	A. D.	L.M	310	23.04.2021	2021-04-13	6770/2	Dorazi	2021-04-26
317	A. Zh.	L.E	311	23.04.2021	2021-04-15	6970/2	Poste	2021-04-26
318	S. E. & C.	L.F	312	23.04.2021	2021-03-01	3843/2	Dorazi	2021-04-27
319	Gj. A. N.	L.T	313	23.04.2021	2021-04-02	6241/2	Poste	2021-04-26
320	A.	L.U	314	23.04.2021	2021-02-04	2133/2	Poste	2021-04-26
321	S. E. & C.	L.F	315	23.04.2021	2021-03-19	5440/2	Dorazi	2021-04-27
322	S.- R.	K.F	316	23.04.2021	2021-03-23	5592/2	Poste	2021-04-26
324	S.	K.A	317	23.04.2021	2021-04-15	7004/2	Dorazi	2021-04-27
325	A. J.	M.A	318	27.04.2021	2021-04-23	7565/2	Dorazi	2021-04-27
326	A. K. 07	L.F	319	27.04.2021	2021-04-07	6399/2	Dorazi	2021-04-20
327	E. K.	K.I	320	27.04.2021	2021-04-21	7398/2	Dorazi	2021-04-30
328	GJ.	J.H	320	27.04.2021	2021-04-21	7397/2	Dorazi	2021-04-30
329	T.	J.E	321	27.04.2021	2021-03-30	5966/2	Dorazi	2021-04-27
330	A. D.	L.M	322	27.04.2021	2021-03-29	5878/2	Poste	2021-05-10
331	N. C.	L.Q	323	27.04.2021	2021-04-19	7189/2	Dorazi	2021-05-04
332	R. C.	L.A	324	27.04.2021	2021-04-23	7566/2	Poste	2021-04-28
333	A..	L.M	326	27.04.2021	2021-04-22	7460/2	Dorazi	2021-04-27
334	L. C.	M.J	327	29.04.2021	2021-04-28	7722/2	Dorazi	2021-04-30
335	K.-P.	L.F	328	29.04.2021	2021-04-06	6285/2	Dorazi	2021-04-30
336	N.-G.	L.P	329	29.04.2021	2021-04-22	7449/2	Poste	2021-05-10
337	R.	K.Q	330	29.04.2021	2021-04-14	6922/2	Poste	2021-05-10
338	M. B.	K.C	331	29.04.2021	2021-03-16	4981/2	Dorazi	2021-04-30
339	B.	K.H	332	27.11.2021	2021-04-08	6445/2	Poste	2021-04-26
340	M.	J.S	332	29.04.2021	2021-04-16	7090/2	Dorazi	2021-04-30
341	XH.	K.I	333	29.04.2021	2021-03-29	5889/2	Poste	2021-05-10
342	E.	J.U	334	29.04.2021	2021-04-13	6778/3	Dorazi	2021-04-30
343	E. G.	L.C	335	29.04.2021	2021-04-19	7243/2	Dorazi	2021-04-30
344	SH. H.	M.R	336	29.04.2021	2021-04-26	7576/2	Dorazi	2021-04-30
345	E.	J.U	337	29.04.2021	2021-04-13	6779/4	Dorazi	2021-04-30
346	S.	J.U	338	30.04.2021	2021-03-12	4474/2	Dorazi	2021-05-04
347	C. G.	L.M	339	30.04.2021	2021-04-20	7270/2	Dorazi	2021-04-30
348	I.	L.B	340	30.04.2021	2021-04-09	6588/2	Poste	2021-04-30
349	G.	K.N	341	30.04.2021	2021-03-12	4801/2	Poste	2021-04-30
350	I.	J.L	342	30.04.2021	2021-04-02	6229/2	Dorazi	2021-04-30
351	S.	J.U	343	30.04.2021	2021-04-07	6400/2	Dorazi	2021-05-04
277	P. G.	L.L	270	24.11.2021	2021-11-16	22052/2	Poste	2021-11-24
323	P. G.	M.C	316	23.4.2021	2021-04-14	6917/2	Poste	2021-04-23
990	I.	K.M	970	04.11.2021	2021-08-23	15527/6	Dorazi	2021-11-23
991	A. G.	J.N	971	04.11.2021	2021-10-18	17010/4	Poste	2021-11-04
992	P.	J.A	972	04.11.2021	2021-10-01	17698/2	Poste	2021-11-04
993	S. C.	M.O	973	04.11.2021	2021-10-06	17928/2	Poste	2021-11-04
994	A. Xh.	L.P	974	04.11.2021	2021-10-06	17962/2	Poste	2021-11-04

995	S. C.	M.M	975	04.11.2021	2021-10-06	17963/2	Dorazi	2021-11-04
996	A.	L.E	976	04.11.2021	2021-10-06	17964/2	Poste	2021-11-04
997	A.	K..J	977	04.11.2021	2021-10-06	17965/2	Poste	2021-11-04
998	Sh. A.	K.N	978	04.11.2021	2021-10-06	17974/2	Poste	2021-11-04
999	R. G.	L.A	979	04.11.2021	2021-10-07	18039/2	Poste	2021-11-04
1000	L. K.	K.H	980	04.11.2021	2021-10-07	18043/2	Poste	2021-11-04
1001	D.	L.D	981	04.11.2021	2021-10-08	18180/2	Poste	2021-11-04
1002	A. ZH.	L.E	982	04.11.2021	2021-10-11	18266/2	Poste	2021-11-04
1003	P. N. PF	K..D	983	04.11.2021	2021-10-13	18430/2	Poste	2021-11-04
1004	G. K.	K.F	984	04.11.2021	2021-10-18	18729/2	Dorazi	2021-11-04
1005	P. T.	L.T	985	04.11.2021	2021-10-19	18899/2	Poste	2021-11-04
1006	B.	K.H	986	04.11.2021	2021-10-21	19179/4	Poste	2021-11-04
1007	G. K.	K.F	987	04.11.2021	2021-10-25	19417/2	Dorazi	2021-11-04
1008	V.	L.A	988	04.11.2021	2021-10-25	19418/2	Dorazi	2021-11-04
1009	U.	J.O	989	04.11.2021	2021-10-27	19538/2	Poste	2021-11-04
1010	E. V.	K.A	990	04.11.2021	2021-10-07	18079/2	Poste	2021-11-04
1011	E.-A.	K.H	991	04.11.2021	2021-10-12	18334/2	Poste	2021-11-04
1012	A.	L.A	992	04.11.2021	2021-10-21	19121/2	Poste	2021-11-04
1013	A. M.	L.Q	993	04.11.2021	2021-10-18	18765/2	Poste	2021-11-04
1014	N. S.	L.O	994	04.11.2021	2021-10-18	18766/2	Poste	2021-11-04
1015	E. C.	K.K	995	09.11.2021	2021-09-02	19721/2	Poste	2021-11-10
1016	D.	K.Ě	996	09.11.2021	2021-10-28	19651/2	Poste	2021-11-10
1017	R.	K.A	997	09.11.2021	2021-10-28	19634/2	Poste	2021-11-10
1018	D.	L.D	998	09.11.2021	2021-10-28	19571/2	Poste	2021-11-10
1019	P. Q. PF	L.A	999	09.11.2021	2021-10-28	19574/2	Poste	2021-11-10
1020	M.-P.	J.D	1000	09.11.2021	2021-10-27	19567/2	Poste	2021-11-10
1021	E. C.	M.M	1001	09.11.2021	2021-10-28	19650/2	Poste	2021-11-10
1022	S.	K.J	1002	09.11.2021	2021-09-16	16804/4	Poste	2021-11-09
1023	V.	L.A	1003	09.11.2021	2021-10-28	19573/2	Dorazi	2021-11-11
1024	A. S. C.	K.O	1004	11.11.2021	2021-11-01	19801/2	Poste	2021-11-11
1025	A. & T..	L.T	1005	11.11.2021	2021-11-04	19967/2	Dorazi	2021-11-11
1026	I. G.	K.H	1006	11.11.2021	2021-11-04	19941/2	Poste	2021-11-11
1027	B. C.	J.O	1007	11.11.2021	2021-11-01	19807/2	Poste	2021-11-11
1028	D. H.	M.P	1008	11.11.2021	2021-11-01	19802/2	Poste	2021-11-11
1029	B.	K.H	1009	11.11.2021	2021-10-27	19552/2	Poste	2021-11-11
1030	E.L. PF	M.I	1010	11.11.2021	2021-10-29	19717/2	Dorazi	2021-11-11
1031	L.SH.	M.S	1011	16.11.2021	2021-11-05	19984/2	Dorazi	2021-11-16
1032	M.	L.K	1012	16.11.2021	2021-11-01	19781/2	Poste	2021-11-16
1033	A. B.	J.A	1013	16.11.2021	2021-11-01	19759/2	Poste	2021-11-16
1034	A. S.	L.F	1014	16.11.2021	2021-11-01	17954/4	Poste	2021-11-16
1035	B.	K.H	1015	16.11.2021	2021-11-01	19800/2	Poste	2021-11-16
1036	B.	K.H	1016	16.11.2021	2021-11-03	19897/2	Poste	2021-11-16
1037	D.	K.B	1017	16.11.2021	2021-11-01	19796/2	Poste	2021-11-16
1038	A. C.	K.O	1018	16.11.2021	2021-11-02	19834/2	Poste	2021-11-16
1039	R.	K.Q	1019	16.11.2021	2021-11-03	19903/2	Poste	2021-11-16
1040	M. T.	L.B	1020	16.11.2021	2021-11-02	19830/2	Poste	2021-11-16
1041	U. H. PF	M.Q	1021	16.11.2021	2021-11-02	19829/2	Dorazi	2021-11-16
1042	E.	K.L	1022	18.11.2021	2021-11-08	20143/2	Poste	2021-11-18
1043	P. G.	L.L	1023	18.11.2021	2021-11-03	19904/2	Poste	2021-11-18
1044	D.	K.Ě	1024	18.11.2021	2021-11-04	19963/2	Poste	2021-11-19
1045	D.	K.Ě	1025	18.11.2021	2021-11-04	19962/2	Poste	2021-11-19
1046	G. C.	L.O	1026	18.11.2021	2021-11-03	16576/4	Poste	2021-11-19
1047	E.M.PF	L.V	1027	26.11.2021	2021-11-11	20394/2	Dorazi	2021-11-26



**Aneksi nr. 4“Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.”**

*Në lekë*

<b>Drejtoritë Rajonale</b>	<b>A-M të lidhura</b>	<b>Subjekt. që lidhin A-M</b>	<b>Vlera Totale e debisë për të cilën është lidhur A-M</b>	<b>Pagesa në momentin e lidhjes A-M (vlera fillestare e pag.)</b>	<b>Vlera e paguar gjatë muajit nga A-M e mbartura</b>	<b>A-M të anuluar</b>
Berat	9	9	4,118,727	1,532,096	3,007,820	3
Dibër	10	10	17,775,449	4,679,158	8,540,357	5
Durrës	79	79	165,243,754	98,933,008	62,823,726	23
Elbasan	54	54	55,086,205	19,249,272	17,700,463	12
Fier	38	38	57,605,677	11,964,604	42,308,788	12
Gjirokastrë	6	6	17,999,791	5,870,115	2,992,718	6
Korçë	33	33	25,229,038	6,069,034	15,912,200	17
Kukës	12	12	21,120,522	11,051,551	6,176,621	5
Lezhe	9	9	41,593,692	10,224,205	28,859,325	2
Sarandë	29	29	29,802,573	8,347,813	7,070,824	12
Shkodër	19	19	16,944,027	4,944,192	13,001,893	6
Tiranë	112	112	345,728,506	143,027,929	190,783,113	23
VIP/NJTM	19	19	308,314,555	78,388,975	125,885,973	3
Vlorë	43	43	44,890,249	13,096,177	19,926,278	13
<b>Total</b>	<b>472</b>	<b>472</b>	<b>1,151,452,765</b>	<b>417,378,129</b>	<b>544,990,099</b>	<b>142</b>

*Burimi: DPT*

**Për sa më lart paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**